BANKA E SHQIPËRISË

ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË NJË DEKADE

Vëllimi I

P e r i u d h a

1 9 9 8 - 2 0 0 0

Dhjetor 2007

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Të nderuar lexues,

Buletini Ekonomik i Bankës së Shqipërisë ka 10 vjet që botohet, për një auditor profesionistësh, si në fushën e biznesit, në atë të bankingut, për akademikët dhe për publikun e thjeshtë. Në përmbajtjen e tij, më të shumtën e rasteve kanë zënë vend artikuj, vrojtime dhe analiza të ndryshme të punonjësve të Bankës. Nisur nga dëshira e mirë që këto punime të mund të përdoren apo të gjenden lehtësisht edhe pas një periudhe relativisht të gjatë kohore, nga botimi i parë zyrtar, menduam të publikojmë këtë përmbledhje të tyre në një format të vetëm.

Duam me këtë rast, të tërheqim vëmendjen tuaj, që këto punime, përveç faktit që shprehin opinione dhe përfundime të autorëve, duhen parë edhe të vendosura në kuadrin kohor kur janë shkruar, të lidhura me ngjarjet të cilave u referohen apo me fenomenet që marrin në shqyrtim.

PËRMBAJTJA

1998

Ekonomia botërore, 1998 – Krizat aziatike dhe ruse 9
Selami Xhepa

Deficiti korent në periudhën 1992-1997. A përbën ai problem? 25
Gramoz Kolasi
Altin Tanku

Kushtetuta dhe Banka e Shqipërisë 73
Teuta Baleta

1999

Kreditimi i ekonomisë gjatë vitit '98 dhe parashikimi për vitin '99 77
Fiqiri Baholli
Edlira Abazi

Roli i incentivave fiskale në nxitjen e biznesit privat 87
Selami Xhepa

Opinione nga zhvillimet në sektorin e jashtëm, 1992-1998 97
Altin Tanku
Evis Ruçi

Shkurtimisht sistemi bankar shqiptar më 1998 111
Teuta Baleta

Mbikëqyrja bankare dhe raporti standard i ekzaminimit *139*
Arian Kraja

Strategjia e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm - një dokument i rëndësishëm për Bankën dhe politikën ekonomike në Shqipëri *155*
Marta Muço

Kufiri i kreditit *165*
Fiqiri Baholli

2000

Ekonomia botërore në dekadën e fundit të shekullit *177*
Selami Xhepa

Zhvillimi i korridoreve të transportit në Evropën Qendrore e Lindore dhe në Ballkan *195*
Selami Xhepa

Bujqësia shqiptare në periudhën e tranzicionit *217*
Luljeta File

Shkurtimisht sistemi bankar shqiptar për vitin 1999 *235*
Miranda Ramaj
Vjollca Berberi

Oferta publike fillestare (IPO) *253*
Elvin Meka
Brizejda Kreshpa

Kosto e ndërmjetësimit për vitin 1999 *267*
Suzana Kodra

Rritja e transparencës në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë *281*
Teuta Baleta
Neritan Kallfa
Adriana Meko

Regjimet e politikës monetare dhe prirja e Bankës së Shqipërisë *295*
Gramoz Kolasi

1998

Ekonomia botërore, 1998 - Krizat aziatike dhe ruse
Selami Xhepa
Shtator 1998

Deficiti korent në periudhën 1992-1997. A përbën ai problem?
Gramoz Kolasi
Altin Tanku
Dhjetor 1998

Kushtetuta dhe Banka e Shqipërisë
Teuta Baleta
Dhjetor 1998

EKONOMIA BOTËRORE, 1998 – KRIZAT AZIATIKE DHE RUSE

*Selami Xhepa**

Fjalë kyçe
- Kriza - Kriza aziatike - Kriza ruse -

Fillimi i vitit 1998 i dha ekonomisë botërore pamjen e një aeroplani katërmotorësh, me dy motorë të prishur dhe me të tretin në prag të prishjes: aeroplani duket sikur po gremiset.

Ekonomia botërore po shkon drejt rënies[1]: Japonia, që prej fillimit të viteve '90 vazhdon të jetë në rënie; shumë ekonomi aziatike po përjetojnë rënien ekonomike më të thellë që prej gjysmë shekulli; ekonomia ruse, gjithashtu, është përfshirë në një nga krizat më të thella që nga shembja e komunizmit; një rënie e ekonomisë së Kinës, mund ta detyronte qeverinë të zhvlerësonte monedhën; ndoshta Amerika Latine do të jetë rajoni tjetër që do të goditet: Wall Street është i shqetësuar[2].

Shumë analistë parashikojnë që rritja e PPB-së botërore gjatë këtij viti të jetë më pak se 2 për qind[3]. Kjo do të ishte e njëjtë me nivelet e shënuara gjatë viteve 1991, 1982 dhe 1975, të treja të përcaktuara si periudha "të rënies globale". Por, nëse në rastet e mëparshme kjo rënie erdhi nga SHBA dhe vendet e pasura, tani është rradha e ekonomive në zhvillim.

Nëse rënia do të prekte edhe SHBA dhe Evropën, bota do të përjetonte krizën më të madhe që nga depresioni i viteve 1930.

Vendet në zhvillim tani llogariten të mbajnë gati gjysmën e prodhimit botëror. Megjithatë, ajo që mund të ndodhë në SHBA, e cila kontribuon në 1/5 e prodhimit botëror, mbetet kritike.

KRIZA AZIATIKE – SHKAQET E SAJ

Pas gati 30 vjetësh të mrekullisë ekonomike, viti që kaloi shënoi krizën më të thellë për të gjitha vendet e Azisë Juglindore (veçanërisht të ASEAN-4). Duke u mbështetur në komentet dhe analizat e bëra tashmë rreth shkaqeve të kësaj krize, më poshtë po evidentojmë disa prej tyre:

1. Pjesërisht për shkak të kurseve fikse të këmbimit të adoptuara nga këto vende dhe nga hyrjet e mëdha të kapitaleve të huaja, veçanërisht flukset afatshkurtra, monedhat e këtyre vendeve, që nga fillimi i viteve '90 u vlerësuan mjaft në terma realë. Kjo e përkeqësoi ndjeshëm situatën e pozicioneve të deficiteve të llogarive korente.
2. Disbalancat e llogarive korente dhe rritja e borxhit të huaj afatshkurtër, erdhën gjithashtu, edhe nga një "bum" i investimeve (dhe i konsumit), të cilat shpesh u drejtuan në sektorë të gabuar: mallra jo të tregtueshëm, prona të patundshme dhe blerje të letrave me vlerë për qëllime spekulative.
3. "Dëmi Moral" (*Moral Hazard*) i shkaktuar nga qeveritë. Duke dhënë garanci qeveritare për bankat tregtare, këto të fundit morën kredi të shumta nga jashtë dhe krediituan biznese që ishin me një shkallë mjaft të lartë rreziku. Dështimi i mjaft projekteve të tilla, i gjeti firmat me borxhe të mëdha afatshkurtra, kryesisht në monedhë të huaj, që nuk mund të shlyheshin. Kriza e kurseve të këmbimit i rriti përmasat e këtij fenomeni, duke qenë se zhvlerësimet drastike të monedhave e rritën barrën reale të borxheve në monedhë të huaj.
4. Një pjesë e konsiderueshme e kreditimeve nuk shkoi në financimin e projekteve të reja, por më tepër të kërkesës spekulative të letrave me vlerë ekzistuese. Kjo i rriti ndjeshëm çmimet në tregjet e kapitaleve dhe kur kjo rritje erdhi në

pikën e saj të shpërthimit, firmat, bankat dhe investitorët që kishin marrë kredi, trashëguan një borxh të jashtëm që nuk mund të shlyhej. Përsëri, kolapsi i monedhave e rëndoi këtë problem.

Megjithëse kriza nuk filloi njëherësh, ajo arriti të përhapej gradualisht duke prekur gjithë grupin e vendeve të këtij rajoni. Përhapja e krizës shpjegohet nga analistët mbi këto konsiderata:

Zhvlerësimi i monedhës në disa vende, i vlerësoi monedhat e vendeve të tjera të rajonit në terma realë, duke përkeqësuar pozitat konkurruese të tyre. Për këtë arsye, edhe ato filluan zhvlerësimin e monedhave.

Faktorë të tjerë që ndikuan në dobësimin e pozitave konkurruese të rajonit ishin edhe:

- Zhvlerësimi nominal prej 50 për qind i monedhës kineze në vitin 1994.
- Vlerësimi i shpejtë i dollarit pas vitit 1995, çoi në një vlerësim të monedhave aziatike, të cilat janë të lidhura me dollarin.
- Vitet 1995-96, shënuan një rënie të kërkesës botërore për gjysmëpërcjellës, një produkt i rëndësishëm ky i eksporteve të këtij rajoni.
- Dobësimi i vazhdueshëm i ekonomisë japoneze, kontribuoi në uljen e eksporteve të rajonit (gati 30 për qind e eksporteve të tyre destinohen në Japoni).
- Rënia e prodhimit industrial në vitin 1997 kundrejt viteve të mëparshme.

Në përgjigje të problemeve të krijuara, këto vende filluan të reagojnë me masa në zgjidhje të tyre. Disa prej tyre iu drejtuan edhe FMN për ndihmë financiare. Vetë Qeveria Japoneze, pas krijimit të kabinetit të ri qeveritar, adoptoi një paketë masash fiskale (që llogariten në 2.5 për qind të PPB-së), të cilat do të ndihmojnë procesin e ristrukturimit të korporatave dhe bankave. Ky proces ristrukturimi ka përfshirë edhe firmat e vendeve të

tjera, si Hong Kong, Tajvan etj.. Më në fund, Azia Inc. duket si një dështim i politikave ekonomike[4] të adoptuara dhe fundi i një miti 30-vjeçar.

Përkundrejt përpjekjeve edhe të komunitetit ndërkombëtar në kapërcimin e kësaj krize, një tjetër vend iu shtua listës së krizave, Rusia.

KRIZA RUSE: SHKAQET DHE TIPARET E SAJ

Stabiliteti dhe konvertibiliteti i rublës; mbajta nën kontroll e inflacionit; progresi i shënuar në reformat strukturore të ekonomisë; dhe mbi të gjitha përkrahja e gjithanshme që iu dha Rusisë, në shndërrimin e ekonomisë së saj drejt ekonomisë së tregut nga të gjitha organizmat financiarë ndërkombëtarë dhe qeveritë e vendeve të Triadës (SHBA, Evropë dhe Japoni), e rritën ndjeshëm besimin e investitorëve të huaj në këtë treg gjigant dhe me mundësi investimi të konsiderueshme.

Pas krizës që përjetoi ky vend gjatë vitit 1992, kriza e shembjes së komunizmit, aktualisht vendi po përjeton një nga krizat më të thella dhe të fuqishme, fillimisht e shfaqur si një krizë financiare, por pasojat e saj ndoshta do të jenë më të mëdha. Ky konkluzion përforcohet ndjeshëm duke analizuar vetë faktorët që çuan në këtë krizë.

SHKAQET E KRIZËS

1-Ajo çfarë shkaktoi fillimin e krizës ruse mendohet të jetë fakti që Kremlini nuk guxoi të marrë masat e nevojshme për të ndaluar hemorragjinë nga e cila po vuante buxheti i shtetit. Ndërkohë që, grumbullimi i taksave gjatë muajit janar u duk mjaft impresiv, duke shënuar një nivel 35 për qind më të lartë (23.5 për qind në terma realë), në muajt pasardhës ky ritëm ra ndjeshëm. Një rënie e këtij treguesi, nën konsideratën që shumica e firmave të mëdha i paguajnë taksat që në fillim të vitit në bazë vjetore (sistemi i taksave është ndërtuar mbi një bazë të ngushtë,

i mbështetur kryesisht tek 100 taksapaguesit më të mëdhenj), përbënte dhe sinjalin e parë për një dobësim të ndjeshëm të financave të shtetit. Vlerësohet se taksat e pagrumbulluara (të fshehura) arrijnë në rreth 20 miliardë dollarë amerikanë, shifër kjo e barabartë me 4.3 për qind të PPB-së ose gati 50 për qind të të ardhurave të buxhetit të shtetit. Nga ana tjetër, këto dobësi në grumbullimin e të ardhurave, nuk u shoqëruan me një harmonizim dhe kontroll mbi shpenzimet. Kjo u arrit për herë të parë vetëm gjatë vizitës së fundit të FMN (maji '98).

Për këtë arsye, në planin politik, në mars, Jelcin shkarkon nga detyra kryeministrin Çërnomerdin dhe emëron 35 vjeçarin, Kirienko.

2-Një fakt i rëndësishëm konsiderohet rënia e çmimeve të naftës në tregun botëror nën 15 dollarë amerikanë/barrelë, çmimi më i ulët që prej 4 vjetësh. Kompanitë e naftës përbëjnë kontribuesit kryesorë në të ardhurat e buxhetit të vendit. Ky ndryshim në koniukturën ndërkombëtare gjeneroi humbje të konsiderueshme për buxhetin e vendit, të vlerësuara me gati 5 miliardë rubla (FMN qershor 1992). Gjithashtu, ka kontribuar edhe falja e detyrimeve fiskale kompanisë së gazit, Gazprom, e cila llogaritet në gati 2-3 për qind të PPB-së (vlerësim i Bankës Botërore). Por rënia e çmimeve si rrjedhojë e rënies së kërkesës së vendeve të ndikuara nga kriza aziatike, ishte njëkohësisht një dukuri që përfshiu edhe lëndët e para industriale, ku Rusia është një eksportuese e fuqishme. (Indeksi i çmimit të mallrave ka rënë në nivelin më të ulët historik të tij që prej 21 vjetësh.)

3-Një analizë e mëtejshme e shkaqeve të krizës ndalet edhe në dështimin e reformave dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore. Duke mos injektuar investime të reja, ndërmarrjet shtetërore u mbajtën në këmbë duke u lejuar nga qeveria të përdorin transaksionet *barter* në pagesat e shërbimeve të tyre, si energji, gaz, ujë, etj.. Reformimi i ndërmarrjeve do të kërkonte shkurtime të ndjeshme të fuqisë punëtore. Por, të ndodhur përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare (1999) është e vështirë të parashikohet nëse politikanët do të rrezikonin me adoptimin e masave të tilla. Ndërkohë, injektimi i kapitalit të

freskët do të ishte i mundur vetëm duke prerë rubël të re, gjë që do të çonte në hiperinflacion. Kjo do të ishte me po aq pasoja të rrezikshme, duke konsideruar që gati 80 për qind e prodhimeve ushqimore në tregun e Moskës janë me origjinë importi. Por, reformimi i ndërmarrjeve shtetërore shihet me skepticizëm edhe nga pozitat e oligarkisë sunduese ruse, "e cila është tashmë e mësuar me korrupsion dhe keqpërdorim të pasurive të ndërmarrjeve shtetërore. Kapitalizmi rus krijoi një ekonomi të mbyllur ku një rreth i ngushtë bankierësh, politikanësh dhe biznesmenësh i përdorën pasuritë e vendit për të fryrë xhepat e tyre. Kjo ka çuar në atë që quhet "dëmi moral" (*moral hazard*). Deri sa të thyhet kjo oligarki, ekonomia ruse nuk do të jetë e aftë të rritet".

IMPLIKIMET E KRIZËS

1-Për të ruajtur stabilitetin e rublës dhe për të penguar largimin e investitorëve të huaj, Banka Qendrore Ruse, në muajin maj, filloi përdorimin e rezervave valutore, duke shpresuar në rezultatin pozitiv të negociatave me FMN-në, për akordimin e 22.6 miliardë dollarëve amerikanë, që do t'i siguronin Rusisë stabilitetin e reformave dhe rishëndoshjen e rezervave. Por, deri tani janë lëvruar vetëm 5.8 miliardë, efekti kryesor i të cilëve është rritja e rezervave valutore në 18 miliardë dollarë amerikanë, ekuivalente vetëm me tre muaj importe.

2-Në këto kushte, një zhvlerësim i rublës ishte ndoshta i pashmangshëm. Shkëndija e saj shihet që të ketë si pikënisje deklaratën e kryefinancierit të njohur botëror, George Soros, sipas të cilës kishte ardhur koha që rubla të zhvlerësohej. Në 17 gusht, Qeveria deklaroi zhvlerësimin efektiv të rublës me 34 për qind dhe për të përballuar vështirësitë e brendshme, shpalli moratoriumin për shtyrjen e pagesës së borxhit të jashtëm (prej 40 miliardë dollarësh amerikanë) për një periudhë prej 90 ditësh. Lejimi i zhvlerësimit të rublës (që arriti deri në 50 për qind), kufizimi i pagesave të llogarive korente dhe shtyrja e pagesës së borxhit të jashtëm afatshkurtër, e tronditën drejtimin e ekonomisë duke hedhur dyshime për rifutjen e saj në rrugën

normale të reformave. Ndërkohë, vështirësitë filluan të shfaqen në sistemin bankar.

3-Përsëri Soros, në letrën e hapur drejtuar Qeverisë Ruse dhe botuar në "*Financial Times*" deklaroi se ''është koha që bankat ruse të paguajnë për dështimin e ekonomisë së tyre". Rreziku më i madh dhe më imediat shihet në përhapjen e panikut tek 1600 bankat ruse të cilat, nga riskedulimi i pasurive të tyre kryesore që janë letrat e borxhit afatshkurtër të qeverisë, janë thuajse të falimentuara. Nga riskedulimi i borxhit, vlerësohet se investitorët do të jenë në gjendje të marrin vetëm 15-30 për qind të vlerës nominale të bonove të thesarit të qeverisë. Ndërkohë, humbjet e parashikuara si pasojë e moratoriumit (në miliardë dollarë amerikanë) janë:

- kreditë e përbashkëta të bankave perëndimore 0.25;
- kontratat repo 2.4;
- kontratat me afat 4050.

U vlerësua se qindra banka të vogla rrezikonin falimentimin në javët në vazhdim, ndërkohë që shtatë bankat më të mëdha ruse u përfshinë në një proces bashkimi.

MASAT E MARRA

1-Për mbrojtjen e kursimeve të popullatës, Banka Qendrore Ruse deklaroi me 20 gusht, se ajo do të garantojë gjithë depozituesit individualë për depozitat e tyre (megjithëse nuk ka ndonjë ligj të posaçëm). Por, kjo shihet si mjet shpëtimi vetëm për Sberbank, e cila mban gati 80 për qind të kursimeve të popullatës. Ndërsa situata për bankat e tjera është krejt e ndryshme. Duke qenë se i vetmi aktivitet i tyre është spekulimi në tregun monetar dhe të letrave me vlerë, falimentimi tyre nuk do të përbënte befasi.

Më 23 gusht, përsëri shkarkohet Kirienko dhe riemërohet Çërnomerdin në krye të qeverisë (propozim i cili për herë të dytë u kundërshtua nga Duma, dhoma e ulët e parlamentit).

2-Për rivendosjen e situatës, autoritetet qeveritare kanë vendosur kufizime për nivelin e tërheqjeve të depozitave nga bankat. Gjithashtu, bankat janë lejuar të përdorin rezervat e tyre të depozituara në Bankën Qendrore. Përqindja e mbajtjes së rezervave të detyruara në bankën qendrore është ulur nga 11 për qind në 10 për qind, që konvertohet me rreth 1.2 miliardë dollarë amerikanë, të cilat mund të përdoren nga bankat. Po kështu, janë rritur huatë pa afat në 8 miliardë rubla, nga 1 miliard që ishin një javë para krizës.

3-Instrumenti i fundit i mbrojtjes shihet tek përdorimi i rezervave valutore të Bankës Qendrore, megjithëse, më 26 gusht Banka Qendrore Ruse shpalli se nuk do të vazhdojë të mbrojë rublën.

Megjithatë, edhe nëse shteti do të arrijë të shpëtojë sistemin bankar nga kjo krizë (ekziston mendimi i përgjithshëm se shteti mund të ofrojë shansin e vetëm për mbijetesën e bankave), perspektivat e bankave ruse duken të zymta. Renditja e tyre për kredidhënie nga Moody's dhe S&P, ka shënuar rënie.

HUMBJET E INVESTITORËVE TË HUAJ DHE NDIKIMI NË TREGJET E KAPITALEVE

Megjithëse një trajtim diskriminues i investitorëve të huaj u shmang në sajë të presionit të FMN-së, për moslëvrimin e transhit të dytë të kredisë, përsëri humbjet e investitorëve të huaj vlerësohen të arrijnë në rreth 33 miliardë dollarë[5] amerikanë. Indeksi i Moskës ra me 80 për qind që nga fillimi i vitit, ndërkohë që vlerësohet se dalja e kapitaleve jashtë vendit vetëm për periudhën 1 maj - mes i gushtit, të jetë rreth 3.5 - 4 miliardë dollarë. Credit Swiss, e para që krijoi tregun e letrave me vlerë të pronësisë në Rusi, vlerësohet të ketë humbur rreth 254 milionë dollarë dhe aksionet e saj ranë me 25 për qind (kundrejt nivelit më të lartë të këtij viti). Në po të njëjtën masë, vlerësohet edhe rënia e aksioneve të bankave gjermane. Soros deklaron të ketë humbur rreth 2 miliardë dollarë. Ekspozimi ndaj rrezikut paraqitet mjaft i lartë për disa nga lojtarët kryesorë të tregut rus, si Salomon Smith Barney (me 2 miliardë dollarë), Chase

Manhattan Co (me 0,5 miliardë dollarë) dhe Bank America (me 412 milionë dollarë).

Megjithëse shumë analistë e konsiderojnë krizën ruse si një çështje të brendshme të sistemit financiar rus, ajo ka shkaktuar luhatje në tregjet botërore të Triadës. Kështu, indeksi Dow Jones ra me 4.2 për qind; Nikkei me 4 për qind; DAX me 3.3 për qind; FTSE-100 me 3.2 për qind; investimet afatgjata më të sigurta në bonot e thesarit 30-vjeçare të Qeverisë Amerikane arritën në nivelin më të ulët të *yield*-it prej 5.34 për qind; indeksi i Torontos ra me 8 për qind (gusht 1998). Kanadaja dhe Australia po rrisin ndjeshëm normat e interesit për të rritur besimin në monedhat e tyre. Investitorët po largohen nga tregjet e letrave me vlerë të pronësisë.

E ARDHMJA – PAQARTËSI DHE PESIMIZËM

Ndërkohë, riemërimi i Çërnomerdin në krye të qeverisë u pa me hezitim nga Perëndimi dhe Amerika. Pritej që masat që mund të adoptoheshin prej tij të përfshinin kufizime në daljen e kapitaleve jashtë si dhe kontroll mbi çmimet. "Me masa monetariste ne nuk mund ta nxjerrim vendin nga kriza", - deklaroi ai, ditën e emërimit. Tensionimi i situatës politike ka arritur shkallën më të lartë, siç është shprehur Zhuganov, që nga Lufta e Dytë Botërore. Më 10 shtator Jelcin emëroi ish- Ministrin e Jashtëm, Primakov në postin e Kryeministrit, i pranuar tashmë edhe nga Duma.

Primakov konsiderohet nga analistët si njeri i pavarur dhe energjik, një figurë me reputacion brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare, megjithë hezitimet e hershme për qëndrimet e tij konservatore rreth marrëdhënieve me SHBA. Deri tani, vetëm mund të shpresohet se aftësitë e tij diplomatike do të jenë në gjendje të rihapin negociatat me Bankën Botërore dhe FMN, për nxjerrjen e vendit nga kriza. Megjithatë, vendi ndodhet përballë kërcënimit të një periudhe superinflacioni. Sipas një vëzhgimi të Interfax, çmimet e mallrave të prodhimit të brendshëm janë rritur me gati 20 për qind, ndërsa ato të importit me 80 për qind. Çmimet e transportit në metro u rritën me 50 për qind.

- Pagesat e pagave të punonjësve, pensioneve dhe borxhet e mëdha (pagat e prapambetura të firmave në 10 sektorë të ekonomisë, llogariten në 70 miliardë rubla (1 korrik 1998).
- Arkat e bankave thuajse të boshatisura (më 21 shtator, Banka Qendrore preu 1 miliard rubla të reja për të furnizuar bankat me kredi afatshkurtra).
- Ulja e aftësisë së vendit për të prodhuar valutë.
- Varësia e gjerë e ekonomisë nga furnizimet jashtë vendit (gati 60 për qind e tregut rus shërbehet nga mallra importi) e bëjnë situatën shumë kritike.

Problem kritik konsiderohet edhe shpërthimi i burokracisë (gjatë gjithë kohës që Çërnomerdin ishte kryeministër i vendit). Me gati gjysmën e popullsisë së ish-Bashkimit Sovjetik, Rusia ka më shumë burokratë të punësuar se gjithë ish-republikat e saj.

Megjithëse në 24 shtator, Primakov shpalli programin antikrizë të kabinetit të tij qeveritar, nuk doli qartë se nga do të vijnë paratë për realizimin e këtij programi.

Është për këto arsye që kriza ruse ka krijuar shqetësim në shkallë globale. Në Washington janë përhapur edhe pëshpërima "për një kërcënim nga uria bërthamore". Shqetësimi global konsiderohet si më i fuqishmi, që nga fundi i luftës së ftohtë. Protestat popullore janë forcuar. Jelcin ka intensifikuar takimet e tij me shefat ushtarakë dhe të sigurimit për t'u azhornuar me gjendjen e situatës politike dhe të sigurisë së vendit.

Pesimizmi i investitorëve perëndimorë për shkak të krizave ruse dhe aziatike ka ngjallur një ndjenjë se ndoshta kriza mund të pasohet edhe në Amerikën Latine, vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Afrikën e Jugut.

AMERIKA LATINE DO TË JETË RAJONI TJETËR?

Vala e zhvlerësimit të rublës dhe problemet e borxhit të jashtëm të Rusisë, bënë që shqetësimi i investitorëve të zhvendosej

gradualisht drejt Amerikës Latine, një rajon ky që historikisht ballafaqohet me të dyja këto probleme.

Shqetësimi i tyre u reflektua menjëherë në tregjet e këtij rajoni, ku aksionet e tyre aktualisht (gusht) kanë humbur 25-30 për qind të vlerës.

Në përgjigje të goditjeve që po merrte ekonomia e rajonit nga kriza aziatike, autoritetet rritën menjëherë normat e interesave dhe filluan zbatimin e kufizimeve buxhetore.

Megjithëse akoma shenja të dukshme të krizës nuk janë shfaqur, ekonomitë e rajonit po përballohen me probleme themelore ekonomike. Kështu, problem themelor vazhdon të mbetet ecuria e dobët e eksporteve. Ato dominohen nga bakri dhe nafta, çmimet e të cilave mendohet të vazhdojnë të dobësohen. Eksportet e mallrave industrialë janë goditur nga forcimi i dollarit, me të cilin janë të lidhura shumica e vendeve të rajonit. Po kështu, kufizimet e politikave monetare të adoptuara në kuadrin e mbajtjes nën kontroll të monedhave dhe deficiteve mund të çojnë në dy probleme strukturore:

a) Financat publike janë përkeqësuar për shkak të mosshkurtimit të shpenzimeve buxhetore dhe normave të larta të interesave, duke rritur kështu edhe pagesat e borxheve të jashtme.
b) Ruajtja e monedhave të forta për të mbajtur në nivele të ulëta inflacionin, po godet rritjen ekonomike të rajonit.

Nga ana tjetër, ekonomia e rajonit është mjaft e lidhur me ekonominë amerikane, për të cilën pritet një rënie gjatë vitit të ardhshëm. Kjo i ka çuar analistët në parashikimin e një rritjeje më të ulët ekonomike të vendeve të Amerikës Latine, e cila pritet në nivelet 1.5 - 2.5 për qind (nga 2.8 për qind të parashikuar nga FMN).

Mbi të gjitha, influencë të konsiderueshme pritet të kenë mesazhet e tregut: investitorët tashmë nuk udhëhiqen aq shumë nga normat atraktive të fitimit se sa nga investimet në tregje të sigurta.

SHQIPËRIA: A ËSHTË E IMUNIZUAR NGA EFEKTET E PËRHAPJES SË KRIZËS?

Globalizimi dhe shkalla e lartë e integrimit të tregjeve ndërkombëtare kanë bërë që krizat të transferohen në mënyrë zinxhir nga një vend në një tjetër, me efekte dhe pasoja të konsiderueshme për ekonominë botërore.

Rrugët e transmetimit të krizave janë:

1-*Tregjet financiare*. Nga shkalla e ekspozimit të investitorëve në këto tregje dhe e integrimit të këtij tregu në atë ndërkombëtar, do të varej edhe shkalla e influencimit të një vendi nga zhvillimet ekonomike globale. Duke konsideruar nivelin e dobët të zhvillimit të tregut financiar të vendit tonë, kjo rrugë transmetimi është inekzistente.

2-*Lidhjet direkte tregtare me vendin që përjeton krizë ekonomike*. Edhe në këtë rast, gjeografia e shpërndarjes së tregtisë së jashtme të vendit tonë, nuk jep arsye të mendojmë për një ndikim direkt të krizave të sotme, qoftë aziatike apo ruse. Gjithë grupi i vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, zë vetëm 5 për qind të totalit të tregtisë së jashtme të vendit, ku Rusia mban gati 2 për qind të kësaj peshe.

Megjithë sa më sipër, ndjeshmëria e ekonomisë ndaj goditjeve të jashtme është rritur, qoftë nga zgjerimi i aktivitetit tregtar, pjesëmarrja në tregun e kredive të huaja (megjithëse shtetërore) etj..

Është pikërisht në mënyrë indirekte, që edhe ekonomia shqiptare do të përjetojë efektet negative të përkeqësimit të situatës ekonomike botërore. Rrugët e përhapjes së krizës dhe ndikimit të ekonomisë sonë do të ishin kryesisht:

a- Nëpërmjet çmimeve të mallrave. Rënia ekonomike e Azisë dhe rritja e ngadaltë e ekonomisë globale, bëri që indeksi i çmimeve të mallrave të bjerë në terma realë në masën 30 për qind ("The Economist", shtator 1998), niveli më i ulët që prej 25 vjetësh. Është pikërisht ky, kanali kryesor

i influencës në ekonominë shqiptare. Evidencë e plotë e saj është fakti që tregtia e jashtme e vendit përbën 74 për qind të PPB kombëtar. Nga disa vlerësime[6] të bazuara në treguesit e tregtisë së jashtme të vitit 1996, rezultojnë: a) Një rënie prej 30 për qind e çmimit të mallrave të lëndëve të para, do të gjeneronte një humbje në të ardhurat nga eksporti prej 13 milionë dollarësh amerikanë dhe rënien prej 5.3 për qind të eksporteve. b) Efekti neto në tregtinë e jashtme do të ishte një rënie e saj në masën 4.3 për qind. c) Në analizë të fundit, në masën e ndikimit të tregtisë së jashtme në PPB, efektet e saj do të reflektoheshin në ngadalësimin e rritjes ekonomike të vendit. Duke iu referuar treguesit të peshës së tregtisë së jashtme në PPB, masa e ndikimit vlerësohet të jetë nën 1 për qind të PPB-së.

b-Kriza e besimit të investitorëve të huaj mendojmë se do të manifestohet jo vetëm në sjelljen e tyre ndaj tregjeve të kapitaleve, por edhe në ecurinë e investimeve të huaja direkte. Efekti i këtij faktori tashmë nuk është i ri për ekonominë tonë, pasi që prej gati dy vjetësh, kriza politike, situata e rendit dhe e sigurisë në vend dhe në rajon, e kanë tronditur thellë besimin e investitorëve vendas dhe të huaj. Kriza ndërkombëtare nuk bën gjë tjetër veçse i shtohet listës së faktorëve që kanë tronditur mobilitetin e qarkullimit të kapitaleve. Rëndësia e investimeve të huaja për ekonominë tonë është mëse e dukshme: përveç efekteve të pamatshme të tyre në krijimin e një mentaliteti të ri biznesi, transferimin e teknologjive etj., me një kontribut në më shumë se gjysmën e totalit të eksporteve, me rritjen e ndikimit që kanë në punësim dhe në PPB, roli i tyre është bërë thelbësor. Është pikërisht ky ndikim që i jep përparësi rikthimit të konfidencës së tyre. Megjithëse ky është një proces afatgjatë, që lidhet me maturitetin e zhvillimeve politike dhe me nivelin e zhvillimit të demokracisë së shoqërisë civile, ai përmbledh në vetvete edhe hapa në afat të shkurtër dhe afat të mesëm. Në një periudhë afatshkurtër, përveç rivendosjes së rendit publik, konsolidimi makroekonomik dhe financiar i vendit, janë tashmë hapat që kanë ndërmarrë dhe po zbatojnë autoritetet financiare të vendit. Në periudhën afatmesme,

sjellja e investitorëve të huaj do të varet dhe influencohet mjaft nga shkalla e kompetitivitetit të ekonomisë kombëtare kundrejt konkurrentëve potencialë.

MBYLLJA

Duket se pasagjerët e aeroplanit kanë të drejtë të jenë nervozë. Është detyra dhe sfida që shtrohet para autoriteteve vendimmarrëse të adoptojnë politika të tilla, që qetësojnë këtë nervozizëm.

Nisur nga shkaqet e këtyre krizave të shumta të këtij fundshekulli, leksionet që dalin prej tyre mendojmë se mund të janë:

1-Rregullimi i tregjeve të brendshme financiare me synim ruajtjen e stabilitetit të brendshëm financiar, mbi normat dhe standardet ndërkombëtare, ndikon negativisht në eficiencën e tregut të brendshëm, duke çuar kështu në dilemën serioze midis stabilitetit dhe eficiencës. Derregullimi i tregjeve deri në standardet ndërkombëtare është domosdoshmëri.

2-Zgjidhja e kësaj dileme, nuk arrihet vetëm nga derregullimi i tregut por gjithashtu, duke zgjeruar ekonominë dhe forcuar rrjetin e asistencës sociale; me qëllim përballimin e dhimbjeve që rezultojnë nga forcimi i konkurrencës.

3-Burim i rëndësishëm i këtyre krizave konsiderohet fakti se këto vende i mbajtën monedhat e tyre të lidhura me një shportë monedhash të manipuluara dhe nuk lejuan luhatjen e tyre. Kjo masë inkurajon hyrjet e kapitaleve të huaja, por ato rrezikohen nga ndryshimet e normave të interesave në vendet e zhvilluara, duke u shndërruar, në momente të caktuara në burime krizash.

4-Parandalimi i krizave, kërkon një monitorim të kujdesshëm të strukturës së maturitetit të borxheve. Mundet që të pranohen edhe pagesa të normave më të larta të interesave për të siguruar një shpërndarje normale të maturiteteve. Procesi monitorues duhet të shoqërohet me rritjen e shkallës së transparencës, lidhur me publikimin e shifrave të borxhit të jashtëm.

5-Vendosja e kufizimeve të forta nga ana e Bankës Qendrore në lehtësitë e ofruara si "huadhënës i fundit në radhë".
6-Procesi i konsolidimit financiar të vendit duhet të monitorohet me kujdes, pasi financat e dobëta dhe niveli i dobët i zhvillimit të ekonomisë kombëtare, mund të bëhen në momente të caktuara burime krizash të monedhave.
7-Monitorimi i kujdesshëm i kreditimit dhe i borxhit të sektorit privat në monedhë të huaj. Tashmë operojnë mjaft banka apo ndërmjetës financiarë që ofrojnë kreditime për sektorin privat në monedha të forta. Ndryshimet e termave ndërkombëtarë të këmbimeve apo normave të interesave, do të kishin pasoja direkte si mbi firmat private ashtu dhe mbi bankat që ofrojnë këto kredi.

Të gjitha krizat evidentojnë se politikat monetare dhe posaçërisht, gjetja e kurseve të sakta të këmbimit, janë thelbësore për stabilitetin dhe rritjen ekonomike të vendit dhe suksesi afatgjatë varet nga konsolidimi i bazave ekonomike dhe fuqizimi i sektorit bankar.

SHËNIME

* Selami Xhepa, Specialist, Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve. Shtator 1998.
(Ky material është bazuar në shkrime të gazetave "New Europe", "Le Monde", "The Economist", Emerging Europe PaineWebber "International Emerging Markets Research", gusht-shtator '98; dokumente të FMN mbi Rusinë, qershor 1998; "Maintaining financial stability in a global economy - What lessons can be learned from recent financial crises", 1997.)

[1] Për herë të dytë brenda këtij viti, FMN uli parashikimin për rritjen e ekonomisë botërore. Deri tani, humbjet e pasurisë financiare të botës nga rënia e çmimeve të aksioneve llogariten në 4 trilionë dollarë amerikanë (shifër e barabartë me PPB të Japonisë).
[2] Dow Jones ka shënuar rënie prej 17 për qind kundrejt pikut të tij (gusht 1998).
[3] J P Morgan ka parashikuar një rritje prej 1.5 për qind në vitin 1998 dhe 1.7 për qind, vitin e ardhshëm.
[4] Në fakt, vende të ndryshme, kanë reaguar në mënyra të ndryshme ndaj kësaj krize. Disa prej tyre po adoptojnë qëndrime ekstremiste në mbylljen e ekonomive të tyre, ku spikat qëndrimi i Malajzisë e cila ka vendosur kontrolle të rrepta në qarkullimin e kapitaleve. Po kështu, Tajvani po rishqyrton projektin e mëparshëm për liberalizimin e plotë të llogarive rrjedhëse deri në fund të vitit 2000, megjithëse ky është një kusht për anëtarësimin e tij në Organizatën Botërore të Tregtisë. Kina urdhëroi firmat vendase që të tërheqin menjëherë mbajtjet e tyre në monedha të forta jashtë vendit, të cilat vlerësohen të jenë rreth 20 miliardë dollarë, si pjesë e masave të mbajtjes nën kontroll të monedhës kombëtare. Priten, gjithashtu, të ndërmerren disa kufizime në hyrjet afatshkurtra të kapitaleve të huaja. Japonia po përgatitet t'i propozojë takimit të Ministrave të Financës së G-7, të mbështesë masa për vendosjen e kontrolleve të përkohshme mbi qarkullimin e kapitaleve (vetë Japonia nuk i ka dënuar masat që ka ndërmarrë Malajzia).
[5] Shifrat në vazhdim për humbjet, i referohen periudhës deri në mesin e muajit gusht 1998.
[6] Analiza bazohet në treguesit e tregtisë së jashtme të vitit 1996 që konsiderohet si një periudhë normale e zhvillimit ekonomik. Saktësia e parashikimit ndikohet nga këta faktorë: a) ajo bazohet në të dhënat e vetëm një viti dhe jo të serive kohore të mjaftueshme. Përdorimi i tyre, përsëri do të rezultonte me një shkallë të konsiderueshme gabimi, pasi ndryshimet në strukturën tregtare të grupmallrave paraqiten mjaft të mëdha; b) analiza bazohet vetëm në dy grupe mallrash sipas klasifikimit SITC, respektivisht të mallrave të papërpunuar dhe lëndëve djegëse dhe jo në një ndarje të detajuar të elementeve përbërëse të kësaj strukture.

DEFICITI KORENT NË PERIUDHËN 1992-1997. A PËRBËN AI PROBLEM?

Gramoz Kolasi
*Altin Tanku**

Fjalë kyçe
- Deficit korent - Transaksione financiare - Transaksione ndërkombëtare - Transferta korente - Sektori i jashtëm -

1. SITUATA E PËRGJITHSHME

Situatat e trazuara ekonomike e politike që kaloi vendi në gjashtëmujorin e parë të vitit 1997, janë reflektuar gjerësisht edhe në sektorin e jashtëm të ekonomisë. Kolapsi i menjëhershëm i skemave piramidale, shkrirja e kursimeve të popullatës dhe pasiguria sociale çuan në zvogëlimin e kërkesës për konsum, në uljen e aktivitetit tregtar dhe në tkurrjen e transfertave private nga jashtë. Si rezultat, llogaria korente u mbyll me një deficit prej rreth 264 milionë usd ose 1.5 herë më e lartë se një vit më parë. Nga ana tjetër, çekuilibrimi i jetës politike të vendit ndikoi në rënien e prurjeve në valuta të forta nga transfertat shtetërore në formën e ndihmave, të kredive dhe të investimeve direkte. Zhvillimet e sipërpërmendura në sektorin e jashtëm i dhanë fund periudhës disavjeçare të lekut të fortë.

Nga këndvështrimi historik në 5 vitet e kaluara (i referohemi periudhës korrik 1992 – dhjetor 1996), zhvillimet në bilancin e pagesave u karakterizuan nga deficite tregtare të larta, nga një nivel i lartë hyrjesh në formën e transfertave korente, nga lëvizje kryesisht modeste në llogarinë kapitale si dhe nga shkallë e lartë papërcaktueshmërie për një sërë transaksionesh të jashtëligjshme dhe rastësore. Megjithatë, gjatë gjithë kësaj

periudhe, pozicioni i përgjithshëm i bilancit ka qenë pozitiv dhe për rrjedhim, rezervat valutore kanë njohur rritje në vlerë absolute, megjithëse niveli i tyre i përgjithshëm është akoma i ulët. Kjo situatë e përgjithshme, ka përkuar dhe me një koniukturë çmimesh jo të favorshme për një kategori mallrash, të cilët tradicionalisht kanë zënë peshën kryesore në eksportet tona. Në përgjithësi, kjo periudhë është karakterizuar nga një ekuilibër relativisht i qëndrueshëm makroekonomik, me një rritje të lartë ekonomike, me një inflacion nën kontroll në kushtet e aplikimit të politikave të shtrënguara monetare dhe fiskale të ndërmarra këto, në kuadrin e një sërë rregullimeve strukturore. Megjithatë, e shohim me interes të ndalemi diçka më shumë në vitin 1996, i cili për nga shumëllojshmëria e zhvillimeve ekonomike, politike dhe sociale është pa dyshim shkatërruesi i gjithçkaje të mirë që u realizua gjatë gjithë viteve të para të tranzicionit.

Shenjat e para të depozitimit të parave në firma të ndryshme (pa bërë dallim nëse ato ishin të angazhuara në aktivitete prodhuese) u vunë re që në vitin 1995 e ndoshta më herët. Ndërkohë që shenjat e para të ekspansionit të deficitit buxhetor përkojnë me gjashtëmujorin e dytë të vitit 1995. Si rezultat i indiferencës së plotë në trajtimin e tyre, i aplikimit të politikave të shtrënguara të kreditit, i mungesës totale të një tregu të rregulluar kapitalesh, i injorimit të kursimeve të individëve etj., çmenduria e investimit në këto firma kapërceu çdo kufi, duke gllabëruar qindra miliona dollarë amerikanë. I parë në këndvështrimin politik, lulëzimi i këtyre skemave të investimit, përkoi me një vit të ngjeshur elektoral, që përveç përkrahjes morale që iu dha skemave piramidale, u tregua dorëlëshuar në shpenzime. Interesat e lartë që paguheshin ishin aq atraktivë, sa pre e këtyre skemave filluan të binin jo vetëm rezidentët, por edhe emigrantët si dhe një numër i konsiderueshëm të huajsh. Shfaqja e fenomenit fajde i bëri shqiptarët të harronin varfërinë e tyre të tejskajshme dhjetravjeçare dhe krijoi iluzionin e një shoqërie të pakufizuar konsumi. Kërkesa e brendshme njohu rritje të paparë, në përgjigje të së cilës, në mungesë të kapaciteteve të brendshme prodhuese, pati një vërshim të paimagjinueshëm mallrash importi, ku nuk përjashtoheshin edhe mallrat e luksit.

Rritja e madhe e agregatit të kërkesës; pashmangërisht, çoi në rritjen e presioneve mbi çmimet e konsumit. Inflacioni në fund të vitit 1996 ishte pothuaj 3 herë më i lartë se një vit më parë dhe premisat për rritje të mëtejshme ishin gjithnjë e më prezente. Muaji i fundit i vitit 1996, me pak fjalë, konturoi tiparet themelore të atij tërmeti ekonomiko-politik që pasoi në muajt në vazhdim.

E shohim të tepërt të riprodhojmë edhe një herë atë çka përjetoi vendi në muajt e parë të vitit 1997. Një mori e tërë arsyesh, kokëfortësish e mllefesh, iniciuan në mënyrën më të egër një katrahurë të paparë, rezultat i të cilës ishte kolapsi i plotë ekonomik, politik dhe financiar i vendit. Pa dyshim, gjoba më e kushtueshme edhe në këtë rast i takoi ekonomisë, e cila edhe para këtij kolapsi ishte shumë e brishtë. Gjithsesi, në kontekst të zhvillimeve më të fundit të ndodhura në pozicionin e jashtëm të vendit, shkurtimisht, është me vend të evidentojmë momentet negative më kulmore me të cilat ekonomia kombëtare u ballafaqua, në 9-muajt e parë të vitit të kaluar.

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë usd; shenja minus tregon debinë).

	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Llogaria korente	-50,8	14,7	-42,7	-14,6	-107,1	-264.1
Eksporti i mallrave, fob	70,0	111,7	141,3	204,8	243,7	158.6
Importi i mallrave, fob	-540,5	-601,6	-601,0	-679,8	-922,5	-693.5
Bilanci tregtar	-470,5	-489,9	-459,7	-475,0	-678,3	-534.9
Shërbimet: kredi	20,3	77,5	83,1	97,0	129,3	62.6
Shërbimet: debi	-89,2	-162,0	-171,5	-156,3	-189,1	-111.6
Të ardhurat: kredi	2,6	64,9	55,6	70,8	83,5	60.3
Të ardhurat: debi	-37,7	-31,0	-41,5	-28,5	-12,0	-6.7
Transferta private	150,0	274,8	374,1	348,9	476,0	235.5
Transferta shtetërore	373,7	280,4	117,2	128,5	83,4	30.7
Investime direkte	20,0	58,0	52,9	70,0	90,0	42.5
Investime portofoli	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Kapitale të tjera	10,7	52,1	11,6	-93,1	-32,5	115.3
Sektori rezident shtetëror	55,0	106,9	119,0	-24,6	67,4	57.5
Bankat tregtare	-59,6	-43,5	-80,2	-56,9	-110,2	90.7
Sektorët e tjerë	15,3	-11,4	-22,3	-11,6	10,5	-33.0
Gabime dhe Harresa Neto	44,8	-9,9	33,0	57,1	96,6	137.9
Bilanci i Përgjithshëm	24,7	114,9	54,8	30,6	47,1	31.6
Rezervat	-24,7	-114,9	-54,8	-30,6	-47,1	-43.8
Përdorim kredish dhe huash nga FMN	13,9	16,6	22,2	11,1	0,0	12.2

Detyrime ndaj autoriteteteve të huaja monetare	...	...	...	...	...	...
Financime të jashtëzakonshme	...	...	...	...	...	...

- Frenim i kërkesës së brendshme, i cili nga ana tjetër përkoi me një shkatërrim të konsiderueshëm të kapaciteteve prodhuese. Ky fenomen përbën një shkak të qenësishëm për një rënie të mundshme të prodhimit në terma realë, e cila së fundi vlerësohet të jetë 7.3 për qind.
- Humbje e besimit publik në sistemin bankar, gjë që çoi në një hemorragji të pandalshme të parasë, ndërkohë që rënia e depozitave pa afat dhe në valutë ishte e pashmangshme. Kompromet imi i politikës monetare u ndihmua ndjeshëm nga bërja inekzistente e financave publike. Mbulimi i deficitit buxhetor me likuiditete të ofruara nga Banka e Shqipërisë, rriti ndjeshëm bazën monetare, duke u bërë në këtë mënyrë një burim i sigurt inflacioni.
- Rënie e ndjeshme e konfidencës në monedhën kombëtare. Zhvlerësimi i lekut shqiptar, në një masë të caktuar pasqyronte dhe zhvillimet e ndodhura në tregjet më të mëdha valutore kudo në botë. Është fakt se marka gjermane, jeni japonez, frangu zviceran, e kështu me radhë, të gjithë ulën kokën para monedhës së gjelbër, duke shënuar pa përjashtim rekorde historike.
- Rënie drastike e nivelit të përgjithshëm të kursimeve. Megjithëse akoma nuk janë bërë të njohura shifrat e sakta mbi totalin e investuar, shumat e kthyera në formë interesi dhe principali, shuma e pjesës së investuar që është shndërruar në investime prodhuese etj., është e kuptueshme që për shkak të administrimit amator, të shpenzimeve të pakontrolluara, të transferimit jashtë vendit të kapitaleve të grumbulluara, të abuzimeve nga vetë personeli i këtyre firmave, mungesës së evidencimit të saktë kontabël etj., një pjesë e mirë e kursimeve të investuara në këto skema nuk ka arritur të rishpërndahet.

Pas krijimit të një ideje të përgjithshme të ecurisë ekonomiko-financiare të Shqipërisë në 4-5 vjetët e fundit, në përgjithësi

përforcohet ideja se zhvillimet në sektorin e jashtëm në mënyrë të përsëritshme, i janë lënë spontanitetit. *Me këtë nuk duam të themi se shteti duhet të kontrollonte, në mos gjithçka, pjesën më të madhe të transaksioneve të Shqipërisë me botën. Vetë koncepti ekonomi e tregut të lirë do ta përjashtonte një gjë të tillë, por nga ana tjetër dihet që politikat* rregulluese *ekonomike hartohen dhe zbatohen nga autoritetet dhe në këtë aspekt, kemi të drejtë të themi se nuk është bërë asgjë.*

Është e vërtetë se janë bërë rregullime të konsiderueshme në kryerjen e transaksioneve në llogarinë korente dhe atë kapitale, është miratuar ligji "Mbi investimet e huaja në Shqipëri", është përmirësuar bashkësia e rregullave që disiplinon funksionimin e tregut të këmbimeve valutore etj.. Por, po kaq e vërtetë është se mënyra e vetme, për financimin e deficitit të madh të llogarisë korente, i besohet rastësisë dhe veprimeve jo të ligjshme, ndërkohë që për nxitjen e eksporteve, turizmit etj., përpjekjet mbeten vetëm në kuadrin e premtimeve dhe të negociatave. Gjithsesi, nëpërmjet një pasqyrimi më të hollësishëm të asaj çka ndodhi gjatë kësaj periudhe, në zërat e veçantë të bilancit të pagesave, parë dhe në spektrin politik të zhvillimit të ekonomisë në këto vite të fundit, do të sqarojmë më bindshëm dinamikën dhe perspektivën e afërt të llogarive të bilancit të pagesave.

2. LLOGARIA KORENTE DHE FLUKSET E KAPITALEVE

2.1 ZHVILLIMET NË BILANCIN TREGTAR DHE SHËRBIME

Duke filluar që nga viti 1992, me liberalizimin e llogarisë korente, tregtia e jashtme nuk ishte më monopol i shtetit. Pikërisht në mes të këtij viti, në Shqipëri, për herë të parë u përdor regjimi fleksibël i këmbimeve valutore, si rruga më e efektshme në reduktimin maksimal të mundshëm të zhbalancimit, në pozicionin e përgjithshëm të bilancit të pagesave. Njëkohësisht, që në fillim të viteve '90, vendi ynë përjetoi një fenomen të ri, atë të emigracionit masiv, i cili me kalimin e viteve u bë një nga faktorët-kyç për financim.



Liberalizimi i tregtisë së jashtme, në të vërtetë, u shfaq në formën e një kontributi, gjithnjë e në rritje, të sektorit privat në anën e importeve, ndërkohë që në burimet tradicionale të eksporteve, roli i këtij sektori nuk ishte i pranishëm. Duke analizuar me kujdes ecurinë e importeve, vihet re se kurba e tyre ishte shumë e ndjeshme ndaj kërkesës së brendshme, gjithnjë në rritje. Në këtë situatë, vërshimi i mallrave nga importi, sidomos i atyre të konsumit, njohu lulëzim. Importohej çdo gjë, duke filluar që nga sendet e konsumit të përditshëm deri tek mallrat elektroshtëpiakë, veshje, automobila etj..

Boshllëkut të trashëguar në pajisje dhe orendi filloi t'i vinte fundi. Ëndrra e shqiptarëve për të pasur një automobil apo një televizor me ngjyra, filloi të bëhej realitet. Nuk është e rastit që në periudhën 1992-1996 u importuan[1] rreth 114 mijë frigoriferë, 183 mijë televizorë, 80 mijë makina larëse etj.. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, Shqipëria thithi, në formën e kredive dhe të investimeve, sasi të konsiderueshme kapitalesh të huaja që kanë hyrë kryesisht si makineri e pajisje (këta mallra klasifikoheshin të dytët në strukturën e importit). Si rrjedhim, vlera e importit nga viti në vit pësoi rritje, duke kulmuar në vitin 1996 me rreth 1 miliard dollarë amerikanë (grafiku 2).



Krejt ndryshe viti 1997, me gjithë vlerën e madhe të importeve në tremujorin e fundit, shënoi një rënie prej 230 milionë dollarësh amerikanë ose rreth 25 për qind më pak se viti i mëparshëm. Përveç zvogëlimit të kërkesës së brendshme për mallra konsumi, në rënien e importeve ndikoi edhe zvogëlimi i hyrjeve të kapitalit nga jashtë, në formën e kredive dhe investimeve direkte.

Edhe eksportet reflektuan krizën e përgjithshme të vitit 1997, kur ato regjistruan një vëllim më të ulët, prej 85 milionë dollarësh amerikanë kundrejt vitit të kaluar (rreth 35 për qind). Nga ana tjetër, përqindja e mbulimit të importeve me eksportet në vitin 1997, u ul më tepër duke arritur në nivelin 23 për qind nga 30 dhe 26 për qind, që ishte përkatësisht në vitet 1995 dhe 1996.

Nisur dhe nga fakti se eksportet e viteve të kaluara kanë qenë në nivele shumë të ulëta (shih grafikun 2), shifra aktuale e eksporteve besojmë se nuk ka nevojë për koment. Gjatë muajve të parë të vitit, vala e shkatërrimeve nuk kurseu asgjë, duke përfshirë edhe ato pak kapacitete prodhuese me destinacion eksportin. Megjithatë, të dhënat janë domethënëse dhe nuk mund të anashkalohen, duke justifikuar çdo gjë me shkatërrimet e muajve të parë të vitit 1997. Kështu, shifra e eksportit të katër vjetëve, 1993-1996 të marrë së bashku, është 702 milionë usd, ndërkohë që vetëm importet e vitit 1996 arritën kuotën 922 milionë usd. Është fakt se megjithëse hyrjet e kapitaleve nga

jashtë (në të gjitha format e mundshme) kanë qenë disa herë më të mëdha se shifra e mësipërme, strategjia e kanalizimit dhe e përdorimit të tyre në funksion të eksportit ka qenë fare e zbehtë ose më mirë të themi nuk ka ekzistuar fare.

Është e vërtetë që liberalizimi i transaksioneve korente i dha një hov importit, por po aq e vërtetë është se nuk i dha asnjë nxitje fuqizimit të eksporteve shqiptare. Në qoftë se gjatë kësaj periudhe është vërejtur një rritje e eksportit në vlerë absolute nga viti në vit, kjo i dedikohet rritjes së eksportit të një kategorie të caktuar mallrash, të cilët kryesisht përfaqësojnë eksporte me material të porositësit, investime të huaja sporadike, të bëra kryesisht në industrinë e lehtë (tekstile, veshje këmbësh etj.), të cilat asnjëherë nuk arritën të bëheshin një bazë e qëndrueshme e eksporteve shqiptare.

Eksportet tradicionale, që deri në vitet '80 vlerësohen rreth 2 herë më të larta se mesatarja e eksportit vjetor, për vitet 1992-1997 stopuan. Pa përjashtuar dhe një koniukturë të pafavorshme të çmimit të kromit, minimumi që mund të bëhej do të ishte krijimi i premisave nxitëse për rigjallërimin e tyre.

Kur themi se nuk ka patur një strategji, me këtë nuk nënkuptohen aspak politikat e kursit të këmbimit apo ato doganore, sepse në të vërtetë këto politika, në ambientin e përgjithshëm ekonomik shqiptar, nuk do të kishin ndikimin më minimal në rritjen e vëllimit të eksportit. Në kushtet e një vëllimi prodhimi industrial të kufizuar, të një vëllimi të prodhimit bujqësor që nuk arrin të plotësojë nevojat e brendshme, të një infrastrukture tejet të amortizuar për tregtimin e shërbimeve, nuk mund të bëhet fjalë për sukses të politikave valutore dhe fiskale.

Në lidhje me kursin e këmbimit duhet të pranojmë se Shqipëria e ka shitur totalisht prodhimin e saj. Problemi nuk ka qenë çmimi i mallit i shprehur në valutë të huaj, por vëllimi fizik i mallrave që ka munguar dhe jashtë standardeve më minimale të cilësisë. Praktika ka treguar se këto politika nuk kanë dhënë rezultat edhe në ekonomitë më të forta të Evropës Lindore. Nga ana tjetër, kanë ekzistuar barriera doganore për një seri shumë të kufizuar

mallrash në varësi të politikave të brendshme të zhvillimit, të cilat tashmë së fundi janë konvertuar në një listë me vetëm dy artikuj. E pra, e keqja nuk qëndron në numrin e madh të barrierave doganore, por thjesht në faktin se nuk ka çfarë të eksportohet.

Edhe në rastin e sanksioneve ndërkombëtare ndaj Jugosllavisë, të gjithë jemi dëshmitarë se për shkaqe abuzimi dhe korruptimi, embargoja u shndërrua në një nocion teorik. Kthimi i saj në një tregti të zezë, solli në Shqipëri sasi të konsiderueshme mjetesh valutore duke lënë mbrapa eksportet e ligjshme. Pra, është e kuptueshme se politikat e vërteta nxitëse për mbështetjen e eksportit, do të ishin ato politika që do të nxisnin rritjen e vëllimit fizik të prodhimit.

Në momentin e hapjes, Shqipëria ofronte përparësi konkurruese siç ishin fuqia e lirë punëtore dhe burimet natyrore. Një mundësi për shfrytëzimin e tyre ishte tërheqja e investitorëve strategjikë që do të ofronin investimet dhe tregjet e shitjes. A ka ekzistuar kjo strategji? Procesi i privatizimit krijoi pronarë të vegjël, të paaftë e të papërvojë për të kooperuar me partnerët e huaj, sepse u privatizuan ndërmarrjet e vogla dhe disa të mesme. Ndërkohë që shteti investonte pak ose aspak në prodhim, u mbajtën shtetërore degët kryesore për eksport prej të cilave vetëm u vol, por nuk u investua asgjë, duke çuar në shkatërrimin e tyre gradual. Kështu, kompani të tilla si ALBKROM, KESH, ALBPETROL dhe ALBBAKËR, sot gjenden në një situatë kritike, situatë e cila është rrjedhim i administrimit abuziv dhe aspak profesionalist, i vjedhjeve sistematike që u janë bërë, i shkatërrimeve të muajve të fundit etj..

Rënia e aktivitetit tregtar u pasqyra edhe në llogarinë e shërbimeve, në uljen e shpenzimeve për transportin e mallrave, që u shoqërua me uljen e të ardhurave nga shërbimet portuale. Pasiguria në vend ndikoi në uljen e të ardhurave nga aktiviteti i turizmit dhe transporti i pasagjerëve respektivisht me 64 dhe 60 për qind, ndërkohë ndërprerja e programeve të ndihmës pati si rrjedhojë shkurtimin e shpenzimeve për asistencë teknike, në masën 68 për qind. Këto zhvillime u pasqyruan në një deficit shërbimesh 17 për qind më të ulët se viti 1996.

Nuk është e lehtë të gjykohen saktësisht shërbimet e transportit të pasagjerëve e të mallrave, por, megjithatë, vlerësohet se ato kanë ndjekur kërkesën e rritur për konsum. Statistikat kanë treguar se, gjatë gjithë periudhës pesëvjeçare këto shërbime kanë pasur korrelacion të plotë me rritjen e transaksioneve tregtare dhe në përgjithësi, janë mbyllur në deficit.

Pa dyshim, në llogarinë e shërbimeve, të ardhurat nga turizmi përbëjnë burimin kryesor të të hyrave valutore në vend. Të ardhurat prej tij janë rritur nga viti në vit, si pasojë e rritjes së numrit të turistëve të hyrë dhe përmirësimit spontan të turizmit familjar. Për më tej, gjatë kësaj periudhe, në raste të rralla ky aktivitet është shndërruar në turizëm të organizuar privat me një infrastrukturë të përshtatshme hoteliere.

Megjithë përpjekjet e mësipërme, gjatë periudhës[2] 1992-1997, të ardhurat e turizmit kanë qenë relativisht të ulta, rreth 300 milionë dollarë amerikanë. Kjo shifër përbën vetëm 21 për qind të totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve. E vënë në raport me potencialin e madh turistik që ofron Shqipëria, kuptohet që përfitimet nga turizmi kanë mbetur në nivele modeste. Në këtë kontekst, periudha që lamë pas, e për më tepër edhe e ardhmja afatmesme, vështirë se do të mund të ofrojnë një normalitet të përgjithshëm favorizues të një turizmi të organizuar dhe cilësor. Megjithatë, duhet pranuar se eksporti i mallrave dhe i shërbimeve është një fenomen shumë i ndjeshëm ndaj ambientit të përgjithshëm politik, social dhe atij ekonomik në përgjithësi.

2.2 TRANSFERTAT KORENTE

Disa herë, më sipër, kemi theksuar një fenomen tejet tipik për Shqipërinë e viteve të fundit, atë të thithjes së sasive të mëdha valutore në formën e dërgesave nga emigrantët, dërgesa të cilat kanë qenë jo vetëm jetike, për pjesën dërrmuese të popullsisë, por edhe zëri kryesor që ka financuar atë ndryshim të madh ndërmjet eksportit të mallrave dhe shërbimeve me importet.

Duke filluar që nga viti 1992, ndoshta dhe më herët, përveç nivelit të lartë të transfertave shtetërore, gjithnjë e më shumë u bënë

Grafik 3. Dërgesat dhe depozitat në sistemin bankar
(në milionë lekë, fluksi për periudhën).



sinjifikative të ardhurat nga emigrantët, të cilat në terminologjinë e bilancit të pagesave njihen si "dërgesa nga të çatdhesuarit". Është fakt se fenomeni i emigracionit në përmasa të mëdha, për herë të parë, u evidentua në mesin e vitit 1990 (ngjarjet me ambasadat në muajin korrik 1990). Që nga ai moment e më tej, prioriteti i vetëm i shtresave të ndryshme të popullsisë ishte si të linin atdheun, në kërkim të një të ardhmeje më të mirë. Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta dhe të besueshme, mendohet që në vendet fqinje punojnë rreth 400 mijë shqiptarë[3], të cilët në vetvete përfaqësojnë të gjitha shtresat e popullsisë.

Realiteti shqiptar i fillimit të viteve '90 dhe aktualiteti shqiptar i vitit të kaluar, nuk lë në mëdyshje se avantazhi i krahut të lirë të punës në Shqipëri, edhe për një kohë të gjatë do të mbetet thjesht potencial, dhe se prirja e tij do të vazhdojë të mbetet emigrimi. Megjithatë, ashtu siç e përmendëm edhe në fillim, duke bërë një vlerësim të avantazheve dhe disavantazheve të këtij fenomeni, ky ka qenë në një shkallë të lartë, amortizues i varfërisë së madhe të shqiptarëve. Përmasat e vogla të vendit, bënë që niveli i të jetuarit, konsumi, kursimet, investimet etj., në mënyrë të menjëhershme, të reflektonin përmirësime të dukshme, nga njëra anë dhe ekuilibri i jashtëm i ekonomisë të bëhej i mundur, nga ana tjetër. Më konkretisht, gjatë periudhës 1992 -1997 në formën e transfertave korente, kanë hyrë rreth 2.8 miliardë dollarë amerikanë, nga të cilat vlerësohet se rreth 1.9 miliardë janë kontribut i emigracionit shqiptar.

Pasi patën kulmin në vitin 1996, vlerësohet që në vitin 1997, dërgesat nga emigrantët të jenë përgjysmuar. Pavarësisht nga kjo, në kushte të ngjashme me periudhën 1993-1994, mund të pritet një ringjallje tjetër e prurjeve nga emigracioni. Thellimi i nivelit të varfërisë, tendenca e fuqishme për emigrim, mund të shihen si faktorë që do të ruajnë një prurje konstante të ardhurash nga emigracioni e ndoshta me një tendencë të lehtë në rritje kundrejt vitit 1997. Megjithatë, më poshtë, kur të analizohet arsyeshmëria e llogarisë korente, përsëri do t'i rikthehemi kësaj çështjeje.

2.3 TRANSAKSIONET KAPITALE DHE FINANCIARE

Deficitet korente kronike të periudhës 1992-1997 janë përballuar vazhdimisht nga hyrje të larta kapitalesh dhe mjetesh të huaja financiare. Këto fonde kanë hyrë në Shqipëri si investime direkte dhe kredi koncensionare. Totali i këtyre influkseve, për periudhën janar 1992 - shtator 1997, vlerësohet në rreth 900 milionë usd. Për rrjedhojë, detyrimet e Shqipërisë ndaj botës, kanë ardhur duke u rritur vazhdimisht, dhe sipas të dhënave më të fundit, në fund të muajit shtator 1997, borxhi i livruar pezull regjistron rreth 450 milionë dollarë. Mbas riskedulimit të borxhit të vjetër, në shtator të vitit 1995, Shqipëria nuk akumulon më detyrime të prapambetura dhe për momentin, niveli i borxhit të pashlyer në afat është zero.

Grafiku 4. Investimet e Huaja Direkte
(në përqindje ndaj PBB).



Në mungesë të alternativave, të tregut të kapitaleve dhe të iniciativës, sistemi bankar ka gjetur prehje në depozitimin e fondeve valutore në bankat e huaja. Këto fonde pasqyrojnë zotërimet e mëdha valutore, të krijuara nga depozitimet e mëdha të popullatës në formën e depozitave në monedha të huaja.

Duke iu rikthyer edhe një herë zërit "investime të huaja direkte", vihet re se niveli i tyre në vitin 1997 është më i ulëti, për periudhën 1993-1997. Krahasuar me vitet 1995 dhe 1996, ky zë është përkatësisht 39 dhe 53 për qind më i ulët. Sigurisht, anormaliteti i vitit të kaluar është domethënës dhe shpjegon më së miri këtë fakt. Megjithatë, duke lënë mënjanë vitin 1997, periudha që lamë pas mbart një total investimesh të huaja direkte në përmasa shumë modeste, vetëm 290 milionë dollarë amerikanë. Siç shihet dhe në tabelën e mësipërme, Shqipëria radhitet e parafundit duke lënë prapa vetëm ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, megjithëse një pjesë e shteteve të listuara kanë qenë të përfshira dhe në konflikte të armatosura rajonale, gjatë periudhës që i referohemi.

Tabelë 2. Hyrja e investimeve të huaja në vendet në tranzicion, 1993-1996, në milionë usd.

		1993	1994	1995	1996
	Evropa Lindore nga e cila:	3999	3469	9152	7171
1	Shqipëri	58	53	70	90
2	Bullgari	40	105	90	82
3	Kroaci	74	98	81	340
4	Republika Çeke	568	862	2562	1428
5	Hungari	2339	1146	4453	1983
6	Poloni	580	542	1134	2741
7	Rumani	94	341	419	210
8	Sllovaki	134	170	157	119
9	Slloveni	113	128	176	186
10	Ish-RJ e Maqedonisë		24	9	6
	Në vëmendje:				
1	Shqipëria ndaj totalit (në përqindje)	1.4	1.5	0.8	1.2
2	Shqipëria për frymë (në usd)	19	17	23	29

I vënë në raport me totalin e hyrjeve në formën e transfertave korente dhe të të hyrave në formën e kredive dhe të investimeve të huaja, totali i investimeve direkte të huaja, të realizuara në periudhën 1992-1997 përbën vetëm 9 për qind, një shifër kjo që nuk ka nevojë për koment.

Në vazhdimësi, për mungesën e një ambienti të përshtatshëm dhe atraktiv për investitorët e huaj, megjithë përparësitë dhe disavantazhet e tregut shqiptar do të ndalemi në veçanti në faktorë të ndryshëm, mungesa e të cilëve ishte me pasoja për ecurinë e investimeve të huaja.

3. ARSYESHMËRIA E DEFICITIT TË LLOGARISË KORENTE

3.1 DEFICITI KORENT. KUR AI MUND TË ÇOJË NË KRIZË?

Përpara se të themi diçka për pyetjen e mësipërme do të ishte më mirë të sqaronim një problem tjetër, i cili nga studiuesit cilësohet jetik dhe i domosdoshëm për t'u sqaruar. Për të qenë më të qartë po i referohemi 10 episodeve të marra nga ecuria ekonomike e 6 vendeve në zhvillim, ku episodi më i spikatur, i takon Meksikës, e cila në periudhën 1991-94 u përball me një krizë të vërtetë valutore. Pasojat e kësaj krize u reflektuan në një kolaps të përgjithshëm të ekonomisë kombëtare dhe u shoqëruan me implikime serioze në tërë rajonin e Amerikës Veriore dhe më gjerë.

Vitet 1970, 1980 u karakterizuan nga rrjedhje të mëdha të kapitalit ndërkombëtar në drejtim të vendeve në zhvillim të Amerikës Latine dhe të Azisë Lindore. Këto hyrje ishin të mjaftueshme për të financuar deficitet konstante të llogarisë korente në këto vende dhe për rrjedhim, gjatë gjithë kësaj periudhe ky grup i madh vendesh në zhvillim, pavarësisht nga politikat e ndërmarra, nuk u përball me kriza valutore.

Ndërkohë mungesa e politikave të përshtatshme, bëri që një grup vendesh (3 nga 10 episodet e marra në vrojtim) me deficite të mëdha dhe të vazhdueshme, në kushtet e ndërprerjes së menjëhershme të hyrjeve të kapitalit ndërkombëtar, të përballen me kriza të përgjithshme financiare, ku më tipik ishte rasti i Meksikës. Nga ana tjetër, aplikimi i politikave të tilla që zëvendëson hyrjet e rastësishme valutore me burime të

përhershme, bënë që grupi tjetër i shteteve të marra në vrojtim të amortizonte shumë butë pakësimin e hyrjeve të kapitaleve të huaja në ekonomitë respektive. Tashmë që eksperienca e Meksikës ka mbetur disi prapa, studiuesit e kanë përqendruar vëmendjen në përcaktimin e qartë të dy çështjeve themelore, të cilat sqarojnë ndërlikimet që deficitet kronike korente i shkaktojnë stabilitetit ekonomik të përgjithshëm, të brendshëm dhe të jashtëm të vendit.

Së pari, bëhet fjalë nëse vendi borxhli është i aftë të paguajë borxhet e akumuluara dhe së dyti, nëse deficiti i llogarisë korente është në nivel të arsyeshëm dhe të pranueshëm.

Një vend ka aftësi paguese nëse ai është i aftë të gjenerojë në të ardhmen suficite të mjaftueshme tregtare për ripagimin e borxhit ekzistues. Vetëm në këtë rast, mund të thuhet se ekonomia kombëtare përputhet me kriterin e aftësisë paguese. Megjithatë, ky nuk është kriteri më i përshtatshëm për të përcaktuar pasojat e zhbalancimeve të sektorit të jashtëm të ekonomisë kombëtare.

Për këtë arsye, studiuesit i referohen nocionit të arsyeshmërisë, i cili në mënyrë të hapur merr në konsideratë dëshirën për të paguar dhe për të dhënë hua. Kështu, për një vend që financon me borxh të ri deficitet permanente të llogarisë korente dhe të bilancit tregtar, është e domosdoshme dhe e nevojshme "një pikë kthese", e cila është e nevojshme për të plotësuar si kriterin e aftësisë paguese ashtu edhe atë të arsyeshmërisë. Problemi qëndron nëse kjo kthesë do të arrihet natyrshëm dhe pa i shkaktuar probleme ekonomisë apo nëse do t'i imponohet nga ngjarje të tilla ekonomike si ndërprerja e menjëhershme e hyrjeve të kapitalit. Nëse deficiti tregtar kthehet gradualisht në suficit pa i detyruar autoritetet të bëjnë ndryshime thelbësore në politikat ekzistuese ekonomike, atëherë deficiti konsiderohet i arsyeshëm. Nga ana tjetër, nëse kjo pikë kthese kërkon një ndryshim drastik të politikave dhe shoqërohet nga rënie të menjëhershme në konsum dhe në aktivitetin ekonomik, deficiti konsiderohet jo i arsyeshëm dhe i patolerueshëm.

3.2 TREGUESIT MAKROEKONOMIKË TË ARSYESHMËRISË

Nga eksperienca e gjashtë vendeve me deficite shumë të larta korente në fillimet e viteve 1980 dhe atyre 1990, u vu re se në tre raste (Kili '79-'81, Meksika '77-'81 dhe '91-'94) pasojat e këtyre deficiteve çuan në kriza financiare. Nga studimet që iu bënë këtyre tre rasteve, u evidentuan lidhje të rëndësishme ndërmjet një numri treguesish makroekonomikë dhe arsyeshmërisë së pozicionit të jashtëm.

3.2.1 Raporti i eksporteve me PBB

Për të shlyer borxhin e jashtëm dhe për ta reduktuar atë, një vendi i duhet të mbështetet në prodhimin e mallrave të tregtueshëm si një burim për thithjen e valutës. Vendet me një sektor të madh eksporti, mund të shlyejnë borxhin e jashtëm më lehtë, sepse shlyerja e borxhit do të absorbojë një pjesë më të vogël të totalit të eksportit.

Tabelë 3. Tregues makroekonomikë të arsyeshmërisë[4].

	Kili '79-'81 ('82-'83)	Kolumbi '80-'84 ('85-'88)	Kolumbi '92-'95	Meksikë '77-'81 ('82-'83)	Meksikë '91-'94 ('95)	Korea '77-'82 ('83-'88)	Malajzi '91-'95	Tajlandë '79-'84 ('85-'86)	Tajlandë '91-'95
Llogaria korente	-9.1 (7.6)	-5.1 (0.5)	-3.4	-5.0 (0.3)	-6.7 (-0.3)	-5.4 (2.6)	-5.7	-6.1 (-1.7)	-6.7
Kursimet	7.4 (5.9)	14.6 (20.5)	16.4	18.7 (22.0)	15.7 (17.9)	25.6 (31.6)	30.0	22.5 (26.9)	34.0
Eksportet	19.7 (21.3)	12.6 (18.1)	18.3	10.6 (17.2)	12.7 (24.0)	32.5 (36.9)	82.4	23.0 (27.8)	36.6
REER	124.1 (118.5)	135.5 (80.2)	77.6	126.4 (103.5)	113.9 (76.0)	103.6 (92.2)	83.5	115.5 (95)	88.5
Bilanci fiskal	2.1 (-3.3)	-3.5 (-1.0)	-0.8	-8.0 (-11.2)	0.4 (0.0)	-2.8 (0.0)	-1.5	-4.3 (-2.8)	3.2
Borxhi i jashtëm bruto	48.2 (89.5)	40.8 (43.3)	28.9	31.4 (62.7)	35.5 (65.1)	50.0 (19.6)	35.1	35.9 (35.1)	42.6

Në vendet e marra si shembull, Korea, Malajzia dhe Tajlanda (konsiderohen si vende të cilat aktualisht kanë mundur të korrigjojnë shpërpjesëtimet kronike të llogarisë korente) eksportet rriten në mënyrë të dukshme. Eksperienca e këtyre vendeve çoi

në konkluzionin se zhbalancimet e mëdha në llogarinë korente kanë probabilitet më të vogël për të shkaktuar kriza të jashtme, kur ekonomia ka një bazë të madhe eksporti.

3.2.2 Kursi real i këmbimit

Një vlerësim i vazhdueshëm i kursit real të këmbimit udhëhiqet nga faktorë "themelorë", si rritja e lartë e produktivitetit të të mirave të tregtueshme ose nga koniukturat favorizuese të tronditjeve tregtare. Shkaqe të tjera që udhëheqin vlerësimin e monedhës kombëtare (në terma realë) mund të përmendim mosharmonizimin e politikës monetare të ndërmarrë me atë të kursit të këmbimit, rasti më tipik i të cilës shfaqet me mbivlerësimin e përqindjeve të brendshme të interesit. Pa u shkëputur nga faktorët që ndikojnë në vlerësimin e monedhës, si shumë të rëndësishme do të përmendim hyrjet e mëdha të kapitalit. Në vendet në zhvillim dhe në ato të Evropës Lindore, të cilat kanë ndërmarrë reforma të gjithanshme strukturore, janë shënuar hyrje të mëdha kapitali, gjë e cila ka rritur ofertën e valutës duke çuar kështu në vlerësimin e monedhës kombëtare. Është tepër e vështirë të gjykohet se një vlerësim real i monedhës kombëtare, pasqyron përmirësim të faktorëve themelorë dhe në çfarë mase ky vlerësim maskon çrregullimet në ekonomi. Megjithatë, të treja episodet e krizave të paraqitura karakterizohen nga një vlerësim i kursit real të këmbimit në periudhat që u paraprinë krizave. Të dhënat statistikore sugjerojnë, se zhbalancimi i madh i llogarisë korente ka probabilitet më të madh për të gjeneruar kriza kur ai shoqërohet nga një vlerësim relativ i kursit të këmbimit.

3.2.3 Investimet dhe kursimet e brendshme

Nivelet e larta të investimeve, duke siguruar rritje të kapaciteteve prodhuese përbëjnë një bazë të sigurt për një rritje të qëndrueshme në të ardhmen. Nga ana tjetër, raportet e mëdha të kursimeve dhe të investimeve përbëjnë një sinjal të sigurt për investitorët e huaj si dhe konturojnë një angazhim serioz të vendit, për rritje të qëndrueshme dhe shlyerje të borxhit të jashtëm në të ardhmen. Në të treja krizat kursimet ishin të ulta, veçanërisht në vendet në zhvillim me standard të mesëm të

ardhurash. Në të kundërt Korea, Malajzia dhe Tajlanda kishin nivele të larta kursimesh dhe investimesh.

3.2.4 Bilanci fiskal

Varësitë e vrojtuara ndërmjet deficiteve buxhetore dhe atyre korente, varësitë ndërmjet aftësisë paguese të buxhetit dhe arsyeshmërisë së llogarisë korente, në veçanti, janë më të forta në vendet ku roli i shtetit në tregun financiar është i lartë. Duke iu referuar dhjetë episodeve të ndodhura në gjashtë vendet në vrojtim (tabela 3) mund të konkludohet:

- nuk do të thotë se mungesa e deficiteve fiskale patjetër do të çojë në përmirësim të llogarisë korente. Eksperienca e Kilit dhe e Meksikës, të cilat në mënyrë respektive në periudhat 1979-1981 për të parin dhe 1991-1994 *për* Meksikën, rezultonin me suficite fiskale në masën 2.1 dhe 0.4 për qind të PBB-së;
- zhbalancimet e mëdha fiskale, pavarësisht nëse ato kulmojnë në arritjen e një krize të jashtme, në mënyrë të padiskutueshme kërkojnë një ndryshim rrënjësor të politikave. Siç e tregon dhe eksperienca e Meksikës, Malajzisë, Kolumbisë dhe Tajlandës, elementi kryesor i rregullimeve të politikës ekonomike është zvogëlimi rrënjësor i deficiteve fiskale. Zvogëlimi, në të katërta vendet çoi në përmirësimin e kursimeve publike dhe për rrjedhim, të bilancit të përgjithshëm të kursimeve duke ndihmuar në reduktimin e zhbalancimeve të jashtme;
- krizat e jashtme lënë një gjobë të rëndë për qeverinë në periudhën që pason krizën.

Ishte ky një përshkrim i ecurisë së gjashtë vendeve, të cilat për nga vendosja gjeografike, shtrirja sipërfaqësore, treguesit demografikë, niveli ekonomik i zhvillimit, niveli i interesimit të vendeve të zhvilluara kundrejt tyre etj., në mënyrë të padiskutueshme janë kryekëput në pozicione ekstreme me vendin tonë. Megjithatë, konkluzionet e nxjerra nga vrojtimi i episodeve në gjashtë vendet e mësipërme, janë aktuale dhe përbëjnë drejtimet themelore në të cilat vendimmarrësit shqiptarë duhet të përqendrojnë fokusin e punës së tyre. Në

vijim do të mundohemi t'i përgjigjemi pyetjeve: A përbën deficiti i llogarisë korente në Shqipëri një rrezik potencial për krizë? A duhet të mbështetet financimi i llogarisë korente nga burime të rastësishme dhe ilegale? Cilat janë pasojat e superlekut në pesë vjetët e fundit dhe në muajt e fundit të vitit 1998? A ekzistojnë mundësitë për një rigjallërim të eksporteve shqiptare? A do të mund të shfrytëzohet potenciali i madh turistik i vendit? A duhet rishikuar diçka nga pikëpamja e politikave të ndjekura?

3.3 DEFICITI KORENT: RASTI I SHQIPËRISË

Që në fillim do të sqarojmë tre momente shumë të rëndësishme për të vazhduar më tej me atë se çka duhet korrigjuar. Së pari, do të donim të përcaktonim nëse Shqipëria gëzon një deficit korent kronik. Së dyti, do të përpiqemi të sqarojmë nëse vendi ynë plotëson kriterin e aftësisë paguese në të ardhmen dhe së fundi, do të ballafaqojmë deficitin korent të Shqipërisë me kriterin e arsyeshmërisë.

1. Krahasuar me vlerën absolute të deficiteve korente të rezultuara në vende të tjera në tranzicion, pa dyshim shifra është shumë e vogël. Megjithatë, po të vihet në raport me tregues të tillë si PBB-në, borxhin e jashtëm, rezervat valutore etj. vihet re që përqindjet e përftuara janë serioze. Ato tregojnë se deficitet korente (rreshti i parë, i dytë dhe i tretë) e kanë shoqëruar vendin tonë në mënyrë të vazhdueshme dhe madhësia e tyre ka qenë e konsiderueshme, aq sa në dy vjetët e fundit fenomeni është bërë alarmant.

Pa dyshim, që të paktën për një periudhë afatmesme, deficiti i llogarisë korrente, për shkak të rënies së pritshme të dërgesave nga emigrantët[5] do të luhatet në nivelet aktuale (5-6 për qind të PBB-së)[6]. Sado që masat e marra do të përpiqen të zbusin deficitin tregtar, nuk është e mundur që të frenosh hyrjet e mallrave pa prekur ndjeshëm nivelin e konsumit. Nga ana tjetër, masat e marra për rigjenerimin e eksporteve i takojnë periudhave afatmesme dhe afatgjata, kështu që për dy-tre vjetët e ardhshëm do të vazhdojë një nivel i ulët eksportesh.

Në tabelën e mëposhtme janë llogaritur tre versione të llogarisë korente nga të cilat më i përshtatshëm mendojmë se është i pari. Është pikërisht versioni i parë, ai që shpreh potencialin e brendshëm të ekonomisë shqiptare për të gjeneruar burime të mjaftueshme valutore, në përgjigje të kërkesës së brendshme për mallra dhe shërbime të huaja.

Tabelë 4. Treguesit makroekonomikë të arsyeshmërisë.

		1992	1993	1994	1995	1996	1997
1	Llogaria korente/ PBB (përjashtuar transfertat)	-85,1	-44.2	-27.7	-21.7	-26.1	-24.9
2	Llogaria korente/ PBB (pa transfertat shtetërore)	-62.9	-21.8	-8.3	-6.1	-7.6	-13,2
3	Llogaria korente/PBB (pa transfertat private)	-29,7	-21,2	-21,6	-16,1	-22,6	-23,5
4	Llogaria korente/PBB	-7,5	1,2	-2,2	-0,6	-4,0	-7,5
5	Eksporti/PBB	10,4	9,1	7.2	8,3	9,0	7,1
6	Kursimet/PBB	-51.0	-14,9	3,6	11,3	9,0	1.2
7	REER (dhjetor 1993 = 100)		100,0	110,1	113,1	108,0	107,3
8	Deficiti fiskal/PBB	-17,0	-10,5	-12,5	-9,4	-12,5	-11,9
9	Totali i detyrimeve të huaja/PBB	78,0	45,9	35,6	13,4	15,1	20,0
10	PBB (miliona usd)	675,7	1.227,7	1.949,0	2.472,1	2.689,0	2263,5

Shënim.

1. *Llogaria korente që përfshin bilancin e mallrave, shërbimeve dhe të të ardhurave.*
2. *Përfshin bilancet e mësipërme plus transfertat private.*
3. *Përfshin bilancet e pikës 1 plus transfertat shtetërore.*
4. *Llogaria korente që përfshin bilancin e mallrave, të shërbimeve dhe të të ardhurave, transfertat korente.*
5. *Përfshin eksportin e mallrave.*
6. *Përfshin kursimet e sektorit shtetëror, privat dhe të individëve. Vlerësim i FMN.*
7. *Indeksi i kursit real efektiv të këmbimit. Nivel mesatar i periudhës.*
8. *Deficiti fiskal në përqindje të PBB-së.*
9. *Përfshihen të gjitha detyrimet që Shqipëria i ka pjesës së mbetur të botës, pavarësisht nëse detyrimi është ose jo i maturuar. Ky koncept është në përputhje me përkufizimin e Bankës Botërore për borxhin e jashtëm. Shifra korresponduese e vitit 1997 i takon faktit të 9-mujorit të parë të vitit në vazhdim.*
10. *Prodhimi i përgjithshëm i konvertuar në usd. Kursi i përdorur i korrespondon mesatares aritmetike të periudhës. PBB në çmime korente është vlerësim i Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj.*

Është e vërtetë se Shqipëria çdo vit, në formën e dërgesave nga emigrantët, ka përfituar shuma të mëdha valutore, të cilat, nuk kanë bërë gjë tjetër vetëm se kanë financuar në mënyrë

të drejtpërdrejtë pjesën e pambuluar të kërkesës së brendshme për mallra dhe shërbime të huaja (rreshti i dytë). Nga ana tjetër, llogaritja e tyre është thjesht një vlerësim dhe për rrjedhim, mbart në vetvete përqindje të caktuara pasaktësie (metoda e përdorur për vlerësim mund të përfshijë në këtë shifër edhe një kategori transaksionesh ilegale të rastësishme, të cilat nuk mund të dallohen). Për më tepër, ky burim jetik i periudhës që lamë pas, nuk mund të konsiderohet si një burim i qëndrueshëm dhe është shumë vështirë që pas ngjarjeve të fundit t'i rikthehet dhe një herë besimi emigrantëve për të depozituar kursimet e tyre në Shqipëri.

2. Nëse gjykohet se kriteri i aftësisë paguese ka të bëjë me gjenerimin e suficiteve tregtare në të ardhmen për të shlyer detyrimet e akumuluara, mund të themi se Shqipëria nuk e kënaq këtë kriter. Duke iu referuar rreshtit 5 dhe atij 9 të tabelës së mësipërme, vihen re dy fenomene të ndryshme, efekti i të cilave, në mënyrë automatike, çon në humbjen e aftësisë paguese të vendit, në të ardhmen, të detyrimeve të akumuluara nga e shkuara. Kështu, ndërsa raporti i eksporteve me PBB është tejet simbolik, mesatarisht 9 për qind për periudhën 1992-1996 dhe për vitin 1997 vlerësohet 7 për qind, detyrimet e huaja si raport ndaj PBB rriten në mënyrë të vazhdueshme duke shënuar 20 për qind në fund të vitit 1997[7].

Duhet theksuar se deri tani i jemi referuar vetëm stokut të borxhit aktual të lëvruar. Në qoftë se do të shtojmë disbursimet e parashikuara si dhe angazhimet e reja (rreth 600 milionë dollarë amerikanë për një periudhë trevjeçare) kuptohet raporti i tyre me PBB do të rritet ndjeshëm, duke u bërë një barrë gjithnjë e më e rëndë për ekonominë shqiptare.

Duke krahasuar shifrat tona me ato të 10 rasteve të përshkruara në pjesën e mësipërme vihet re se vetëm në tre raste (dy të Meksikës dhe një i Kolumbisë) raporti eksport me PBB është në kufirin 10-13 për qind, dhe siç e thamë më sipër në të dyja rastet e Meksikës, situata përfundoi në kriza financiare. Nga ana tjetër, shtetet që i shërbyen me sukses rritjes së eksporteve (rastet e vendeve aziatike ku raporti eksport me PBB zhvendoset

nga 30 për qind e sipër), mundësuan shmangien e katastrofave financiare.

3. Pa dyshim që çështja më e rëndësishme, siç trajtohet tashmë së fundi nga të gjithë studiuesit, është fakti nëse niveli i deficitit të llogarisë korente është i arsyeshëm apo më mirë të themi i tolerueshëm. Ashtu siç shpjeguam më sipër, ky kriter tregon nëse niveli aktual i deficitit imponon një pikë kthese, e cila presupozon marrjen e vendimeve të reja rregulluese, ekonomike dhe financiare.

Ndonëse në pamje të jashtme, nga studiuesit e ekonomisë në Shqipëri, çështjet e lidhura me llogarinë korente janë prekur shumë pak ose në njëfarë mënyre janë anashkaluar, vetë ekzistenca e programeve të mirëfillta makroekonomike (programi gjashtëmujor i stabilizimit korrik-dhjetor 1992, programi afatmesëm trevjeçar 1993-1995, programi aktual gjashtëmujor tetor 1997 - mars 1998) mbart në brendi masat korrigjuese jo vetëm për ekonominë në tërësi, por edhe për pozicionin e jashtëm të vendit në veçanti. Kështu, angazhimi i autoriteteve për zbatimin e politikave restriktive fiskale dhe monetare nuk bën gjë tjetër veçse frenon kërkesën e brendshme, që do të thotë konsum më i ulët, e për rrjedhim më pak importe mallrash e shërbimesh.

4. VËSHTRIM I HOLLËSISHËM MBI FAKTORËT QË KUSHTËZOJNË ECURINË E LLOGARISË KORENTE NË SHQIPËRI

Më sipër kemi përmendur se Shqipëria gëzon avantazhe të tilla si krahu i lirë i punës, pasuritë nëntokësore, burimet e bollshme hidroenergjitike, vendndodhja gjeografike, potenciali i madh turistik etj.. Por, po kaq e vërtetë është se aktualisht Shqipëria ndeshet me mungesë totale të institucioneve të specializuara, me një infrastrukturë tejet të amortizuar, me potenciale prodhuese të paprivatizuara, me forma tregjesh tepër "origjinale", me fuqi punëtore të pakualifikuar, me

ekonomi private shumë të copëzuara, me mungesë të plotë të çdo forme kooperimi etj.. Duke bërë një balancim të kësaj bashkësie faktorësh, duket se sa vështirë është të konkludohet nëse ekziston një ambient i përgjithshëm ekonomik i favorshëm, shumë i favorshëm apo aspak i favorshëm për të gjithë atë grup faktorësh që në kompensim të tyre, injektojnë apo thithin në ekonominë e brendshme para të huaja.

Pavarësisht nga sa më sipër, në tërësinë e kushteve më të domosdoshme për rritjen e prurjeve valutore në ekonominë e brendshme, literaturat citojnë stabilitetin makroekonomik, liberalizimin e transaksioneve të llogarisë korente, politikat valutore, heqjen ose lehtësimin, e kuotave dhe tarifave për eksport, krijimin e një ambienti të përshtatshëm për investimet e huaja, funksionimin normal të tregut financiar dhe të atij të kapitalit në veçanti, ngritjen e bankave dhe të instituteve të sigurimit të specializuara për mbështetjen me fonde të programeve të eksportit, privatizimin e shpejtë dhe transparent të ndërmarrjeve të sektorëve të ndryshëm ekonomikë, emetimin e letrave me vlerë për projekte ambicioze etj..

4.1 STABILITETI MAKROEKONOMIK

Pas kolapsit të përgjithshëm në fillim të viteve '90, në fund të vitit 1992 u mundësua frenimi i rënies së mëtejshme të prodhimit të përgjithshëm. Vitet që pasuan, regjistruan një qëndrueshmëri të përgjithshme, e cila pasqyrohet në ritme të larta rritjeje, në normë inflacioni nën kontroll dhe në një deficit buxhetor në linjë me objektivat e vendosur. Fundi i '96 dhe viti 1997 kthyen kokëposhtë çdo gjë dhe për pasojë ekonomia u zhyt në një tjetër krizë, ndonëse jo në përmasat e asaj të mëparshme.

Megjithatë, ndryshe nga kriza e mëparshme, mundësitë për ta kontrolluar dhe për të rivendosur një ekuilibër modest të ekonomisë, janë më të shumta. Programi i mbështetjes së FMN-së, përbën një garanci tjetër për arritjen e ekuilibrit të dëshiruar makroekonomik.

Pa dashur të përsërisim atë çka thamë më sipër, na duket me vend të theksojmë një dukuri që në periudhën të cilës i referohemi, u shndërrua në një katalizator fatal për precipitimin e ekonomisë në krizë. Që nga viti 1992 e në vazhdim, karakteristika kryesore e programeve makroekonomike të hartuara, ka qenë ndjekja e një politike të shtrënguar monetare, instrumenti kryesor i të cilës ishte aplikimi i kufijve mbi kreditin e brendshëm për ekonominë.

Nga ana tjetër, në mënyrë paradoksale importet, si të makinerive e pajisjeve dhe të mallrave të konsumit, janë rritur nga viti në vit. E në kushtet e mungesës së plotë të tregut të kapitaleve dhe kufizimeve në tregun e kreditit është e kuptueshme (zhvillimet e vërtetuan plotësisht) që nevojat për financim u plotësuan nga tregu joformal. Indiferenca ndaj këtij tregu, pasiviteti për integrimin e tij, injorimi total i vëllimit të transaksioneve që realizoheshin jashtë programit të autoriteteve, bënë që kolapsi të ishte i paevitueshëm.

Megjithë goditjen që mori, tregu joformal është përsëri i pranishëm dhe nuk është çudi që shumë shpejt të shndërrohet në një gllabërues fondesh. Njësoj si në periudhën të cilës i referohemi, ineficienca e tregut të kapitaleve, parasë dhe këmbimeve valutore, korniza ligjore nuk kanë ndryshuar dhe për rrjedhim, janë një burim potencial për çrregullime. Kemi përshtypjen se në programin afatmesëm që Shqipëria pritet të ndërmarrë, duke filluar që nga tremujori i dytë i vitit 1998, është e domosdoshme marrja e një pakete rregullimesh strukturore dhe e një programi të përpunimit intensiv të publikut.

4.2 LIBERALIZIMI I LLOGARISË KORENTE DHE KAPITALE

Në korrik të vitit 1994, Banka e Shqipërisë miratoi "Rregulloren e tregut valutor", në të cilën për herë të parë u sanksionua liberalizimi total i pagesave për mallra, shërbime, të ardhurat dhe transfertat korente. Ndërkohë që në pjesën e llogarisë kapitale, u lejua pa asnjë lloj kufizimi, riatdhesimi i kapitaleve fillestare dhe i fitimeve të realizuara nga investitorët e huaj.

Parë në këtë prizëm, mund të thuhet se një nga faktorët parësorë në nxitjen e tregtisë me jashtë ka kohë që është realizuar, megjithëse ndikimi i tij konkret në drejtim të eksporteve nuk duket se ka dhënë efektin që duhej. Nga ana tjetër, restriksionet në llogarinë kapitale, me të drejtë mund të thuhet se kanë ekzistuar vetëm në letër dhe heqja e tyre *de jure,* me ligjin e miratuar në muajin dhjetor "Për Bankën e Shqipërisë", ishte një hap që duhej të ndërmerrej me kohë.

Megjithatë, problemi i liberalizimit të transaksioneve kapitale mbetet ende i diskutueshëm. Pyetja që shtrohet është nëse do të përdorë Banka e Shqipërisë autoritetin e vet për të mbajtur ende kufizimet mbi llogarinë kapitale? Ka argumente pro dhe kundër liberalizimit të transaksioneve kapitale. Rreziku më i madh që mund të shoqërojë këtë liberalizim është largimi i kapitaleve dhe i kursimeve të brendshme, aq më tepër në kushtet kur vështirësitë ekonomike të momentit rrisin shkallën e dyshimit ndaj reformave të ndërmarra nga autoritetet. Gjithashtu, eksperiencat tregojnë se liberalizimi i llogarisë kapitale mund të ushtrojë presione të shpeshta mbi kursin e këmbimit, në përgjigje të ndryshimeve sado të vogla në ambientin politiko ekonomik dhe destabilizim makroekonomik, si rrjedhim i luhatjeve në kapitalet afatshkurtra.

Eksperienca e viteve të kaluara tregoi se restriksionet e impozuara në llogarinë e kapitaleve ishin thjesht koncepte juridike, të cilat jo vetëm nuk penguan rrjedhjen e kapitaleve financiare jashtë shtetit, por përkundrazi eliminuan dhe përdorimin e kanaleve të specializuara në lëvizjen e fondeve nga brenda jashtë dhe anasjelltas. Siç e dimë, *de facto* ka kohë që lëvizjet e fondeve valutore në dy drejtimet realizohen pa vështirësi, megjithë rrezikun e madh që merret përsipër. Nga ana tjetër, heqja e kufizimeve në transferimet e kapitalit, përveç të tjerash, do të bindë çdo individ se është më mirë të shfrytëzojë lehtësitë që të ofron sistemi bankar se sa të priret drejt mënyrave të rrezikshme dhe aventureske. Për më tepër, megjithëse kufizimet janë të pranishme nuk janë, të paktën minimalisht, reduktuar luhatjet në kursin e këmbimit, në tregues të tjerë dhe në stabilitetin makroekonomik më gjerë.

Pasi kemi lënë pas periudhën pesëvjeçare, me të drejtë mund të thuhet se liberalizimi i transaksioneve korente dhe i atyre kapitale, përbënte thjesht heqjen e një kufizimi administrativ dhe asgjë tjetër. Megjithatë, edhe pas ndërmarrjes së një hapi të tillë, që në vetvete do të thotë një ekonomi tërësisht e liberalizuar ndaj të huajve, kuptohet që efektiviteti i këtij liberalizimi kërkon rregullime të tjera. Në botën e zhvilluar (edhe në një sërë vendesh të tjera të Evropës Lindore, të Amerikës Latine dhe të Azisë) transaksionet në llogarinë kapitale dhe në atë financiare gjithnjë e më shumë po bëhen faktorë të ruajtjes apo të prishjes së ekuilibrit të përgjithshëm.

Grafik 5. Kursi mesatar mujor i këmbimit (lekë për 1 usd).



Ndoshta madhësia e tregut shqiptar, legjislacioni i cunguar, infrastruktura e amortizuar, paaftësia e administratës etj., mendohet të jenë faktorë, të cilët zbehin ndjeshëm efektet pozitive që sjell heqja e kufizimeve në rrjedhjen e mallrave dhe vlerave monetare, nga jashtë brenda dhe anasjelltas.

4.3 POLITIKA E KËMBIMEVE VALUTORE

Që nga korriku i vitit 1992, në Shqipëri u përdor një regjim kursesh këmbimi fleksibël, në të cilin çmimet e monedhave të huaja në raport me lekun caktoheshin lirisht në varësi të kërkesë - ofertës. Pa u ndalur në shkaqet që çuan në aplikimin e këtij regjimi, në historikun e shkurtër të cilit i referohemi, leku është

karakterizuar nga një stabilitet relativisht i çuditshëm. Ndërkohë që kërkesa për monedha të huaja ka qenë e fortë, vazhdimisht është kompensuar me tepri nga një ofertë po kaq e lartë. Kjo ofertë e lartë, e cila ka mundësuar dhe vendosjen dhe ruajtjen e stabilitetit të monedhës kombëtare (pa lënë pas dore masat shtrënguese të politikës monetare që me fillimin e reformës në korrik të 1992) nuk është siguruar nga faktorët prodhues dhe hyrjet në formën e kapitalit financiar, por thjesht nga dërgesat spontane të emigrantëve dhe për më tej, nga aktivitete rastësore dhe të jashtëligjshme.

Grafik 6. Kursi real efektiv i këmbimit
(Indeks, dhjetor 1993=100).



Megjithatë, në muajt e parë të vitit 1997, stabiliteti pothuajse katërvjeçar u përmbys dhe për rreth 6 muaj leku humbi rreth 80 për qind të vlerës së tij, jo vetëm kundrejt dollarit por edhe ndaj monedhave të tjera të forta (ndonëse jo në të njëjtën masë) që operojnë në treg. Siç shikohet dhe në grafikun 5, në muajin qershor 1997, 1 dollar amerikan kushtonte mesatarisht 180 lekë. Gjithsesi, kjo shifër u pa të ishte e përkohshme dhe shumë shpejt leku fitoi terren dhe siç shikohet përsëri në grafikun 5, në muajin nëntor, 1 dollar amerikan blihej mesatarisht me 143 lekë.

Shkurtimisht do të ndalemi në spektrin e politikave të ndjekura dhe të implikimeve që ato kanë pasur, në ecurinë e llogarisë korente. Meqenëse regjimi i zgjedhur është një formë e pastër e kursit luhatës të këmbimit, kuptohet që çmimi

i monedhës kombëtare është vendosur lirshëm në treg, në bazë të kërkesës dhe të ofertës. Aplikimi i një regjimi të tillë nuk presupozon ndërhyrjet e Autoritetit Monetar dhe në këtë kuadër, nuk presupozon përdorimin e rezervave valutore të vendit për ruajtjen e një niveli të caktuar të kursit të këmbimit. Konkretisht, ndërhyrjet e realizuara kanë qenë sporadike dhe të pakta, duke synuar shmangien e spekulimeve në treg. Megjithatë, pa u shmangur nga realiteti, ndonëse në mënyrë jo të hapur, preferenca e autoriteteve ka qenë ruajtja një superleku (një ëndërr e gënjeshtërt dhe që në asnjë mënyrë nuk duhet të përsëritet) ndërkohë që rregullimet e bëra për mbështetjen e një leku të qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të burimeve të qëndrueshme valutore, kanë qenë tejet modeste dhe krejt spontane.

Ndër nxitësit e ofertës së madhe në valutë, do të veçonim lulëzimin e tregut joformal. Interesat që aplikonte ky treg, bënë që vëmendja e emigrantëve shqiptarë si dhe një numër i konsiderueshëm personash jorezidentë, të investonin sasi të mëdha në këto skema, duke siguruar kështu sasi të mëdha hyrjesh valutore, të mjaftueshme për të financuar deficitin gjithnjë e në rritje të tregtisë dhe të shërbimeve. Nga ana tjetër, një nivel i lartë i aktiviteteve të jashtëligjshme, të manifestuara në formën e një kontrabande të pastër, në mënyrë të pandërprerë (embargo kundër Jugosllavisë, trafiku i klandestinëve dhe prostitucionit) siguronte në mënyrë të vazhdueshme hyrje të mëdha valutore. Pra, siç shihet, burimet kryesore të ofertës për monedha të huaja ishin identike me zërat kryesorë financues të deficitit të llogarisë korente dhe për rrjedhim, ndjeshmëria e lartë e reagimit të këtyre burimeve ndaj rrethanave të caktuara ekonomiko-politike bëri që dhe kursi i këmbimit dhe për rrjedhim, deficiti i llogarisë korente, të ndiqnin besnikërisht nivelin e dy burimeve të sipërpërmendura.

Duke përgjithësuar sa më sipër, mund të arrijmë në konkluzionin se niveli aktual i këtyre dy zërave të bilancit të pagesave (dërgesa nga emigrantët dhe gabime dhe harresa) është përcaktuesi kryesor i kursit të këmbimit, ndërkohë që efekti i anasjelltë i ecurisë aktuale të kursit të këmbimit, nuk mund të

thuhet se do të kushtëzojë ecurinë e shtimit apo të pakësimit të këtyre dy zërave[8].

Nga ana tjetër, vetë kursi i këmbimit asnjëherë nuk ka luajtur rolin e një katalizatori në nivelin e tregtisë së jashtme, aq më shumë po t'i referohemi eksporteve. Nuk mund të thuhet se në Shqipëri, në përgjigje të një sasie më të madhe lekësh në këmbim të njësisë së një monedhe të huaj, tregtarët apo prodhuesit shqiptarë do të preferonin të tregtonin jashtë kufijve, në vend të tregut të brendshëm. Kjo për një arsye të vetme, se në Shqipëri gjatë periudhës që i referohemi, sasia fizike e mallrave dhe e shërbimeve të prodhuara, në përgjithësi dhe për eksport në veçanti, ka qenë aq e ulët sa për të mos thënë inekzistente.

Megjithatë, ashtu siç u evidentua dhe në pjesën e mësipërme, kur iu referuam 10 rasteve të ndryshme të marra nga 6 vende në zhvillim, vlerësimi në terma realë i kursit efektiv të këmbimit për një kohë të gjatë, nuk bën gjë tjetër veçse çon në përkeqësimin e deficitit të llogarisë korente dhe është pararendës i krizave valutore. Konkretisht, duke iu kthyer përsëri tabelës 4, rreshti 7 vihet re se pas një zhvlerësimi të shpejtë në vitet 1993, '94, '95 në dy vjetët e fundit, indeksi i kursit efektiv real të këmbimit ka filluar të bjerë me shpejtësi, duke treguar një vlerësim të lekut përkatësisht në masën 4.5 dhe 0.6 për qind për vitin 1996 dhe për atë 1997.

Pavarësisht nga sa u tha më sipër, një sërë çështjesh kërkojnë përgjigje. A mund të shndërrohet kursi i këmbimit në një faktor nxitës të eksporteve? A i intereson Shqipërisë të ruajë me fanatizëm një lek të qëndrueshëm, ndërkohë që kapacitetet prodhuese janë të shkatërruara dhe sistemi financiar karakterizohet nga një sërë mangësish, eliminimi të cilave për shkaqe objektive është tejet i vështirë?

Megjithëse, niveli i rezervave valutore është akoma i ulët, kemi mendimin që në spektrin e politikave valutore të këmbimit, të zbatohet një kurs këmbimesh i luhatshëm, i rregulluar. Pa u ndalur në përkufizimin teorik të regjimit të luhatshëm të këmbimit, është e ditur se ky lloj regjimi rregullon ose eliminon deficitet apo suficitet e bilancit të pagesave. Megjithatë, gjatë aplikimit

të regjimit të luhatshëm, flukset valutore të cilat tentojnë që të eliminojnë automatikisht deficitet në pozicionin e përgjithshëm, shfaqin një sërë problemesh të dukshme si shkalla e lartë e papërcaktueshmërisë, përkeqësimi tregtar, frenimi i investimeve, ekspozimi i madh ndaj spekulimeve, inflacioni i lartë në terma afatgjatë etj..

Një version tjetër, i cili në spektrin e regjimeve të mundshme për t'u aplikuar (nga regjimi fiks në atë fleksibël), qëndron një hap më para kursit të këmbimit të luhatshëm është regjimi i kursit të këmbimit të luhatshëm të rregulluar. Në njërën anë, është i mirënjohur fakti se ndryshimi i kushteve ekonomike ndërmjet vendeve të ndryshme imponon ndryshime të vazhdueshme në kursin e këmbimit, për të shmangur deficitet ose suficitet e qëndrueshme si dhe në anën tjetër, ndryshimet afatshkurta të kursit të këmbimit tentojnë të çorientojnë dhe të dekurajojnë flukset tregtare dhe financiare. Prandaj, në përgjithësi, në shumë vende të botës, bankat qendrore blejnë ose shesin mjete valutore të huaja, me qëllim që të zbusin ndryshimet e mëdha dhe të menjëhershme të kursit të këmbimit. Me fjalë të tjera, bankat qendrore duhet që të administrojnë ose të stabilizojnë ndryshime spekulative në normat e këmbimit.

Aktualisht, duket sikur Banka e Shqipërisë një politikë të tillë e ka ndjekur prej kohësh. Megjithatë, po të shihen me vëmendje, ndërhyrjet kanë qenë me synime modeste dhe për pasojë, efekti ka qenë minimal. Përgjithësisht, kanë tentuar të frenojnë zhvlerësimin e monedhës kombëtare, dhe janë realizuar kryesisht në momente specifike për vendin, si fushata zgjedhjesh apo periudha paqartësie ekonomike dhe politike, dhe në një apo dy raste ato kanë tentuar të eliminojnë spekulimet. Por, duhet pranuar se efekti ka qenë i menjëhershëm pavarësisht nga sasia minimale e rezervave të përdorura.

Ky fakt është mjaft domethënës, sepse tregon që kostoja e orientimit të tregut është relativisht e ulët dhe objektivi për të kontribuar në një zhvlerësim nominal të lekut prej 10 për qind çdo vit, është lehtësisht i realizueshëm. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që Banka e Shqipërisë do t'i qëndrojë me fanatizëm shifrës

së mësipërme. E thënë ndryshe, kjo do të thotë që në kushte të një stabiliteti të përgjithshëm politiko-ekonomiko-financiar, Banka do të tentojë të zhvlerësojë vlerën e lekut me 10 për qind. Nga ana tjetër, kjo nuk presupozon ndërhyrje të Bankës për të shmangur një zhvlerësim të lekut shqiptar mbi këtë kuotë, gjithnjë nëse stabiliteti i përgjithshëm konsiderohet i vendosur.

Grafik 7. Krediti i brendshëm në sektorin formal
(në miliona lekë, fluksi për periudhën).



Efektet e kësaj politike valutore në zbutjen e deficitit korent, në radhë të parë do të manifestohen në uljen graduale të deficitit tregtar. Kuptohet që importet do të bëhen më të shtrenjta për shqiptarët, ndërkohë që në këmbim të një njësie të eksportuar, do të sigurohet më shumë monedhë kombëtare. Me këtë rast, nuk pretendohet t'i vihet fre konsumit e për rrjedhim nivelit të mirëqenies, por në radhë të parë, nisur nga parimi i zëvendësimit, kjo do të shërbejë si një rrugë e tërthortë për të nxitur prodhimin e brendshëm. Dihet se një gamë e gjerë mallrash konsumi, për të cilat ekzistojnë mundësitë optimale për t'u prodhuar në vend, për shkaqe nga më të ndryshmet, importohen. Pra, siç shihet, zhvlerësimi i moderuar i lekut do të ruajë kompetitivitetin e ekonomisë shqiptare.

Nga ana tjetër, për vetë efektet psikologjike që do të shkaktojë një politikë e tillë do të rrisë pritshmërinë e njerëzve për një kurs më të mirë këmbimi në shitje. Kjo do të bëjë që në çdo moment të rrijë pezull, në formë kursimesh, një shumë e konsiderueshme

e të ardhurave nga emigrantët dhe njëkohësisht, më pak fonde të lira do të jenë disponibël për financimin e tregut informal nga ky burim.

4.4 NIVELI I KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE

Pa dyshim që periudha që lamë pas i dha një shans historik Shqipërisë për të krijuar një nivel të përgjithshëm ambicioz kursimesh të brendshme. Themi nivel të përgjithshëm sepse dihet që, përveç të ardhurave të krijuara nga shfrytëzimi i burimeve të brendshme, Shqipëria gëzoi avantazhin e madh të thithjes së një sasie të pallogaritshme fondesh nga komuniteti ndërkombëtar ashtu si dhe nga puna e shqiptarëve në mërgim. Pra, siç shihet, ekzistonin të gjitha mundësitë për të krijuar një pozicion të përgjithshëm pozitiv kursimesh si në sektorin publik, në sektorin privat ashtu edhe në atë të individëve.

Është e vërtetë se fillimet e dhjetëvjeçarit aktual e gjetën Shqipërinë me deficite të mëdha sektoriale, gjë që reflektohej në një pozicion negativ të llogarisë korente në të gjithë sektorët, duke filluar që nga pozicioni i Qeverisë e deri në atë të individëve. Rënia e prodhimit në vitet 1991, 1992 i thelloi më tepër deficitet e brendshme sektoriale duke çuar në thellimin e shpejtë të borxhit të jashtëm të vendit, i cili në fund të vitit 1992 përbënte rreth 78 për qind të prodhimit të përgjithshëm. Në shpjegimet e dhëna për ecurinë e transferimeve korente dhe të atyre kapitale e financiare, u evidentua një nivel i lartë i hyrjeve në formën e transfertave korente dhe të kredive me kushte lehtësuese nga njëra anë, dhe hyrje modeste në formën e investimeve direkte, nga ana tjetër. Gjithashtu, periudha që pasoi vitin 1992 u karakterizua nga ritme të larta rritjeje ekonomike, duke krijuar premisa realë për shëndoshje të deficiteve sektoriale të trashëguara. Megjithatë, në mungesë të politikave rregulluese dhe orientuese çdo burim të ardhurash u prir drejt konsumit, i cili në fund të vitit 1996 arriti pikun e tij me rreth 1.5 miliardë dollarë amerikanë. Megjithatë, gjatë periudhës në fjalë, pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të krijuara u investuan në forma të ndryshme, nga të cilat dominuese kanë qenë investimet në

degën e ndërtimit, të shërbimeve, në industrinë e lehtë dhe diçka në atë ushqimore. Por, duhet theksuar se këto investime i takonin sektorit privat të ekonomisë. Një pjesë e vogël e projekteve të huaja u kanalizua nga sektori publik, të cilat kryesisht synonin përmirësimin e sistemit energjitik të vendit, të furnizimit me ujë dhe atij të telekomunikacionit.

Gjithsesi, duke i bërë një analizë të fundit mund të thuhet se niveli i lartë i të ardhurave (në çfarëdo lloj forme të mundshme), nuk u ballafaqua me mentalitetin sa të lashtë aq dhe bashkëkohor të të shpenzuarit të parave. Këto burime të çmueshme nuk u përballën kurrë me një politikë të drejtë kursimi dhe investimi, që të mbështeste rrjedhjen e këtyre fondeve në drejtim të atyre degëve të prodhimit që i shërbenin eksportit, ndërkohë që ato nuk bënë gjë tjetër veçse nxitën konsumin dhe krijuan një ide të gabuar mbi investimin dhe rrezikun që e shoqëron atë. E, pa dyshim, në këtë mes faji kryesor i takon vendimmarrësve.

Pa lënë mënjanë pengesat objektive që ekzistojnë në Shqipëri dhe që kanë të bëjnë me probleme të infrastrukturës, mentalitetit, varfërisë së madhe të trashëguar, boshllëkut ligjor dhe institucional, përmasave gjeografike, demografike dhe të tregut etj., të cilat në njëfarë mënyre shërbejnë si argumente justifikuese, do të donim të ndaleshim edhe në momentet e mëposhtme:

Së pari, dhe pa dyshim më e spikatura, është dalja jashtë kontrollit e tregut informal, i cili në fund degjeneroi në një sistem të pastër piramidal, pasojat e të cilit nuk kanë nevojë për koment, dhe pak a shumë janë pasqyruar edhe në pjesën e parë të këtij materiali.

Së dyti, megjithëse që prej më shumë se katër vjetësh nga Parlamenti u miratua ligji "Për mbrojtjen dhe nxitjen e investimeve të huaja" dhe njëkohësisht u krijua Agjencia për Nxitjen e Investimeve të Huaja, ky angazhim politik nuk u pasua me krijimin *de facto* të institucioneve që do të konkretizonin këtë angazhim. Nga eksperienca e vendeve të Evropës Lindore, të cilat akoma nuk kanë ndërtuar një demokraci të konsoliduar dhe

ku problemet ekonomike dhe sociale janë të shumta, vendimi për të krijuar institucionet e garantimit të investitorëve të huaj dhe të aktiviteteve prodhuese me synim eksportin, ka qenë shumë i suksesshëm. Megjithëse ligji garanton trajtim jodiskriminues nga ana e autoriteteve, është fakt, se institucioni që do të sanksiononte eliminimin e rrezikut politik[9] ka munguar. Ç'është më e keqja, pasojat e kësaj do të ndihen edhe për një periudhë afatmesme. Megjithatë, eksperienca e Bosnjes tregoi se garantimi nga një institucion shtetëror për eliminimin e rrezikut politik, krijon një ambient shumë atraktiv në të cilin rezultatet janë të shpejta.

Së treti, praktikisht nuk funksionoi hallka e specializuar që do të lidhte kursimet me investimet. Sistemi bankar, si ndërmjetësi më i specializuar, as që u përpoq ta luante këtë rol dhe *de facto* nuk do të mund ta luante këtë rol. Brishtësia e sistemit financiar, mungesa e bankave private, sistemi primitiv i pagesave, niveli i pakënaqshëm i shërbimit, aplikimi i kufizimeve në aktivet e brendshme, mungesa e institucioneve të specializuara financiare (bankat e zhvillimit dhe shoqëri sigurimi që financojnë dhe garantojnë eksportet) etj., mbështesin idenë e mësipërme për pamundësinë e sistemit bankar në kryerjen me efektivitet të ndërmjetësit.

Kështu u lanë jashtë këtij procesi mjetet monetare që qarkullonin çmendurisht në tregun informal, i cili, duke u paraqitur si mundësia më e mirë për investim, e shmangu vëmendjen nga prodhimi dhe nxiti vetëm konsumin, duke rritur importin dhe për rrjedhim, deficitin tregtar.

Grafiku 3 ilustron bindshëm se cila pjesë e dërgesave të emigrantëve[10] depozitohej në bankat tregtare në formën e depozitave[11] me dhe pa afat, pavarësisht se ishin të shprehura në lekë ose në valutë të huaj. Ndërsa grafiku 7, nga njëra anë ilustron potencialin e madh investues të siguruar nga dërgesat e emigrantëve dhe financimin e brendshëm që bankat e nivelit të dytë kanë realizuar efektivisht, nga ana tjetër.

Një gabim tjetër i mundshëm ka qenë mosparaqitja e saktë e nevojave të vendit në kuadrin e projekteve të ndihmës dhe

bashkëpunimit shumëpalësh e dypalësh, si dhe paaftësia e administratës për finalizimin. Fakti i mësipërm evidentohet në mosdisbursimin[12] prej 270 milionë dollarësh nga 520 milionë dollarë amerikanë të premtuara nga donatorët, qeveritë, institucionet financiare të huaja etj..

4.5 PRIVATIZIMI

Pas tabusë 50-vjeçare mbi formën shtetërore të pronësisë, në fillim të viteve '90, ndër masat e para të marra për decentralizimin e ekonomisë ishte privatizimi i tokës, një proces i cili u realizua relativisht shpejt. Privatizimi i tokës u pasua nga një strategji globale privatizimi, etapat e të cilës konsistonin në privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe më tej pas plotësimit të kuadrit ligjor, të procedohej me privatizimin masiv të ndërmarrjeve të mëdha.

Objektivat e kësaj sipërmarrjeje të madhe ishin ambiciozë dhe kryesisht, kishin për qëllim transferimin e pronësisë shtetërore në duart e biznesit privat, me qëllim që efikasiteti dhe fleksibiliteti i këtij sektori të bëheshin promotorë për rigjenerimin e kapaciteteve prodhuese, të cilat në fund të dekadës së kaluar dhe në fillim të viteve '90 ishin krejt të amortizuara. Pa gjykuar nëse u gjet rruga më e përshtatshme për privatizimin, fakt është se fundi i vitit 1997, ndër të tjera evidentoi:

- megjithëse privatizimi i tokës u konsiderua si proces i mbyllur që prej vitit 1992 është fakt se ka akoma kontradikta në përcaktimin e saktë të kufijve dhe nga ana tjetër, edhe në ato zona ku këto probleme janë kapërcyer nuk lejohet shitblerja e tokës së punueshme si dhe nuk ekziston asnjë lloj kooperimi. Dihet që në këta shtatë vjet lëvizjet e popullsisë drejt zonave urbane (sidomos drejt kryeqytetit) kanë qenë shumë të mëdha, duke çuar në një ulje të dendësisë së popullsisë në zonat rurale. Gjithashtu, është për t 'u përmendur se skemat e investimit gllabëruan jo vetëm kursimet e këtyre, por edhe gjënë e gjallë që u konvertua në para. Të gjithë këta faktorë bënë që efekti

i privatizimit të zbehej ndjeshëm. Për rrjedhim, prodhimi bujqësor pas gjallërimit në vitet 1992-1994 mbeti në nivele të ulta rritjeje, gjë që çoi në rritjen e importeve për produkte bujqësore.

Shqipëria konsiderohet vend bujqësor dhe në eksportet tradicionale prodhimet bujqësore kanë qenë të rëndësishme. Ndoshta, është momenti i përshtatshëm për aplikimin e politikave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta fiskale dhe financiare për të nxitur forma të ndryshme kooperimi, epërsia e të cilave nuk ka nevojë për koment. Për aq kohë sa ekonomia bujqësore do të jetë e copëzuar në mijëra pjesë, mundësia për të shfrytëzuar favoret ose epërsitë e teknikës, biologjisë dhe financave do të mbetet një nocion abstrakt. Gjithsesi, si një proces i ndërlikuar, kërkon dhe përmirësim të kornizës ligjore ku si prioritet do të ishte rregullimi i marrëdhënieve për shitblerjen e tokës etj..

- Në fillim të viteve '90 industria shqiptare karakterizohej nga ekzistenca e një numri të madh ndërmarrjesh prodhuese, shërbimi, eksport-importi etj., të cilat për nga forma e madhësia mund të klasifikoheshin të vogla, të mesme dhe të mëdha. Eksporteve shqiptare u ka shërbyer një numër i vogël nga kjo mori e madhe ndërmarrjesh, kryesisht një grup minierash i lokalizuar në pjesën verilindore të vendit. Pjesa tjetër, jo vetëm që nuk i kontribuonte, por në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90, si rezultat i amortizimit total moral e fizik u shndërruan në kapacitet prodhues pa asnjë vlerë, që thithte subvencione të mëdha nga buxheti i shtetit. Privatizimi i deritanishëm nuk ka bërë gjë tjetër, veçse, këtë grup joeficient ndërmarrjesh të vogla e të mesme e ka transferuar në duar të tjera, të cilat për hir të së vërtetës treguan se nuk ishin të afta as t'i riaktivizonin e jo t'i shërbenin eksportit.

Nga ana tjetër, ato njësi prodhuese të cilat tradicionalisht kanë siguruar pjesën dërrmuese të eksporteve shqiptare, u riorganizuan në forma drejtimi të centralizuara (Albkromi, Albbakri, KESH, Albpetroli etj.), të cilat siç i kemi përmendur edhe më sipër, në mënyrë graduale por sistematike, degjeneruan dhe sot gjenden në situata tejet të rënduara ekonomiko-financiare.

Pra, krijimi i një shtrese të re pronarësh të vegjël, e cila në mungesë të asistencës teknike dhe financiare rezultoi joefektive nga njëra anë, dhe abuzimi sistematik me të ashtuquajturat korporata të mëdha shtetërore nga ana tjetër, bënë që kontributi i prodhimit industrial në rritjen e prodhimit të përgjithshëm të ishte i papërfillshëm për rrjedhojë, dhe në rritjen eksportit. Ndoshta, në të ardhmen e afërt, prioritet i privatizimit do të jetë thjeshtimi në maksimum i procedurave burokratike dhe dhënia e një sërë lehtësive, të paktën për dy - tre vitet e para, pasi vetëm kështu do të mundësohet tërheqja e investitorit strategjik, aftësia administruese e të cilit dhe intuita për të fituar, është e padiskutueshme.

4.6 BORXHI I JASHTËM PEZULL

Pas faljes së borxhit të jashtëm të prapambetur, në tremujorin e tretë të vitit 1995, Shqipëria fitoi statusin e një shteti pa detyrime të prapambetura. Megjithatë, si rezultat i kredive të disbursuara në periudhën 1992-1995, shuma e detyrimeve ndaj jorezidentëve në fund të vitit 1995, llogariste rreth 15 për qind të prodhimit të përgjithshëm, krahasuar me 40 për qind në fund të vitit 1994. Gjithsesi, fundi i vitit 1997 regjistroi një gjendje borxhi të jashtëm prej rreth 500 milionë usd, një barrë kjo tejet e rëndë për ekonominë në të ardhmen afatmesme. Megjithëse kjo shumë përbën kredi me terma shumë lehtësuese dhe afatgjata, duke shtuar dhe angazhimet e marra nga donatorët e huaj (600 milionë usd për tre vjetët e ardhshëm) kuptohet që ringjallja e kapaciteteve të ekonomisë shqiptare për të gjeneruar burime të mjaftueshme valutore, merr një rëndësi themelore. Kjo për vetë logjikën se:

Së pari, rritja e vazhdueshme e stokut të borxhit, i humbet Shqipërisë mundësinë për të financuar deficitet e sektorit të jashtëm me borxh të ri.

Së dyti, rritja e borxhit të jashtëm shoqërohet në mënyrë të pandërprerë me rritjen e borxhit të brendshëm fakt i cili, në një mënyrë ose një tjetër, konsumon burimet e brendshme të

financimit, të cilat do të përdoreshin për shlyerjen e borxhit të jashtëm.

Së treti, në kushtet e ekzistencës së një deficiti kronik korent rritja e pandalshme e borxhit gjithsej bëhet premisë për përkeqësimin e pandalshëm të deficitit korent, i cili mund të shpërbëjë të gjithë ekuilibrat.

Së katërti, paaftësia e dukshme për të nxitur rritjen e eksporteve si dhe paaftësia e theksuar për të zhvendosur pjesën e shtuar nga konsumi në investime, përforcojnë bindjen se rreziku potencial për të ndodhur një krizë valutore është real.

Së pesti, mbas rreth pesë vjetësh, niveli aktual i rezervës valutore, megjithë rritjen në vlerë absolute, vazhdon të jetë modest. Një frenim i menjëhershëm i financimit të huaj do ta reduktonte atë thjesht në një koncept financiar (shih grafikun 9).

Grafik 8. Borxhi i jashtëm pezull dhe eksporti (në përqindje ndaj PBB).



Më lart, në shembullin e marrë nga episodet e ndodhura në disa vende të Amerikës Latine e të Azisë, zgjidhjet e dhëna në vendet e Azisë Juglindore trajtohen si rastet më të suksesshme dhe treguesit ekonomikë të tyre konsiderohen të kënaqshëm. Megjithatë, eksperienca e muajve të fundit të vitit kaluar, tregoi se këto ekonomi të suksesshme u ballafaquan me kriza valutore, si rezultat i të cilave tregjet e kapitalit dhe ato të këmbimeve

valutore, pësuan goditje të papara. Eksperienca e kohëve të fundit e vendeve aziatike, tregoi se një vend nuk mund të jetë pambarimisht atraktiv për investitorët e huaj. Megjithëse këto vende në periudhat e mëparshme bënë çmos për t'i shërbyer zbutjes së deficitit korent në të ardhmen, aktualisht ato nuk mund të bënin asgjë në rrethanat e ndërprerjes së influkseve afatshkurtra të kapitalit (ndryshimi i preferencave të investitorëve)[13]. Nga sa më sipër, kuptohet që çdo vend, pavarësisht nga niveli i raportit të eksporteve ndaj PBB, borxhit të jashtëm etj., mund të përballet me kriza në qoftë se nuk gjen rrugë për të thithur mjete të huaja, të cilat nga ana e tyre nuk duhet të rrisin në mënyrë eksesive detyrimet afatshkurta dhe ato afatmesme.

Grafik 9. Rezervat valutore dhe importi (në milionë usd).



Duke iu rikthyer edhe një herë tabelës 4 vihet re se, që nga fundi i vitit 1996 tregues të tillë si llogaria korente, eksporti, deficiti fiskal, detyrimet e huaja janë përkeqësuar, duke arritur në nivele kritike në fund të vitit 1997. Siç vihet re nga grafiku 8, mund të thuhet se Shqipëria në kushtet aktuale nuk është e aftë të gjenerojë suficite të mjaftueshme tregtare në të ardhmen.

Në këto rrethana, përveç prioritetit themelor që është nxitja me të gjitha mjetet e mundshme e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, përparësi mbetet trajtimi i kujdesshëm i fondeve që Shqipërisë i hyjnë në formën e dërgesave nga emigrantët, aktivitetet rastësore dhe flukse të tjera kapitali afatgjatë.

Regjistrimet e bilancit të pagesave tregojnë se në përgjithësi, këto të ardhura janë shfaqur me luhatje, por kanë ruajtur një nivel të lartë. Gjithashtu, gjatë gjithë periudhës së marrë në shqyrtim, e sidomos në vitet e fundit, aktivitetet e jashtëligjshme kanë siguruar burime valutore në rritje. Duhet pranuar se të dy këta faktorë financues nuk mund të llogariten si burime për gjenerimin e valutave. Nga njëra anë, aktivitetet e jashtëligjshme as që mund të mendohen si burime financimi, ndërkohë që transfertat varen në dëshirën e emigrantëve dhe mund të reduktohen në dërgesa minimale jetese.

Grafik 10. Borxhi gjithsej pezull (në përqindje ndaj PBB).



Në pjesën e parë të këtij materiali kemi argumentuar se edhe për disa kohë (të paktën për një periudhë afatmesme), transfertat korente do të kenë një rol vendimtar, por megjithatë lënia totale në dorë të spontanitetit, mund të ndikojë në rënien e nivelit të tyre dhe mund të reduktohen në fonde minimale jetese. Konkretisht, duke iu referuar një vendi si Turqia, Argjentina etj., për të cilat siç dihet emigracioni është fenomen masiv, do të sugjeronim një politikë interesash më atraktive në tregun ndërkombëtar. Ashtu si në rastin e vendeve të mësipërme, do të mundësohej jo vetëm thithja e fondeve të emigrantëve, të destinuara për mbajtjen e familjarëve dhe investimet në vendet e origjinës, po edhe kursimet e tyre pranë bankave të vendeve në të cilat punojnë. Në qoftë se nuk do të veprojmë me shpejtësi për një politikë të zhdërvjelltë, ka mundësi që hapa të ngjashëm të ndërmerren nga bankat e huaja që janë ngritur dhe atëherë

fondet do të kthehen andej nga kanë ardhur. Marrëveshje dypalëshe të Bankës së Shqipërisë me banka të fuqishme në vende të tilla si Itali, Greqi dhe Gjermani, mund të synojnë në dhënien e interesave më të lartë për emigrantët shqiptarë, ndërkohë që kostoja e këtij operacioni mbi vlerën e tregut mund të përballohet nga Banka e Shqipërisë.

Megjithë koston relative që mbart ky operacion, fakti që këto dërgesa janë jetike për vendin tonë e bën këtë operacion të domosdoshëm dhe nga ana tjetër, i kanalizon ato në sistemin bankar, ndryshe nga periudha që lamë pas.

5. KONKLUZIONE

Deficitet permanente korente kanë qenë shpesh shkaqe për gjenerimin e krizave në ekonomi, pasojat negative të të cilave i kanë detyruar autoritetet të qëndrojnë vigjilente ndaj tyre. E thënë ndryshe, sa herë që ekonomia e një vendi jep sinjale krize, autoritetet ekonomike marrin masa rregulluese për shmangien apo amortizimin e goditjeve që ato mbartin.

Siç e përshkruam edhe më sipër, pozicioni aktual i llogarisë korente në Shqipëri paraqitet kompleks, me mundësi të theksuara potenciale për të gjeneruar krizë valutore, pasojat negative të së cilës do të jenë fatale. Brishtësia e ekuilibrave politikë, ekonomikë dhe financiarë të momentit rrit më tepër probabilitetin e gjasave që këto mundësi potenciale të konvertohen në "*shock*" të vërtetë.

Megjithëse është e vështirë të parashikosh ecurinë e afërme dhe të largët të deficitit korent (kuptohet se është akoma më vështirë ta programosh atë qoftë dhe në terma afatshkurtër), prioritetet për të lehtësuar këtë parashikim në të ardhmen, kryesisht konsistojnë në krijimin e një ambienti të përgjithshëm makroekonomik të qëndrueshëm. Aplikimi i politikave restriktive fiskale dhe monetare, rezulton të jetë një masë efikase për zbutjen e deficitit korent. Është e vërtetë që vënia nën kontroll e agregatit të kërkesës së brendshme, do të thotë kontroll mbi

konsumin e për rrjedhim, kontroll mbi importet. Por, nga ana tjetër kjo do të thotë kontroll mbi investimet, që indirekt do të thotë më pak eksporte. Gjithsesi, duke parë mundësitë aktuale të vendit, të paktën për të ardhmen e afërt , si dhe angazhimet e komunitetit ndërkombëtar është plotësisht e justifikueshme që të synohet një reduktim i ndjeshëm i nivelit të importeve, për arsyen e thjeshtë se efektet e rregullimeve strukturore dhe institucionale kërkojnë kohë, ndërkohë që situata aktuale duhet konsideruar emergjente.

Megjithatë, çështja themelore nuk qëndron në parashikimin në terma afatshkurtër, por në kryerjen e rregullimeve të përshtatshme ligjore, institucionale dhe strukturore, të cilat për një periudhë të paktën afatmesme, do të mundësonin zbutjen graduale të deficitit të llogarisë korente. Domosdoshmëria e tyre përforcohet ndjeshëm kur në realitetin e përditshëm ballafaqohesh me mangësi të theksuara:

- në gjendjen aktuale të kapaciteteve prodhuese të vendit;
- në nivelin aktual të infrastrukturës kombëtare;
- në funksionimin dhe strukturën e sistemit bankar;
- në formën e organizimit, funksionimit dhe pjesëmarrësve në tregje;
- në numrin e pakët të opsioneve të investimit;
- në kuadrin jo të plotë ligjor;
- në shkallën e ulët të edukimit publik.

Nga sa më sipër, përforcohet ideja se, për çdo ekonomi me një deficit korent të përmasave të tilla si në rastin e Shqipërisë, prioriteti themelor në terma afatmesëm konsiston në domosdoshmërinë e rritjes së eksporteve, pa të cilën nuk do të mund të arrihet kurrë pika e kthesës, e cila do të gjenerojë suficite korente të mjaftueshme për të shërbyer borxhin e jashtëm.

Realizimi dhe suksesi i këtyre masave rregulluese, shpesh kërkon rishikimin e politikave themelore mbi të cilat funksionon ekonomia kombëtare. Për më tepër, largimi prej politikave ekzistuese bëhet më i lehtë kur eksperienca tregon qartë se politikat aktuale nuk kanë funksionuar ose nuk u kanë shërbyer të

paktën minimalisht, qëllimeve për të cilat ato janë zgjedhur. Ndër këto, liberalizimi i llogarisë kapitale dhe zhvlerësimi konstant, por i moderuar i monedhës kombëtare, janë hapa të cilët duhet të ndërmerren pa vonesë. Politika të tilla, duke ndikuar sjelljen e publikut në mënyrë indirekte, do të ndihmojnë autoritetet në nxitjen e dëshirës për të kursyer apo për të konsumuar.

Meqenëse, të paktën edhe për një periudhë afatmesme, llogaria korente do të vazhdojë të financohet nga kursimet e pjesës tjetër të botës, kuptohet që në një masë të caktuar do të rriten dhe detyrimet në valutë të Shqipërisë ndaj saj. Shfrytëzimi i kujdesshëm i këtyre fondeve valutore, në mënyrë që në të ardhmen ato jo vetëm të riprodhojnë vetveten por edhe të sigurojnë të ardhura shtesë, mbetet një përparësi. Administrimi i keq i tyre do të çojë pashmangshmërisht në kriza të sektorit të jashtëm, në momentin kur do të ballafaqohemi me shlyerjen e detyrimeve afatgjata. Aktualisht, koeficientët e llogaritur të borxhit, janë të tillë që nuk premtojnë shlyerjen e borxhit me borxh të ri.

Kufizimi real i mundësive për të rritur huamarrjen kërkon zhvendosjen e barrës së deficiteve korente nga kreditë e çfarëdolloji, në format e tjera të thithjes së kapitaleve siç janë investimet e huaja, kryesisht investimet direkte. Këto forma kapitalesh kërkojnë një treg kapitalesh tërheqës, krijimi i të cilit mund të realizohet vetëm përmes një strategjie të shpejtë privatizimi të kapaciteteve reale të prodhimit[14]. Kjo u jep paketën kontrolluese investitorëve të fuqishëm, që zotërojnë kapitalet dhe tregjet. Nga ana tjetër, krijimi i institucioneve të specializuara financiare për të mbështetur me fonde dhe për t'i garantuar ato, do të jetë një faktor vendimtar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm jo vetëm për investitorët e huaj, por dhe për projektet e brendshme që tentojnë të mbështesin eksportet.

Eksperienca e shkurtër e tranzicionit na tregon se financimi i deficiteve të larta tregtare, në pjesën më të madhe, nuk është financuar nga flukset e kapitaleve, por nga vetë zëra të tjerë të llogarisë korente (dërgesat nga emigrantët). *Mjetet valutore të krijuara nga puna e emigrantëve, duhet patjetër të ballafaqohen*

me një politikë të zgjuar të autoriteteve monetare. Kjo politikë, përveç kanalizimit të transfertave korente private nga konsumi në investime, ashtu si edhe në raste të tjera, duhet të tentojë të thithë të gjitha mjetet valutore të gjeneruara nga puna e emigrantëve, pavarësisht nga fakti nëse hyjnë në Shqipëri si transferta apo qëndrojnë si depozita kursimi në shtetet ku ata jetojnë.

SHËNIME

* Gramoz Kolasi, Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve.
Altin Tanku, Përgjegjës i Sektorit të Statistikave të Bilancit të Pagesave. Dhjetor 1998.

[1] Shifrat i referohen të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Megjithatë, nuk ka dyshim se sasia e importit të këtij grupi mallrash në realitet është më e madhe se ajo e regjistruar në regjistrat doganorë.

[2] Të dhënat për vitin 1997, janë vlerësim, objekt i rishikimeve në të ardhmen.

[3] Ka supozime se ky numër arrin deri në 600 mijë vetë, nga të cilët, më shumë se gjysma, jeton në shtetin fqinj të Greqisë.

[4] Llogaria korente, eksportet, kursimet dhe bilanci fiskal janë përqindje ndaj PBB-së (mesatare të periudhës). REER janë mesatare për periudhën (REER: mesatarja e 1970-95 = 100). Borxhi i jashtëm bruto është shprehur si përqindje e PBB-së dhe i referohet vitit të fundit të periudhës. Shifrat në kllapa reflektojnë periudhat pas ndërmarrjes së rregullimeve të ekonomisë. Të dhënat IMF Working Paper 96/110, Current Account Sustainibility: Selected East Asian and Latin American Experiences)

[5] Krahasuar me vitet 1995 e 1996.

[6] Rreshti i katërt i tabelës 4.

[7] Duhet theksuar se rreshti 9 i tabelës së mësipërme pasqyron edhe shlyerjen e borxheve të prapambetura të Shqipërisë në vitin 1995. Kjo është arsyeja që shifra bie nga 35 për qind në vitin 1994, në 3 për qind në vitin 1995.

[8] Siç dihet zëri "Gabime dhe Harresa" llogaritet si mbetje dhe për rrjedhim, pasqyron nivelin e transaksioneve me jashtë, të cilat nuk arrijnë të maten. Në këtë zë, pjesën më të madhe e zënë aktivitetet e jashtëligjshme, të cilat njihen me termin kontrabandë. Kuptohet se niveli i tyre nuk përcaktohet nga tregues të tillë si kursi i këmbimit, por nga faktorë të tjerë të natyrave nga më të ndryshmet. Gjithashtu, ekziston mundësia që në zërin "Dërgesa nga emigrantët" të jenë përfshirë padrejtësisht hyrje valutore, burim i të cilave janë aktivitete të jashtëligjshme.

[9] Në këtë lloj rreziku zakonisht përfshihen luftërat civile, anarkia civile, vendimet e qeverisë të cilat imponojnë përqindje këmbimi jo të ndershme ose diskriminuese, veprime të qeverisë të cilat privojnë nga e drejta e pronësisë, veprime të qeverisë për vendosjen e barrierave doganore etj..

[10] Matja e dërgesave nga emigrantët është vlerësim i Bankës së Shqipërisë, në të cilin nuk përfshihen fondet financiare valutore, të siguruara nga transaksionet kontrabandë. Kjo të le të kuptosh se diferenca ndërmjet asaj çka hynte dhe asaj çka depozitohej në bankë është më e madhe se ajo e ilustruar në grafikun 3.

[11] Për të ilustruar më mirë diferencën midis dërgesave dhe depozitave për vitin 1996, janë hequr depozitat pa afat të firmave të mëdha rentiere në bankat e nivelit të dytë.

[12] Të dhënat i referohen periudhës janar 1995 - tetor 1997.

[13] Megjithatë, është për t'u theksuar se kriza aktuale e vendeve të Azisë është

më komplekse dhe në fund të fundit, paraqet një krizë të përgjithshme të tregut aziatik, i cili pas një periudhe relativisht të gjatë rritjeje të pandalshme, po përjeton një periudhë recesioni të përgjithshëm. Lidhjet e shumanshme të këtyre tregjeve ndikuan në mënyrë të ndërsjelltë midis tyre, duke e globalizuar krizën valutore në të gjitha vendet e Azisë Juglindore.

[14] Ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, përfshirë dhe sektorët strategjikë të ekonomisë.

REFERENCA

IMF working paper "Leading Indicators of Currency Crises" by Graciela Kaminski, Saul Lizondo and Carmen M.Reinhart.

IMF Survey Volume 26, Number 16, 1997 "The IMF as Crisis Manager", by James M.boughton.

IMF Survey, Volume 26, Number 17, 1997, "Dubrovnik Conferees Discus External Sector Issues In Transition Economies".

IMF working paper "Current Account Sustainability: Selected East Asian and Latin American Experiences" by Gian Maria Milesi-Ferretti and Assaf Razin.

IMF Survey, Volume 26, Number 17, 1997 "Recent Developments Highlight Exchange Rate Regime Issues in Developing Countries".

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë 1992-1996.

Raporti Statistikor i Bankës së Shqipërisë 1997.

International Financial Statistics, Year Books 1992-1997.

Relacion për Këshillin Mbikëqyrës "Mbi disa zhvillime të fundit në ekonomi", nga G. Kolasi, A. Tanku dhe K. Rexha, prill 1997.

Opinione "Mbi zhvillimet në sektorin e jashtëm për vitin 1997", nga Altin Tanku, shkurt 1997.

"Something horrible out there" Finance and Economics, The Economist, October 18, 1997.

IMF working paper "Capital Account Liberalization and the Role of IMF" by Stanley Fischer.

IMF occasional paper "Currency Convertibility and the Transformation of Centrally Planed Economies", by Joshua e Greene and Peter Isard.

IMF occasional paper "Exchange Rate Policy in Developing Countries: Some Analytical Issues", by Bijan B. Aghevili, Mohsin s. Khan, and Peter J. Montiel 1991.

IMF working paper "Effects and Capital Account Convertibility", by Peter Isard, Joshua E. Greene.

"Calculation of Real Effective Exchange Rate", the IMF Course in Tirana, 1993.

"Proposal for Privatization in Eastern Europe", Staff papers, IMF, volume 38, by Borensztein, Eduardo and Manmohan S. Kumar.

Economic Survey of Europe in 1993-1997, Economic Comission for Europe, United Nations, Geneva.

Economic Bulletin for Europe in 1994-1997, Economic Comission for Europe, United Nations, Geneva.

"Large Changes in Current Accounts: The Italien Case" by Salvatore Rossi, Conference on "Current Account Imbalances in East and West: Do they matter?", Oesterreichische Nationalbank Vienna, November 1997.

"Current Account Imbalances: A case Study of Thailand" by Anoop Singh, Conference on "Current Account Imbalances in East and West: Do they matter?", Oesterreichische Nationalbank Vienna, November 1997.

"Current Accounts: What is Their Relevance for Economic Policymaking?", by Malcolm Knight, Conference on "Current Account Imbalances in East and West: Do they matter?", Oesterreichische Nationalbank Vienna, November 1997.

KUSHTETUTA DHE BANKA E SHQIPËRISË

*Teuta Baleta**

Fjalë kyçe
- Banka e Shqipërisë - Kushtetuta - Guvernatori -

Shteti Shqiptar pati për herë të parë një bankë qendrore në vitin 1992, funksionet e së cilës u përcaktuan në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë". Që me miratimin e këtij ligji në prill 1992, kuadri ligjor i saj ka ndryshuar vazhdimisht, në varësi të ndryshimeve të përgjithshme të ekonomisë shqiptare, e në veçanti të sistemit bankar, pa i shpëtuar në ndonjë rast, edhe kthesave të forta të politikës shqiptare. Ndryshimet që i janë bërë ligjit, kanë synuar përveç të tjerash, edhe shprehjen gjithnjë e më qartë të pavarësisë së Bankës së Shqipërisë.

Po me këtë ide u kërkua që edhe Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë, të kishte një nen të veçantë për Bankën e Shqipërisë. I vendosur në ligjin themeltar të shtetit, neni 161 i sanksionon Bankës së Shqipërisë funksionet e saj kryesore:

1. Të drejtën ekskluzive për nxjerrjen dhe qarkullimin e monedhës shqiptare.
2. Të drejtën për të zbatuar në mënyrë të pavarur politikën monetare të Shtetit Shqiptar.

Kjo e drejtë, e kombinuar dhe me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë "ruajtjen e stabilitetit të çmimeve", të shprehur në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", e përforcon më tej pavarësinë

saj. Strategjia që adopton Banka e Shqipërisë për politikën e saj monetare është e orientuar kah stabiliteti. Kjo e bën atë edhe më të interesuar për zgjidhjen e problemeve në afat të gjatë, duke e shkëputur nga interesat e momentit dhe zgjidhjet përkohësisht të mira.

3. Të drejtën për të mbajtur dhe administruar rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë.

Neni shpreh në mënyrë të qartë dhe të detajuar, mënyrën e drejtimit të Bankës së Shqipërisë duke përcaktuar edhe afatin e qëndrimit në detyrë të numrit një të këtij institucioni, Guvernatorit. Kjo mendojmë se ka mjaft rëndësi në kushtet kur treguesi i qëndrimit në detyrë të Guvernatorit është i ulët. Mesatarisht, çdo Guvernator ka drejtuar Bankën e Shqipërisë për 16 muaj nga 84 muaj të mandatit të tij[1].

Përfshirja e këtij neni në ligjin themeltar të shtetit, flet për një hap pozitiv drejt forcimit të pavarësisë së Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, mund të themi që ligji do të ishte më i qartë, në synimin e tij për të sanksionuar pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, po të përmbante, të shprehur qoftë edhe në një fjali të vetme, - "Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur nga të gjitha pushtetet" apo "Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur nga ndërhyrjet politike".

Gjithsesi, asnjë ligj nuk mund të sigurojë pavarësinë e një institucioni, qoftë ky autoritet monetar, nëse nuk ekziston vullneti për respektimin e tij. Në këtë kuadër, hapi i parë që duhet hedhur, është pranimi i idesë se ligjet duhen respektuar rigorozisht.

---

* Teuta Baleta, Drejtore, Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve.

[1] Nga muaji prill 1992 e deri më sot, Banka e Shqipërisë është drejtuar nga 5 guvernatorë:
Z. Ilir Hoti (prill 1992 - nëntor 1993).
Z. Dylber Vrioni (nëntor 1993 - dhjetor 1995).
Z. Kristaq Luniku (dhjetor 1995 - maj 1997).
Z. Qamil Tusha (maj 1997 - shtator 1997).
Z. Shkëlqim Cani (shtator 1997 - vazhdon).

Kreditimi i ekonomisë gjatë vitit '98 dhe parashikimi për vitin '99
Fiqiri Baholli
Edlira Abazi
Mars 1999

Roli i incentivave fiskale në nxitjen e biznesit privat
Selami Xhepa
Mars 1999

Opinione nga zhvillimet në sektorin e jashtëm, 1992-1998
Altin Tanku
Evis Ruçi
Qershor 1999

Shkurtimisht sistemi bankar shqiptar më 1998
Teuta Baleta.
Shtator 1999.

1999

Mbikëqyrja bankare dhe raporti standard i ekzaminimit
Arian Kraja
Dhjetor 1999

Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm - një dokument i rëndësishëm për Bankën dhe politikën ekonomike në Shqipëri
Marta Muço
Dhjetor 1999

Kufiri i kreditit
Fiqiri Baholli
Dhjetor 1999

KREDITIMI I EKONOMISË GJATË VITIT '98 DHE PARASHIKIMI PËR VITIN '99

Fiqiri Baholli
*Edlira Abazi**

Fjalë kyçe
- Sistemi bankar - Kreditimi i ekonomisë - Kufiri i kreditit - Programi monetar -

Banka e Shqipërisë në programin e saj monetar, ndër të tjera, parashikon rritjen e kërkesës së parasë nga kredia për ekonominë.

Mbështetja e ekonomisë me kredi është një nga detyrat kryesore të sistemit bankar, e lidhur ngushtë kjo me kushtet specifike të vendit tonë si:

- Niveli i prapambetur i teknologjisë dhe i infrastrukturës.
- Kërkesat e reja që shtron tranzicioni.
- Mundësitë natyrore që ofrohen dhe mungesa e aktiviteteve që zhvillohen mbi bazën e tyre.
- Elementet e reja të kapitalizmit në biznes dhe konkurrenca e huaj.

Për të kontrolluar ekspansionin e parasë nga krediti për ekonominë[1], Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e kufirit të kreditit[2] që në fillim të aktivitetit të saj si bankë qendrore e vendit.

Për këtë qëllim, në përputhje me objektivat kryesorë të programeve ekonomike, është përcaktuar, në fillim të çdo viti, rritja e gjendjes së kredive në sistemin bankar.

Kufiri i kreditit, i parashikuar në programin monetar për vitin 1998 ishte fillimisht 6 miliardë lekë dhe më vonë u rishikua në 2,5 miliardë lekë.

Në fillim të vitit 1998, gjendja e kredive në bankat e nivelit të dytë ishte:

	Bankat shtetërore+Banka Dardania	Bankat private
Teprica e kredisë	13127.7	2707.3
Kredi afatshkurtër	4364.3	1953.7
Kredi afatgjatë	8763.4	753.6
Nga kjo:		
Kredi me probleme	9236.7	302.3
Afatshkurtër	3838.7	185.3
Afatgjatë	5398	118

Kreditimi i ekonomisë për këtë vit u kanalizua sidomos nëpërmjet bankave private dhe të përbashkëta, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Bankat me kapital shtetëror Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Kursimeve dhe Banka Dardania u përjashtuan nga e drejta për përdorim kufi kredie.

Për vitin 1998, ecuria e kredisë së brendshme me dy kategoritë e saj:

- kredinë për qeverinë;
- kredinë për ekonominë, paraqitet:

Përqindja e kredisë ndaj kredisë së brendshme:

					1998
	Dhjetor '97	T 1	T 2	T 3	T 4
Kredia për qeverinë	91.3	90.9	91.1	91.3	91.5
Kredia për ekonominë	8.7	9.1	8.9	8.7	8.5

Nga sa më lart, vëmë re që kredia për qeverinë zë peshën kryesore në totalin e kredisë së brendshme, prandaj edhe për vitin 1998 deficiti buxhetor ka qenë burimi kryesor i ekspansionit të kërkesës për para. Fakti që sektori publik përbën mesatarisht 91 për qind të kreditit të brendshëm, tregon se pjesa më e madhe e parave, pra e depozitave, shkon për të financuar sektorin publik në shpenzime, që në pjesën më të madhe janë joprodhuese. Dihet që investimi në bono thesari nga ana e bankave të nivelit

të dytë është një investim me rrezik minimal. Por, nga ana tjetër ekzistenca e raporteve të mësipërme të kredisë së brendshme mund të çojë në të ardhmen në zhbalancime në ekonomi. Ndryshimi i tepricës së kredive si sistem bankar, tendencat e saj nga njëri tremujor në tjetrin, krahasuar me fundin e vitit 1997 (sipas gjendjes monetare) janë:

Sistemi bankar	Dhjetor '97	Mars '98	Qershor '98	Shtator '98	Dhjetor '98
Teprica e kredisë mln lekë	15835	16418	16892	17397	17692
Ndryshimi i tepricës së kredisë mln lekë		583	1057	1562	1857
Në % ndaj vitit 1997		3.6	6.6	9.9	12

Për vitin 1998, rritja e tepricës së kredive për ekonominë nga sistemi bankar, siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, nuk arriti në nivelin e parashikuar në programin monetar. Deri në fund të vitit, teprica e kredisë u rrit me rreth 1,8 miliardë lekë. Kredia e re e akorduar në vitin 1998 arriti në 8 miliardë lekë, ndërkohë që arkëtimet nga kreditë ishin 4.2 miliardë lekë. Raporti shlyerje / përdorim për gjithë vitin, arriti në 72.4 për qind, gjë që tregon se kreditë e dhëna në vazhdimësi gjatë vitit 1998 janë shlyer rregullisht. Arkëtimet dhe përdorimet e reja të kredisë për vitin 1998, për bankat shtetërore dhe private janë si më poshtë:

(në milionë lekë)

	Përdorim + ristrukturim	Arkëtime
Bankat shtetërore	905.5	1827.1
Bankat private	4857.7	2403.6

Kredia në lekë në tepricën e kredisë gjatë vitit 1998 përbën 69,4 për qind, ndërsa në fund të vitit 1997 përbënte 77 për qind të stokut të kredive.

Kredia në valutë ka qenë preferencë e bankave private duke arritur në 41,6 për qind të tepricës së kredisë gjithsej. Në vitin 1997, ajo zinte 23 për qind të stokut të kredive si sistem bankar.

Si sistem bankar në strukturën e tepricës së kredive për vitin 1998, 43 për qind e përbën kredia afatshkurtër, ndërsa kredia me probleme zë 59,8 për qind të stokut të kredisë.

Për bankat private të huaja dhe me kapital të përbashkët në stokun e kredive, në fund të vitit 1998 kredia afatshkurtër zë 73 për qind.

Në bankat me kapital shtetëror kredia afatshkurtër zë 22,1 për qind të tepricës. Gjendja e kredisë me probleme në këto banka, është 79,8 për qind e tepricës së kredisë (Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Kursimeve, Banka Tregtare Agrare).

Portofoli i kredisë si sistem bankar përbëhet nga 12607 lekë, që është stoku i kredisë në bankat me kapital shtetëror dhe 5058 milionë lekë, stoku i kredisë në bankat me kapital privat dhe të përbashkët.

Vemë re se, në përgjithësi, janë mbështetur me kredi nga bankat private dhe të huaja, degë të tilla të ekonomisë që nuk luajnë ndonjë rol të madh në treguesin e prodhimit të përgjithshëm të vendit, si tregtia, silvikultura, ndërtimi, peshkimi, turizmi, riparimi i automobilave e pajisjeve shtëpiake etj.. Vetëm Banka Alpha Credit ka akorduar kredi në degën e industrisë së përpunimit agroushqimor.

Rritja e tepricës së kredive sipas bankave, gjatë vitit 1998 paraqitet:

(milionë lekë)

Bankat	Stoku i kredive në dhjetor '97	Stoku i kredive në dhjetor '98	Rritja e stokut të kredive
BKT*	2079.8	1525.3	(554.5)
BK*	9454.3	9704.7	250.4
B. Dardania	220.5	159.1	(61.4)
BISH	2520	3674	1154
B. Tirana	159.1	743.5	584.4
BKG	0	0	-
BNT Malajziane	28.3	210.5	182.2
B. Alpha Credit	0	297.8	297.8

* Kredia për Entin e Banesave nga Banka Kombëtare Tregtare ka kaluar në Bankën e Kursimeve.

Banka Italo Shqiptare është banka me rritjen më të madhe të stokut të kredive, në krahasim me të gjitha bankat e tjera që ushtrojnë aktivitetin kreditues në vendin tonë. Portofoli i kredisë në fund të vitit 1998, përbën 42 për qind të totalit të aktivit dhe 68 për qind të totalit të depozitave.

Banka e Tiranës ka përdorur 48 për qind të kufirit të kreditit.

Banka Tregtare Ndërkombëtare ka përdorur rreth 82 për qind të kufirit të shpërndarë.

Banka Alpha Credit edhe pse aktivitetin kreditues e ka filluar në tremujorin e dytë të vitit 1998, rezulton me një realizim të kufirit të kreditit 62 për qind.

Banka Kombëtare Greke gjatë gjithë vitit 1998 nuk ka dhënë kredi.

Kështu, për vitin 1998 mund të arrijmë në këto përfundime:

- Kufiri i kreditit i përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në programin monetar për këtë vit ishte i mjaftueshëm dhe nuk u bë pengesë për kreditimin e ekonomisë nga sistemi bankar.
- Bankat private kanë preferuar të japin kredi në valutë edhe pse kursi i këmbimit të lekut me valutat kryesore ka qenë i stabilizuar.
- Dominuese në kreditimin e ekonomisë ka qenë kredia afatshkurtër, gjë që tregon se mbështeten me kredi biznese të vogla dhe jo projekte të rëndësishme për investime në degë kyçe për ekonominë shqiptare.
- Shkalla e ulët e realizimit të kufirit të kreditit aktualisht pasqyron investimet shumë të sigurta të parave në bono thesari dhe depozita në valutë të huaj.
- Ekziston "një kontradiktë" midis bankierëve dhe biznesmenëve në dhënien e kredisë. Arsyet, sipas bankierëve, janë projektet e hartuara me mangësi. Aplikimet për të marrë kredi nga biznesmenët shqiptarë, në shumicën e rasteve, janë të pashoqëruara me një plan

biznesi bindës dhe të detajuar.

- Në të njëjtën kohë, element i rëndësishëm për kreditimin nëpërmjet bankave private, është historia e marrëdhënieve të klientit me bankën. Është shumë e rëndësishme, që një klient i cili aplikon për kredi, të ketë patur llogari me bankën dhe veprime të vazhdueshme në të. Përmirësime në këtë drejtim do të sjellë në të ardhmen sistemi i pagesave.
- Mendojmë që të gjitha bankat e huaja private kanë patur dhënien e kredive në nivele të ulëta, duke qenë më tepër të interesuara të ruajnë paratë për strategjinë e së ardhmes dhe duke minimizuar sa më shumë rrezikun.
- Problem në kreditimin e rajoneve dhe komunave të tjera (veç Tiranës, Durrësit, Fierit) mendojmë është dhe shtrirja e degëve të bankave private të huaja në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në këtë drejtim, dihet që vendi ynë ka një mungesë infrastrukture të theksuar duke filluar nga rrugët e deri tek linjat telefonike, të mos përmendim pastaj rendin dhe qetësinë që lënë për të dëshiruar. Ngjarjet e shtatorit ndikuan shumë negativisht në besimin e investitorëve për të kërkuar kredi dhe në aktivitetin kreditues të bankave. Ndryshe nga vitet e tjera, ku tremujori i tretë dhe ai i katërt janë pikat kulmore të aktivitetit kreditues të bankave, pasiguria dhe gjithçka e tronditur për dy ditë, treguan se rreziku i vendit është në nivele shumë të larta.
- Në Shqipëri, paratë e grumbulluara nga kontrabanda dhe trafiqet e ndryshme, investohen pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Kjo zvogëlon deri-diku kërkesën për kredi.
- Stabilizimi i situatës brenda vendit dhe në rajon do të shtonte besimin e bankave private për të zgjeruar aktivitetin kreditues për ekonominë dhe rrjetin e tyre në të gjithë territorin e vendit.

Për vitin 1999, Banka e Shqipërisë në programin monetar ka planifikuar një kufi krediti si sistem bankar prej 8 miliardë lekësh, i shpërndarë si më poshtë:

(në milionë lekë)

Bankat	T - 1	T- 2	T - 3	T - 4	Vjetore
1. Banka Italo- Shqiptare	580	720	870	720	2890
2. Banka Dardania[3]	0	70	80	70	220
3. Banka Tirana	380	470	570	470	1890

4. Banka Kombëtare Tregtare Greke	70	290	340	290	990
5. Banka Alpha Credit	200	250	300	250	1000
6. Banka Tregtare Kombëtare	90	110	140	110	450
7. Banka Amerikane e Shqipërisë	280	90	100	90	560
Totali	1600	2000	2400	2000	8000

Mbështetur në këtë shpërndarje, Departamenti i Politikës Monetare në datën 18.02.1999, me anë të një shkrese drejtuar bankave të mësipërme, iu kërkoi që brenda datës 26.02.1999 të jepnin prononcimin e tyre lidhur me mundësitë për realizimin e kufirit të kreditit për vitin 1999, synimet, problemet dhe vështirësitë që ekzistojnë për realizimin e tij.

Në përgjithësi, të gjitha bankat shprehen se qëllimi i aktivitetit të tyre nuk është vetëm të krijojnë një klientelë të bazuar në depozita dhe transferta, por dhe të zhvillojnë një veprimtari krediti, duke krijuar vende të reja pune nëpërmjet mbështetjes së biznesit privat me kredi. Por, kjo bie në kundërshtim me politikën e tyre kundrejt rrezikut. Vlerësimi i rrezikut nga secila bankë është një nga pikat kyçe, kur bëhet fjalë për të marrë një vendim për akordim kredie. Disiplinimi i rrezikut shmang huatë me probleme dhe përmirëson cilësinë e portofolit të kredisë.

Të gjitha bankat që kanë të drejtë përdorimi të kufirit të kreditit, të shpërndarë nga Banka e Shqipërisë për vitin 1999, pavarësisht se synojnë të realizojnë kufirin e kreditit, ngrenë disa probleme dhe shqetësime që hasin gjatë akordimit të kredisë:

- Pasiguria politike, ndaj së cilës biznesi privat është shumë i ndjeshëm. Duke njohur rëndësinë e madhe që ka arritja e një stabiliteti politik dhe ekonomik, mbetet detyrë dhe përgjegjësi e Shtetit Shqiptar dhe e të gjitha forcave politike në vend, krijimi i një klime sigurie për investime në vend.
- Në Shqipëri mungon një qarkullim gjysmë i mbyllur i fondeve dhe transferta e parave vonon gati 20 ditë. Pagesat për çdo lloj transaksioni kryhen me lekë në dorë.
- Të punuarit me banka nuk është bërë edukatë e përditshme e biznesmenëve. Ata i drejtohen bankës vetëm në rastet kur kanë nevojë pra, kur kërkojnë hua, ndërkohë që marrëdhënia e tyre duhet të jetë konstante. Që banka të japë kredi ajo duhet së pari ta njohë klientin dhe më pas të

bëjë vlerësimin për dhënie kredie.

- Vështirësia e vlerësimit të kolateralit është një pengesë tjetër për kreditimin e bizneseve private. Ekziston vështirësia e garantimit të pasurive të paluajtshme, ka paqartësi për regjistrimin e hipotekave. Nuk ekziston një vlerësim paraprak i pasurive, por ky vlerësim bëhet gjatë negocimit për dhënie kredie.
- Bankat nuk u besojnë klientëve për dhënie kredie. Mungesa e aktiviteteve të qëndrueshme nuk u jep siguri atyre për qëllimin e përdorimit të huasë. Në këtë rast banka nuk ka siguri në kthimin e kredisë.
- Nuk ekzistojnë ligje për përcaktimin e kolateralit, vlerësimin e garancisë dhe ekzekutimin e tyre. Hartimi i një kornize të plotë ligjore është i domosdoshëm për të patur një shumëllojshmëri kolateralesh.
- Korrupsioni në sistemin e drejtësisë krijon vështirësi në zgjidhjen e problemeve që kanë bankat.

Bankat private që filluan aktivitetin kreditues në vitin 1998 nuk kishin krijuar portofolin e tyre dhe vazhdojnë të punojnë për plotësimin e personelit që ndjekin kreditin.

Nga ana tjetër, nuk janë vetëm fondet e vetë bankave që mbulojnë kërkesat për kredi të bizneseve. Nëpërmjet bankave dhe fondacioneve të ndryshme, në Shqipëri kalohen projekte financimi që nuk përfshihen në kufirin e kreditit. Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave nuk kanë të dhëna të plota për këto aktivitete. Për grumbullimin e këtyre të dhënave do të fillojë puna në vitin 1999, sipas rekomandimeve të misionit shumësektorial të statistikave kombëtare. Megjithatë, mund të themi që gjatë vitit 1998 kredi janë dhënë nga FEFAD, i cili në fund të vitit kishte një portofol prej 615 milionë lekësh (me një xhiro të akumuluar prej rreth 1,3 miliardë lekësh). Ky institucion ka marrë licencë bankare këtë vit dhe do të vazhdojë të kreditojë me fondet e KFW dhe me fondet e veta si bankë. Gjithashtu, ka projekte të tjera që mbështesin bizneset me para të trajtuara nga: GTZ, Agjencia e Bankës Botërore IFC, projektet e SME, sponsorizimet e ndryshme nga fondacioni "Soros" dhe fondacione të tjera.

Gjatë vitit 1999, si dhe më parë, nga sistemi bankar do të lëvrohen shumë kredi të huaja dhënë Qeverisë Shqiptare, për të cilat janë lidhur marrëveshje. Kështu, veç kredive që trajtojnë bankat shtetërore, janë lidhur marrëveshje me bankat private për: kredinë e Qeverisë Greke prej 5 miliardë dhrahmish (ose rreth 2,5 miliardë lekë) që është me kushte lehtësuese (afati i shlyerjes 10 vjet, interesi 9 për qind në vit dhe periudha e pagimit të kështit të parë fillon pas 2 vjetësh); kredinë e Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim nga e cila deri tani janë dhënë 145 milionë lekë. Veç këtyre, ka edhe projekte të tjera që mbështesin biznesin e vogël dhe të mesëm, si dhe programe për mbështetjen e biznesit të madh me investime si ai i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (që bën pjesë në grupin e Bankës Botërore).

Një burim tjetër i financimit të bizneseve është edhe paraja që vjen nga dërgesat e emigrantëve. Nga të dhënat e bilancit të pagesave mësojmë që dërgesat e emigrantëve gjatë vitit 1998 vlerësohen të jenë 521 milionë dollarë amerikanë, ndërkohë që në sistemin bankar depozitat në valutë janë rritur vetëm 28 milionë dollarë amerikanë. Për vitin 1999 janë parashikuar dërgesa rreth 350 milionë dollarë amerikanë (aq sa ishin parashikuar në fillim të vitit 1998). Kjo shumë parash qarkullon në shtesë të parave të arkëtuara nga aktivitete të paligjshme (klandestinë, drogë, prostitucion, transit etj.).

Për arsyet e mësipërme dhe kufizimet që krijon në dhënie kredie gjendja e kredive afatshkurtra në portofolet e bankave, në fund të vitit 1998 (bankat private 3.615 milionë lekë, bankat shtetërore dhe Dardania 4.015 milionë lekë) mendojmë që kufiri i kreditit të shpërndarë në vitin 1999 është i lartë dhe bankat që do të kreditojnë ekonominë nuk do ta rrisin tepricën e tyre të kredive të dhëna nga fondet e depozituesve, me 8 miliardë lekë.

SHËNIME

* Fiqiri Baholli, Drejtor, Departamenti i Politikës Monetare.
Edlira Abazi, Specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.
Mars 1999.

[1] Termin "kredi për ekonominë" do ta përdorim për kredinë e sistemit bankar, jo për qeverinë.

[2] Kufiri i kreditit, i shprehur në gjuhën e programit monetar është "tavani i kredive".

[3] Bankës Dardania i është ndaluar që të japë kredi në tremujorin e parë, ndërsa për të ardhmen do të vendoset në një kohë të dytë. (Kjo shpërndarje konsiderohet si paraprake, pasi në bazë të zhvillimeve Banka e Shqipërisë ruan të drejtën për të ndryshuar dhe rishpërndarë kufirin e një tremujori në tremujorët e tjerë.)

ROLI I INCENTIVAVE FISKALE NË NXITJEN E BIZNESIT PRIVAT

*Selami Xhepa**

Fjalë kyçe
- Incentiva fiskale - Investime - Lehtësi fiskale -

1. HYRJE

Si një vend me ekonomi në tranzicion, Shqipëria po synon ristrukturimin industrial, nëpërmjet përmirësimeve të teknologjive dhe adoptimit të programeve të privatizimit në të gjithë sektorët e ekonomisë. Tërheqja e kapitalit privat dhe në veçanti, e investimeve të huaja direkte, përbën një element me rëndësi thelbësore në suksesin e këtyre përpjekjeve. Rritja e konkurrencës në tregun e kapitaleve, ka bërë që vendet të përdorin instrumente të posaçme në tërheqjen e investimeve private, ku incentivat financiare dhe jofinanciare, zënë një vend të veçantë. Në këtë kontekst, përpunimi i një platforme apo strategjie të veprimit, të bazuar jo vetëm në konkurrencën midis instrumenteve nxitëse, por edhe në elementet e tjera të strategjisë, si konsumatorët (investitorët) dhe fuqitë e dobësitë e tregut të investimeve, përbën tashmë një çështje të një rëndësie parësore.

Nxitja për të shkruar edhe një herë mbi domosdoshmërinë e dhënies së lehtësive fiskale për sipërmarrësit privatë, vjen nga projektet e ofruara nga qeveria dhe të debatuara kohët e fundit në shtyp, për heqjen e lehtësive që janë ofruar deri tani.

2. ARGUMENTET KUNDËR DHE NË FAVOR TË PËRDORIMIT TË INCENTIVAVE

Në përgjithësi, autoritetet fiskale dhe financiare janë kundër përdorimit të incentivave. Argumenti klasik që përdoret është se "*përdorimi i tyre deformon aktivitetet ekonomike për shkak të divergimit të standardeve të fitimeve para dhe pas taksave, e për rrjedhojë, çon në një shpërndarje të burimeve ekonomike të ndryshme nga ai që gjenerohet nga ekuilibri i tregut*". Megjithatë, nëse ky argument që i referohet tregjeve të konsoliduara, aplikohet edhe në vendet me ekonomi në tranzicion, është një çështje e debatueshme[1]. Një tjetër argument i përdorur është ai që "*taksimi dhe skemat e financimit të zhvilluara nga organizmat qeveritarë kanë një efekt mjaft të vogël në zgjedhjen e vendosjes së një projekti investimi*". Si faktorë më të rëndësishëm konsiderohen stabiliteti i sistemit të taksave dhe predikueshmëria e tyre në një afat të mesëm.

Nga ana tjetër, agjencitë zhvillimore dhe vetë biznesi privat, bëjnë "lobbing" pranë autoriteteve politike vendimmarrëse, duke ndikuar në dhënien e incentivave. Argumentet që përdoren prej tyre në këtë rast janë të shumta:

Së pari, incentivat shihen si një instrument për përmirësimin e konkurrencialitetit të ekonomisë, duke përmirësuar aftësinë e saj për tërheqjen e kapitalit ndërkombëtar të lëvizshëm[2].

Së dyti, ato janë korrektore të "*dështimit të tregut*". Kjo mund të rezultojë, për shembull, në situata të informacionit jo të plotë mbi oportunitetet e tregut për investime, gjë që do të çonte në më pak investime se sa mund të realizoheshin në kushtet e një tregu plotësisht të mirinformuar.

Së treti, argumentet në favor të incentivave bazohen edhe në konsideratat makroekonomike. Në këtë rast, ato përdoren për të adresuar probleme të tilla si ndryshimet ciklike apo strukturore të papunësisë, deficitet e bilancit të pagesave dhe korrektimet për shkak të normave të larta të inflacionit dhe efekteve të tyre në detyrimet e firmave ndaj organeve tatimore.

Së fundi, përdorimi i tyre shihet si "*kompensim për disavantazhet e vendosjes së një projekti*", që burojnë kryesisht nga infrastruktura e dobët, administrata joeficiente, kostot e larta të shërbimit të biznesit etj..

Pse kjo kontradiktë e dukshme ndërmjet dy opinioneve dhe qëndrimeve ndaj përdorimit të incentivave?

Një shpjegim mund të gjendet në përkufizimin e gjerë të incentivave të përdorura nga qeveritë dhe biznesi. Përkufizimi i gjerë i këtij termi përfshin "çdo veprim të qeverisë, i cili rrit fitimprurjen e investimeve mbi nivelet që do të realizoheshin, nëse veprime të tilla nuk do të ishin ndërmarrë ose që reduktojnë rreziqet e investimit".

Për shkak të një përkufizimi të tillë të gjerë, është e qartë që incentivat ndikojnë në investimet, përfshirë edhe investimet e huaja direkte. Për shembull, barrierat tregtare, të cilat rrisin fitimprurjen e investimeve dhe reduktojnë rreziqet që përfshin realizimi i një investimi, njihen tashmë si influencuese pozitive në tërheqjen e investimeve të huaja.

Ndërsa, koncepti përgjithësisht më i pranuar i incentivave i referohet "masave fiskale, të tilla si reduktimi i nivelit të taksave ose lehtësi të tjera financiare të ofruara për projektet e investimeve".

3. EKSPERIENCAT E VENDEVE TË NDRYSHME ME INCENTIVAT

Bashkimi Evropian shpenzon rreth 1/3 e buxhetit të tij vjetor (gati 30 miliardë euro) në katër fondet strukturore, që përbëjnë bazën e subvencionimit të rajoneve apo sektorëve që konsiderohen më në vështirësi. Njëri prej tyre, për shembull, Fondi Evropian i Investimeve, merr pjesë si bashkëfinancues me gati 2 milionë euro, në çdo biznes të vogël, kryesisht nëpërmjet fondeve të investimeve. Tabela e mëposhtme jep një panoramë të shpërndarjes së këtyre fondeve ndërmjet vendeve anëtare:

Vendet	Popullsia që[3] do të mbulohet (në %)	Kufiri maksimal i ndihmës[4]
Belgjikë	33	30
Danimarkë	20	25
Francë	42	25
Gjermani	42.8	23
Greqi	100	75
Irlandë	100	75
Italì	49	65
Luksemburg	80	25
Holandë	16.6	25
Portugali	100	75
Spanjë	58.3	75
Mbretëri e Bashkuar:		
Britani e Madhe	34	30
Irlanda e Veriut	100	75

Burimi: Financial Times, 27 shtator 1997.

Fondet për zhvillimin rajonal zënë rreth 20 për qind të totalit të ndihmës, ndërsa fondet e ndihmës për zhvillimin e sektorit prodhues zënë rreth 50 për qind të totalit.

Siç shihet, incentivat (kryesisht të tipit financiar), janë përdorur gjerësisht nga vendet e Bashkimit Evropian në promovimin e zhvillimit industrial. Është pikërisht nën shembullin e vendeve të zhvilluara, që vendet me ekonomitë në tranzicion, pasi mbaroi koha e naivitetit për hyrjen e investimeve të huaja (mjafton të themi që ne jemi vend i hapur për kapitalet e huaja dhe investitorët do të vraponin!), filluan të adoptojnë programe të posaçme në tërheqjen e investimeve, ku incentivat janë përdorur dhe po përdoren gjerësisht. Në këto eksperienca, u bazuan edhe programet stimuluese për zhvillimin e biznesit privat dhe për tërheqjen e kapitalit të huaj që u adoptuan nga autoritetet shqiptare, që nga fillimi i vitit 1993.

4. EKSPERIENCAT E VENDIT TONË ME INCENTIVAT E OFRUARA

Parimet e ndërtimit të sistemit të incentivave të ofruara nga legjislacioni ynë, bazoheshin kryesisht në thjeshtësinë e aplikimit të tyre nga autoritetet tatimore dhe ishin të orientuara si në stimulimin e krijimit të sipërmarrjeve të reja (nëpërmjet përjashtimit nga tatim fitimi për një periudhë katërvjeçare për

investimet në sferën prodhuese), ashtu edhe në stimulimin e procesit investues në teknologji të reja (përjashtimi nga detyrimet doganore për makineritë dhe pajisjet). Kjo masë e fundit stimuluese u aplikua deri në mesin e vitit 1995 dhe më pas u hoq (me përjashtim të sektorit të turizmit). E vetmja masë e posaçme inkurajuese për kapitalin e huaj është rimbursimi i tatim fitimit të paguar në rast se fitimet nuk riatdhesohen në vendin e origjinës, por riinvestohen. Disa nga efektet më të rëndësishme dhe të dukshme të realizuara nga këto masa stimuluese ishin:

- Eksportet nga sektori privat u rritën nga 50 për qind në vitin 1994, në 80 për qind në vitin 1996. Numri i kompanive private (të huaja dhe vendase) që përfitonin lehtësi të tilla u rrit, duke shënuar në fund të vitit 1997 numrin prej 1800 subjektesh.
- Importet e makinerive dhe të pajisjeve arritën mesatarisht në 100 milionë dollarë amerikanë në vit, deri në momentin e përjashtimit të tyre nga detyrimet doganore, ndërkohë që, pasi kjo masë u eliminua, importet e tyre kanë rënë mesatarisht me 30 për qind në vit.
- Kontributi i tyre në punësim është i konsiderueshëm (shoqata e investitorëve italianë deklaron se vetëm investitorët e këtij vendi, kanë të punësuar rreth 60 mijë forca pune).

Argumenti i përdorur për heqjen e lehtësive fiskale të ofruara është ai i humbjeve të buxhetit të shtetit. Dhe, analiza e autoriteteve tatimore, në këtë rast mbetet vetëm në konstatimin e humbjeve (të cilat përsëri janë vetëm tentativë) dhe nuk merr në konsideratë përfitimet e realizuara. Megjithatë, duke mbetur në kuadrin e analizës së humbjeve, le të hedhim një vështrim të shkurtër mbi faktet e ndodhura.

	'93	'94	'95	'96	'97
Të ardhurat nga taksat (në % të PPB)	16.6	16.0	13.2	10.7	9.8
Të ardhurat nga dogana (në % të PPB)	2.9	3.4	2.7	2.7	2.6
Të ardhurat nga VAT (në % të PPB)	4.0	2.7	2.4	3.2	4.6
Deficiti i buxhetit (në % të PPB)	9.27	8.95	6.76	10.25	10.82

Burimi: Statistikat Fiskale, Ministria e Financave, qershor 1998.

Siç shihet nga tabela, me vendosjen e taksës doganore mbi mallrat kapitalë (gusht 1995), të ardhurat e buxhetit nga

doganat ranë, duke qëndruar mesatarisht 48 për qind poshtë nivelit të tyre mesatar për periudhën 1993-1994.

Rënia e kontributit të tyre në të ardhurat buxhetore, pavarësisht nga rritja e tarifës doganore (nga 0 në 7 për qind), mendojmë se reflekton një kontraktim të aktivitetit investues, qoftë nga firmat vendase dhe ato të huaja (për shkak të rritjes së kostos së kapitalit).

Nga ana tjetër, të ardhurat shtesë të realizuara nga buxheti i shtetit (në terma absolutë), nuk janë shpenzuar në aktivitete produktive, përkundrazi, shpenzimet kapitale të buxhetit gjatë kësaj periudhe ranë me 7 për qind.

Një tjetër llogaritje e servirur nga autoritetet tatimore janë humbjet prej gati 9.6 miliardë lekësh (rreth 65 milionë dollarë amerikanë), për shkak të përjashtimit të firmave nga pagimi i tatimit mbi fitimin si dhe përjashtimet doganore për investimet në turizëm. Mendojmë se llogaritja reale mund të realizohej vetëm nëse do të ishte e mundur të parashikohej se sa prej këtyre projekteve do të realizoheshin nëse këto incentiva nuk do të ishin ofruar. Nga një studim i kryer mbi këtë fakt, rreth 80 për qind e firmave të huaja të intervistuara[5] pyetjes 'a do të kishin investuar nëse incentivat nuk do të ishin ofruar', i janë përgjigjur 'jo'. Mbi këto fakte, llogaritjet mbi fitimin e munguar të buxhetit të shtetit nuk tingëllojnë të jenë reale. Për më tepër, llogaritjet nuk mbajnë në konsideratë përfitimet e buxhetit nga taksat e tjera kombëtare e lokale, efektet multiplikatore nga nënkontraktimet etj..

5. SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E SKEMËS SË INCENTIVAVE

Incentivat në vetvete nuk mund të eliminojnë efektet negative të klimës politike, ligjore dhe ekonomike. Pra, vendimi për investime është një proces kompleks ku analiza e faktorëve të përgjithshëm të gjendjes së vendit (situata politike dhe e sigurisë, situata makroekonomike, kuadri ligjor dhe institucional etj.) ka

prioritet. Por, incentivat në çdo rast mund të përdoren si një element kundërbalancues, përveçse si element konkurrencial me vendet e tjera të rajonit, të cilat gjithashtu, aplikojnë të tilla skema nxitëse.

Përjashtimi nga tatim fitimi, nga vetë natyra e tij është një masë që nuk lidhet aq shumë me investimin se sa me nxitjen e krijimit të bizneseve të reja. Në këtë kuptim, vendimi për heqjen e kësaj incentive do të ishte i rekomandueshëm që të shoqërohej me stimulimin e sipërmarrjeve tashmë të thelluara dhe operuese në vend, me masa që të lidheshin me vetë investimin. Si i tillë, është i rekomandueshëm aplikimi i përjashtimeve nga detyrimet doganore për importimet e teknologjive dhe materialeve (të cilat normalisht nuk deformojnë konkurrencën e tregut, pasi ato nuk prodhohen apo gjenden në tregun e brendshëm). Kjo do të ndikonte ndjeshëm në uljen e kostos së vendosjes së projekteve të investimeve dhe do të kundërbalanconte, deri në një masë të caktuar, edhe efektet e politikës së shtrënguar monetare. Kundrejt tipeve të tjera të incentivave që mund të përdoreshin, kjo ofron dhe thjeshtësinë e aplikimit nga autoritetet tatimore. Rezultatet e përpunuara të pyetësorit me sektorin privat, të pyetur mbi renditjen e incentivave sipas rëndësisë së tyre, paraqiten si në tabelë:

Renditja	Lloji i Incentivës
1	Përjashtimi nga detyrimi doganor
2	Reduktimi i nivelit standard të tatimit mbi fitimin
3	Amortizim i përshpejtuar
4	Përjashtim nga tatimi mbi fitimin
5	Zbritje për investimin/riinvestimin
6	Zbritje nga kontributi i sigurimeve shoqërore
7	Zbritje specifike nga të ardhurat bruto, për qëllime të taksave
8	Incentiva jo fiskale

Një incentivë e tillë ka provuar të jetë e suksesshme edhe nga eksperienca aziatike si dhe e mjaft prej vendeve në tranzicion.

Veç kësaj, eliminimi i përjashtimit nga tatim fitimi, mund të shoqërohet edhe:

- me zgjatjen e afatit të së drejtës së firmave për mbartjen e humbjeve nga tre vjet, që është aktualisht, në mbi pesë vjet;

- me rishikimin e normave të amortizimit dhe aplikimin e normave standarde të OECD etj..

Përjashtimi nga detyrimi i pagimit të akcizës për subjektet që veprojnë në turizëm duket i pakuptimtë dhe si i tillë ai mund të hiqet (le ta pijë turisti Whiskey dhe me akcizë!).

Më në fund, incentiva më e rëndësishme dhe reale për biznesin privat mbetet sigurimi i një konkurrence të ndershme, ku autoritetet tatimore të sigurojnë që të gjitha subjektet të respektojnë rregullat e lojës. Nuk mundet që zgjidhja për të mbushur buxhetin e shtetit, të gjendet përherë në rritjen e niveleve të taksave e tatimeve.

Rritja gjithmonë ka një fund. Përpara se autoritetet financiare të shqetësohen për rrjedhjet e buxhetit, të krijuara nga lehtësitë fiskale të ofruara (që janë rrjedhje të ligjshme), ato duhet të shqetësohen për evazionin fiskal që është me përmasa shumë herë më të mëdha (rrjedhje jo të ligjshme).

SHËNIME

* Selami Xhepa, Specialist, Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve.

[1] Regjimi për investimet, i adoptuar nga vendi ynë bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të investitorëve të huaj dhe vendas. Në këtë kontekst, të gjitha incentivat e ofruara kanë qenë disponibël jo vetëm për investitorët e huaj por edhe për biznesin privat vendas. Referimi në disa raste në këtë shkrim vetëm për investimet e huaja private, bëhet për të theksuar rëndësinë e tyre si një element shtesë në tërheqjen e kursimeve të huaja në ekonomi, por jo për të bërë dallim në trajtimin e lehtësive që duhet t'i ofrohen biznesit privat.

[2] Kapitale të lëvizshme konsiderohen të gjitha projektet e investimeve të drejtuara në sektorët e ekonomisë, me përjashtim të sektorëve strategjikë.

[3] Shprehur në përqindje ndaj popullsisë së vendit.

[4] Maksimumi i granteve të lejuara, si përqindje e shpenzimeve kapitale të një investimi.

[5] Janë intervistuar gjithsej 150 firma të huaja, përfaqësues të të gjithë sektorëve të ekonomisë, me një ritëm të kthimit të pyetësorëve prej 10 për qind.

LITERATURA

David Holland and Richard J. Vann, "Income Tax Incentives for Investment" Tax Law Design and Drafting, Vol. 2, IMF Publication, 1998.

Roger W. Schumenner: "Making Business Location Decisions", Prentice Hall Inc. 1982; pg 65.

"Foreign Direct Investment – Lessons of Experience", IFC/FIAS, no. 5, 1997; pg. 45

Për një përshkrim më të hollësishëm që ofrojnë vendet në tranzicion shih: Prof. Antonios I. Kontis, Selami Xhepa "Role of Incentives in Industrial Restructuring: case of Albania", përgatitur në kuadrin e programit "NATO Science Fellowships Programme", dhjetor 1998.

Sporken C.J.E.A: "Taxation of FDI in CEE: A Summary and Analysis of the OECD Report in European Taxation", October 1995, pg. 321.

OPINIONE NGA ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM, 1992-1998

Altin Tanku
*Evis Ruçi**

Fjalë kyçe
- Bilanci i pagesave - Tranzicion - Statistika - Pozicion ndërkombëtar i investimeve -

Gjatë tetë viteve tranzicion, statistikat e bilancit të pagesave kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përshkrimin dhe parashikimin e zhvillimeve të pozicionit të jashtëm të ekonomisë shqiptare. Në tërësinë e statistikave ekonomike, kjo kategori statistikore ka pasqyruar në detaje të konsiderueshme transaksionet ndërkombëtare të tregtisë së mallrave e shërbimeve dhe lëvizjet e kapitaleve. Bilanci i pagesave ka luajtur, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në përshkrimin e zhvillimeve të pozicionit financiar të Shqipërisë. Në ambientin e përgjithshëm ekonomik të trazuar, statistikat e bilancit të pagesave i kanë shërbyer autoriteteve si një tregues ndihmës i rëndësishëm për përcaktimin e politikës monetare dhe të ndërhyrjeve në kursin e këmbimit.

Këto statistika (bilanci i pagesave) përveçse përshkruajnë zhvillimet në pozicionin e jashtëm të një ekonomie, luajnë një rol shumë të rëndësishëm si një indikator i gjendjes së ekonomisë, veçanërisht në ato vende që ndjekin një politikë monetare të pavarur[1], duke shërbyer deri-diku edhe si një test, mbi efektshmërinë e politikave të ndjekura në ekonominë e brendshme.

Duke paraqitur bilancin e të ardhurave dhe shërbimeve në transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, bilanci

i pagesave, njëkohësisht, përcakton ecurinë apo zhvillimin në kohë të gjendjes së detyrimeve dhe pretendimeve, kundrejt pjesës tjetër të botës. Ai reflekton vendimet e rezidentëve dhe jorezidentëve, sjelljen e tyre në lidhje me investimet, kursimet, konsumin, pozicionin fiskal, faktorët demografikë etj.. Rezultatet e transaksioneve korente dhe lëvizjet e flukseve të kapitalit, mund të shërbejnë si indikatorë të mirë për pritshmëritë e investitorëve të huaj mbi të ardhmen e ekonomisë në tërësi si dhe për degë të veçanta. Lëvizjet dhe zhvillimet në bilancin e pagesave ndërthuren shumë – dhe njëkohësisht shërbejnë si indikatorë – mbi veprimet dhe pritshmërinë e të gjithë pjesëmarrësve të tregut në një ekonomi të hapur.

Treguesi më i përdorshëm dhe më delikat i bilancit të pagesave është bilanci i llogarisë korente. Veçanërisht në dy-tre vitet e fundit, ai është shndërruar në një sinjal alarmi për situatat e papëlqyera ekonomike. Arsyeshmëria dhe aftësia paguese e tij, rastet kur ai paraqet rrezik dhe shenjat e shfaqjes së këtij rreziku janë bërë ndër objektet kryesore në të cilat kanë përqendruar vëmendjen institucionet financiare.

Këto deficite të larta korente duhet detyrimisht të financohen nga një rritje e detyrimeve kundrejt botës ose një reduktim i mjeteve të huaja financiare. Prandaj, pozicioni i llogarisë kapitale e financiare është një tregues po aq i rëndësishëm sa edhe bilanci korent. Përbërja dhe natyra e detyrimeve dhe mjeteve financiare si dhe lëvizjet e tyre janë, gjithashtu, një indikator i rëndësishëm i zhvillimeve të pritshme ekonomike. Zhvillimet në këtë kategori mund të japin shkëndijën që i shndërron deficitet problematike në kriza të vërteta financiare.

Eksperienca e vendeve të Azisë Juglindore është rasti më tipik. Këta dy faktorë apo edhe një kombinim i tyre mund të çojë në përkeqësimin e mëtejshëm të deficitit korent. Kjo ndërthurje e llogarisë korente dhe asaj financiare shpesh përfundon në një situatë destabilizuese, në të cilën deficiti korent përkeqësohet vazhdimisht deri sa të detyrojë ndryshimin e kursit të politikave ekonomike apo të ndonjë variabli (për shembull, kursi i këmbimit, zhvlerësim i madh e i menjëhershëm i tij) për të

ndaluar përkeqësimin e mëtejshëm. Kriza e sektorit të jashtëm që përjetoi ekonomia jonë në fund të viteve '80 e që arriti kulmin në mesin e vitit 1992 është një shembull i përkryer për të ilustruar këtë fenomen.

Qëllimi i këtij artikulli nuk është të shpjegojë nëse përbën rrezik pozicioni i jashtëm i deficitit korent, në rastin e Shqipërisë apo të ndalet në faktorët që përcaktojnë shkallën e ekspozimit ndaj këtij rreziku. Në këtë artikull, dëshirojmë që shkurtimisht përmes analizës së ngjarjeve dhe dukurive në pozicionin e jashtëm të Shqipërisë, të përshkruajmë atë që nënkuptojnë zhvillimet e bilancit të pagesave për statistikat e tjera makroekonomike duke përdorur lidhjet që ky (pra bilanci i pagesave) ka me këta variabla. Me fjalë të tjera, do të përpiqemi që përmes zhvillimeve të bilancit të pagesave të japim një ide mbi ato elemente, të cilat për momentin nuk vlerësohen, dhe konkretisht për pozicionin ndërkombëtar të investimeve dhe bilancin e kursimeve dhe të investimeve.

Pra, do të japim opinionin tonë për ato që qëndrojnë pas deficiteve të larta korente e tregtare, flukseve të kapitalit dhe shifrave shumë të larta në zërin "gabime dhe harresa".

ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË TRANZICIONIT

Nën modelin më konservator të ekonomisë së centralizuar dhe sloganin e mbështetjes në forcat e veta, politika e ndjekur në sektorin e jashtëm të ekonomisë, deri në fundin e viteve '80 ka tentuar të jetë një politikë e zhvillimeve të balancuara, në funksion të së cilës bilancet e tregtisë së mallrave e shërbimeve duhet të ishin zero. Pas vitit 1985, pozicioni i jashtëm i Shqipërisë përkeqësohet dukshëm dhe kjo reflektohet në uljen e eksporteve dhe rritjen e kërkesës për importe. Reformat politike dhe ekonomike të viteve 1990-1991 (që i paraprinë periudhës së tranzicionit), u shoqëruan nga një presion në rritje për importe më të mëdha mallrash konsumi, që rezultoi në thellimin e deficitit korent si në monedha të konvertueshme ashtu edhe në rubla.

Deficitet në bilancin e pagesave u financuan nga shpenzimi pothuaj i plotë i rezervave valutore (përfshirë këtu edhe shitjet e arit), huamarrjet nga jashtë, detyrimet e papaguara në afat, huamarrjet ndërbankare dhe moszbatimi i kontratave të Forex-it. Pra, Shqipëria u gjend përpara një borxhi të jashtëm relativisht të madh.

Në këtë situatë, në kuadrin e ndryshimeve të politikave ekonomike dhe transformimit të ekonomisë, u ndërmorën reformat edhe në sektorin e jashtëm. Në kuadrin e programeve ekonomike, ndryshimet u përqendruan kryesisht në heqjen e kufizimeve ligjore për marrjen e kredive dhe hyrjen e investimeve nga jashtë, dhe në një liberalizim të pjesshëm, e më vonë të plotë, të tregtisë së jashtme (me përjashtim të një liste të kufizuar mallrash, tregtimi i të cilave kërkon licencë) dhe këmbimeve valutore. Periudha që pasoi këto ndryshime, vitet 1992 deri më 1998, u shoqërua nga një llogari korente e alternuar, deficite të larta tregtare në mallra e shërbime, të cilat janë rritur nga viti në vit si pasojë e kërkesës së brendshme të nxitur nga rritja ekonomike.

Tabelë 1. Bilanci i pagesave në milionë usd.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998
Llogaria korente	-50.8	14.7	31.2	36.6	-62.4	-253.7	-45.2
Llogaria korente pa transfert. shtet.	-405.6	-223.7	-87.5	-100.0	-158.7	-286.5	-133.1
Eksporti, fob	70.0	111.7	141.3	2048	243.7	158.6	208.0
Importi, fob	-540.5	-601.6	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7
Bilanci tregtar	-470.5	-489.9	-459.7	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6
Shërbimet: kredi	20.3	77.5	83.1	98.2	127.3	67.9	94.6
Shërbimet: debi	-89.2	-162.0	-97.6	-106.4	-142.3	-101.1	-133.7
Të ardhurat: kredi	2.6	64.9	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1
Të ardhurat: debi	-37.7	-31.0	-41.5	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7
Transfertat private	150.0	274.8	374.1	348.9	476.0	235.7	437.7
Transfertat shtetërore	373.7	280.4	117.2	128.5	83.4	29.0	82.5
Investime direkte	20.0	58.0	52.9	70.0	90.1	47.5	45.0
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitale të tjera	10.7	52.1	-7.0	-95.0	-35.6	95.3	0.6
Gabime dhe harresa neto	44.8	-9.9	44.5	-7.9	-54.9	-142.4	55.0
Bilanci i përgjithshëm	24.7	114.9	54.8	30.6	47.0	43.8	63.3
Rezerva dhe zëra të lidhur me të							
Rezervat	-24.7	-114.9	-54.8	-30.6	-47.0	-43.8	-63.3
Përdorim kredi e hua nga FMN	13.9	16.6	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9

Kthesa në zhvillimet ekonomike të vitit 1992 (ndalja e rënies ekonomike), u konsolidua gjatë vitit 1993, i cili përmes rritjes së importeve solli një zgjerim të menjëhershëm të vëllimit të tregtisë së jashtme dhe ndryshime të rëndësishme në strukturën e saj. Deficiti tregtar kapi shumën 490 milionë dollarë. Ky deficit i ndjekur nga ai korent (përjashtuar transfertat shtetërore), i shprehur si përqindje ndaj PPB-së shfaqi tendenca në rënie deri në vitin 1995. Pas këtij viti, si deficiti tregtar dhe ai korent u rritën ndjeshëm si pasojë e zhvillimeve në tregjet formale (ndjekja e një politike fiskale liberale tej kufijve të programuar) e ato informale, të cilat gjatë vitit 1996 lulëzuan çmendurisht dhe jashtë çdo logjike e parashikimi. Në fund të vitit 1996 deficiti i transaksioneve tregtare arriti 678 milionë dollarë amerikanë.

Gjatë vitit 1997, zhvillimet politike e sociale i dhanë një tjetër goditje të fuqishme sektorit të jashtëm. Shkëmbimet ekonomike e tregtare me botën ranë në mënyrë të dukshme dhe u pasqyruan në tkurrjen e deficitit tregtar në 535 milionë dollarë amerikanë. Në dallim nga vitet e mëparshme, tkurrja e deficitit tregtar nuk u shoqërua njëkohësisht me reduktimin e deficitit korent, i cili përkundrazi arriti një shifër marramendëse prej 254 milionë dollarësh amerikanë. Situata e deficitit korent u normalizua disi gjatë vitit 1998, vit i cili në pamjen e përgjithshme ruan karakteristikat kryesore të periudhës së tranzicionit. Në përgjithësi, mund të thuhet se rolin përcaktues në transaksionet korente gjatë gjithë periudhës në fjalë e kanë luajtur deficitet e larta tregtare dhe dërgesat e emigrantëve në mjete valutore (kryesisht në *cash*).

Këto të fundit kanë mundësuar financimin e një pjese kryesore të deficiteve të larta tregtare duke u bërë në të njëjtën kohë dhe nxitësi kryesor për rritjen e konsumit (dhe rrjedhimisht importit).

Financimi i deficiteve korente është mundësuar nga hyrjet e kapitaleve kryesisht në formën e kredive dhe investimeve të huaja. Pjesë e rëndësishme e financimit të huaj deri në vitin 1995 ka qenë dhe rritja e detyrimeve të prapambetura, një pjesë e të cilave u shlyen në tremujorin e tretë të vitit 1995. Si rregull i përgjithshëm në fund të çdo viti, llogaria kapitale është

mbyllur me shifra pozitive, që do të thotë se çdo vit, Shqipëria ka importuar më shumë kapitale sesa i ka eksportuar ato.

Kapitalet e hyra kanë luajtur një rol vendimtar në rezervat valutore, të cilat nga viti 1992 deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 1999, vetëm janë rritur. Rritja e rezervave valutore duket se është udhëhequr nga dy qëllime kryesore (filozofi të ndryshme). Deri në vitin 1995, rezervat valutore janë rritur në funksion të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të borxhit të jashtëm, më pas rritja e rezervave ka synuar krijimin e një stoku mjetesh valutore, të aftë për të përballuar nevojat emergjente për importe në rastin e një krize në sektorin e jashtëm. Në funksion të kësaj politike është kërkuar vendosja e një kufiri dysheme për treguesin e rezervave valutore të shprehura në muaj importe, në fund të çdo viti. Në shërbim të këtij treguesi, i cili përcaktohet si një ndër objektivat kryesorë të programit makroekonomik, Banka e Shqipërisë, çdo vit ka akumuluar (ka blerë) të gjitha hyrjet e mjeteve valutore në emër të Qeverisë Shqiptare (këtu kemi parasysh si disbursimet e kredive dhe ndihmat në *cash*).

BILANCI I PAGESAVE DHE POZICIONI NDËRKOMBËTAR I INVESTIMEVE

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, analizon zhvillimet dhe tendencat në ecurinë e ekonomisë kundrejt ekonomisë botërore, në një datë të caktuar. Pozicioni neto i investimeve, tregon çfarë zotëron apo çfarë detyrohet një ekonomi kundrejt pjesës tjetër të botës. Statistikat e pozicionit ndërkombëtar të investimeve nuk llogariten ende në Shqipëri. Arsye e vetme për këtë është mosekzistenca e të dhënave të sakta e të plota mbi gjendjen e mjeteve dhe detyrimeve financiare. Aktualisht, me përjashtim të mjeteve dhe detyrimeve financiare që rrjedhin nga transaksionet e depozitave dhe marrëdhëniet e borxhit të jashtëm publik, ka shumë pak ose më mirë të themi nuk ka informacione mbi ndryshimet në vlerën e mjeteve për kategoritë e investimeve të tjera. Mungesa e këtyre informacioneve e bën të pamundur llogaritjen e ndryshimeve që rrjedhin nga luhatjet e kursit të këmbimit dhe ndryshimet e çmimit të këtyre mjeteve dhe detyrimeve financiare.

Pavarësisht nga mungesa e kësaj kategorie statistikore, duke ndjekur zhvillimet në bilancin e pagesave, mund të thuhet diçka në përgjithësi për pozicionin ndërkombëtar të investimeve. Siç është përmendur edhe më lart, karakteristika kryesore e kësaj periudhe ka qenë financimi i deficiteve të larta tregtare e buxhetore përmes hyrjeve të kapitaleve të huaja në formën e investimeve direkte dhe huamarrjeve nga jashtë. Natyrisht edhe rezidentët shqiptarë kanë eksportuar kapitale të konsiderueshme në drejtim të ekonomive të tjera (këtu bëhet fjalë për pretendimet e sistemit bankar jashtë dhe kursimet e popullsisë në valutë të huaj brenda sistemit bankar apo jashtë tij, në xhepat e individëve).

Karakteristikë tjetër dalluese e periudhës, ka qenë rritja e vazhdueshme e rezervave valutore të Autoritetit Monetar, rritje e cila pothuajse në të gjitha rastet ka qenë e krahasueshme me ndryshimet në mjetet dhe detyrimet e llogarisë financiare. Për rrjedhim, megjithëse si karakteristikë e përgjithshme e periudhës, transaksionet financiare janë shoqëruar nga rritja e detyrimeve, madje edhe në ato raste kur bilancet korente janë mbyllur me suficit, rezultati neto i transaksioneve financiare përfshirë ato të Autoritetit Monetar ka rezultuar herë në favor të rritjes së detyrimeve dhe herë në favor të rritjes së mjeteve[2].

Ekonomia shqiptare ka trashëguar nga kriza e fundit të viteve '80, një borxh të jashtëm shumë të lartë. Një pjesë e këtij borxhi, rreth 500 milionë dollarë amerikanë, u shlye në tremujorin e tretë të vitit 1995, duke i ulur ndjeshëm detyrimet e prapambetura për pagesat e borxhit të jashtëm. Megjithatë, sipas vlerësimeve tona, të bazuara në statistika, të cilat kanë si burim FMN-në, inventari i detyrimeve të prapambetura (borxhit të panegociuar) mbetet në madhësi të konsiderueshme mbi 250 milionë dollarë amerikanë edhe pas vitit 1995. Në qoftë se do të merret në konsideratë gjendja e këtyre detyrimeve të prapambetura të borxhit dhe t'i shtohet rezultatit financiar të transaksioneve të kapitaleve, nuk është e vështirë të arrish në përfundimin se në fund të çdo viti, detyrimet e Shqipërisë ndaj botës kanë qenë më të mëdha se pretendimet (mjetet financiare) e saj ndaj botës (shih tabelën nr. 2).

Tabelë 2. Ndryshimi në mjete dhe detyrimeve financiare në milionë usd.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998
Llogaria financiare	30.7	110.2	47.8	-403.3	49.6	152.9	22.5
Ndryshimi në detyrime	103.9	188.8	155.6	-305.3	190.3	95.9	152.3
Ndryshimi në mjete	-73.2	-78.8	-107.7	-98.0	-140.7	57.1	-129.8
Ndryshime në rezerva	-24.7	-114.9	-54.9	-30.6	-47	-43.8	-63.3
Rezultati neto i transaksioneve	6.0	-4.7	-7.1	-434	2.6	109.1	-40.8

Rrjedhimisht, pozicioni ndërkombëtar i investimeve duhet të jetë mbyllur vazhdimisht me shenjë negative.

Ndryshimet e tjera që përfshihen në përllogaritjen e pozicionit ndërkombëtar të investimeve (PNI) nuk duhet të luajnë ndonjë rol përcaktues. Ndryshimi i vlerës së mjeteve dhe detyrimeve financiare si efekt i ndryshimit të çmimeve, duhet të jetë i kufizuar, sepse elementet të cilat dallohen për luhatje të fuqishme të çmimeve (kryesisht investimet në letrat me vlerë) sipas statistikave të bilancit të pagesave janë zero, gjithashtu, tregu i kapitaleve është inekzistent. Kështu që, në rastin e Shqipërisë ndryshimet në çmimin e investimeve kufizohen në ndryshimin e çmimit të mjeteve të qëndrueshme (makineri e pajisje dhe ndërtesa) të ndërmarrjeve të investimit direkt, të cilat ndryshojnë vetëm për efekt të regjistrimeve kontabël (amortizim, rivlerësim etj.).

Ndryshimet që rrjedhin nga kursi i këmbimit në përgjithësi, kanë ndikuar në përkeqësimin e pozicionit ndërkombëtar të investimeve. Që nga fillimi i tranzicionit, Leku Shqiptar (referuar kursit më 31 dhjetor të çdo viti) ka pësuar një zhvlerësim të vazhdueshëm deri në fund të vitit 1997, për t'u vlerësuar në vitin 1998. Kjo do të thotë se detyrimet, të cilat në madhësi absolute janë më të mëdha se mjetet financiare, janë rritur edhe për efekt të zhvlerësimit të lekut, ndërkohë që mjetet janë zvogëluar për të njëjtën arsye.

Kjo situatë përmbyset vetëm për vitin 1998. Pavarësisht nga vlerësimi apo zhvlerësimi, këto ndryshime nuk mund të kenë pasur vlerë përcaktuese po të mbahet parasysh niveli i lartë i detyrimeve financiare (përfshirë këtu edhe borxhin).

Ndikimin kryesor në rritjen e detyrimeve e kanë huamarrjet nga jashtë, pra detyrimet e borxhit (përfshirë këtu borxhin e ri dhe atë të vjetër, të trashëguar para vitit 1992) dhe investimet e huaja direkte të cilat kanë hyrë në Shqipëri që prej fillimit të tranzicionit. Rrjedhimisht, detyrimet e ekonomisë shqiptare, në pjesën më të madhe, përbëhen nga borxhi i jashtëm dhe investime të huaja. Pjesa tjetër e detyrimeve përbëhet prej kredisë tregtare dhe depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar shqiptar. Nga ana tjetër, mjetet (pretendimet e shqiptarëve) janë kryesisht depozita të sistemit bankar shqiptar me institucionet financiare jorezidente dhe mjetet valutore të mbajtura nga popullsia. Nuk përjashtohet mundësia që të ketë edhe mjete të tjera, të paregjistruara nga statistikat zyrtare. Një indikator i mirë për këtë qëllim janë statistikat e vendeve partnere, të cilat raportojnë investime direkte të rezidentëve shqiptarë.

Një ndër karakteristikat kryesore të bilancit të pagesave, në rastin e Shqipërisë, është mungesa e regjistrimeve për transaksionet e investimeve të portofolit apo flukse të tjera investimesh afatshkurtra (bëhet fjalë për borxhin afatshkurtër). Në përgjithësi, detyrimet e ekonomisë shqiptare kanë formën e detyrimeve afatgjata dhe kreditorët kryesorë të saj kanë qenë e vazhdojnë të jenë institucionet financiare si Banka Botërore, FMN, Komuniteti Evropian apo qeveritë e vendeve të ndryshme[3]. Megjithëse aktualisht detyrimet e ekonomisë shqiptare mbeten në kufijtë e alarmit dhe trajtimi i tyre kërkon vëmendje e kujdes, pozicioni neto i detyrimeve përmban edhe ndonjë element pozitiv.

Kur themi këtë, nënkuptojmë pikërisht mungesën e investimeve të portofolit dhe të detyrimeve financiare (investime të huaja dhe borxh) afatshkurtra. Kriza e vitit 1997 në ekonominë, deri atëherë të suksesshme, të Azisë Juglindore, tregoi se instrumentet e investimit afatshkurtër janë të rrezikshme dhe në varësi të ndryshimit të sjelljes, të preferencave apo të pritshmërisë së investitorëve të huaj, mund të shndërrohen në detonatorë të krizave financiare.

Duke iu referuar të njëjtës eksperiencë, shpërthimi i krizës në këto vende tregoi se përfshirja e sistemit bankar në huamarrje

nga jashtë është një precedent i rrezikshëm i krizës. Nga ky këndvështrim, shpërndarja sektoriale e stokut të detyrimeve nxjerr në pah një tjetër karakteristikë pozitive të detyrimeve tona. Statistikat tregojnë se me gjithë shkallën e lartë të detyrimeve që ka Shqipëria në pjesën më të madhe, rreth 94 për qind, janë detyrime të Qeverisë dhe Autoritetit Monetar, pra sektorët e tjerë (rreth 5 për qind) dhe ç'është më e rëndësishmja sistemi financiar, kanë shumë pak ose nuk kanë detyrime financiare ndaj botës. Kjo nuk do të thotë se jemi jashtë rrezikut apo se me këtë shpërndarje "të zgjuar" (pasi borxhi i është dhënë qeverisë) po e eliminojmë rrezikun, por tregon vetëm se në listën e shkaqeve që mund të shkaktonin një krizë financiare kemi një element më pak dhe kjo nuk është e parëndësishme, madje mund të konsiderohet pozitive.

BILANCI I PAGESAVE, RAPORTI KURSIM INVESTIME DHE PRIRJA NDAJ KONSUMIT

Lidhja ndërmjet bilancit të pagesave dhe zhvillimeve të ekonomisë së brendshme shprehet në barazimin që ekziston ndërmjet ndryshimeve në bilancin e llogarisë korente (rrjedhimisht në fluksin neto të kapitaleve) me diferencën ndërmjet kursimeve bruto dhe investimeve në ekonomi. E thënë ndryshe, deficiti i llogarisë korente reflekton sjelljen e kursimeve dhe investimeve në ekonominë e brendshme. Po t'i referohemi kësaj lidhjeje nuk është e vështirë të kuptosh, prej bilancit të pagesave, se ekonomia shqiptare ka më shumë për zemër investimet ose më mirë të themi shpenzimet, sesa kursimet.

Statistikat e bilancit të pagesave (po t'i referohemi kryesisht bilancit korent përjashtuar transfertat shtetërore) nuk lënë dyshim për faktin se shqiptarët në përgjithësi, kanë shpenzuar vazhdimisht më shumë se ç'kanë gjeneruar burimet e të ardhurave të tyre. Duke filluar që nga viti 1993, i cili shënoi mbarimin e krizës dhe fillimin e rritjes ekonomike në ekonominë shqiptare janë hedhur vazhdimisht të ardhura shtesë, të cilat janë thithur prej saj. Sipas statistikave, në vitet me të ardhura më të larta, shpenzimet kanë qenë më të larta. Në fakt, është e vështirë të bëhet një analizë

e hollësishme duke shfrytëzuar ekuacionet makroekonomike që lidhin bilancin e pagesave me variablat e tjerë, pasi sjellja e faktorëve ekonomikë në secilin nga këto vite, është ndikuar edhe nga fenomene të jashtëzakonshme, të cilat janë gjeneruar prej faktorit politik ose prej ekonomisë informale.

Megjithatë, diçka më shumë për sjelljen e ekonomisë shqiptare ndaj të ardhurave dhe konsumit mund të thuhet bazuar në zhvillimet e bilancit tregtar të mallrave dhe shërbimeve, dhe influkset e kapitaleve nga jashtë. Statistikat e tregtisë së jashtme tregojnë se influkset e rritura të kapitalit nga viti në vit, janë orientuar gjithnjë e më tepër në rritjen e importit të mallrave dhe të shërbimeve (përfshirë këtu edhe bilancin e të ardhurave). Importi i mallrave të konsumit, përfshirë këtu ato të konsumit afatshkurtër dhe atij afatmesëm, përbën grupin më të madh të importeve të mirëfillta (përjashtuar importet për përpunim aktiv). Ky grup importesh është rritur nga viti në vit në madhësi të konsiderueshme. Pra, në përgjithësi, mund të thuhet se gjatë këtyre viteve prirja e përgjithshme e ekonomisë shqiptare ka qenë drejt rritjes së konsumit.

Por, duhet të jemi të kujdesshëm. Është e vërtetë se në përgjithësi të gjitha burimet e të ardhurave janë orientuar drejt rritjes së konsumit, por kjo nuk do të thotë se rezidentët shqiptarë nuk kanë shfrytëzuar influkset e larta valutore për të rritur nivelin e kursimeve të tyre. Sipas mendimit tonë, në statistikat e bilancit të pagesave ka indikatorë që tregojnë se gjatë viteve të tranzicionit, një pjesë e të ardhurave nga sektori i jashtëm janë orientuar drejt kursimeve.

Një nga karakteristikat kryesore të bilancit të pagesave ka qenë ekzistenca e shifrave të larta pozitive, të cilat shpesh nëpër analiza përcaktohen si aktivitete të jashtëligjshme apo të papërcaktuara. Shifrat e larta pozitive të zërit "gabime e harresa" veçanërisht të larta për vitet 1996 -1997, ndoshta mund të shërbejnë si një indikator se këto kursime kanë ekzistuar, e ndoshta në vlerë jo të papërfillshme. Regjistrimet e bilancit të pagesave kanë përshirë të gjitha ato transaksione që janë shoqëruar nga rritja e mjeteve valutore në sistemin bankar (rrjedhimisht, ka përfshirë

edhe mjetet valutore të firmave piramidale që përfaqësonin kursimet valutore të publikut). Por, nga ana tjetër, nuk mund të regjistronin pakësimin e këtyre mjeteve në sektorin privat e atë shtëpiak. Në të vërtetë, ajo që ka ndodhur në këtë periudhë mund të shpjegohet si një zhvendosje e kursimeve në mjete valutore të sektorit privat e shtëpiak, nga "dysheku" në sistemin bankar, ndërkohë që statistikat kanë regjistruar vetëm rritjen e mjeteve valutore në banka. I njëjti fenomen, por në drejtim të kundërt, duhet të ketë ndodhur gjatë vitit 1997, duke shkaktuar rritjen e vlerës së zërit "gabime dhe harresa neto". Kjo nuk do të thotë se shifrat në "gabime e harresa" përfaqësojnë totalisht dhe detyrimisht kursimet valutore të publikut, të cilat u investuan në skemat piramidale, por sipas mendimit tonë në pjesën më të madhe përfaqësojnë këtë fenomen.

Grafik 1. Llogaria korente dhe bilanci fiskal në përqindje ndaj PBB.



Lidhja ndërmjet sektorit të brendshëm e atij të jashtëm të ekonomisë mund të shtrihet më në detaje duke bërë dallimin ndërmjet sektorit qeveritar dhe sektorit privat, i cili nxjerr në pah një konkluzion tjetër të rëndësishëm. Bilanci i llogarisë korente mund të shprehet ndryshe edhe si shumë e bilancit (kursim-investime) të sektorit privat, me bilancin e qeverisë. Ndjekja e kësaj logjike sugjeron se sektori privat në Shqipëri, gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, ka dalë vazhdimisht me një bilanc pozitiv, domethënë të ardhurat në këtë sektor kanë qenë vazhdimisht më të larta se shpenzimet. Deficitet e larta

buxhetore të periudhës, të shtyjnë në këto përfundime (shih grafikun 1). Në të gjitha këto vite, nga këndvështrimi i sektorit të jashtëm, politika fiskale ''ka ngrënë" bilancet pozitive të gjeneruara nga sektori privat dhe për më keq, i ka orientuar ato drejt konsumit (struktura e shpenzimeve buxhetore ku investimet janë të vogla).

Në analizën e ndryshimeve të pozicionit korent është e rëndësishme të kuptohet mënyra se si këto zhvillime kanë reflektuar ndryshimet në sjelljen e publikut, në lidhje me kursimet dhe investimet. Politikat rregulluese ekonomike, monetare e fiskale, gjatë periudhës '92-'98 kanë synuar të sigurojnë mbajtjen e shpenzimeve apo të kërkesës së brendshme, në kufijtë e burimeve të brendshme dhe financimit të huaj, pa penguar rritjen e prodhimit të brendshëm. Deficitet e larta tregtare dhe ato korente në rritje, tregojnë se autoritetet e kanë pasur shumë të vështirë që nëpërmjet politikave ekonomike të orientojnë sjelljen e ekuilibruar të ekonomisë kundrejt shpenzimeve dhe kursimeve.

Pra, mbajtja e konsumit në nivele të mjaftueshme për të shmangur revanshin e tij mbi kursimet, ka qenë shumë e vështirë për t'u arritur. Kjo edhe për faktin se gjatë këtyre tetë viteve reformat dhe programet ekonomike janë shoqëruar nga fenomene, të cilat mbeten jashtë kuadrit të politikave monetare si tregjet informale dhe ato paralele, tregtitë ilegale e veçanërisht lulëzimit të skemave piramidale, të cilat kanë rimodeluar sjelljen e konsumatorëve.

SHËNIME

*Altin Tanku, Përgjegjës, Sektori i Statistikave të Bilancit të Pagesave, Departamenti i Politikës Monetare.
Evis Ruçi, Specialiste, Sektori i Statistikave të Bilancit të Pagesave, Departamenti i Politikës Monetare. Qershor 1999.

[1] Këtu politikë e pavarur monetare nënkupton ato politika monetare, të cilat nuk kushtëzohen nga kurset e lidhura të këmbimit apo ato fikse.

[2] Momenti më pozitiv për pozicionin ndërkombëtar të investimeve është regjistruar në tremujorin e tretë të vitit 1995 dhe lidhet me shlyerjen e pjesshme të detyrimeve të prapambetura të borxhit të jashtëm. Rrjedhim i këtij veprimi, ishte reduktimi i detyrimeve për rreth 306 milionë dollarë amerikanë. Rezultati i transaksioneve financiare në fund të këtij viti, tregonte se zvogëlimi detyrimeve dhe rritja e pretendimeve të rezidentëve u kombinuan në një llogari financiare prej -435 milionë dollarësh amerikanë.

[3] Në listën e kreditorëve mungojnë kreditorët privatë.

SHKURTIMISHT SISTEMI BANKAR SHQIPTAR MË 1998

*Teuta Baleta**

Fjalë kyçe
- Sistem bankar - Kredi - Mjaftueshmëri kapitali -

Artikulli do të paraqesë një rishikim të llogarisë fitim e humbje, bilancit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar në Shqipëri, duke e vënë theksin në zhvillimet e vitit 1998 dhe duke i krahasuar këto zhvillime me një vit më parë.

1. TIPARE TË PËRGJITHSHME TË SISTEMIT BANKAR NË VITIN 1998

Viti 1998 u karakterizua nga rritja e numrit të bankave që zhvillojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Numri i përgjithshëm i bankave në fund të vitit 1998 ishte 10. Dy banka të reja, përfaqësuese të kapitalit të huaj, të quajtura Banka Amerikane e Shqipërisë dhe Dega Bankës Alpha Credit, filluan veprimtarinë e tyre pas marrjes së licencës nga Banka e Shqipërisë; ndërkohë iu revokua licenca Bankës Tregtare Agrare, bankë me kapital shtetëror. Më tej, tre banka, po përfaqësuese të kapitalit të huaj, morën licencën paraprake, duke përcaktuar në këtë mënyrë tendencën në rritje e zgjerim të sistemit bankar nëpërmjet shtimit të numrit të bankave[1] për vitin 1999.

Çdo vit, të paktën që nga viti 1996, sistemi bankar është shtuar me banka të reja me kapital të huaj (që në vijim do t'i

referohemi si banka të huaja[2]). Gjatë vitit 1996 filluan aktivitetin Banka Tirana dhe Dega[3] në Tiranë e Bankës Kombëtare të Greqisë dhe në vitin 1997 filloi aktivitetin Banka Tregtare Ndërkombëtare.

Kështu, viti 1998 nuk mund të konsiderohet si një përjashtim apo vit i veçantë, por si vazhdim i tendencës dyvjeçare për zgjerimin e sistemit bankar me banka të huaja. Në tërësi, viti 1998 u karakterizua dhe nga reformimi i strukturës së sistemit bankar. Nga njëra anë kemi rritje të prezencës së bankave të huaja dhe nga ana tjetër ulje të numrit të bankave shtetërore dhe përgatitjen e tyre për privatizim. Kjo ka çuar në një ulje të peshës së bankave shtetërore në veprimtarinë e sistemit bankar, hapësirë e cila është mbushur pjesërisht dhe pritet të shfrytëzohet nga grupi i bankave të huaja.

Këto zhvillime japin qartë tendencën e sistemit bankar shqiptar në fillim të mijëvjeçarit tjetër: Sistem bankar tërësisht (ose pothuaj tërësisht) privat ku do të dominojë kapitali i huaj.

Por, pavarësisht nga këto ndryshime sasiore, që pa frikë konsiderohen si pozitive, nuk u panë ndryshime në zhvendosjen gjeografike të rrjetit bankar. Bankat vazhdojnë të jenë të përqendruara në qytetin e Tiranës pa shtrirje në rrethe të tjera. Shërbimet bankare në këto rrethe ofrohen nga degët e bankave shtetërore. Ky rrjet, duke filluar nga fundi i vitit 1997, ka ardhur duke u tkurrur. Në fund të vitit 1998, sistemi bankar kishte në përbërje të tij 45 degë, prej të cilave vetëm dy i përkisnin Bankës Tirana (bankë private me kapital të huaj); ndërsa të tjerat i përkasin Bankës Kombëtare Tregtare (10) dhe Bankës së Kursimeve (33).

Në kuadrin e përgjithshëm makroekonomik, viti 1998 konsiderohet si viti i fillimit të rimëkëmbjes ekonomike e stabilizimit të vendit, pas krizës së përjetuar në vitin 1997. Ky stabilizim i përgjithshëm pritej që të ndikonte në zhvillimin e një veprimtarie bankare normale (duhet kujtuar që bankat në Shqipëri, gjatë vitit 1997, sidomos gjatë gjysmës së parë të tij dhe veçanërisht në disa rrethe të vendit, nuk kishin asnjë

mundësi të ofronin shërbimet e tyre). Me synimin për të nxitur kreditimin nga sistemi bankar, mbështetur dhe në zhvillimet monetare, sjelljen e çmimeve të konsumit, të kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë uli disa herë normat minimale të interesit për depozitat me afat të vendosura në bankat shtetërore si dhe miratoi një kufi kredie më liberal (kufiri i kredititi i miratuar për vitin 1998 ishte tre herë më i lartë se ai i vitit 1997 dhe dy herë më i lartë se ai i vitit 1996)[4].

Tabelë 1. Kalendari i ndryshimit të normave minimale të interesit për depozitat me afat në bankat shtetërore gjatë vitit 1998.

Data e vendimit	Afati i maturimit të depozitave (norma e interesit në %)		
	tremujore	gjashtëmujore	njëvjeçare
- para 19 majit 1998	26.0	26.0	27.0
- 19 maj	24.0	24.0	24.0
- 18 qershor	22.0	22.0	21.0
- 24 gusht	20.0	20.0	20.0
- 22 tetor	18.0	18.0	18.0
- 12 nëntor	16.5	16.5	16.5

Ky veprim i Bankës së Shqipërisë u shoqërua me:

- ulje të përqindjes mesatare të depozitave nga 27.8 (fundi i vitit 1997) në 16.5 (fundi i vitit 1998);
- ulje të interesit mesatar të kredisë afatshkurtër nga 43 (fundi i vitit 1997) në 25 (fundi i vitit 1998) për qind.

Megjithatë, veprimet e ndërmarra nga banka qendrore nuk dhanë efektin e dëshiruar në fushën e kreditimit nga ana e bankave. Kështu, kufiri i kredititi i miratuar në fillim të vitit në masën 6 miliardë lekë, u reduktua në 2.5 miliardë lekë. Arsyet më të përgjithshme që mund të përmendim për këtë nivel kreditimi janë:

- Rreziku i lartë e kredisë në Shqipëri, i ndikuar si nga mjedisi ekonomik ashtu edhe nga mungesa e efektivitetit në veprimtarinë e gjyqësorit.
- Gatishmëria e ulët e bankave private për t'u zgjeruar në këtë fushë.
- Pengimi i bankave shtetërore për të dhënë kredi. Ky vendim u mor si pasojë e cilësisë së rënduar të portofolit të tyre të huave dhe përgatitjes për privatizim.
- Niveli i lartë i kthyeshmërisë që fitohet nga bonot e thesarit.

Në fund të vitit 1998, *yield*-i mesatar i bonove me maturim një vit ishte 23 për qind. Pra, për dy lloje të ndryshme investimesh, që nga pikëpamja e rrezikut qëndrojnë në dy pole të kundërta[5], diferenca e frytshmërisë së pritshme ishte vetëm 2 pikë.

Gjatë vitit 1998, rritja dymbëdhjetëmujore e tepricës së kredisë ka qenë negative (0.7 për qind)[6], duke bërë që në strukturën e aktiveve të sistemit bankar portofoli i huave të zërë vetëm 7.8 për qind dhe 10.3 për qind, përkatësisht në fund të vitit 1998 dhe, atij 1997.

Në përgjithësi, në sistemin bankar shqiptar, në vitet në vazhdim, pritet një intensifikim i konkurrencës. Kjo do të jetë si pasojë e hyrjes së bankave të reja dhe e nevojës së tyre për të siguruar fitime; rregullimeve strukturore që po ndërmerren të cilat do të çojnë në prishje të monopoleve që ekzistojnë sot në tregun bankar; si dhe të vetë masave që po merr Banka e Shqipërisë në këtë drejtim.

Ky shtim konkurrence shihet si i favorshëm nga pikëpamja e përmirësimit të aktivitetit bankar në Shqipëri, e shtrirjes gjeografike të tij dhe e prezantimit të produkteve të reja, si nevojë e thithjes së klientelës. Mbi të gjitha, rritja e konkurrencës në sistemin bankar sjell përfitime për klientët në drejtim të uljes së kostos së shërbimeve bankare të ofruara.

2. STRUKTURA E SISTEMIT BANKAR

Sa herë flitet për strukturë të sistemit bankar në Shqipëri, vetvetiu bëhet një grupim bankash sipas origjinës së kapitalit të tyre në tre grupe:

- Banka tregtare me kapital shtetëror (dy banka).
- Banka tregtare me kapital të përbashkët, pjesëmarrja shqiptare përsëri është kapital shtetëror në masën 40 për qind në secilën bankë (dy banka).
- Banka të tjera, të cilat përfaqësojnë grupin e bankave të

huaja (6 banka në fund të vitit 1998 dhe 8 deri në shtator 1999).

Nëse do të krahasoheshin me njëra-tjetrën bankat brenda çdo grupi, do të vërehej që ato kanë edhe karakteristika të tjera të njëjta.

Grupi i parë përbëhet nga bankat tregtare me kapital shtetëror. Këtu bëjnë pjesë bankat më të mëdha të sistemit bankar shqiptar nga pikëpamja e totalit të aktiveve, nivelit të llogarive rrjedhëse e depozitave, tepricës gjithsej të kredive, investimit në bono thesari etj.. Origjina e këtyre bankave është e njëjtë. Ato u krijuan nga shndërrimi i bankave që ekzistonin para vitit 1992 (që konsiderohet si viti i fillimit të reformës në sektorin bankar) nga banka që trajtonin një sektor të caktuar të ekonomisë (bujqësinë apo tregtinë e jashtme etj.) në banka universale. Këtyre bankave u duhej tashmë që të vepronin në një mjedis të ri, të drejtuara nga një filozofi e re, në kushtet e mungesës së aftësive të mjaftueshme si dhe të ndërhyrjeve të vazhdueshme të qeverisë (si pronari i vetëm). Kjo gjë i shndërroi ato shumë shpejt në banka problemore.

Problemi më i madh tyre ishte dhe vazhdon të jetë portofoli i huave. Niveli i huave të këqija arriti në shifra shumë të larta duke ulur rentabilitetin dhe për pasojë, duke gërryer kapitalin. Këtyre problemeve u shtohet edhe mungesa e cilësisë së shërbimit, e nxitjes për të prezantuar produkte të reja, lëvizjet e vazhdueshme të personelit (qoftë drejtues, qoftë punonjësve të zakonshëm). Megjithatë, *pozicionin monopol në sistemin bankar ato nuk e humbën duke ulur kështu efikasitetin e gjithë sistemit bankar dhe duke bërë që problemet e tyre të jenë probleme të krejt sistemit bankar*.

Në fund të vitit 1998 ky grup përfaqësonte 85 për qind të aktiveve të sistemit bankar; 91 për qind të depozitave dhe 69 për qind të kredive të krejt sistemit bankar, shifra këto që në vitin 1994 kanë qenë mbi 95 për qind. Pra, në periudhën katërvjeçare, tendenca ka qenë ulja e peshës së këtyre bankave si pasojë e ndryshimit në numër të tyre, por edhe e kufizimit të veprimtarisë (për shembull, bankat shtetërore nuk lejohet të

japin kredi). Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe konsiderohet si një tendencë pozitive.

Grupi i dytë përbëhet nga bankat tregtare me kapital të përbashkët. Në këto banka, shteti zotëron 40 për qind të aksioneve. Deri më sot shteti është përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregtare, por pas vendimeve të fundit për privatizimin e saj, aksioner i drejtpërdrejtë del Ministria e Financave. Bankat e këtij grupi u çelën pothuaj në të njëjtën kohë dhe parashikimet qenë që ky grup, duke qenë se kishte në përbërje kapital të huaj përfaqësues i bankave të njohura (italiane dhe arabe) do të kthehej në grupin që do të drejtonte sistemin bankar nga pikëpamja e cilësisë së shërbimit, zgjerimit të rrjetit bankar, prezantimit të produkteve të reja bankare.

Në fakt nuk ndodhi kështu. Për vite të tëra bankat e këtij grupi u mjaftuan me thithjen e një numri të ngushtë klientësh, kryesisht biznesmenë apo qytetarë të huaj bashkëkombës të kapitalit të bankës dhe u përqendruan në veprimtaritë anësore bankare si shërbimet e pagesës, kryesisht me jashtë, dhe këmbimet valutore. Vetëm në dy vitet e fundit (1997 e 1998) mund të thuhet se pesha e këtij grupi ka filluar të jetë e ndjeshme.

Grupi i fundit përfshin të gjitha bankat që nuk klasifikohen në dy grupet e para. Këto janë përgjithësisht banka të reja në kuptimin që kanë hyrë në tregun bankar vitet e fundit (në vitin 1996 e më tej). Ato janë përfaqësuese të kapitalit të huaj, privat dhe shtetëror. Në tërësi janë degë ose filiale të bankave të huaja. Kështu, zgjerimi i këtij grupi tregon në njëfarë mase edhe interesin e investitorëve të huaj për tregun bankar shqiptar. Si banka të reja ato ende konsiderohen "të vogla" nga pikëpamja e totalit të aktivit dhe peshës që zënë në tërësi në sistemin bankar. Por, tendenca ka qenë zgjerimi i aktivitetit të tyre. Në ndryshim nga bankat me kapital të përbashkët, ato u treguan më agresive në treg që në momentet e para të hyrjes dhe pritet që ky të jetë grupi që "do të drejtojë" sistemin bankar[7].

Mjafton të përmendim që gjatë vitit 1998 pesha e tyre në totalin e bilancit të sistemit bankar është rritur nga 3.6 për qind

(fundi i vitit 1997) në 8.9 për qind ose për shembull, në totalin e kredive për të njëjtat periudha kohe treguesit janë 2.5 dhe 8.7 për qind.

Një strukturë e tillë e tregut bankar nuk është veçanti vetëm për Shqipërinë. Në të gjitha vendet e Evropës Lindore e Qendrore, niveli i lartë i përqendrimit të tregut bankar është pasojë e mënyrës se si u krijua sistemi bankar dynivelor. Si rregull i përgjithshëm sistemi bankar dynivelor është krijuar duke ndarë bankat ekzistuese në sistemin njënivelor, të cilat ishin të specializuara nga pikëpamja e aktivitetit të tyre. Ky përqendrim tregu, më vonë filloi të varej edhe nga shkalla e hyrjes së bankave të reja. Kështu, në pjesën më të madhe të rajonit të Evropës Qendrore e Lindore tregu bankar paraqitet mjaft i përqendruar, gjë që pasqyron dominimin e bankave shtetërore. Mjafton të përmendim rastin e Hungarisë, një ndër vendet ish-socialiste më të suksesshme në reformën ekonomike.

Nga fillimi i reformës në sistemin financiar në vitin 1987 dhe si pasojë e hyrjes së bankave të reja dhe konvertimit të institucioneve financiare të vogla të specializuara në banka tregtare, numri i bankave u rrit nga 8 në 30 në vitin 1990 dhe pesha e katër bankave më të mëdha tregtare ra nga 58 në 48 për qind[8].

Tabelë 2. Pesha e pesë bankave më të mëdha (në përqindje sipas totalit të aktiveve) për disa vende të Evropës Lindore e Qendrore (1994).

Vendi	Pesha e pesë bankave më të mëdha sipas totalit të aktiveve	
	Gjithsej	Bankat shtetërore
Bjellorusia	75	0
Republika Çeke	65	0
Hungaria	63	49
Letonia	27	6
Polonia	66	66
Rumania	74	74
Rusia	33	21
Republika Sllovake	79	36
Sllovenia	70	48
Ukraina	70	11

Burimi: BREE Ltd., BERZH dhe Banka Botërore.

Shihet që përqendrimi që ofron sistemi bankar shqiptar aktualisht është edhe më i madh, ku vetëm dy banka zotërojnë mbi 85 për qind të totalit të aktiveve.

Siç u përmend dhe më sipër, paraqitja e një pamjeje të shkurtuar të strukturës së sistemit bankar ka rëndësi, pasi nëpërmjet saj shpjegohen dhe shumë fenomene të vërejtura në veprimtarinë bankare.

3. ECURIA E REZULTATIT FINANCIAR

Rezultati financiar neto në fund të vitit 1998 nuk doli jashtë tendencës së vërejtur që prej vitit 1994. Sistemi bankar shqiptar vazhdoi të operojë me humbje, pra të paraqitet si një sistem joefikas.

Humbja e deklaruar në fund të vitit 1998 është rreth 3.1 miliardë lekë (0.7 për qind e PPB-së).

Megjithatë, në krahasim me një vit më parë (7.9 miliardë lekë ose 2.3 për qind e PPB-së), humbja është reduktuar në masën 61 për qind. Për pasojë, reduktim të ndjeshëm kanë pësuar edhe dy treguesit e rentabilitetit, përkatësisht kthyeshmëria nga aktivet (ROA) dhe kthyeshmëria nga kapitali i vet (ROE). Për sistemin bankar për vitin 1998, këta tregues u ulën në –1.7 për qind dhe –77.6 për qind nga –5.9 për qind dhe –84.9 për qind që ishin në fund të vitit 1997. Por a përfaqëson ky "përmirësim" treguesish të rentabilitetit, përmirësim real të efikasitetit të veprimtarisë së bankave gjatë vitit 1998. Përgjithësisht jo. Duhet kujtuar që humbjet e larta të pësuara gjatë vitit 1997 janë pasojë e situatës së atij viti, sidomos gjatë gjysmës së parë. Në këtë periudhë, sistemi bankar u detyrua të përballojë dhe një kosto shtesë atë të vjedhjeve apo të ndërprerjes së aktivitetit. Pra, humbjet e vitit 1997, më tepër se sa pasojë e aftësisë së bankave u ndikuan nga situata e jashtëzakonshme në vend.

Në tërësi, rezultati i sistemit bankar në Shqipëri ndikohet nga dy faktorë:

- Ecuria e rezultatit financiar në grupin e bankave shtetërore.
- Ecuria në nivelin e të ardhurave neto nga interesat, shpenzimet për fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (provigjonet) dhe shpenzimet e veprimtarisë.

A. REZULTATI FINANCIAR I GRUPIT TË BANKAVE SHTETËRORE

Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të këtij grupi përbën 93.3 për qind dhe 93.9 për qind të të ardhurave dhe shpenzimeve gjithsej të sistemit bankar.

Ky përqendrim i takon pothuaj të gjithë zërave të veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tabelë 3. Të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati financiar për vitin 1998 (milionë lekë).

Treguesi	Të ardhurat	Shpenzimet
1. Sistemi bankar	36 728	39 819
2. Grupi i parë	34 257	37 384
3. Rezultati financiar	- 3 091	- 3 127

Shihet fare qartë që humbja e pësuar nga dy bankat shtetërore ul rentabilitetin e krejt sistemit bankar. Por, arsyeja kryesore e humbjeve të pësuara në secilën prej bankave shtetërore është e ndryshme. Rreth 51.5 për qind e humbjes së Bankës Kombëtare Tregtare shkaktohet nga të ardhurat neto negative prej interesave. Ndërsa Banka e Kursimeve ka siguruar për vitin 1998 të ardhura neto pozitive nga interesat, por cilësia e rënduar e portofolit të huave dhe niveli i lartë i shpenzimeve për provigjone, e kthen në negativ rezultatin nga ndërmjetësimi financiar (rreth 2 miliardë lekë humbje)[9].

Konkludohet që të dyja këto banka kanë cilësi jo të mirë investimesh, prej të cilave nuk sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe janë të detyruara të kenë shpenzime shtesë të larta, në formën e shpenzimeve për provigjone.

B. NDIKIMI I ZËRAVE TË VEÇANTË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

- Interesat.

Të ardhurat neto nga interesi në fund të vitit 1998 janë rreth 200 milionë lekë (0.1 për qind e aktiveve mesatare) nga negative për rreth 235 milionë lekë, në fund të vitit 1997

(-0.16 për qind e aktiveve mesatare). Ky nivel të ardhurash nga interesat gjykohet se është relativisht i ulët, për të mbuluar shpenzimet e veprimtarisë dhe të krijimit të fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (në material për lehtësi shkrimi do t'i referohemi si shpenzimet për provigjone). Prej vitesh sistemi bankar shqiptar nuk ka mundur të sigurojë një nivel të mjaftueshëm të ardhurash nga interesat për mbulimin e shpenzimeve dhe sigurimin e fitimit.

Këto të ardhura ndikohen nga të dy krahët, shpenzimet që kryhen për interesat dhe të ardhurat gjithsej që sigurohen nga interesat. Por, gjatë vitit 1998, vërehet që është arritur një e ardhur neto nga interesat pozitivë. Cili krah ka patur ndikimin e vet në këtë nivel?

Gjatë këtyre viteve i vetmi shpenzim për interesa shkaktohet nga interesat që paguhen për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat. Prandaj, niveli i këtyre shpenzimeve do të varet nga ndryshimi i tepricës së depozitave si dhe nga ndryshimi i normës së interesit që aplikohet për to.

Të ardhurat nga interesat janë nën ndikimin e më tepër zërave, pasi ato sigurohen prej disa burimeve: nga vendosjet me bankat (kryesisht me bankat e huaja në formën e llogarive rrjedhëse e depozitave), nga investimi në bonot e thesarit dhe nga kreditë e dhëna. Ndryshimi i normave të interesit për këtë krah është më pak fleksibël në krahasim me ndryshimin e normave të interesit për depozitat dhe vazhdimisht ruhet një diferencë e lartë midis interesave aktivë e pasivë. Prandaj, në nivelin e të ardhurave prej interesave më tepër ndikim ka struktura e investimit ose përqendrimi në investime të caktuara. Investimi në masë më të madhe në aktive pa rrezik ose me rrezik të ulët, siguron një frytshmëri të ulët. Po kështu, cilësia e rënduar e portofolit të huave ul të ardhurat nga ky investim dhe nga ana tjetër, e rëndon sistemin bankar me shpenzime të larta për provigjone.

Si kanë vepruar elementet e përshkruara më sipër gjatë vitit 1998?

Gjatë vitit 1998, në mënyrë të vazhdueshme Banka e Shqipërisë uli normën minimale të interesit për depozitat me afat në bankat shtetërore (shih tabelën 1). Kjo u shoqërua me ulje të interesit që aplikohej për depozitat nga të gjitha bankat, interesit mesatar të kredive dhe *yield*-it të bonove të thesarit. Kjo ulje normash interesi vlerësohet se ka patur ndikim pozitiv në të dy krahët.

Është e kuptueshme që ulja e normës së interesit ul sasinë e interesave për t'u paguar, pra koston e depozitave. Por kjo ulje është pozitive dhe në krahun e të ardhurave për dy arsye:

Së pari, diferenca midis interesave aktivë e pasivë është në nivel të lartë, pra interesat aktivë nuk u ulën në të njëjtën masë ose me të njëjtin hap, duke krijuar hapësira për të ulur marzhin (interesat aktivë ndryshojnë më ngadalë) dhe;

Së dyti, diferenca midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj ndryshimit të normës së interesit për sistemin bankar është negative. Me fjalë të tjera, aktivet prej të cilave sistemi bankar merr interes (dhe për pasojë janë të ndjeshme ndaj interesit) janë më pak se sa pasivet për të cilat paguhet interes. Kjo do të thotë që një ulje e normës së interesit sjell një reduktim më të madh të kostos se sa të të ardhurave. Për më tepër, kjo diferencë negative vërehet pothuaj në të gjitha bankat dhe për pjesën në lekë të aktivitetit të tyre, pjesë e cila i ekspozohet më tepër ndryshimit të normës së interesit.

Tabelë 4. Diferenca aktive-pasive me normë interesi (milionë lekë).

Treguesi	1998
1. Diferenca gjithsej	-19620
2. Diferenca për pjesën në lekë	-33243

Nga ana tjetër, struktura e depozitave vlerësohet si e përshtatshme që uljet në normat e interesit të japin efekt të konsiderueshëm. Uljet në normën e interesit më tepër (për të mos thënë tërësisht) ndikojnë në depozitat me afat. Ky grup përbën një pjesë të konsiderueshme të depozitave gjithsej (rreth 79.2 për qind në fund të vitit 1998). Teorikisht, për krejt këto depozita ulet kostoja.

Edhe brenda depozitave me afat, ndikimi nuk është i barabartë sepse norma e interesit ka të bëjë vetëm me depozitat me afat në lekë. Vetëm ky grup ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm, pasi përbën 85.6 për qind të depozitave me afat ose 67.7 për qind të depozitave gjithsej. Në total kostoja ulet për rreth 70 për qind të depozitave të sistemit bankar.

Efekti vlerësohet më maksimal i mundshëm pasi 98.8 për qind e depozitave me afat në lekë janë të përqendruara në bankat shtetërore, të cilat, për shkak të rentabilitetit jo të kënaqshëm, kanë reaguar menjëherë duke ulur normat që ato ofrojnë në nivelin më të ulët të lejuar.

Megjithatë, kostoja totale për depozitat është ulur në një masë më të vogël si pasojë e rritjes së nivelit të depozitave me afat në lekë në sistemin bankar. Pavarësisht nga ulja e vazhdueshme e interesit, tendenca gjatë vitit 1998 ka qenë rritja e vendosjeve me bankat shtetërore.

Arsyet tashmë janë të mirënjohura: mungesa e alternativave të tjera të investimit dhe niveli relativisht i lartë i interesave realë pozitivë, nga negativë që ishin në vitin 1997.

Tabelë 5. Normat interesit dhe ajo e inflacionit (në përqindje).

Treguesi	1997	1998
Norma vjetore e inflacionit	42.1	8.7
Norma minimale e miratuar nga Banka Shqipërisë për depozitat me afat njëvjeçar	27.0	16.5
Interesi mesatar për depozitat	27.8	16.5

Nëse do të merrnim të shkëputur efektin e reduktimit të interesit mesatar për depozitat me afat në lekë nga fundi i vitit 1997 në fundin e vitit 1998 do të kishim[10]:

Në tërësi depozitat janë rritur brenda një viti me 36.8 për qind (rreth 45.9 miliardë lekë); për depozitat me afat dhe depozitat me afat në lekë, norma e rritjes është më e lartë, 47.1 për qind dhe 63.4 për qind përkatësisht.

Rritja e depozitave me afat në lekë, prej 44844 milionë lekësh gjatë vitit 1998, ka dhënë një efekt prej 7399 milionë lekësh në rritjen e shpenzimeve për interesa (faktori sasior). Ulja e normës së interesit (në llogaritje merret norma mesatare) prej 11.3 pikë përqindjeje, ka dhënë një efekt prej 7988 milionë lekësh në uljen e shpenzimeve për interesa (faktori cilësor). Në total, ndikimi ka qenë në reduktim të shpenzimeve për interesa për 589 milionë lekë.

Për këtë arsye, në tërësi shpenzimet për interesa janë rritur me 20 pikë më pak se sa të ardhurat nga interesat, duke siguruar një rezultat neto nga interesat pozitivë.

- Shpenzimet për provigjone.

Viti 1998 nuk doli nga tendenca e përgjithshme e këtyre viteve ku rezultati nga interesat përkeqësohet më tej nën efektin e shpenzimeve për provigjone dhe shpenzimeve të veprimtarisë.

Shpenzimet për provigjone arrijnë në rreth 3.3 miliardë lekë nga 4.1 miliardë lekë që ishin në vitin 1997. Ato janë rreth 16.3 herë më të mëdha se sa të ardhurat neto nga interesat ose 1.8 për qind e aktiveve mesatare të sistemit bankar. Me fjalë të tjera mund të thuhet që sistemi bankar jep hua për të humbur.

Lehtësisht arrihet në konkluzionin që sistemi bankar realizon një ndërmjetësim financiar joefikas. Ky nivel i lartë i shpenzimeve për provigjone shkaktohet drejtpërdrejt nga cilësia e rënduar e portofolit të huave.

Këto shpenzime për grupin e bankave shtetërore përfaqësojnë 92.9 për qind të shpenzimeve të sistemit bankar për provigjone. Pra, është cilësia e huadhënies në bankat shtetërore ajo që mban "peng" rentabilitetin e sistemit bankar.

Megjithatë, në raport me një vit më parë vërehet që këto shpenzime kanë një reduktim prej 0.8 miliardë lekësh ose 20.5 për qind si pasojë e bllokimit të veprimtarisë kredituese të bankave shtetërore, fshirjes nga bilanci të një pjese të kredive të

humbura si dhe revokimit të licencës së Bankës Tregtare Agrare, portofoli i huave të së cilës u transferua në Agjencinë e Trajtimit të Kredive. Gjithashtu, niveli i provigjoneve në vitin 1998 është rritur edhe si pasojë e ndryshimit të rregullave për llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë. Në bazë të rregullave të rinj, të miratuar në prill 1998, provigjonet do të llogariten edhe për huatë e klasifikuara si standarde. Ky është një pozicion më konservator që ka adoptuar Banka e Shqipërisë në gjykimin e kredive, me qëllim që t'i paraprihet mjedisit me rrezik më të lartë ekonomik në Shqipëri.

- Shpenzimet e veprimtarisë.

Shpenzimet e veprimtarisë, rreth 2.7 miliardë lekë në fund të vitit 1998, janë rritur me 7.8 për qind në krahasim me fundin e vitit 1997. Kjo rritje, më tepër është shkaktuar nga hyrja në treg e dy bankave të reja dhe dihet që shpenzimet e veprimtarisë për nga natyra, janë në shumicën e tyre shpenzime fikse. Megjithatë, në raport me aktivet mesatare niveli i këtyre shpenzimeve ka rënë nga 1.7 për qind në fund të vitit 1997, në 1.5 për qind në fund të vitit 1998. Pra, rritja e tyre është shoqëruar me një zgjerim më të madh të aktivitetit bankar. Në tërësi një nivel i tillë shpenzimesh veprimtarie shihet si i pranueshëm.

Niveli i shpenzimeve të veprimtarisë në grupet e ndryshme bankare, përfaqëson drejtpërdrejt shtrirjen e bankave në vend dhe nivelin e automatizimit të proceseve bankare si dhe të shpërblimit të punonjësve.

Grupi i bankave shtetërore kryen rreth 63 për qind të shpenzimeve të veprimtarisë së sistemit bankar. Por, kjo nuk do të thotë që këto banka kanë nivel të lartë dhe të pajustifikuar të tyre. Këto banka kanë një rrjet të gjerë degësh, punojnë me klientë të vegjël dhe procesi i punës nuk është i automatizuar. Në raport me totalin e shpenzimeve, ky zë përfaqëson vetëm 4.5 për qind ose 1 për qind të aktiveve mesatare.

Dy grupet e tjera kanë një nivel të lartë shpenzimesh veprimtarie, madje në disa prej bankave janë këto shpenzime

arsyeja kryesore e rezultatit negativ të tyre. Në raport me totalin e shpenzimeve, shpenzimet e veprimtarisë zënë 53.9 dhe 35.5 për qind përkatësisht në grupin e dytë dhe atë të tretë. Megjithëse këto banka nuk kanë rrjet të zgjeruar apo numër të madh punonjësish, niveli i pagave (ndjeshëm më i lartë se i bankave shtetërore) dhe investimet relativisht të larta për ambientet e punës dhe për teknologjinë, çojnë në shpenzime të larta.

Për më tepër, të tilla shpenzime pritet që të rriten në raport me aktivet mesatare në vitet e ardhshme për dy arsye:

- Hyrjes së bankave të reja në treg. Interesante është të shihet që shpenzimet e veprimtarisë për grupin e tretë nga 17.6 për qind që zinin në totalin e shpenzimeve të veprimtarisë në fund të vitit 1997, në vitin 1998 zinin rreth 23.6 për qind.
- Privatizimit të bankave shtetërore që do të shoqërohet detyrimisht me kryerje investimesh në teknologji si dhe rritje të shpërblimit të punonjësve për të arritur që të përballojnë konkurrencën e tregut.

Në tërësi, nga struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve për sistemin bankar mund të thuhet që përmirësimet mund të bëhen në dy elemente kryesore:

- Rritjes së nivelit të të ardhurave neto nga interesat.
- Reduktimit të shpenzimeve për fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë.

Si faktori kryesor që do të ndikojë në përmirësimin e rentabilitetit mbetet cilësia e huadhënies, e cila ka efekt të dyfishtë negativ në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat neto nga interesat mund të përmirësohen nëpërmjet rritjes së të ardhurave nga interesat. Në krahun e shpenzimeve për interesat ka më pak mundësi "manovrimi". Ato do të varen nga reagimi i depozituesve kundrejt bankave dhe niveli i normës së interesave.

4. BILANCI I BANKAVE, CILËSIA E AKTIVEVE DHE KAPITALI

Karakteristikë për sistemin bankar shqiptar është niveli i ulët i kreditimit. Portofoli i kredive përfaqëson vetëm 7.8 për qind të totalit të aktiveve, ndërsa vendosjet me bankat (në formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat) si dhe investimi në bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare për fundin e vitit 1998, dalin si investimet kryesore duke zënë përkatësisht 35.3 dhe 43.3 për qind të totalit të aktiveve.

Struktura e aktivit të sistemit bankar nuk ka pësuar ndryshim nga viti 1997. Si grupe kryesore edhe gjatë këtij viti, dalin vendosjet me bankat dhe bonot e thesarit. Ajo çka ka ndryshuar është reduktimi i mëtejshëm i peshës së kredive gjatë vitit 1998, e cila është zëvendësuar me rritje të investimeve në bono (në fund të vitit 1997 pesha e këtij zëri ishte 34.5 për qind, ndërkohë që vendosjet me bankat kanë mbetur në nivelin 35.8 për qind të totalit të aktiveve).

Kjo strukturë nuk paraqitet e njëjtë në të treja grupet e bankave. Grupi i parë (dhe siç është shpjeguar më sipër edhe gjithë sistemi bankar) ka si grup kryesor investimi bonot e thesarit, që në fund të vitit 1998 arrijnë në 50 për qind të totalit të aktivit. Dy grupet e tjera të bankave i vendosin fondet e tyre kryesisht pranë bankave të huaja në formën e depozitave me afat dhe të llogarive rrjedhëse (shih tabelën 6). Nga pikëpamja e rrezikut, vërehet që pjesa më e madhe e aktiveve bankare është e përqendruar në aktive pa rrezik ose me rrezik të ulët.

Tabelë 6. Grupet kryesore të aktivit (në përqindje ndaj totalit të bilancit).

Zëri	Grupi I		Grupi II		Grupi III	
	1997	1998	1997	1998	1997	1998
1. Bono thesari	38.4	50.0	0.2	3.8	0.9	5.4
2. Kredi	9.5	6.3	23.1	30.6	6.7	7.4
3. Vendosje me bankat	33.2	30.4	50.5	40.5	70.7	77.5

Edhe struktura e pasiveve ka mbetur e pandryshuar. Zërin kryesor të pasivit e përbëjnë llogaritë e klientëve, më specifikisht

depozitat me afat. Siç u theksua edhe më lart, rritja kryesisht e depozitave me afat në lekë gjatë vitit 1998, ka çuar edhe në rritje të peshës së depozitave në tërësi nga 78.2 për qind (fundi i vitit 1997) në 81.6 për qind (fundi i vitit 1998). E kundërta ka ndodhur me nivelin e fondeve të veta.

Megjithë, hyrjen e dy bankave të reja që do të thotë më tepër kapital i paguar, pesha e kapitalit ka rënë për të njëjtën periudhë nga 7.1 për qind në 1.2 për qind. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e përfshirjes së humbjes së pësuar në vitin 1997 në zërat e kapitalit të vet. Ky faktor shpjegon edhe përkeqësimin e mëtejshëm të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit nga 5.5 për qind në -8.9 për qind.

Tabelë 7. Grupet kryesore të pasivit (në përqindje ndaj totalit të bilancit).

Zëri	Grupi I		Grupi II		Grupi III	
	1997	1998	1997	1998	1997	1998
1. Depozitat gjithsej	80.7	87.6	51.0	49.8	67.3	45.5
Nga këto:Depozitat me afat	61.7	72.8	19.0	9.7	28.4	22.2
2. Fondet e veta	3.4	-2.5	43.2	37.8	30.4	12.8

Në total sistemi bankar paraqitet i pakapitalizuar, megjithë strukturën e favorshme të aktiveve. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar, në fund të vitit 1998 është -8.9 për qind nga 5.5 për qind në fund të vitit 1997. Arsyeja kryesore e mungesës së kapitalit është gërryerja e tij, si pasojë e humbjeve të vazhdueshme të pësuara nga sistemi bankar, kryesisht nga grupi i parë i bankave. Nëse shihet struktura e bankave, mungesë të theksuar të kapitalit kanë bankat shtetërore (norma e mjaftueshmërisë është -57.7 për qind në fund të vitit 1998[11]) banka të cilat edhe kanë pësuar humbjet më të mëdha. Ndërkohë, dy grupet e tjera të bankave paraqiten tepër të kapitalizuara (norma e mjaftueshmërisë është 76.8 dhe 43.6 për qind përkatësisht për grupin e dytë dhe atë të tretë të bankave).

Duke qenë se bankat e grupit të parë janë në proces privatizimi, mungesa e kapitalit në to nënkupton dhe një kosto injektimi të kapitalit që deri në fund të vitit 1998, arrin afërsisht

në 11.2 miliardë lekë, kosto e cila për shkak të humbjeve që pësohen vazhdimisht vjen duke u rritur.

Megjithëse kredia ka një peshë relativisht të kufizuar në totalin e bilancit, ka rëndësi të trajtohet cilësia e saj. Sistemi bankar shqiptar paraqet në tërësi një portofol huash me cilësi të rënduar, e matur kjo me nivelin e lartë të kredive të klasifikuara si të parregullta. Kjo shkakton edhe rritjen e shpenzimeve për provigjone, duke përkeqësuar rentabilitetin e madje shkaktuar dhe humbje.

Në total, për sistemin bankar janë klasifikuar si kredi jo të rregullta rreth 57 për qind e portofolit të huave. Ky nivel i lartë kredish jo të rregullta vërehet vetëm në grupin e parë të bankave (rreth 77 për qind), ndërsa në dy grupet e tjera treguesi është 8.9 dhe 17.3 për qind, përkatësisht. Kjo është pasojë kryesisht e bllokimit të dhënies së kredive të reja nga bankat shtetërore dhe e kthimit në kredi me probleme të portofolit ekzistues. Ndërsa në dy grupet e tjera tregohet më tepër kujdes në dhënien e kredive.

Më shqetësues akoma mbetet fakti që si sistem bankar dhe në veçanti, grupi i parë i bankave ka një nivel të lartë kredish të këqija (kredi të klasifikuara si të dyshimta dhe të humbura me probabilitet të vogël kthimi). Niveli i tyre është 46.7 për qind dhe 63.9 për qind, përkatësisht.

Ky nivel i rënduar i cilësisë së portofolit, i cili është prezent prej disa vitesh, ka diktuar marrjen e disa masave nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kështu, u adoptua një rregullore më konservatore në lidhje me klasifikimin e portofolit të huave dhe llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë. Portofoli grupohet në katër kategori huash jo të rregullta nga tre të mëparshmet. Është shtuar kategoria e "huave në ndjekje", ku përfshihen hua që sipas kritereve të mëparshme klasifikoheshin në huatë standarde. Për shkak se këto shfaqin rrezikun e kthimit në hua jo të rregullta, klasifikohen në këtë kategori. Gjithashtu, kërkohet që fond rezervë të krijohet edhe për huatë e kategorisë "në ndjekje", madje edhe për huatë standarde.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë mori vendim për moslejim dhënie kredish të reja nga ana e bankave, portofoli i të cilave kishte hua të pakthyera në afat prej 30 ditësh, mbi 20 për qind. Ky vendim rezultoi të ishte një masë e drejtë për momentin, pavarësisht nga kundërshtitë që pati. Nëpërmjet këtij vendimi u krijua mundësia që të bllokohej dhënia e mëtejshme e kredive me cilësi të dobët, duke reduktuar kështu humbjet e ardhshme në formën e krijimit të kredive të reja problemore me pasojat që ato kanë.

Tabelë 8. Cilësia e portofolit të huave (në përqindje ndaj tepricës së kredisë gjithsej).

Zëri	Grupi I		Grupi II		Grupi III	
	1997	1998	1997	1998	1997	1998
1. Kredi të klasifikuara si jo të rregullta	64.6	77.0	14.3	8.9	46.6	17.3
2. Kredi të këqija	46.5	63.9	6.8	7.6	33.0	11.1

5. ÇËSHTJE TË TJERA

Duke u nisur nga zhvillimet e derisotme të sistemit bankar shqiptar nga pikëpamja e origjinës së kapitalit të bankave dhe privatizimit të pritshëm të bankave shtetërore, ku synimi i shprehur dhe në strategjinë e privatizimit është gjetja e investitorëve strategjikë të huaj, në një të ardhme të afërt (2-3 vjet) nuk do të ketë (ose pesha do të jetë në nivel të ulët) "pronarë shqiptarë të bankave".

Lejimi i hyrjes në tregun shqiptar të bankave të huaja është një strategji e mirë për të gjallëruar dhe zhvilluar sistemin bankar. Kjo strategji ka dhënë frytet e veta edhe në vende të tjera të Evropës Lindore e Qendrore. Megjithatë, sot në këto vende ka filluar të shfaqet gjithnjë e më shumë shqetësimi nëse të huajt "do të sundojnë" sistemet bankare të këtyre vendeve. Në Poloni[12] rreth gjysma e kapitalit bankar posedohet nga të huajt, në Sllovaki rreth 35 për qind[13]. Në Hungari në periudhën 1994-1998 pronësia e huaj në sektorin bankar u rrit nga 15 për qind në 60 për qind[14]. Në Shqipëri, prania e kapitalit të huaj në sistemin bankar është rreth 47 për qind në fund të vitit 1998, duke pësuar një rritje të ndjeshme brenda një viti (në fund të vitit 1997 ky tregues ishte në nivelin 37 për qind). Pesha e kapitalit të huaj pritet të rritet në vitet e ardhshme.

Interesante është të vërehet edhe numri i bankave që veprojnë në një vend të caktuar. Në Poloni, vend me popullsi rreth 38.6 milionë banorë[15] konkurrojnë 70 banka (ose një bankë për rreth 552 mijë banorë) dhe një ndër 5 polakë ka llogari në bankë[16] (në Evropën Perëndimore një raport i tillë është 4:5).

Ndërkohë, Kroacia ka rreth 62 banka dhe 33 banka kursimesh. Guvernatori i Bankës Qendrore të Sllovakisë është shprehur se në Sllovaki ka një numër të mjaftueshëm bankash në vend dhe kundërshton synimin e shprehur të qeverisë për nxitje të konkurrencës së sektorit bankar, nëpërmjet politikës liberale të licencimit. Sipas tij ajo çka duhet bërë është përmirësimi i cilësisë së institucioneve financiare[17]. Të njëjtën mënyrë të shprehuri gjejmë edhe për Republikën Çeke. Shumë vëzhgues theksojnë që 40 banka për një vend me madhësinë e Republikës Çeke janë shumë[18] (ose një bankë për rreth 257 mijë banorë). Pra, tendenca e dytë që del në pah është kufizimi i licencimit dhe shtimi i përpjekjeve për konsolidim dhe përmirësim cilësie të institucioneve ekzistuese bankare.

Në Shqipëri, po të nisemi nga treguesi i numrit të bankave në raport me popullsinë, dukemi se jemi një vend "i mbipopulluar" me banka. Në fund të vitit 1998 operonin 10 banka, në një popullsi prej 3.3 milionë ose 1 bankë për 336 mijë banorë; po t'i referohemi shtatorit 1999 ku numri i bankave në funksionim është 12, një bankë i shërben një numri edhe më të vogël banorësh (280 mijë banorë)[19].

Një tregues i tillë mund të dukej fare normal nëse Shqipëria do të ishte një vend me trashëgimi bankare dhe ku njerëzit (qoftë si individë, qoftë si pronarë shoqërish) do t'i kishin shumë të zhvilluara marrëdhëniet me bankat. Realiteti është krejt tjetër. Nuk mund të themi sa shqiptarë kanë marrëdhënie aktive me bankat (pasi nuk e disponojmë një shifër të tillë) por vlerësohet që kjo të mos jetë e lartë.

Kjo nuk do të thotë që të ndërmerren veprime për të reduktuar numrin e bankave ekzistuese, as për të ndërprerë ose shtrënguar procesin licencues. Në fund të fundit, numri i

bankave do të varet nga hapësirat që u krijon atyre tregu për të mbijetuar dhe për të qenë të suksesshme. Kjo mendoj se është më tepër një tregues që tregu bankar shqiptar e kaloi fazën e "urisë" për banka të reja dhe kapital të huaj. Në këtë moment duhet ndryshuar filozofia e licencimit, e adoptuar nga Banka e Shqipërisë dhe politikat që ndjek ajo në drejtim të sistemit bankar. Banka e Shqipërisë nuk ka më nevojë thjesht të nxisë "hyrjen e bankave të reja në treg", por duhet të synojë hyrjen e bankave të reja me cilësi të reja. Me këtë kuptohet hyrja e bankave që premtojnë dhe përfshijnë në planet e tyre të biznesit, kryerjen e veprimtarive të tilla që sot mungojnë në sistemin bankar shqiptar. Të tilla mund të ishin banka që premtojnë përdorim produktesh të reja në sistemin e pagesave, premtojnë investime në tregun e letrave me vlerë, ofrim shërbimesh bankare edhe jashtë territorit të Tiranës dhe, ajo çka është më e rëndësishme, të jenë "më dashamirëse" ndaj aktivitetit të kreditimit, sidomos të bizneseve shqiptare.

Është fakt i njohur që disa prej bankave të licencuara vitet e fundit ose nuk kanë filluar aktivitet kreditues ose janë zgjeruar me një ritëm shumë të ulët në këtë drejtim. Treguesi më domethënës është mosrealizimi i kufirit të kreditit për disa vite. Po kështu, është mjaft e njohur dhe njëra ndër arsyet që shpjegon moskreditimin nga sistemi bankar "mjedis ekonomik me rrezik të lartë dhe biznesmenë apo shoqëri që nuk dinë të bëjnë plane biznesi e që nuk janë klientë bankash". Kjo arsye është mëse e vërtetë. Megjithatë, pa dashur të ofendojmë ndonjë, kjo arsye duket dhe mjaft komode për të fshehur deri në njëfarë mase, dëshirën e moskreditimit. Mjedisi ekonomik shqiptar është me rrezik të lartë dhe i pastabilizuar e i parregulluar. Përveç të tjerash ai është goditur dhe nga kriza të brendshme e të jashtme. Nga ana tjetër, ky mjedis ekonomik "i rrezikshëm" nuk u krijua brenda një nate. Të paktën prej një dekade ai klasifikohet si i tillë. Në këtë mënyrë, bankat e reja që kanë filluar aktivitet këto vite supozohet se e kanë njohur, kanë studiuar anët pozitive dhe negative të tij, dhe në bazë të këtij studimi kanë marrë vendimin të hyjnë në tregun bankar shqiptar, madje për këtë kanë hartuar dhe plan-bizneset përkatëse, në bazë të të cilave kanë mundësuar dhe sigurimin e licencës.

As fakti që bizneset shqiptare nuk janë klientë bankash, nuk është i ri. Është e qartë që biznese që nuk kanë as 8 vjet veprimtari, pa një kulturë marrëdhëniesh me bankat, nuk mund t'i afrohen bankave dhe nuk mund të jenë në gjendje të bëjnë plane biznesi. Në raste të tilla janë bankat ato që, po qe se kanë interes të funksionojnë si banka normale, zhvillojnë politika nxitëse për të afruar klientët. Kështu, një bankë, duke parë këtë boshllëk në kulturën ekonomike, fare mirë mund të zhvillojë një aktivitet të ri, atë të ofrimit të shërbimit të konsulencës për bizneset e reja.

Kështu, "faji" nuk qëndron vetëm tek biznesi apo klienti shqiptar. Kjo duhet detyrimisht të rimodelojë politikën e licencimit nga ana e Bankës së Shqipërisë, si hap i parë.

Si hap i dytë, duhet që funksioni i mbikëqyrjes nga banka qendrore të zhvillohet dhe me një element të ri. Vlerësimin e realizimit të planeve të bizneseve të paraqitura në kërkesën për licencë. Të mos harrohet që licenca përftohet në bazë edhe të disa premtimeve të bëra në formën e plan-biznesit, të cilat e klasifikojnë kërkuesin si të përshtatshëm për të hapur bankë. Moszbatimi i këtij plani tërësisht ose në pjesën më të madhe të tij dhe kur nuk kanë vepruar faktorë tepër specifikë (sepse këto plane studiohen nën supozimin që kërkuesi ka njohuri dhe e ka studiuar tregun shqiptar), ul përshtatshmërinë e kërkuesit për aktivitet bankar.

Një tjetër hap, që tashmë është realizuar nga Banka e Shqipërisë, është forcimi i kërkesave për licencim, e në radhë të parë shtimi i shumës së kapitalit minimal të domosdoshëm për çeljen e një banke. Kjo automatikisht e bën më cilësor procesin e përzgjedhjes.

Tjetër parim që duhet të zërë vend në procesin licencues është edhe diversifikimi i origjinës së kapitalit të huaj bankar. Kjo ka dy ndikime pozitive. Së pari, sjell kultura të ndryshme bankare, me interesa të drejtuar në fusha të ndryshme të ekonomisë shqiptare apo në segmente të ndryshme të tregut të klientëve. Së dyti, ul ekspozimin e sistemit bankar shqiptar ndaj një ekonomie

të vetme, duke reduktuar mundësinë e pësimit të goditjeve të jashtme në rast se ekonomia e atij vendi ka probleme. Kjo e fundit mund të duket si pak paradoksale në kushtet kur ekonomia shqiptare nuk është shumë e integruar me ekonomitë e tjera dhe kur problemet e brendshme të vetat eklipsojnë problemet e ekonomive të tjera. Por, jo gjithmonë do të jetë kështu.

Një faktor tjetër mund të jetë edhe rritja e transparencës në procesin e licencimit. Transparencë në licencim nuk do të thotë vetëm deklarimi në media i licencave të dhëna. Që në momentin kur në Bankën e Shqipërisë paraqiten kërkesa për licencë, një gjë e tillë mund të bëhet publike. Njoftimet është e qartë që nuk do të përfshijnë dhënien e informacionit të klasifikuar si konfidencial. Nga ana tjetër, bërja publike do të ndihmonte Bankën e Shqipërisë të thithte opinionin, në radhë të parë të ekonomistëve si dhe reagimet nga shtresa të ndryshme biznesi e të popullsisë. Kjo, patjetër që do ta ndihmonte për marrje vendimesh më të pjekura. E theksoj këtë fakt nisur dhe nga eksperienca me disa nga firmat piramidale, të cilat paraqitën kërkesa për t'u licencuar si banka në Bankën e Shqipërisë. Vetëm me paraqitjen e kërkesës së tyre për t'u licencuar si banka, u krijua një element shtesë që popullsia të besonte në këto firma. Në mënyrë të rrufeshme u përhap parulla "tani firma X do të bëhet edhe bankë". Kjo mund të ishte penguar nëse në media Banka e Shqipërisë do të shpjegonte që për të marrë një licencë nuk mjafton vetëm paraqitja e kërkesës. Akoma më i madh do të ishte efekti nëse Banka e Shqipërisë do të bënte të njohur edhe faktin që këtyre firmave nuk u ishte miratuar marrja e licencës bankare (dhe një refuzim i tillë ka ndodhur që në gjysmën e parë të vitit 1996) duke shpjeguar arsyet përkatëse apo që firma të tjera sapo u ballafaquan me listën e kërkesave u tërhoqën nga ky proces. Në asnjë rast Banka e Shqipërisë nuk ka bërë publike mosdhëniet e licencave (dhe raste të tilla ka patur).

Ndërkohë, vazhdimi i zbatimit të politikës për licencim bankash të huaja, duket i përshtatshëm për momentin. Bankat e huaja, për shkak të përvojës dhe të aftësive, kanë strategji më të qarta dhe administrim më efikas, sidomos në drejtim të kontrollit të

rrezikut. Ato janë dhe më të përgatitura në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë bankare me pakicë[20], gjë e cila shihet si një rrugë e mundshme për afrimin e popullsisë shqiptare tek bankat.

Prania e bankave të huaja në një vend sidomos në ekonomitë në tranzicion, siguron përfitime afatgjata në formën e presionit shtesë që ushtrohet mbi bankat vendase, në lidhje me ndërmarrjen e rreziqeve të përshtatshme; të transferimit të aftësive dhe të teknologjisë; të nxitjes së konkurrencës etj.. Bankat e huaja mund të ndikojnë edhe në përmirësimin e procesit rregullator të një vendi, pasi ato rregullohen dhe nga autoritetet e vendeve të tyre (gjithnjë kur këto banka kanë origjinë nga vende të zhvilluara)[21]. Ato mund të përballojnë më me sukses goditjet e brendshme, pasi kanë portofole investimesh më të diversifikuara (mund të jenë filiale ose degë të bankave të huaja me shtrirje në vende të tjera, ose banka nga vende me strukturë ekonomike të ndryshme). Por, efekti i këtij ndikimi mund të reduktohet ndjeshëm nëse bankat e huaja vijnë nga i njëjti vend ose rajon, ose nga vende me strukturë të ngjashme prodhimi.

Në situatën aktuale të sistemit bankar shqiptar është ende politikë e vlefshme lejimi i hyrjes së bankave të huaja në treg, por duhet të rritet cilësia e procesit përzgjedhës të tyre.

SHËNIME

* Teuta Baleta, Drejtore, Departamenti Kërkimeve dhe Publikimeve. Shtator 1999.
Mendimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk përputhen domosdoshmërisht me opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
[1] Këto banka janë: Dega e Bankës së Parë të Investimeve, Banka FEFAD dhe Banka Tregtare Ndërkombëtare e Detit të Zi. Deri në shtator 1999, dy prej tyre kanë filluar aktivitetin gjatë gjysmës së parë të vitit 1999, ndërsa Bankës Tregtare Ndërkombëtare të Detit të Zi iu miratua kërkesa për zgjatje afati të fillimit të aktivitetit.
[2] Termi "banka të huaja" ose "banka me kapital të huaj" nuk nënkupton që nga pikëpamja e legjislacionit shqiptar këto banka janë jorezidente. Cilësimi bëhet vetëm për të dalluar origjinën e kapitalit.
[3] Sa herë që në emërtimin e një banke përdoret termi "degë" duhet patur parasysh që nga pikëpamja e legjislacionit shqiptar dhe sidomos e kërkesave rregullatore nuk ka dallim apo trajtim të diferencuar midis një banke apo dege. Ato janë në të njëjtat pozita.
[4] Shih "Raporti Vjetor, 1998" i Bankës së Shqipërisë, faqe 37.
[5] Sipas rregullave të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, në përgjithësi investimet në bonot e thesarit konsiderohen si investime me rrezik zero (pa rrezik), ndërsa kreditë si aktivi me rrezikun më të lartë (koeficienti i rrezikut 1).
[6] Teprica e kredisë në fund të viteve 1997 dhe 1998 është përkatësisht 16.4 dhe 16.3 miliardë lekë.
[7] Për të dhëna më të hollësishme në lidhje me peshën e secilit grup bankash në sistemin bankar referojuni rubrikës "Të dhëna të mbikëqyrjes" të Buletinit Ekonomik.
[8] Burimi: Entering the 21st century", World Development Report 1999/2000. The World Bank.Kapitulli 8: "Case studies recommendations! Hungary".
[9] Rezultati neto nga ndërmjetësit financiarë gjendet duke zbritur nga rezultati neto prej interesave, shpenzimet për provigjone.
[10] Në këto llogaritje nuk merret parasysh niveli i depozitave në valutë, llogaritë rrjedhëse në lekë për të cilat paguhet interes dhe norma për to nuk ka ndryshuar, struktura e maturimit të depozitave me afat si dhe fakti që norma mesatare e interesit për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor ka ndryshuar disa herë gjatë vitit 1998. Këto elemente janë abstraguar për thjeshtësi llogaritjeje dhe qëllimi është të tregohet mjedisi i favorshëm që është krijuar për bankat për reduktim të shpenzimeve për interesa.
[11] Norma minimale e lejuar për mjaftueshmërinë e kapitalit për një bankë është 12 për qind.
[12] Revista e përjavshme "Business Week", 2 gusht 1999, faqe 18.
[13] Sipas Guvernatorit të Bankës Qendrore të Sllovakisë, cituar nga gazeta "New Europe", 29 nëntor - 5 dhjetor 1998.
[14] Burimi: "Entering the 21st century", World Development Report 1999/2000. The World Bank. Kapitulli 8: "Case studies and recommendations. Reforming

weak banking system: Hungary", fq. 161.
[15] CIA World Factbook, 1999 (vlerësimet për muajin korrik 1999).
[16] Revista e përjavshme "Business Week", 2 gusht 1999, faqe 18.
[17] Sipas Guvernatorit të Bankës Qendrore të Sllovakisë, cituar nga gazeta "New Europe", 29 nëntor - 5 dhjetor 1998.
[18] Sipas revistës "European Banker", "Private banks takes slice of pie", nr. 165, prill 1999, faqe 11.
[19] Nëse do të merrej në konsideratë vetëm popullsia e qytetit të Tiranës (rreth 700 000 banorë), ku edhe janë përqendruar bankat, treguesi do të ishte në nivelet 70 mijë banorë dhe 58 mijë banorë, përkatësisht për fundin e vitit 1998 dhe muajin shtator 1999.
[20] Retail banking : "Dictionary of Banking" i autorit Jerry M. Rosenberg, 1993 jep këtë përkufizim: shërbime bankare të ofruara për publikun e gjerë, përfshi ndërmarrjet tregtare, konsumatorët dhe biznesin e vogël.
"Dictionary of Modern Economics" i autorit David W. Pearce, 1989 jep këtë përkufizim: termi që përdoret për operacionet bankare tradicionale të kryera nga bankat që shërbejnë si qendra të pastrimit të marrëdhënieve (clearing) dhe gjithnjë e më tepër nga bankat e kursimeve, që merren me aktivitetin e kujdestarisë (trustee) dhe të tjerat, nëpërmjet rrjeteve të tyre të degëve me publikun e gjerë. Siç nënkuptohet, veprimtaria bankare me pakicë angazhon një numër të madh transaksionesh – depozitim dhe tërheqje parash (cash), pagesa çeqesh, dhënie kredish në llogari të zbuluar dhe dhënie huash të tjera – në shuma të vogla.
"Encyclopedic Dictionary of Finance" i autorëve Dean Paxson dhe Douglas Wood, 1998 shpjegon: historikisht veprimtaria bankare me pakicë është një biznes relativisht i thjeshtë. Bankat tregtare, që operojnë kryesisht nëpërmjet një rrjeti degësh, marrin depozita konsumatorësh, të cilat atëherë përdoreshin zakonisht për të dhënë hua, në pjesën më të madhe të vendeve në formën e huasë me llogari të zbuluar, për sektorin e korporatave. Për depozitat e mbajtura në llogari rrjedhëse bankat ofronin shërbime transaksioni falas, kryesisht nëpërmjet përdorimit të çeqeve në ekonomitë më të zhvilluara. Huatë personale për konsumatorët, gjithashtu, viheshin në dispozicion por ato nuk përbënin ndonjë pjesë të konsiderueshme të portofolit të huave të bankës. Nuk kishte aspak ose kishte fare pak segmentim të tregut konsumator.
Nga fundi i viteve '60 produktet elektronike personale ishin në fillimet e tyre, rrjeti i makinave automatike të parave (ATM) i pazhvilluar dhe financimi me kredi trajtohej si një produkt periferik (i dorës së dytë) dhe deri në njëfarë mase i pakëndshëm. Roli i degës ishte të ofronte një gamë të plotë shërbimesh për të gjithë llojet e klientëve. Drejtuesi i degës mendohej edhe si administrator, edhe si vlerësues krediti (brenda kufijve të ngushtë), edhe duhej të kishte njohuri për shërbimet e brendshme që ofronte banka.
Shërbimet ndërkombëtare zakonisht ofroheshin nga specialistët që punonin në degën (departamentin) ndërkombëtare. Sistemi bazohej në letrat, tentonte të ishte negativ kundrejt qëndrimit dhe përqendrimit të klientit, i ngadaltë, i shtrenjtë dhe kishte mungesa serioze në përpjekjet për marketing dhe shitje (shih Channon, 1998).

[21] Në botimin e Bankës Botërore të titulluar "Entering the 21st century", World Development Report 1999/2000 vërehet se nga një studim i fundit mbi efektet e bankave të huaja në sistemin bankar të 80 vendeve, ka rezultuar se bankat e vendit kanë nivel më të ulët shpenzimesh dhe kjo pjesëmarrje tenton të përmirësojë rezultatin e tyre.

REFERENCA

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, 1998.

Deklarata e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, gjashtëmujori i dytë i vitit 1998.

Të dhëna të sistemit bankar botuar në Buletinet Ekonomike të Bankës së Shqipërisë.

"Entering the 21st Century", World Development Report 1999/2000. The World Bank.

"Banking on change", revista "The European Banker", nr. 157, shtator 1998.

"Central bank governor says enough banks in Slovakia…", gazeta "New Europe", 29 nëntor -5 dhjetor 1998.

"Will foreigners rule the banks?", revista "Business Week", 2 gusht, 1999.

"Developing financial institutions and markets", Transition Report, European Bank for Reconstruction and Development.

"Banking Brief, Special Report: Commercial Banks in 1998", Federal Reserve Bank of Philadelphia

"Private banks take slice of pie", revista "European Banker", nr. 165, prill 1999.

MBIKËQYRJA BANKARE DHE RAPORTI STANDARD I EKZAMINIMIT

*Arian Kraja**

Fjalë kyçe
- Mbikëqyrja bankare - Raport ekzaminimi - Sistemi CAMELS -

1. MBIKËQYRJA BANKARE

1.1. Ç'ËSHTË MBIKËQYRJA BANKARE?

Mbikëqyrja bankare është procesi i monitorimit të gjendjes së një banke të veçantë të sistemit bankar, si edhe i vetë sistemit si një i tërë. Ky proces fillon me miratimin e kërkesave standarde për të licencuar një bankë dhe zbatimin e tyre; vazhdon me vlerësimin e veprimtarisë së bankës; dhe, kur është e nevojshme, përfshin marrjen e masave korrektuese dhe vënien e gjobave në mënyrë që të sigurohet zbatimi i ligjit dhe krijimi i një industrie bankare të shëndoshë. Këto masa kanë si kufi të fundit heqjen e licencës së bankës.

1.2. PËRSE DUHET MBIKËQYRJA BANKARE?

Bankat mbikëqyren më tepër dhe më nga afër prej autoriteteve mbikëqyrëse zyrtare se sa bizneset e tjera, për shkak të rolit që ato kanë në jetën ekonomike dhe financiare të vendit. Bankat pranojnë depozita nga publiku dhe qeveria.

Në këtë mënyrë ato luajnë rolin e një instituti "të madh", të cilit shoqëria i beson pasuritë e saj financiare. Bankat zënë vendin kryesor në mekanizmin e pagesave për publikun, biznesin dhe qeverinë.

Gjithashtu, ato luajnë një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e burimeve financiare të vendit, duke qenë ndërmjetëse midis depozitimit të fondeve dhe dhënies hua të tyre, duke gjykuar më parë mbi mundësitë e huamarrësve për të shlyer huanë.

Kjo është në kontrast të dukshëm me praktikat e një ekonomie me planifikim të centralizuar, ku bankat si rregull kanë një rol pasiv të kufizuar duke shërbyer thjesht si kanale për shpërndarjen e fondeve, pa qenë nevoja që ato vetë të marrin vendime për dhënie kredish.

Për shkak të rolit të veçantë që luajnë bankat, arsyeja e parë se pse duhet të ekzistojë mbikëqyrja bankare është reduktimi, sa më shumë që të jetë e mundur, i rrezikut për humbje të parave nga ana e depozituesve dhe duke siguruar në këtë mënyrë ruajtjen e besimit publik në sistemin bankar si një i tërë.

1.3. ÇFARË ËSHTË PROCESI I MBIKËQYRJES BANKARE?

Mbikëqyrja bankare është një proces i vazhdueshëm, që fillon me dhënien e licencës. Pikërisht në këtë moment, vlerësohen nëse janë ose jo të pranueshëm për të zhvilluar biznes bankar individët dhe/ose personat juridikë që kanë aplikuar për të çelur një bankë. Ky vlerësim bëhet duke patur parasysh plotësimin e një sërë kërkesave standarde si për shembull, kërkesa që kanë lidhje me kapitalin fillestar, me kualifikimin e drejtuesve, me përshtatshmërinë e planeve të biznesit bankar dhe të planeve strategjike etj..

Procesi i mbikëqyrjes bankare vazhdon me kërkesat për raportim. Të dhënat e raportuara shqyrtohen dhe vlerësohen në Sektorin e Analizës dhe Informacionit. Ndryshe ky proces njihet me emrin "mbikëqyrja e jashtme". Më tej banka inspektohet prej inspektorëve të Bankës së Shqipërisë.

Ky proces njihet si "inspektimi në vend i bankës". Nëpërmjet inspektimeve verifikohen informacionet e dhëna nga banka si dhe shqyrtohet veprimtaria dhe rezultatet e bankës. Këto inspektime mund të jenë të përgjithshme (inspektim i plotë i gjithë aktivitetit të bankës) ose mund të përqendrohen në fusha të veçanta (inspektim i pjesshëm për një ose më shumë aktivitete të bankës). Në përfundim të çdo inspektimi, jepen konkluzionet dhe rekomandimet në formë të shkruar. Dokumenti që përmban konkluzionet dhe rekomandimet quhet raport ekzaminimi. Bankave, të cilat kanë ushtruar veprimtari jo të shëndoshë dhe me rrezik, do t'u kërkohet t'i ndërpresin ato. Përveç kësaj, të tilla banka janë të detyruara të ndërmarrin një sërë masash korrektuese. Pra, mangësitë e vërejtura në aktivitetin e një banke gjatë mbikëqyrjes së saj, si nga procesi i analizës ashtu edhe gjatë inspektimeve në vend, duhet që të korrektohen. Neni 44, i ligjit nr. 8365, datë 22.07.1998, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" përmend një varg masash me anë të të cilave mund të reagojë Banka e Shqipërisë në rast se një bankë nuk respekton kërkesat e mbikëqyrjes.

2. RAPORTI I EKZAMINIMIT

2.1. Ç'ËSHTË RAPORTI I EKZAMINIMIT?

Raporti i ekzaminimit është një dokument, i cili përdoret për të prezantuar tek drejtuesit e Bankës së Shqipërisë dhe te këshilli drejtues i bankës së inspektuar, gjetjet më të rëndësishme, konkluzionet dhe veprimet korrektuese të rekomanduara, çështje këto të cilat dalin nga një inspektim në vend. Me fjalë të tjera ky raport është komunikimi i shkruar që realizohet midis mbikëqyrësve dhe drejtuesve të bankës qendrore si dhe drejtuesve të bankës që inspektohet.

Meqenëse raporti i ekzaminimit komunikon probleme dhe rekomandime të rëndësishme, ai ka një rol kyç në procesin e përgjithshëm të mbikëqyrjes. Pothuajse në të gjitha rastet, raporti i ekzaminimit shërben si një dokument që justifikon marrjen e masave korrektuese.

Për të siguruar uniformitet në prezantimin e gjetjeve të inspektimeve, lexim më të lehtë të tyre dhe identifikimin e menjëhershëm të problemeve dhe konkluzioneve kryesore, është përgatitur një format i standardizuar i raportit të ekzaminimit.

Faqja e parë e këtij dokumenti liston konkluzionet e përgjithshme për gjetjet më të rëndësishme. Kjo ndiqet nga një faqe tjetër, ku listohen çështjet më të rëndësishme tek të cilat duhet të përqendrohet vëmendja e këshillit drejtues të bankës së inspektuar.

Më pas, jepen komentet përmbledhëse për çdo element të sistemit të vlerësimit CAMELS[1] si dhe çështje të tjera nëse shihet e nevojshme. Këto fletë shoqërohen me tabela dhe të dhëna të tjera, me synimin për të konfirmuar konkluzionet e dhëna në fillim të raportit.

2.2. STRUKTURA E RAPORTIT STANDARD TË EKZAMINIMIT

Raporti i ekzaminimit përbëhet nga 4 komponentë kryesorë:

1. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME
2. VLERËSIMI
3. INFORMACION SHTESË
4. PJESA KONFIDENCIALE

2.2.1 Komponenti 1: Konkluzione dhe rekomandime

Ky komponent vlerësohet si një ndër pjesët më të rëndësishme të raportit të ekzaminimit pasi në të, në mënyrë të shkurtuar e konçize, jepen:

A. gjetjet kryesore dhe konkluzionet e ekzaminimit;
B. çështjet që kërkojnë vëmendjen e këshillit drejtues të bankës së ekzaminuar;
C. shkeljet e ligjeve dhe të rregulloreve në fuqi.

Në rubrikën "*Gjetjet kryesore të ekzaminimit*" vlerësohen, në përputhje me sistemin "CAMELS", gjendja financiare e bankës,

kapitali, cilësia e aktiveve, portofoli i kredive dhe i investimeve, kuadri i përgjithshëm i politikave dhe praktikave, rentabiliteti, likuiditeti etj., si dhe shpjegohet cilësia dhe tendenca e çdo komponenti.

Po kështu, nëse shihet e nevojshme, shpjegohet ndonjë ndryshim i ndjeshëm apo tendencë për ndryshim në të ardhmen. Kjo rubrikë firmoset nga ekzaminuesi përgjegjës dhe nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes.

Në rubrikën "*Çështje që kërkojnë vëmendjen e këshillit drejtues*" prezantohen, çështjet kryesore që kërkojnë vëmendjen e këshillit drejtues, duke i renditur përsëri sipas elementeve përbërëse të sistemit "CAMELS", gjetjet e ekzaminimit për të cilat këshilli drejtues duhet të marrë masa për përmirësim si për shembull, hartimin e politikave, miratimin e rregulloreve dhe udhëzimeve, hartimin e programeve të nevojshme ose marrjen e masave administrative për ndreqjen e shkeljeve apo përmirësimin e gjendjes financiare të bankës, probleme të cilat janë vërejtur gjatë ekzaminimit dhe janë bërë prezent në raportin e ekzaminimit.

Çdo anëtar i këshillit drejtues të bankës që inspektohet, ka përgjegjësi për të analizuar në mënyrë të plotë të gjithë raportin e ekzaminimit.

Çdo anëtar i këshillit drejtues duhet të firmosë faqen "*Firmat e Anëtarëve të Këshillit Drejtues*", me qëllim që të konfirmohet se secili prej tyre ka parë raportin në tërësi.

(Skematikisht faqja ka pamjen e mëposhtme)

Emri Mbiemri	Funksioni në Këshillin Drejtues	Data	Firma

Në rubrikën "*Shkelje të ligjeve dhe të rregulloreve*" renditen shkeljet e ligjeve ose të rregulloreve, që ekzaminuesit kanë gjetur në bankë, duke renditur në fillim shkeljet e ligjeve e më pas shkeljet e rregulloreve si dhe sipas shkallës së rrezikut që ato bartin për bankën.

2.2.2 Komponenti 2: Vlerësimi

Kjo pjesë përbëhet nga 6 elementet e sistemit CAMELS. Në këtë pjesë, jepet vlerësimi për gjendjen financiare të bankës parë në të gjitha aspektet. Nëse do të ndiqej renditja normale e sistemit CAMELS, vlerësimi do të fillonte me kapitalin. Por, për rëndësinë dhe ndikimin e gjithanshëm që ka menaxhimi, është e udhës që ky vlerësim të fillojë me menaxhimin dhe administrimin.

A- Menaxhimi/Administrimi.

Menaxhimi vlerësohet kundrejt të gjithë faktorëve të nevojshëm për të drejtuar institucionin në mënyrë të shëndoshë dhe të sigurt dhe në përputhje me praktikat e pranuara. Vëmendja përqendrohet tek kompetenca teknike, udhëheqja dhe aftësitë administrative; pajtueshmëria me rregulloret dhe statutin; aftësia për të planifikuar dhe për t'iu përgjigjur rrethanave në ndryshim; efektiviteti i sistemeve të menaxhimit të informacioneve; mjaftueshmëria dhe zbatueshmëria e politikave të brendshme; përgjigja ndaj rekomandimeve të kontrollorëve dhe autoriteteve të mbikëqyrjes; dhe cilësia e menaxhimit. Konkretisht, kjo pjesë trajton:

- Vlerësimin e menaxhimit si nga pikëpamja e drejtimit rutinë të bankës, ditë për ditë, ashtu dhe afatgjatë.
- Gjykimin mbi politikën e bordit për funksionet bazë të bankës (depozitat, kreditë, letrat me vlerë etj.).
- Problemet që meritojnë vëmendjen e bordit.
- Zbatimin ose jo të rekomandimeve të kontrollit të brendshëm ose të jashtëm si dhe citohen me emër menaxhuesit për sqarimet që japin.
- Vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të bankës.
- Gjykimin mbi identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve nga menaxhimi.
- Gjykimin e aktiviteteve të bankës në lidhje me personat e lidhur me bankën.

B- Mjaftueshmëria e kapitalit.

Mjaftueshmëria e kapitalit vlerësohet në lidhje me rregulloret

në fuqi për kapitalin rregullator dhe mjaftueshmërinë e fondeve të veta; gjendjen e përgjithshme financiare; natyrën, tendencat dhe vëllimin e aktiveve të klasifikuara si nënstandarde; aktivet e patrupëzuara, aktiveve jashtë bilancit dhe fitimet; ritmet e rritjes etj..

Përveç kësaj, nga këndvështrimi i nevojave të kapitalit, jepen konsiderata për fitimet e bankës; rrezikun e përgjithshëm të normës së interesit; arsyeshmërinë e dividendëve të paguar; si dhe planet për mbajtjen e kapitalit në nivel të mjaftueshëm apo marrjen e masave përkatëse korrektuese.

Për të dhënë gjykimin për nivelin e kapitalit dhe mjaftueshmërinë e tij studiohen raportet e mëposhtme:

Raportet e kapitalit dhe tendencat			
RAPORTET	Data e ekzaminimit (Data)	Ekzaminimi i mëparshëm (Data)	Ekzaminimi i mëparshëm (Data)
Totali i zërave të dyshimtë & nënstandard/ fondet e veta Kapitali bazë/totali i aktiveve Fondet e veta/totali i aktiveve Kapitali bazë/aktive të korrektuara			
	Data e ekzaminimit (Data)	Ekzaminimi i mëparshëm (Data)	Ekzaminimi i mëparshëm (Data)
Dividend/ardhura neto Përqindja e rritjes së aktiveve Fitimi/Humbja e viteve të kaluara/ kapitalin aksioner mesatar			

Më tej komentohet shkurtimisht, cilësia e kapitalit në lidhje me cilësinë e aktiveve, me fitimet, me rritjen e aktiveve si dhe me filozofinë e administrimit për pozicionin e kapitalit.

C- Cilësia e aktiveve (mjeteve).

Cilësia e aktiveve vlerësohet në lidhje me nivelin, shpërndarjen, tendencën dhe klasifikimin e mjeteve me probleme. Me këtë koncept lidhet niveli, përbërja dhe tendenca e mjeteve të maturuara, të cilave u ka kaluar afati i pagimit, u është pezulluar përllogaritja e interesit; aftësia e demonstruar për të identifikuar, administruar dhe mbledhur kreditë me probleme.

Përveç këtyre, vlerësohet cilësia e investimeve në letra me vlerë; mjaftueshmëria e politikave të investimeve, rreziku i investimeve etj., apo efektiviteti i politikave huadhënëse dhe procedurat e administrimit të kreditit.

Raportet e cilësisë së aktiveve dhe tendencat			
RAPORTET	Data e ekzaminimit (Data)	Ekzaminimi i mëparshëm (Data)	Ekzaminimi i mëparshëm (Data)
Aktivet e klasifikuara/totalin e aktiveve Kreditë e klasifikuara/totalin e aktiveve Kreditë e klasifikuara/totalin e kredive Kreditë e klasifikuara/fondet e veta Kreditë nënstandarde dhe të dyshimta/ fond. veta			

Me anë të këtyre raporteve:

- Vlerësohet gjendja e përgjithshme e mjeteve, vëllimi i mjeteve të klasifikuara.
- Jepet struktura e aktiveve.
- Paraqitet struktura e portofolit të kredive në lekë e valutë, sipas afatit të maturimit; struktura e portofolit të investimeve etj..

D- Të ardhurat.

Cilësia dhe sasia e të ardhurave vlerësohen në lidhje me aftësinë për të përkrahur veprimet e tanishme dhe të ardhshme, mbulimin e humbjeve dhe mbajtjen e kapitalit të mjaftueshëm; nivelin dhe tendencën e fitimeve; cilësinë dhe strukturën e fitimeve; marzhin neto të interesit; si dhe ekspozimin e fitimeve kundrejt ndryshimit të normave të interesit.

Po kështu, merren në konsideratë mjaftueshmëria e shpenzimeve për fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë (provigjoneve); kontributi i zërave të jashtëzakonshëm, transaksionet e letrave me vlerë, efektet e taksave në të ardhurën neto dhe pagesat e dividendit etj..

Treguesit dhe tendencat			
RAPORTET	Periudha (Data)	Periudha (Data)	Periudha (Data)
Të ardhura neto mbas taksave/ aktivet mesatare Të ardhura neto mbas taksave/ fondet e veta mesatare Shpenzime të veprimtarisë/të ardhura bruto të veprimtarisë			

Përveç llogaritjes së treguesve të mësipërm, në këtë pjesë bëhet:

- Vlerësimi i nivelit të fitimeve si dhe ndikimit të tyre në kapital.
- Vlerësimi i shpenzimeve, sidomos ato më të spikatura.
- Vlerësimi i planit të fitimeve në të ardhmen si dhe faktorët që do të ndikojnë në të.
- Gjykimi i nivelit të mjaftueshmërisë së provigjoneve për kreditë.
- Analizimi i përbërjes së të ardhurave (të ardhurat nga marrëdhëniet me bankat, të ardhurat nga marrëdhëniet me klientët, të ardhura nga dhëniet hua klientëve etj.).

E- Likuiditeti dhe administrimi i aktiveve/pasiveve.

Likuiditeti dhe administrimi i aktiveve/pasiveve vlerësohen në lidhje me përbërjen dhe qëndrueshmërinë e depozitave; shkallën dhe tendencën e mbështetjes në burimet afatshkurtra dhe shumë likuide të fondeve; ndonjë vështirësi në sigurimin e fondeve; dhe në likuiditetin e parashikuar nga letrat me vlerë dhe aktive të tjera.

Përveç kësaj, merret në konsideratë dhe mjaftueshmëria e likuiditetit, e politikave e praktikave të fondeve, duke përfshirë dispozita për burime alternative të fondeve; administrimit të rrezikut të normës së interesit; apo natyrës, tendencës dhe vëllimit të aktiviteteve jashtë-bilancit.

Rëndësi e veçantë do t'i jepet zbatimit të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Mbi likuiditetin bankar". Për këtë element përcaktohen:

- Cilësitë e burimeve të fondeve për të plotësuar nevojat për kredi dhe tërheqjet e depozitave.
- Mënyra e llogaritjes nga banka e raportit të likuiditetit.
- Struktura e depozitave (në lekë e në valutë) dhe komentohet ajo.
- Ekzistenca e komitetit për administrimin e aktiveve dhe pasiveve (ALCO) dhe efektiviteti i punës së tij.

F- Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut.

Ndjeshmëria e komponentit të rrezikut të tregut, reflekton shkallën në të cilën ndryshimet në normën e interesit, normat e këmbimit valutor, çmimet e mallrave ose të aksioneve, ndikojnë në fitimet ose bazën kapitale të institucionit.

Kur vlerësohet ky komponent, duhet marrë në konsideratë: aftësia e administrimit për të identifikuar, për të matur, për të monitoruar dhe për të kontrolluar rrezikun e tregut; madhësinë e institucionit; natyrën e kompleksitetit të aktiviteteve të tij; dhe mjaftueshmërinë e kapitalit dhe fitimeve të tij në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut të tregut. Për këtë çështje bëhet:

- Vlerësimi i faktorëve që ndikojnë (ndikimi i normave të interesit; ndikimi i normave të këmbimeve valutore).
- Vlerësimi i sistemit të përdorur nga administrimi për monitorimin dhe kontrollin e këtyre faktorëve.
- Komentimi mbi ndikimet e tyre në fitimet e institucionit.

G- Administrimi i rrezikut.

Janë disa pika që e ndihmojnë ekzaminuesin në vlerësimin e rrezikut dhe mënyrën se si drejtuesit e bankës merren me administrimin e rrezikut, të cilat po i japim më poshtë:

1. Vlerëso programin e administrimit të rrezikut të institucionit, komento se si drejtimi identifikon, mat, kontrollon dhe monitoron rrezikun formalisht ose joformalisht.

Kjo pikë kërkon një vlerësim të gjerë të administrimit të rrezikut,

të monitorimit dhe praktikave monitoruese. Nuk kërkohet që të shkohet në përshkrime të detajuara të çdo politike dhe praktike. Përkundrazi, ajo parashikohet të përcaktojë mjaftueshmërinë e mekanizmave për të identifikuar rrezikun e brendshëm e të jashtëm; çfarë rreziqesh banka do të marrë dhe si maten këto rreziqe etj..

Kur themi mjaftueshmëria e mekanizmave për të identifikuar rreziqet nga burime të brendshme ose të jashtme, duhet të kemi parasysh që:

a) Burime të jashtme të rrezikut - janë rreziqet që administrimi nuk mund t'i kontrollojë. Ato përfshijnë ndryshimet teknologjike, konkurrencën ekonomike, ngjarjet politike. Administrimi ka për detyrë të identifikojë dhe më pas t'i përgjigjet influencave të këtyre burimeve.
b) Burime të brendshme të rrezikut - janë të kontrollueshme sepse ato vijnë nga vendimet e administrimit si planifikimi strategjik dhe ndarja e burimeve. Për shembull, në qoftë se plani strategjik specifikon rritjen në një fushë të caktuar, a i ka institucioni burimet njerëzore të përshtatshme për të përkrahur këta objektiva? A e ka institucioni sistemin e informacionit për të trajtuar të tilla ndryshime?

Në këtë element përcaktohet nëse praktika dhe linja të rrezikut, në secilin funksion të bankës (kredi, depozitat, letra me vlerë) koordinohen me planin e përgjithshëm strategjik.

2. Vlerëso praktikat e shkruara të institucionit dhe administrimin e kreditit, duke përfshirë dokumentacionin, miratimin dhe kërkesat e raportimit. Vlerëso politikat dhe praktikat e huadhënies dhe të mbledhjes së kredisë, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e funksionit të huadhënies dhe përbërjen e portofolit.

Për këtë element komentohen politika e kredidhënies dhe e administrimit të kredisë, nëse këto politika janë ose jo të plota e të përshtatshme.

3. Vlerëso procesin e rishikimit të huave dhe sistemin e brendshëm të klasifikimit. Vlerëso metodologjinë e institucionit për përcaktimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve për humbjet nga huatë.

4. Vlerëso politikat dhe praktikat e administrimit të mjeteve dhe burimeve. Vlerëso udhëzimet e investimeve, strategjinë e fondeve, objektivat e likuiditetit dhe administrimin e rrezikut nga normat e interesit.

Për këtë element komentohet në mënyrë të veçantë likuiditeti i bankës dhe administrimi i fondeve si dhe rreziku i normës së interesit.

5. Vlerëso kontrollet e brendshme dhe sistemin e informacionit të administrimit. Vlerëso pavarësinë, kontrollet dhe frekuencën e kontrollit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Komento zbatimin e rekomandimeve të kontrollit të brendshëm.

6. *Vlerëso politikat e institucionit në lidhje me transaksionet me punonjësit e vet ose konfliktin e interesave. Komento çështje të tjera që lidhen me administrimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin nga drejtorët dhe administrimi.*

7. Vlerëso njohjen e administrimit dhe vullnetin për të vepruar në përputhje me ligjet e rregulloret.

Për këtë element përmenden shkeljet e ligjeve ose të rregulloreve.

8. Identifiko ndonjë individ ose interes që kontrollon institucionin, shkallën dhe mënyrën e kontrollit.

2.2.3 KOMPONENTI 3: Informacion shtesë

Në rubrikën "*Informacione shtesë*" jepen në detaje pasqyrat kryesore të gjendjes financiare të bankës, si më poshtë:

në milionë/lekë

	31/12/19xx	31/12/19xx
Aktivet[2]		
Arka		
Marrëdhënie me bankën qendrore		
Marrëdhënie me bankat		
Kreditë		
Investime në letra me vlerë etj...		
TOTALI I MJETEVE		
Pasivet Depozita Detyrime të tjera etj...		
TOTALI I DETYRIMEVE		
KAPITALI AKSIONER		
TOTALI I PASIVEVE DHE I KAPITALIT AKSIONER		
Zërat jashtë bilancit		

Vihet re se vendosja e faqes së menaxhim/administrimit, në fillim, pasqyron rëndësinë që kanë veprimet ose mosveprimet e drejtuesve të bankës, në kushtet e përgjithshme financiare të bankës ose të institucionit financiar.

Përmbledhje e zërave subjekt i klasifikimit dhe vëmendjes së veçantë				
	Zërat e klasifikuar			
Kategoritë	Nënstandarde	Të dyshimta	Të humbura	Totali
Kredi dhe dhënie me qira Letra me vlerë Të tjera pasuri të paluajtshme Aktive të tjera (p.sh. "Debitorë për interesa të përllogaritur dhe të kaluar në të ardhura")				
Totali në 31/12/19xx				
Totali në 31/12/19xx-1				
Totali në 31/12/199xx-2				
Totali në 31/12/199xx-3				

Shuma, përshkrime	KATEGORITË		
dhe komente	Nënstandarde	Të dyshimta	Të humbura
1. 2. 3.			

Zërat subjekt i klasifikimit. Përfshin aktivet dhe zërat jashtë bilancit, të cilët janë detajuar në kategoritë e mëposhtme:
Aktivet nënstandarde përfaqësojnë aktivet nënstandarde që janë mbrojtur, në mënyrë të pamjaftueshme nga pasuria aktuale e shëndoshë dhe nga kapaciteti pagues i borxhliut ose i kolateralit të marrë peng, në qoftë se ka. Aktivi, i klasifikuar në këtë mënyrë, duhet të ketë një dobësi të përcaktuar mirë ose që rrezikon pagimin e borxhit. Ato janë karakterizuar nga një mundësi e qartë që institucioni do të mbajë humbje, në qoftë se mangësitë nuk korrigjohen.
Aktivet e dyshimta, kanë të gjitha dobësitë e trashëguara si aktivet nënstandarde me karakteristika të shtuara.

- Përshkruaj dhe komento me hollësi të gjitha kategoritë e aktiveve të klasifikuara si më sipër.

Kuadrimi i provigjoneve për humbjet nga kreditë.

	31/12/19xx	31/12/19xx	31/12/19xx
Bilanci në fillim Humbje bruto nga kreditë Rikuperime Provigjone për humbjet nga kreditë			
Bilanci në fund			

Gjithashtu, për këtë pjesë koordinohet vlerësimi i administrimit me vlerësimin e komponentëve përbërës të CAMELS, që tregojnë në fund të fundit gjendjen e bankës dhe administrimin e saj.

Analiza e fitimeve	

Pasqyra krahasuese e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	31/12/19xx	31/12/19xx	31/12/19xx
Të ardhurat nga interesat Shpenzime për interesa			
Të ardhurat neto nga interesat Të ardhura jo nga interesat Shpenzime jo për interesa Provigjone për humbje nga kreditë dhe lisingu Fitime (Humbja) nga letrat me vlerë			
Humbje/Fitim nga operacionet valutore			
Të ardhura neto operacionale (Para taksave) Taksa e aplikueshme për të ardhurat			
Të ardhura neto operuese (Pas taksave)			
Të ardhura neto			
Pagesa e dividendit Ndryshimi neto në llogari kap. aksioner			

Mbas komponentit të vlerësimit, është vendosur, në mënyrë logjike informacion shtesë i grupuar sipas CAMELS, që nevojitet për të përkrahur komentet e bëra në pjesën e vlerësimit apo të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Raporte të komponenteve të profitabilitetit dhe tendencat.			
RAPORTET	31/12/19xx	31/12/19xx	31/12/19xx
Të ardhura neto nga interesat/Aktive mesatare që sjellin fitim Totali i shpenzimeve jo për interesa/ Aktivet mesatare Të ardhurat neto/Kapitalin mesatar aksioner Humbje neto/totalin mesatar të huave			

E rëndësishme është faqja e administrimit të rrezikut, e cila duhet marrë parasysh dhe kërkon që ekzaminuesi të vlerësojë nivelin e tolerancës së administrimit të përgjithshëm të rrezikut, si dhe vlerësimin e ekonomisë lokale se si ndikon te banka dhe sa mirë administrimi monitoron këtë ndikim.

SHËNIME

* Arian Kraja, Përgjegjës i grupit të bankave tregtare, Sektori i Inspektimeve në Vend, Departamenti i Mbikëqyrjes.

[1] CAMELS është një sistem standard vlerësimi për bankat e nivelit të dytë. Secila nga gërmat përfaqëson një element për të cilin vlerësohet banka: C- Kapitali; A- Aktivet; M- Menaxhimi; E- Të ardhurat; L-Likuiditeti dhe S- Ndjeshmëria. Për secilin nga këto elemente jepet vlerësimi nga 1 në 5, ku 1 përfaqëson vlerësimin më të mirë dhe 5 vlerësimin më të dobët.

[2] Aktivet dhe pasivet në këtë tabelë renditen sipas bilancit të bankës që ekzaminohet.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AFATIN E MESËM - NJË DOKUMENT I RËNDËSISHËM PËR BANKËN DHE POLITIKËN EKONOMIKE NË SHQIPËRI

*Marta Muço**

Fjalë kyçe
- Strategji zhvillimi - Zhvillim institucional - Banka e Shqipërisë - Transparencë -

Me vendim nr. 111, datë 17.11.1999, të Këshillit të Mbikëqyrjes[1] u miratua Strategjia e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm.

Varianti i parë i Strategjisë u hartua një vit më parë dhe u rishikua e u diskutua në të gjitha nivelet e punonjësve të Bankës së Shqipërisë. Ai u miratua në parim nga Këshilli Mbikëqyrës, në shkurt 1999, duke i lënë një periudhë kohe prej gati 10 muajsh që të testohej, të përmirësohej dhe të diskutohej më tej nga të gjitha strukturat e Bankës.

Kjo edhe për arsyen që Banka, për herë të parë, hartoi një dokument të kësaj natyre dhe u përpoq të jepte edhe një shembull të transparencës së institucionit dhe rritjes së komunikimit brenda tij.

Nga ana tjetër, kishim bindjen se përcaktimi i kësaj strategjie kërkonte jo vetëm një hedhje të disa ideve, por edhe studime më të thelluara në aspekte të veçanta të saj, duke mbajtur në konsideratë një sërë faktorësh ndikues që veprojnë brenda e jashtë institucionit.

Në kuadrin e mungesës së një strategjie kombëtare zhvillimi, Banka e Shqipërisë ndërmori këtë iniciativë për të mbushur, së

paku, boshllëkun në fushën që ajo mbulon. Dhe kjo fushë nuk është pak. Banka e Shqipërisë formulon dhe zbaton politikën monetare të vendit, që është një nga drejtimet e rëndësishme të politikës ekonomike. Nga kjo pikëpamje, formulimi i strategjisë së zhvillimit të institucionit përcakton edhe piketat ku do të ecet në afatin e shkurtër për zbatimin e politikës monetare.

Nga ana tjetër, ambiciet legjitime të përfshirjes në proceset integruese evropiane e më gjerë, diktuan nevojën për t'i paraprirë procesit me strategji të menduara. Gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti ngjarjet e rajonit, aq më shumë, shtruan domosdoshmërinë e pasqyrimit në punën tonë të ndryshimeve, që diktuan rrethanat e reja dhe pranimi i Paktit të Stabilitetit.

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E STRATEGJISË

Qëllimi i formulimit të këtij dokumenti është shumëplanësh.

1. Qëllimi i përgatitjes së Strategjisë së Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë është të përcaktojë objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm, të cilët synohen të arrihen.
2. Dokumenti ka për qëllim të vlerësojë nivelin e arritur në zhvillimin institucional, si dhe të tregojë rrugët nga u kalua për të arritur deri këtu.
3. Formulimi i Strategjisë ka për qëllim edhe përcaktimin e afateve kohore të realizimit të objektivave.
4. Strategjia nëpërmjet përcaktimit të rrugës së zhvillimit, vendos prioritetet dhe mënyrën e realizimit të tyre në afatin e mesëm.

Formulimi i një dokumenti të tillë ka rëndësi sepse:

1. Bën transparente synimet e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë duke i prezantuar ato të renditura dhe të analizuara, si për vetë institucionin ashtu edhe për publikun.
2. Shmang zhvillimet rastësore të institucionit dhe bashkërendon më mirë punën ndërmjet departamenteve.
3. Përcakton në mënyrë konkrete rrugën ku dhe si do të

ecet për të realizuar objektivat e vendosur me ligj dhe përmbushjen e funksioneve të Bankës.

PËRMBAJTJA E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AFATIN E MESËM

Dokumenti i miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes përbëhet nga 5 pjesë kryesore.

Ai fillon me një hyrje, ku prezantohet qëllimi dhe rëndësia e shkruarjes së dokumentit.

Në pjesën e dytë, paraqitet një vështrim historik mbi sistemin bankar, gjendja dhe synimet e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar në afatin e shkurtër. Aty trajtohet sistemi bankar shqiptar deri në ditët tona si dhe ristrukturimi dynivelesh i tij mbas vitit 1992. Gjithashtu, në këtë pjesë paraqitet shkurtimisht Banka e Shqipërisë dhe funksionet e saj mbas ristrukturimit.

Aty përshkruhen gjendja dhe synimet në programet ESAF 1 dhe 2 si dhe rezultatet e arritura deri në ditët tona.

Në pjesën e tretë, trajtohet strategjia e përgjithshme e zhvillimit të Bankës. Në këtë pjesë, që përfaqëson edhe trungun kryesor mbi të cilin ngrihet ky dokument, përcaktohet se cili do të jetë modeli institucional që do të mbahet në konsideratë nga ana e Bankës së Shqipërisë në procesin e përsosjes së punës dhe afrimit me standardet ndërkombëtare. Strategjia përcakton se modeli, nga i cili do të orientohet gradualisht Banka e Shqipërisë, është ai i Bankës Qendrore Evropiane. Arsyet për këtë zgjedhje janë gjetur tek vendndodhja gjeografike, tradita e lidhjeve ekonomike si dhe peshat në strukturat e import-eksportit të Shqipërisë.

Gjithashtu, u gjykua se ky model përmban elemente të kompromisit, të favorshme për një bankë qendrore të re si ajo e Shqipërisë. Nga ana tjetër, zona e veprimit të euros mbulon një pjesë të madhe të vendeve të cilat, aktualisht dhe në perspektivë,

mendohet se do të jenë partnerët kryesorë ekonomikë të vendit. Në këtë pjesë tregohet se procesi i gjatë dhe kompleks i përshtatjes me standardet evropiane do të imponojë ndryshime që zënë fill nga instrumentet e politikës monetare deri tek ndërtimi i përshtatur strukturor i Bankës së Shqipërisë, infrastruktura dhe politikat e punësimit e kualifikimit, teknologjia dhe organizimi i informacionit etj.. Kjo mendohet të bëhet me etapa, duke krijuar kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në afatin e gjatë në institucionet evropiane dhe më gjerë.

Niveli i pavarësisë së Bankës përbën një tjetër problem që trajtohet në strategjinë e zhvillimit afatmesëm të institucionit. Kjo çështje trajtohet nga dy këndvështrime. Së pari, duke interpretuar nocionin e pavarësisë brenda kompetencave të përcaktuara me ligj dhe duke treguar pse ajo është e domosdoshme. Së dyti, duke theksuar realizimin *de facto* të kësaj pavarësie të përcaktuar me ligj. Kjo e fundit është parë si një rritje e shkallës së kredibilitetit të Bankës, e hapjes, informimit dhe transparencës me publikun, sidomos përsa i takon vendimeve të politikës monetare.

Plotësimi dhe përmirësimi i paketës ligjore dhe rregullatore si dhe ndërgjegjësimi i publikut, janë dy probleme të tjera që trajtohen si prioritete të zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Veçanërisht kjo e fundit, është parë në strategjinë e miratuar si një element i rëndësishëm i punës në të ardhmen. Trajtimi i publikut si një aleat i natyrshëm i Bankës, përballë sfidave të zhvillimit ekonomik dhe reformave, do të realizohet nëpërmjet zgjerimit të komunikimit brenda dhe jashtë bankës, rritjes dhe përmirësimit të publikimeve, zgjerimit të informimit dhe masa të tjera që lidhen me marrëdhëniet me homologët në botë.

Politika monetare dhe tregjet financiare mbulojnë fushën më të rëndësishme në këtë pjesë të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve përbën objektivin kryesor të punës së Bankës të përfshirë në ligj dhe të detajuar në programin monetar dhe atë ESAF. Ndjekja e ecurisë dhe analiza e inflacionit, e trajtuar në një syth të veçantë në strategji, është parashikuar që të bëhet nëpërmjet arritjes së objektivit të ndërmjetëm sasior, siç është rritja e ofertës

së parasë, kur baza monetare mund të shihet si një objektiv ndërmjetës i përshtatshëm.

Nga ana tjetër, agregatë më të gjerë monetarë do të ishin më të përshtatshëm në të ardhmen, si tregues për hartimin e politikës monetare. Në të njëjtin syth diskutohen edhe objektivat strategjikë për përdorimin e instrumenteve të politikës monetare si dhe kalimin gradual nga instrumentet direkte në ato indirekte, në afatin e mesëm. Hapi i parë në këtë drejtim është konsideruar heqja e kufirit të kredisë. Zhvillimi i tregjeve financiare si ai i parave, tregu valutor dhe ai i kapitaleve janë pjesë e strategjisë së Bankës në afatin e mesëm, nëpërmjet parashikimit e planifikimit konkret të hapave që do të ndërmerren për nxitjen e mëtejshme të tyre. Po ashtu, në kushtet e vazhdimit të zbatimit të një regjimi të luhatshëm të kursit të këmbimit, administrimi i rezervës valutore do të përsoset, duke synuar zvogëlimin e borxhit të jashtëm të Qeverisë, si dhe për të përballuar importet kur ato nevojiten.

Në pjesën e katërt të këtij dokumenti, përshkruhen zhvillimet strategjike të funksioneve të tjera të Bankës. Përsosja e mbikëqyrjes bankare si një nga detyrat më të rëndësishme që realizon Banka e Shqipërisë, trajtohet me hollësi në strategji. Detyrat që duhen realizuar në afatin e mesëm dhe objektivat që ka Banka e Shqipërisë për afrimin e standardeve me nivelet ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes, janë parë në katër drejtime kryesore: a- Mbikëqyrja e procesit të hyrjes së bankave të reja; b- Kuadri rregullator dhe mbikëqyrja e bankave të nivelit të dytë; c- Mbikëqyrja e ecurisë financiare të bankës; dhe d- Mbikëqyrja e procesit të trajtimit të bankave me probleme. Zhvillimi i statistikave dhe fuqizimi i sektorit kërkimor përbëjnë, gjithashtu, një prioritet në zhvillimin afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Është konsideruar si mjaft e rëndësishme që Banka të konsolidojë dhe zhvillojë statistikat, mbështetur në nivele ndërkombëtare standarde. Ky standardizim, në afatin e mesëm, do të arrihet nëpërmjet punës për anëtarësimin në dy sisteme standarde të shpërndarjes së të dhënave, GDDS dhe SDDS.

Po ashtu, detyra prioritare janë përcaktuar përmirësimi i lëvizjes së informacionit brenda bankës, përmirësimi i cilësisë së

të dhënave si dhe thithja e tij nga burime alternative. Realizimi i tyre do të bëhet nëpërmjet asistencës së huaj teknike, duke mbajtur në konsideratë edhe kujdesin e saktësinë në përpunimin e të dhënave. Zhvillimi i aftësive kërkimore është konsideruar si një nga objektivat më afatgjatë dhe që do të implementohet me faza. Përgatitja e nevojshme e kapitalit human, fuqizimi i funksionit kërkimor të njësisë përkatëse dhe përgatitja e analizave për autoritetet e bankës dhe publikun, janë përcaktuar si drejtime të rëndësishme, që do të ndikojnë në rritjen e cilësisë së vlerësimeve të ekonomisë që bën banka, krahas realizimit të parashikimeve dhe të programimeve.

Për një bankë relativisht të re, siç mund të konsiderohet Banka e Shqipërisë, zhvillimi i teknologjisë së informacionit, në kushtet kur jetojmë në një botë gjithnjë e më të informatizuar e të organizuar, është konsideruar si një hap i rëndësishëm që duhet realizuar në afatin e mesëm, për arritjen e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Duke qenë të ndërgjegjshëm se jemi në hapat e parë të zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe duke njohur domosdoshmërinë e këtij zhvillimi për ecurinë e bankës, drejtimet ku do të përqendrohen përpjekjet janë në zgjerimin e njohurive dhe të eksperiencës, të organizimit më të mirë të burimeve njerëzore, të thellimit të procesit të automatizimit, implementimit të sistemeve informative si dhe zhvillimit të sistemit të informacionit raportues e statistikor.

Përsosja e sistemit të pagesave dhe kontabilitetit është pjesë përbërëse e strategjisë afatmesme të bankës. Meqenëse Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës i sistemit të pagesave në Shqipëri dhe institucioni përgjegjës për funksionimin normal të tij, objektiv strategjik për përsosjen e këtij sistemi është rritja e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar, pra reduktimi i përdorimit të *cash*-it. Kjo do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të sistemit të pagesave ndërbankare dhe nëpërmjet përmirësimit të pagesave në vlera të vogla, në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë. Strategjia e përmirësimit të sistemit të pagesave ndërbankare do të realizohet nëpërmjet implementimit të një

sistemi të tipit RTGS. Nga ana tjetër, banka synon të automatizojë sistemin e kleringut duke rritur bashkëpunimin me bankat e nivelit të dytë. Në këto përpjekje do të ndikojë edhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator të sistemit të pagesave.

Sistemi i kontabilitetit, si një mjet në shërbim të nevojave të drejtimit të brendshëm, do të vazhdojë të përsoset në afatin e mesëm, me objektiv strategjik që të shërbejë edhe si një mjet për t'i komunikuar publikut informacionin e nevojshëm dhe transparent apo si mjet për ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e bankës. Në zbatim të këtij objektivi strategjik, në afatin e mesëm do të synohet modernizimi i sistemit kontabël dhe përputhja e tij me standardet ndërkombëtare.

Në funksionet e saj si bankë qendrore, Banka e Shqipërisë ka ekskluzivitetin e emetimit të monedhës kombëtare. Lidhur me këtë funksion, në strategji përcaktohen drejtimet kryesore ku do të përqendrohet emetimi i monedhës në vitet që vijnë.

Zhvillimi i suksesshëm i institucionit në afatin e mesëm varet nga shkalla e aftësive dhe e kualifikimit të burimeve njerëzore në bankë. Për këtë arsye, kjo fushë e rëndësishme trajtohet në strategji duke analizuar prioritetet e administrimit dhe kualifikimit të kapitalit human. Kështu, do të synohet që ky proces të sigurojë harmonizimin e interesave aktualë dhe perspektivë të bankës me ata të punonjësve, lidhur me kualifikimin dhe karrierën e tyre. Gjithashtu, përcaktohet si i domosdoshëm realizimi i procesit të vlerësimit të punës dhe motivimit të punonjësve, duke planifikuar krijimin e kushteve optimale jo vetëm të punës, por edhe të pushimit, argëtimit e çlodhjes.

Të gjitha këto detyra strategjike nuk mund të realizohen pa zhvillimin e infrastrukturës në Bankën e Shqipërisë. Për këtë arsye, në dokumentin e strategjisë zënë një vend modest edhe problemet e përmirësimit të ambienteve të punës, të mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe përmirësime të strukturës organizative.

Pjesa e pestë dhe e fundit e Strategjisë së Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm trajton, në formën e shënimeve

përmbyllëse, lidhjen që ka realizimi i detyrave strategjike me mjedisin ekonomik shqiptar. Elemente të veçuara të bashkëpunimit ndërmjet këtij mjedisi ekonomik dhe bankës, janë të përfshira në programet ekonomike të zhvillimit të vendit dhe sidomos në të dyja programet ESAF. Megjithatë, në strategji theksohet se disa tregues të caktuar si rritja ekonomike, deficiti buxhetor, reforma strukturore dhe privatizimi, demokratizimi i shoqërisë, anëtarësimi në organizma ndërkombëtarë etj., përbëjnë parakushte për suksesin e zbatimit të këtij dokumenti në afatin e mesëm.

Meqenëse Strategjia e Zhvillimit Afatmesëm të Bankës së Shqipërisë është konsideruar të jetë edhe një dokument vetëvlerësimi, bëhen përpjekje, ndoshta për herë të parë në një dokument si ky, për të përcaktuar pikat e forta dhe të dobëta të tij. Kështu, Strategjia e Bankës së Shqipërisë është përpjekja e parë për një analizë pa eufori dhe me detyra të përcaktuara për një spektër të gjerë sektorësh të bankës dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Ai është një program koherent e realist që mbështetet në arritjet, por merr në konsideratë edhe vështirësitë. Ne vlerësojmë se ai është një program modern, që përpiqet të mbështetet në elemente teorike e praktike të drejtimit bashkëkohor të bankingut.

Por, ne jemi të ndërgjegjshëm edhe për anët e dobëta të tij. Mungesa e analizave të plota statistikore e bën strategjinë relativisht të vështirë për t'u konceptuar si një program konkret. Kjo bën që, sidomos për funksionet kryesore të bankës, ajo të marrë, në ndonjë rast, trajtën e një plani masash. Nga ana tjetër, përcaktimi i kostove të vërteta të realizimit përbën një vështirësi, që vetëm pjesërisht varet nga ne. Gjithashtu, shkalla e njohjes së disa problemeve që lidhen me integrimin në sistemet evropiane e më gjerë, është e kufizuar. Nuk duhet harruar se hartimi i këtij dokumenti bëhet kur stabiliteti i zhvillimit ekonomik e institucional të vendit ka ende elemente pasigurie.

REALIZIMI I STRATEGJISË

Angazhimi i Bankës për ta realizuar këtë dokument është maksimal. Por, realizimi i strategjisë së zhvillimit të Bankës

së Shqipërisë, sikurse thamë më lart, nuk përbën një akt të shkëputur që varet vetëm nga zhvillimet e sistemit bankar apo dëshira e mirë e institucionit për të realizuar detyrat në afatin e mesëm. Ajo do të kryhet në sfondin e domosdoshëm të reformës së transformimeve të gjithanshme ekonomike, institucionale e politike të vendit. Për pasojë, realizimi i këtij synimi do të interferojë reciprokisht segmente të ndryshme të këtij procesi tranzicioni, duke lënë edhe gjurmët e veta në të.

Me qëllim që të ndiqet ecuria e realizimit është ndërtuar edhe programi i punës i cili, kryen fazimin kohor dhe konkretizimin e parimeve të dokumentit të strategjisë. Ai do të ndiqet në vazhdimësi nga të gjitha strukturat e bankës, duke bërë edhe përshtatjet e nevojshme apo ato që dikton koha. Vendosja e afateve plotësisht të përcaktuara dhe njësive organizative përgjegjëse, e bën akoma më të përgjegjshëm dhe bindës angazhimin e realizimit të këtij dokumenti.

Gjatë realizimit do të mbahet parasysh, gjithashtu, pasqyrimi i detyrave të kryera në zbatim të porosive edhe udhëzimeve të lëna nga misionet e FMN, që diskutojnë programin monetar me Bankën e Shqipërisë; pasqyrimi i njohurive të reja në fushat e politikës dhe operacioneve monetare, në fushën e mbikëqyrjes, të kontabilitetit e pagesave si dhe të kërkimeve e statistikave, të realizuara me ndihmën e misioneve të asistencës nga FMN, BB, USAID etj.; pasqyrimi i problemeve aktuale që mund të ndodhin gjatë zbatimit, si dhe zhvillimet pozitive institucionale.

Banka e Shqipërisë ka besim të plotë dhe ka angazhimin e duhur për vënien në jetë të këtij dokumenti.

---

* Marta Muço, Shefe e Kabinetit të Guvernatorit.

[1] Teksti i plotë i këtij dokumenti është botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, dhjetor 1999.

KUFIRI I KREDITIT

*Fiqiri Baholli**

Fjalë kyçe
- Kufi krediti - Raporti i likuiditetit - Kontroll monetar -

1. TIPARET MË TË PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT NË VENDE TË NDRYSHME

Kufiri i kredititi është një instrument direkt që një bankë qendrore përdor për kontrollin monetar. Vende të ndryshme e përdorin si një instrument të përkohshëm të politikës monetare për të kontrolluar kërkesën e parasë ose si një mjet që kontrollon gjatë gjithë kohës, kredinë agregate.

Kufiri i kredititi[1] që u vendosej bankave të nivelit të dytë për kreditimin e ekonomisë u përcaktua, nga Banka e Shqipërisë, si rritja e gjendjes së kredive në bilanc deri në një nivel të caktuar.

Eksperiencat e vendeve të ndryshme në përdorimin e kufijve të kredititi, kanë variuar shumë në lidhje me objektivat e autoriteteve monetare dhe me aplikimin specifik të instrumentit.

Shkaqet për përdorimin e kufirit të kredititi:

- Lehtësia për t'u zbatuar.
- Transmetimi i saktë i objektivave monetarë dhe të kredititi.

- Mendohet të jetë instrumenti më efektiv monetar në kushtet e tregjeve të pazhvilluara financiare ose/dhe në kushtet e mundësive teknike të kufizuara të autoriteteve monetare.
- Mjet i mirë për të drejtuar burimet e fondeve në sektorët "më të favorizuar".

Duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të zhvillimit të tregjeve financiare, një vështrim në vendet që përdorën kufirin e kreditit tregon se ky instrument u përdor në kushtet e:

- strukturave bankare jokonkurruese;
- tregjeve të pazhvilluara (ose pak të) të letrave me vlerë të qeverisë;
- kostos së lartë të transaksioneve;
- kufizimeve në daljen e kapitalit.

Sistemet bankare jokonkurruese karakterizohen nga kostoja e lartë e ndërmjetësimit dhe diferenca e madhe e interesave depozitë-kredi, gjë që dëmton mekanizmin e transmetimit të politikës monetare në ekonomi dhe veprimet e tregut të hapur. Për më tepër, në vendet me pak banka, përqendrimi në pak duar çoi në ankande joefektive të letrave me vlerë.

Vende të OECD i kanë përdorur kufijtë e kreditit si një instrument emergjence, në periudha të ndryshme të mospërputhjes së maturimeve të aktiveve dhe pasiveve.

Disa vende në zhvillim i kanë përdorur kufijtë e kreditit "për të favorizuar" sektorë të ekonomisë si për shembull, bujqësinë.

Në vitet 1990, disa vende në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore i përdorën kufijtë e kreditit për të kontrolluar agregatët monetarë dhe të kredisë, gjatë fazës kalimtare nga ekonomia e planifikuar në atë të bazuar në parimet e tregut (Shqipëria, Bullgaria, Çekosllovakia, Polonia, Rumania dhe Maqedonia).

Eksperienca e përdorimit të kufijve të kreditit në vende të ndryshme, ka nxjerrë në pah avantazhet dhe disavantazhet e tyre:

Avantazhet:

- kontrolli më i besueshëm për agregatët e kreditit;
- mund të jetë i vetmi instrument monetar praktik kur ka tregje të vogla ose të dështuara;
- zbatohen lehtë kur ka numër të kufizuar bankash;
- vendosen dhe lidhen me lehtësi me treguesit e programit monetar;
- nuk ndikohen nga regjimi i kursit të këmbimit.

Disavantazhet:

- nuk mund të përdoren për përmirësimin e administrimit afatshkurtër të likuiditetit;
- tentojnë që të vazhdojnë ndarjen e tregut të kredive, pavarësisht nga konkurrenca midis bankave;
- kufizojnë konkurrencën midis bankave duke dëmtuar zhvillimin e tregut të parasë;
- mund të shkaktojnë mikroadministrimin e shpërndarjes së kredive nga banka qendrore;
- mund të jenë të vështira për t'u monitoruar, pasi kredia mund të jepet në forma që nuk mbulohen nga kufiri;
- mund të çojnë në shumëfishimin e kontrollit direkt dhe në kufizime financiare;
- vështirësohet zbatimi në vendet me sistem të madh bankar;
- mund të prishet ndërmjetësimi midis sektorit formal dhe sektorëve joformalë.

Si konkluzion:

Kufiri i kreditit mund të shërbejë si instrument i dobishëm në rrethana të caktuara, kur lidhjet midis agregatëve monetarë janë të paqëndrueshme ose në fazat e tranzicionit, kur tregjet financiare janë të pazhvilluara dhe nuk mund të përdoren instrumentet indirekte. Me kalimin e kohës, pasi orientimi nga tregu i kontrollit monetar bëhet më prezent, banka qendrore duhet të kalojë gradualisht në instrumentet indirekte për të arritur objektivat monetarë dhe të inflacionit. (Megjithatë, ky

instrument ekziston në arsenalin e bankës qendrore, si një kthim prapa në momente të vështira.)

2. APLIKIMI I KUFIRIT TË KREDITIT NGA BANKA E SHQIPËRISË

Në zbatimin e instrumentit të kufirit të kreditit nga Banka e Shqipërisë, përmendim disa elemente kryesore:

1. Në fillim të çdo viti në programin monetar, që ishte pjesë e programit të zhvillimit ekonomik të vendit, parashikohej rritja e kredisë për ekonominë në bilancet e bankave të nivelit të dytë. Kjo rritje mund të përshkruhet ndryshe si përdorimi i burimeve të brendshme të sistemit bankar për zhvillimin e ekonomisë, në përputhje me objektivin kryesor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve të konsumit.
2. Shpërndarja midis bankave bëhej e ndarë në tremujorë, duke parë ecurinë e depozitave në lekë dhe në valutë, ecurinë e kredive të rregullta dhe me probleme, kapitalin e paguar për çdo institucion bankar të licencuar nga Banka e Shqipërisë.
3. Ndjekja e realizimit të kufirit të kreditit bëhej çdo tremujor në bazë të informacioneve të marra nga bankat e nivelit të dytë për përdorimin, shlyerjen dhe ndryshimin e gjendjeve në fillim dhe në fund të periudhës.
4. Si çdo instrument detyrues, edhe kalimi mbi shumën e lejuar të kredive për bankat kishte masa penalizuese për drejtuesit e tyre dhe për vetë bankat.

Banka e Shqipërisë, gjatë kohës së aplikimit të kufirit të kreditit, ka synuar nxitjen e zhvillimit të ekonomisë, duke tentuar që të nxisë dhënien e kredive nga bankat me rezultate më të mira në aktivitetin kreditues.

Për këtë qëllim, janë lejuar dhe pranuar kërkesat për shtesë të kufirit në periudha të caktuara, tregtueshmëria e kufirit të kreditit midis institucioneve dhe rishpërndarja gjatë vitit. Në të njëjtën kohë, diversifikimi i portofolit të kredive (sipas afatit) u

krijonte mundësi bankave për të dhënë më shumë kredi gjatë një viti.

Nga viti 1993 deri në fund të muajit shtator 1999, kufiri i kreditit, realizimi në përqindje, kredia e re dhe shpërndarja në monedhë, afat, sektorë paraqiten si më poshtë :

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1998[2]	Shtator '99
Kufiri i kreditit(mld lekë)	7.4	3.7	2.9	3.1	2.3	6	2.5	8
Realizimi në %	39.4	64	60.1	95	75	30	72	11
Kredi e re (në mld lekë)	10.3	7.4	6.7	7.4	3.98	5.8	5.8	5.5
Nga kjo e dhënë:(në %)								
Kredia në lekë		90	86.5	63	37	20	20	25.5
Kredia afatshkurtër	74	54	61	50	65.5	67.2	67.2	73
Kredi për sek. privat	53	74	70	83	98	100	100	100

Për vitin 1999, në programin monetar u parashikua që pjesa e kreditit për ekonominë në mjetet e brendshme neto (kërkesa për para) të rritej me 8 miliardë lekë. Ky tavan krediti, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, u shpërnda sipas tremujorëve, për bankat, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin kreditues në vendin tonë:

Në milionë lekë

	T1	T2	T3	T4	Viti
Totali	1600	2000	2400	2000	8000

Që nga dhjetori i vitit 1998, duke veçuar bankat private nga ato shtetërore, sipas të dhënave të gjendjes monetare, gjendja e kredive paraqitet:

Në milionë lekë

Parashikimi për rritjen e kredive nga 6 në 2,5 miliardë lekë	Dhjetor '98	T 2 '99	T3 '99	Ndryshimi i tepr. së kredisë dhjetor '98 T3'99
Bankat private	5084.9	6864.5	7529.6	2444.7
Bankat shtetërore	11230	9953.4	9656.3	-1574
Sistemi bankar	17691.3	18195.4	18563	871.7
Sektor shtetëror	2830.3	1913.4	2056.8	-872.3
Sektor privat	14862	16282	1958	1743
Lekë	12065.3	10372.4	10343	-1722.3
Valutë	5626	7823	8220	2594
Tregues llogaritës (kursi i këmbimit)	140.58	136.9	134.1	

Deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 1999 janë akorduar 5,5 miliardë lekë dhe janë arkëtuar 4,3 miliardë lekë.

Kredia në lekë ka ardhur duke u ulur dhe në të njëjtën kohë ajo në valutë vazhdon të rritet, duke përbërë 44 për qind të stokut të kredisë si sistem bankar, në një kohë që në dhjetor 1998 ajo zinte 32 për qind. Sipas të dhënave, bankat private vazhdojnë akordimin e kredive në valutë edhe pse leku ka qenë në nivele të qëndrueshme kundrejt valutave kryesore. Në bankat shtetërore vërehet një ulje e stokut të kredisë, pasi janë të përjashtuara nga ushtrimi i aktivitetit kreditues.

Kryesisht, janë mbështetur me kredi degë të tilla të ekonomisë si bujqësia, tregtia, ndërtimi, industria përpunuese, nxjerrëse dhe prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike dhe ujit.

Duke e konsideruar instrumentin e kufirit të kreditit si një instrument të dobishëm në rrethana të caktuara, për të mbajtur nën kontroll kërkesën e parasë, fillimisht përdorimi i këtij instrumenti u kushtëzua nga numri i vogël i bankave në vendin tonë, tregjet e pazhvilluara të letrave me vlerë dhe mungesa e normave të mbikëqyrjes për kontrollin e bankave të nivelit të dytë.

Në dy vitet e fundit, kufiri i kreditit për bankat e nivelit të dytë nuk u realizua, me gjithë rritjen e numrit të institucioneve bankare të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Ndërkohë, tregu i letrave me vlerë të qeverisë është zgjeruar si përsa i përket numrit të pjesëmarrësve, ashtu dhe operacioneve që kryhen në të. Po kështu, është plotësuar dhe kuadri ligjor i rregullave të mbikëqyrjes bankare për vendosjen e normave mbi cilësinë e portofolit të huave, përqendrimin e kredive etj..

Me propozim të Departamentit të Politikës Monetare dhe të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi heqjen e instrumentit kufi krediti për bankat e nivelit të dytë. Me forcimin e mbikëqyrjes bankare dhe hartimin e rregulloreve të ndryshme nga ana e saj, bëhet i mundur kontrolli indirekt i kërkesës për kredi.

Në fazën aktuale të privatizimit të bankave me kapital shtetëror, përsëri me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, u ndalohet aktiviteti i kredidhënies bankave të nivelit të dytë, me mbi 20 për qind të kredive me probleme.

3. ROLI I MBIKËQYRJES BANKARE ME HEQJEN E INSTRUMENTIT TË KUFIRIT TË KREDITIT

Banka e Shqipërisë, në kuadër të objektivave të saj për funksionimin normal të sistemit bankar të bazuar në parimet e tregut, ka ndërmarrë hapat përkatës në funksionet e mbikëqyrjes bankare si nëpërmjet sistemit rregullativ ashtu edhe inspektimeve në vend.

- inspektimet në vend; ato gradualisht po arrijnë në standardet bashkëkohore, duke shqyrtuar edhe zona me rrezik të lartë siç është krediti. Stafi i këtij sektori është shtuar në numër dhe po trajnohet vazhdimisht. Çdo tremujor hartohet raporti "Mbi gjendjen e përgjithshme të bankës" për çdo bankë, sipas sistemit "CAMELS". Gjithashtu, edhe raportet e ekzaminimit në vend po hartohen sipas këtij sistemi.

Është shtuar numri i ekzaminimeve në vend. Kështu, nga 4 ekzaminime të planifikuara për vitin 1999 do të realizohen 7. Gjithashtu, janë kryer edhe 18 ekzaminime të pjesshme, ku vend të rëndësishëm kanë zënë ekzaminimet e veprimtarisë kredituese.

Për vitin 2000, lidhur me ekzaminimet e plota do të synohet që çdo bankë t'i nënshtrohet një ekzaminimi të tillë një herë në 12 muaj. Gjatë këtij viti parashikohen të realizohen ekzaminime të plota në 10 - 11 banka.

- për anën rregullative; mund të theksojmë se një nga instrumentet indirekte të kontrollit të likuiditetit të bankës, i cili zëvendëson instrumentet direkte siç është ai i caktimit të kufirit të kreditit është raporti i likuiditetit, përcaktuar në rregulloren "Për raportin e likuiditetit", miratuar me vendim

të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 71, datë 02.06.1999.

Qëllimi i llogaritjes së raportit të likuiditetit është:

- Për të kontrolluar dhe ndjekur në vazhdimësi mundësinë e bankës për shlyerjen e detyrimeve me afat shumë të shkurtër, të tilla si me afat deri në maturim jo më të madh se një muaj ose pa afat por, me një probabilitet statistikor për t'u shlyer brenda muajit .
- Për të kufizuar rrezikun e transformimit të burimeve afatshkurtra.

Rregullorja "Për kontrollin e rreziqeve të mëdha", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 78, datë 07.07.1999, ka si qëllim matjen dhe kontrollin e përqendrimit të rrezikut për të njëjtin përfitues, për të shmangur efektet negative financiare të bankës si rezultat i përqendrimit të tepërt të rrezikut mbi të njëjtin përfitues. Ky qëllim realizohet nëpërmjet respektimit të përhershëm dhe të njëkohshëm të:

- një raporti maksimal deri në 20 për qind ndërmjet tërësisë së rreziqeve, që banka merr përsipër gjatë operacioneve të saj mbi çdo përfitues dhe kapitalit rregullator të vet bankës;
- një raporti maksimal deri në 700 për qind ndërmjet shumës të rreziqeve të mëdha dhe kapitalit rregullator të vet bankës, duke kuptuar me rrezik të madh të gjitha rreziqet që banka merr përsipër gjatë operacioneve të saj me të njëjtin përfitues, kur raporti i tyre me kapitalin rregullator është më i madh se 10 për qind.

Në rregulloren "Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 50, datë 22.04.1999, përcaktohen rregullat, kriteret dhe mënyrat e klasifikimit të aktiveve të bankës, si dhe baza për përcaktimin e një niveli të përshtatshëm rezervash për mbulimin e humbjeve nga kreditë. Për të kufizuar rrezikun e kredisë, bankat analizojnë

gjendjen e kredive dhe të aktiveve të tjera, të ngjashme me to. Kreditë klasifikohen periodikisht në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. Në çdo rast, bankat kanë në dispozicion fondin rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, të krijuar sipas kësaj rregulloreje.

SHËNIME

* Fiqiri Baholli, Drejtor, Departamenti i Politikës Monetare.
[1] Termi në anglisht - credit ceiling.
[2] Në programin monetar të vitit 1998, duke vlerësuar ecurinë e programit në fund të nëntëmujorit, u rishikua parashikimi për rritjen e kredive nga 6 në 2.5 miliardë lekë.

Ekonomia botërore në dekadën e fundit të shekullit
Selami Xhepa
Mars 2000

Zhvillimi i korridoreve të transportit në Evropën Qendrore e Lindore dhe në Ballkan
Selami Xhepa
Qershor 2000

Bujqësia shqiptare në periudhën e tranzicionit
Luljeta File
Qershor 2000

Shkurtimisht sistemi bankar shqiptar për vitin 1999
Miranda Ramaj
Vjollca Berberi
Qershor 2000

Oferta publike fillestare (IPO)
Elvin Meka
Brizejda Kreshpa
Qershor 2000

2000

Kostoja e ndërmjetësimit për vitin 1999
Suzana Kodra
Shtator 2000

Rritja e transparencës në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë
Teuta Baleta
Neritan Kallfa
Adriana Meko
Shtator 2000

Regjimet e politikës monetare dhe prirja e Bankës së Shqipërisë
Gramoz Kolasi
Dhjetor 2000

EKONOMIA BOTËRORE NË DEKADËN E FUNDIT TË SHEKULLIT

*Selami Xhepa**

Fjalë kyçe
- Tregje financiare - Financa botërore - Qarkullim kapitalesh - Kriza -

1. HYRJE

Krizat financiare që mbërthyen shumicën e vendeve të botës[1] në prag të mijëvjeçarit të ri, shtruan para autoriteteve financiare ndërkombëtare nevojën e reformimit të sistemit financiar ndërkombëtar, me synim ruajtjen e stabilitetit ekonomik botëror. Vitet '90 do të shihen nga historianët e mendimit ekonomik si periudha të përmbysjeve të mëdha në teoritë e krizave monetare. Me një shpejtësi të paparë, lindën gjeneratat e modeleve të reja të shpjegimit të krizave[2].

Urgjenca e reformimit të sistemit financiar botëror është rritur ndjeshëm, duke konsideruar zhvillimet mjaft intensive të globalizimit të tregjeve financiare ndërkombëtare dhe pjesëmarrjes aktive në to të vendeve me ekonomitë në zhvillim. Kjo ka çuar në një rritje të paqëndrueshmërisë së tregjeve financiare globale, duke u bërë burim krizash të shpeshta, e për rrjedhojë, perspektivat e zhvillimit të ekonomisë botërore po kompromentohen dukshëm. Efektet e integrimit global dhe qëndrueshmëria e lidhjeve midis tregjeve kapitale të vendeve me ekonomitë në lindje dhe atyre të zhvilluara, janë vënë në dyshim.

2. ÇFARË KA NDRYSHUAR NË SKENËN E EKONOMISË BOTËRORE GJATË KËTIJ 10-VJEÇARI?

Kushtet ekonomike globale deri në fillim të viteve '90 ishin krejt të ndryshme me panoramën që prezanton dekada e fundshekullit. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, politikat ekonomike u drejtuan në krijimin e një sistemi ekonomik botëror, që do të dinamizonte zhvillimin e saj dhe mirëqenien e njerëzimit. Arkitekti i sistemit ekonomik e financiar botëror i njohur me emrin e Sistemit të Bretton Woods-it ishte Kejnsi dhe pikëpamjet e tij dominuan krijimin e strukturave ndërkombëtare, siç ishte krijimi i FMN dhe i Bankës Botërore. Ky sistem bazohej tërësisht në rolin e udhëheqësit amerikan në ekonominë globale, rol që mbështetej në faktin se vetëm ekonomia amerikane kishte dalë nga lufta si vendi më i fuqishëm dhe i aftë ekonomikisht të luante një rol të tillë.

Financat botërore u bazuan mbi dollarin ndërsa programet e zhvillimit ekonomik u bazuan në pikëpamjet Kejnesiane: në uljen e taksave dhe rritjen e shpenzimeve qeveritare, domethënë, rritjen e vazhdueshme të borxheve të qeverive. Natyrisht që burimi i këtyre borxheve ishin bankat amerikane dhe Federal Reserve, duke krijuar një inflacion gjigand të dollarit jashtë vendit. Duke patur parasysh edhe sfondin e zhvillimeve gjeopolitike të kohës[3], mjaft financime nuk lidheshin drejtpërdrejt me projekte ekonomike. Pikërisht në fillim të viteve '70, filluan të shfaqeshin dukshëm shenjat e humbjes së kontrollit mbi monedhën, të cilat simbolikisht mund të lidhen me vendimin e administratës amerikane në vitin 1973, për të hequr lidhjen e dollarit me arin. Kjo periudhë shënon edhe fundin e politikave ekonomike Kejnesianiste të zbatuara si nga Amerika, Evropa dhe Japonia. Vendimi për shembjen e sistemit monetar të mbështetur mbi dollarin, u përshpejtua nga fillimi i krizës energjitike pas një vendimi të vendeve të OPEK-ut për kufizimin e kuotave të prodhimit të naftës dhe rritjen e çmimeve të saj. Këto zhvillime goditën menjëherë industritë kryesore evropiane, amerikane dhe japoneze të petrokimisë, të prodhimit të makinave dhe industrinë mekanike, të cilat kishin qenë shtyllat që kishin siguruar rritjen ekonomike të Triad-ës (SHBA, Evropë dhe Japoni). Bota filloi të

përjetojë fenomenin e ri ekonomik, të panjohur deri atëherë, stangflacionin, i karakterizuar nga rritje ekonomike negative ose zero dhe inflacion 10-15 për qind. 'Epoka e Artë' kishte marrë fund.

Kjo rënie ekonomike për një kohë të gjatë, kontribuoi në rënien e eksporteve dhe përkeqësimin e kushteve tregtare për shumë nga ekonomitë në zhvillim. Nga ana tjetër, nevoja për mbajtjen nën kontroll të inflacionit, çoi në një rritje të lartë të normave të interesit në tregjet kryesore financiare, gjë e cila rëndoi më tej barrën e borxhit të jashtëm të vendeve në zhvillim. Panorama e viteve '90 paraqitet krejt e ndryshme. Ekonomitë e zhvilluara u karakterizuan nga një rënie e normave të inflacionit dhe nivele të ulëta interesash. Rënia edhe në normat e interesit në tregjet e letrave me vlerë të këtyre vendeve, i shndërroi tregjet e vendeve në zhvillim në tregje tërheqëse. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ishte edhe rënia e çmimit të rrezikut në tregjet e pasurisë, duke nënvizuar kështu një tolerancë më të lartë ndaj rrezikut ose një perceptim, që rreziku ishte në rënie.

Gjatë këtyre dy grupeve periudhash, kemi edhe një ndryshim në strukturën e qarkullimit të kapitalit. Në vitet '90 kemi një rritje mjaft të lartë dhe më të shpejtë të kapitaleve private ndaj atyre zyrtare. Ndërsa kapitalet zyrtare (shtetërore) në ekonomitë në zhvillim përfaqësonin 49.5 për qind të totalit të hyrjeve kapitale në vitet '70-'80, në vitet '90-'96 ato zinin vetëm 9.5 për qind. Hyrjet neto totale të kapitalit në ekonomitë në zhvillim, gjatë gjysmës së parë të viteve '90, llogariten në mbi 1 trilion dollarë amerikanë.

Edhe vetë strategjitë e zhvillimit ekonomik paraqiten të ndryshme. Shumica e vendeve vazhdonin të ndiqnin politikat e zëvendësimit të importeve, të mbështetura nga nivele të larta tarifash doganore dhe politika financiare të normave të ulëta të interesave, duke rritur kështu kreditin për sektorë të caktuar të ekonomisë. Për të parandaluar daljen e kapitaleve të rezidentëve, autoritetet zbatonin sisteme të kontrollit të fuqishëm mbi lëvizjet kapitale. Huamarrja nga jashtë kufizohej vetëm për ndërmarrjet publike (përfshi bankat shtetërore).

Vitet ‘80 provuan qartë mangësitë e politikave të tilla. Për rrjedhojë, fillimi i viteve ‘90, shënoi një lëvizje të fuqishme drejt liberalizimit ekonomik, përfshi liberalizimin e transaksioneve financiare dhe tregtare, politika më të shtrënguara fiskale, reforma strukturore që synonin rritjen e fleksibilitetit të tregjeve të brendshme, si dhe një zgjerim të rolit të sektorit privat.

Sofistikimi i tregjeve financiare, hyrja në to e vendeve në zhvillim si rezultat i liberalizimit të llogarive kapitale, por edhe e lojtarëve të rinj pa eksperiencë nga vendet e zhvilluara, vëllimi i lartë i transaksioneve dhe shkalla e lartë e integrimit të tregjeve, kanë rezultuar në një rritje të konsiderueshme të shkallës së ndjeshmërisë së sistemit financiar botëror. Dështimi i mundshëm në një nga tregjet financiare, do të ekspozonte dhe shtrinte efektet e tij negative, në gjithë sistemin financiar botëror.

Kriza e borxheve e viteve ‘80, inkurajoi një valë shkrirjesh e bashkimesh mes korporatave (dhe mjaft falimentime) duke i dhënë jetë krijimit të një gjenerate të re grupesh financiare të fuqishme, tendencë që u përforcua më tej me krizën e Wall Street, të vitit 1987. Për rrjedhojë, në tregjet financiare është krijuar një koncentrim i madh i fuqisë; investitorët institucionalë shpesh diktojnë fatin e kompanive të listuara në treg.

Tabelë 1. Hyrjet e kapitaleve private në vendet në zhvillim; në miliardë dollarë.

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997
Totali i hyrjeve të kapitaleve neto private	31	126.9	120.9	164.7	160.5	192	240.8	173.7
Hyrjet nga kreditorët qeveritarë	22.2	25.7	17.6	18.7	-2.5	34.9	-9.7	29
Hyrjet neto totale	53.2	152.7	138.5	183.4	158	226.9	231.1	202.7

Burimi: FMN/EBS/98/121; 1998.

Qarkullimi ditor në tregun ndërkombëtar të parasë, që arrin në gati 1300 miliardë dollarë (1995), e tejkalon nivelin e rezervave valutore botërore (të vlerësuara në 1202 miliardë dollarë). Në këtë kuptim, nën etiketën e mbrojtjes së vlerës së monedhës kombëtare, bankat qendrore kanë transferuar në duart e individëve privatë jo vetëm valutën, por edhe pushtetin.

Në kontekstin e zhvillimeve të tilla, që nga viti 1998 janë intensifikuar përpjekjet e autoriteteve financiare, të FMN dhe

të Bankës Botërore, në konturimin e një arkitekture të re të financave botërore.

3. ARKITEKTURA E RE E FINANCAVE GLOBALE

3.1 ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Krizat e fundit, e vunë në qendër të kritikës akademike dhe qarqeve politike rolin e organizmave financiarë botërorë, veçanërisht të FMN, për parandalimin dhe shmangien e krizave dhe efekteve të saj përhapëse, në vendet e tjera. Thelbi i kritikave është përqendruar në rolin dhe funksionet e këtij institucioni, të cilat pas zhvillimeve të viteve '90, rishfaqin po të njëjtën domosdoshmëri të rishikimit, ashtu siç pësuan në vitet e krizës energjitike. Një ndër problemet më të diskutueshme është ai i nevojës për një 'huadhënës të radhës së fundit', pra që FMN të marrë rolin e një banke qendrore botërore (domethënë, FMN të ketë rezervat dhe të emetojë paranë e saj – propozim që ishte bërë nga Keynes që në krijimin e këtij organizmi). Nevoja për një 'huadhënës të radhës së fundit' lind nga luhatjet e kurseve të këmbimit dhe frika e një paniku, të cilat rrezikojnë jo vetëm vendin në krizë, por gjithë sistemin financiar botëror.

Nëse FMN nuk do të luajë këtë rol, mendimi i shumicës është që të krijohet një mekanizëm tjetër, botërisht i pranueshëm, që të merret me riskedulimin, vendet në pamundësi financiare dhe me falimentimin. Kjo ka çuar në nxitjen e debatit rreth një kapitulli shtesë (Super Chapter 11) në statutin e FMN-së mbi falimentimin. Pasi, nëse ky fenomen njihet për rastin e një kompanie dhe rregullohet në legjislacionet kombëtare, kombet konsiderohen si sovrane dhe falimentimi nuk njihet si një akt ligjor. Ndërkohë, brenda FMN-së janë krijuar disa mekanizma të rinj për të ndihmuar vendet në krizë apo parandalimin e tyre, të tillë si "Mekanizmat Emergjentë të Financimit" (që u zbatua në rastin e krizës koreane, ku linja e kredisë u lëvrua brenda dy javësh), "Lehtësia e Rezervës Suplementare" etj.. Po diskutohet dhe ideja e rritjes së kuotës dhe kapitalit të FMN-së nga 45 miliardë dollarë që është aktualisht, në 88 miliardë dollarë.

Oponentët e rolit të FMN-së në zgjidhjen e krizave kanë zhvilluar gjerësisht teorinë e "dëmtimit moral", ku siguria për shpëtimin e një vendi në krizë, inkurajon investitorët të ndërmarrin rreziqe më të larta në kërkim të normave më të larta të fitimit.

Përveç ridimensionimit të rolit të FMN-së, janë krijuar dhe dy institucione të reja: Forumi për Stabilitetin Financiar dhe G-20. Objektivi i këtij Forumi është grumbullimi i informacioneve dhe zhvillimi i indikatorëve të paralajmërimit të hershëm të krizave. Në përbërje të këtij organizmi janë ministrat e financave të G-7 dhe guvernatorët e bankave qendrore të tyre, FMN dhe Banka Botërore, Komiteti i Bazelit, Organizata Botërore e Tregjeve të Letrave me Vlerë dhe Shoqata Botërore e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Roli i këtij organizmi, si përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve dhe tregjeve financiare, konsiderohet si thelbësor në parandalimin e krizave të ardhshme.

Hyrja në skenën e ekonomisë botërore të disa ekonomive të mëdha të vendeve në zhvillim, kërkon dhe një koordinim më të mirë të politikave midis vendeve të zhvilluara dhe këtij grupi vendesh. Për këtë qëllim, në shtator 1999 u lançua krijimi i një grupi të ri ekonomik ndërkombëtar, i quajtur G-20, i cili përfshin përveç vendeve të G-8 edhe gjigandë të tillë, si India dhe Kina[4].

3.2 AXHENDA

Axhenda tashmë e përcaktuar për reformim, përfshin pesë fusha kryesore:

- Transparencën, standardet dhe mbikëqyrjen.
- Forcimin e sistemeve financiare.
- Integrimin e rregulluar të tregjeve financiare ndërkombëtare.
- Përfshirjen e sektorit privat në parandalimin dhe zgjidhjen e krizave financiare; dhe
- Aspektet sistemike.

Në fushën e transparencës, objektivi kryesor përfshin fuqizimin e vendimmarrjes dhe arritjeve më të mira ekonomike, duke përmirësuar transparencën e politikave ekonomike dhe të praktikave kombëtare. Propozimet specifike në këtë drejtim konsistojnë në publikimin e më shumë informacioneve rreth politikave ekonomike të zbatuara dhe eficiencës së tyre; thellimin e konsultimeve me vendet e varfra me borxhe të larta, deri në një rikonsiderim të thelluar të politikave dhe praktikave të FMN.

Objektivi i adoptimit të standardeve të pranueshme konsiston në fuqizimin e standardeve për aktivitetet ekonomike, financiare dhe të biznesit. Kryesisht rregullimet do të prekin çështje të tilla si procedurat e kontabilitetit, të falimentimit, drejtimin e firmave dhe korporatave, rregullimin e sigurimeve dhe sistemeve të pagesave, rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë etj..

Forcimi i mbikëqyrjes synon në fuqizimin e rregullave të monitorimit të aktiviteteve financiare, bazuar në standardet ndërkombëtare. Përmirësimi i sistemeve të monitorimit të lëvizjeve të kapitaleve afatshkurtra do të shërbente si instrumenti kryesor në përcaktimin e shkallës së ndjeshmërisë së një vendi ndaj një *shock*-u të jashtëm.

Fuqizimi i sistemeve financiare kërkon nga autoritetet kombëtare rishikimin periodik të mbikëqyrjes së sistemit financiar të vendit, veçanërisht të institucioneve me një shkallë të lartë borxhesh apo me ekspozim të lartë ndaj rreziqeve të mundshme. Po kështu, një analizë më e kujdesshme e lidhjeve të politikave makroekonomike me gjendjen e sistemit bankar, do të ndihmonte në fuqizimin e sistemit financiar të vendit.

Diskutime janë zhvilluar edhe lidhur me mundësinë e aplikimit të këtyre instrumenteve:

- Rritjen e fleksibilitetit të kurseve të këmbimit. Për këtë qëllim, vendeve mund t'iu kërkohet të mos i lidhin monedhat e tyre me monedhat e tjera të forta.
- Pjesëmarrjen e sektorit privat në ristrukturimin e borxhit, duke lejuar shkëmbimin e borxheve me letra me vlerë të

pronësisë ose dhënien e fondeve të reja në kohë krize.
- Janë propozuar ndryshime në kontratat e obligacioneve, për të lejuar një koordinim më të mirë midis emetuesve dhe mbajtësve të tyre. Një ide është që, për të ndryshuar termat e pagesave, të aplikohet shumica e kualifikuar e votuesve të mbajtësve të obligacioneve në vend të unanimitetit të zakonshëm.
- Rritjen e rezervave të bankave që u japin hua vendeve në zhvillim (gjë që do të ndikojë në rritjen e kostove të financimit të ekonomive huamarrëse).
- Krijimin e një mekanizmi gatishmërie me financim privat, për të ofruar kredi të reja në raste krizash ose pamundësie pagimi.

4. KONTROLLI MBI QARKULLIMIN E KAPITALEVE

Liberalizimi i transaksioneve të llogarive kapitale ka dhënë një influencë të fuqishme në hyrjet e kapitaleve drejt vendeve në zhvillim. Nga një studim[5] mbi liberalizimin e tregjeve financiare, liberalizimi financiar përfshin gjashtë dimensione:

- Eliminimin e kontrollit të kreditit.
- Liberalizimin e normave të interesit.
- Hyrjen e lirë në industrinë bankare dhe në përgjithësi, në industrinë e shërbimeve financiare.
- Autonominë e bankave (mosndërhyrje në operacionet e përditshme të administrimit të tyre).
- Privatizimin dhe pronësinë private mbi bankat; dhe
- Lejimin e hyrjeve të kapitaleve ndërkombëtare.

Nëse deri në fillim të kësaj dekade, qeveritë e vendeve të varfra ishin thjesht vëzhguese pasive të krizave financiare globale, tashmë ato po ballafaqohen me dilema në marrjen e vendimeve të përshtatshme, të cilat do të influencojnë formën e ekonomisë botërore të shekullit të ardhshëm. Vendimi është nëse të vazhdojnë drejt liberalizimit të plotë të llogarive kapitale (për të përfituar nga financimet e huaja) apo të rrisin barrierat ndaj kapitalit të huaj (për të ruajtur ekonominë e brendshme

nga goditjet e jashtme). Kjo dilemë ka përfshirë Amerikën Latine, Azinë dhe Evropën Lindore (në të vërtetë, Amerika Latine ka tashmë një histori 150-vjeçare 'on-off love' me kapitalin e huaj). Shuma të mëdha kapitalesh të huaja hyjnë në këto vende, por pa mundur të thithen në mënyrë produktive. Me një histori të tillë, Amerika Latine ofron edhe mësime të suksesit në kontrollin e kapitaleve. Kështu, Kili, deri në vitin 1991 ka zbatuar rregulla për kontrollin e kapitaleve. Ky kontroll përfshinte si madhësinë dhe maturitetet e hyrjeve afatshkurtra të kapitaleve, duke e taksuar (30 për qind) këtë kategori kapitali.

Problemi madhor me të cilin ballafaqohen këto vende është: si të ruhen nga largimi i investitorëve apo t'i bindin ata të rikthehen[6].

Nga ana tjetër, dy burimet e rreziqeve që shqetësojnë mbajtësit e kapitalit të huaj janë: a) një zhvlerësim i madh dhe i paparashikuar i valutave ose nivelet e larta të inflacionit, do të krijonin humbje në vlerën reale të letrave me vlerë të pasurisë, të emetuara në monedhë kombëtare; dhe b) huamarrësit (qeveria apo sektori privat) do të dështonin në pagimin e shërbimit të borxhit të huaj (si Rusia).

Eksperienca e disa vendeve me masat mbi kontrollin e kapitaleve:

Brazili: Në gjysmën e vitit 1994, i ballafaquar me një nivel inflacioni prej 2000 për qind në vit, Brazili zbatoi një plan të stabilizimit të inflacionit (real plan), duke lidhur monedhën kombëtare (real) me dollarin amerikan. Pikërisht nga ky forcim i politikës monetare, ulje e inflacionit dhe stabilitet i kursit nominal të këmbimit, rezultoi një rritje e hyrjeve të kapitaleve të huaja, kryesisht afatshkurtra. Për të mbajtur nën kontroll deficitin e llogarisë kapitale dhe për të ndikuar strukturën e maturiteteve të hyrjeve të kapitaleve, autoritetet adoptuan një paketë taksimi mbi kapitalet e huaja, konkretisht:

- *Për emetimin e letrave me vlerë të borxhit jashtë vendit, taksa mbi firmat vendase u rrit nga 3 për qind në 7 për qind.*

- *Një taksë prej 1 për qind filloi të aplikohej mbi firmat e huaja që investonin në bursën e vendit.*
- *Taksa mbi blerjet nga të huajt të investimeve fikse të vendit u rrit nga 5 për qind, në 9 për qind.*

Paralelisht me fillimin e zbatimit të masave të tilla, politikat sterilizuese të Bankës Qendrore të Brazilit, rezultuan në një rritje të ndjeshme të normave të interesave [nga 7.1 për qind në vitin 1993 deri në 26 për qind në vitin 1995 dhe atë 1996]. Norma të tilla të larta të interesave ishin përsëri shumë atraktive për kapitalin e huaj edhe pas zbritjes së taksave, gjë që inkurajonte përsëri hyrjet e kapitaleve të huaja. Për rrjedhojë, bilanci i llogarisë kapitale (ndaj PBB) u rrit nga 2.5 për qind, në vitin 1994 në 4.7 për qind, në vitin 1994.

Mbi këto konsiderata, shumë studiues konkludojnë se politikat kufizuese mbi hyrjen e kapitaleve të huaja të adoptuara nga Brazili nuk kanë rezultuar efektive. Ato që fajësohen janë politikat sterilizuese të adoptuara nga banka qendrore dhe norma e ulët e nivelit të taksës së aplikuar.

Kili: E shqetësuar nga rritja e hyrjeve të kapitaleve të huaja në fillim të vitit '90, për të mbrojtur vlerën e monedhës kombëtare, Banka Qendrore e Kilit filloi operacionet sterilizuese në tregjet e këmbimit valutor. Shkalla e gjerë e këtij operacioni, çoi në rritjen e ndjeshme të normave të brendshme të interesave, gjë që inkurajonte edhe më tepër hyrjet e kapitaleve të huaja. Bilanci i llogarisë kapitale arriti në 10 për qind të PBB-së, ku hyrjet e maturitetit afatshkurtër llogariteshin në 1/3 e totalit të hyrjeve.

Në qershor 1991 autoritetet aplikuan një normë 20 për qind, si rezervë të detyruar të parimunerueshme, që firmat duhet të mbanin pranë bankës qendrore. Njëkohësisht, banka qendrore filloi reduktimin e politikave sterilizuese.

Për rrjedhojë, bilanci i llogarisë kapitale u reduktua nga 10 për qind në 2.4 për qind të PBB-së në vitin 1991, ndërsa hyrjet afatshkurtra u bënë negative (-0.7 për qind të PBB-së). Në maj të vitit 1992, kërkesa mbi rezervën u rrit në 30 për qind, gjë që është në fuqi akoma. Shumë autorë konsiderojnë se suksesi i Kilit lidhet pikërisht me aplikimin e kësaj takse dhe me reduktimin e operacioneve

sterilizuese nga banka qendrore. Të njëjtën politikë (por me një normë takse shumë më të lartë) aplikoi edhe Kolumbia.

Republika Çeke: Të inkurajuar nga një diferencial i konsiderueshëm i normave të brendshme me ato të huaja të interesave si dhe një parashikim i një vlerësimi të koronës, hyrjet e kapitaleve të huaja e rritën ndjeshëm bilancin e llogarisë kapitale, nga 6.6 për qind të PBB-së në vitin 1994, në 16.7 për qind në vitin 1995.

Përgjigjja e parë në kundërveprim të saj ishin politikat sterilizuese të bankës qendrore, të pasuara nga vendosja (prill 1995) e një takse prej 0.25 për qind mbi transaksionet në monedhë të huaj dhe kërkesat administrative të miratimit të transaksioneve (gusht 1995) për huatë e huaja. Si rrjedhojë, llogaria kapitale u reduktua në 3.5 për qind të PBB-së.

Malajzia: Ishte një ndër vendet e para që provoi hyrje të konsiderueshme të kapitaleve të huaja, që në vitin 1989. E shqetësuar nga efektet e tyre mbi programin e reformave ekonomike të vendit dhe ndikimin në kursin e këmbimit, banka qendrore filloi operacionet sterilizuese si dhe rriti kërkesën mbi rezervën ndaj bankave tregtare.

Zgjerimi i diferencialit të normave të interesave (të vendit me të huajat) si dhe parashikimi investitorëve mbi forcimin e ringit (monedhës kombëtare), inkurajuan akoma më shumë hyrjet e kapitaleve, duke e çuar llogarinë kapitale në 17.2 për qind të PBB-së, në fund të vitit 1993.

Në janar 1994, Qeveria e Malajzisë i konsideroi këto hyrje si të një natyre spekulative dhe adoptoi një paketë masash kufizuese (të konsideruara si të përkohshme) që konsistonin në:

- *Rezidentëve u ndalohej shitja jorezidentëve e instrumenteve afatshkurtra të tregut monetar.*
- *Bankave iu vendosën tavane për pasivet e tyre jotregtare ose jo të lidhura me investimet.*
- *Bankat duhet të depozitonin në ringit pranë bankës qendrore, fondet e institucioneve bankare të huaja, të mbajtura si llogari pa interesa.*
- *Bankave u ndalohej ndërmarrja e transaksioneve jotregtare*

në operacionet swap dhe outright forward në 'bid', me klientë të huaj.

Në fund të vitit, llogaria kapitale ra në 2.1 për qind të PBB-së ndërsa hyrjet afatshkurtra ranë nga 8.6 për qind në –4.6 për qind të PBB-së.

Burimi: C.M.Reinhart, R.T.Smith 'Temporary Capital Controls' draft paper, August 1997.

5. PËRGJIGJET E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE NDAJ DESTABILIZIMIT FINANCIAR

Masa kryesore për kufizimin e hyrjes së kapitaleve afatshkurtra, e zbatuar nga vendet në zhvillim ishte: lejimi i luhatjes së kursit të këmbimit, me qëllim që ai t'i përgjigjej presioneve të këtyre hyrjeve. Vendet që zbatonin kurse fikse ose të administruara, fillimisht ndërhynë në treg për të reduktuar presione të tilla në vlerësimin e monedhës.

Nga shqyrtimi i efektivitetit të përdorimit të këtyre politikave sterilizuese, shumë studime kanë arritur në konkluzionin që ato mund të mos jenë shumë efektive në një bazë të qëndrueshme dhe mund të shoqërohen me probleme në termat e axhustimeve ekonomike ndaj hyrjeve të kapitaleve në shkallë të gjerë, për arsye se:

- Megjithë ndërhyrjen në shkallë të gjerë nga autoritetet, ato kanë qenë të paafta të eliminojnë presionet në tregjet valutore.
- Interesat afatshkurtër tentojnë të rriten (kur autoritetet fillojnë përpjekjet sterilizuese) gjë që inkurajon edhe më tepër këto hyrje.

Ndërkohë, lejimi i vlerësimit të kurseve të këmbimit ka, gjithashtu, përparësi:

- Në veçanti, lejimi i vlerësimit të monedhës ndihmon që të mbrohet ekonomia nga oferta e brendshme e parasë, e ardhur nga efektet ekspansioniste të hyrjeve kapitale. Për rrjedhojë, nëse ekonomia do të dëmtohet nga vlerësimi real i kursit të këmbimit, axhustimi i saj do të vijë nga përshtatja e kursit të këmbimit më tepër se nga nivelet më të larta të inflacionit.
- Paqëndrueshmëritë për shkak të rritjes së luhatshmërisë së monedhës, dekurajojnë hyrjet e kapitaleve afatshkurtra, veçanërisht të atyre për qëllime spekulative.

Megjithatë, vlerësimet e larta të monedhës do të impononinedhe kosto të larta në ekonomi. Për më tepër, nëse në vend nuk ekzistojnë instrumentet mbrojtëse, fleksibiliteti i kurseve të këmbimit mund të dekurajojë edhe kapitalet afatmesme.

Një tjetër përgjigje ndaj kufizimit të hyrjes së kapitaleve afatshkurtra, mund të jenë kufizimet fiskale për të reduktuar presionet në rritjen e kërkesës agregate dhe për të kufizuar ndikimin inflacionist të hyrjeve të tilla.

6. BORXHET E VENDEVE NË ZHVILLIM

Krizat financiare kanë dhënë efekte të mëdha në gjithë ekonominë botërore, por veçanërisht në vendet e varfra. Rreth dy vjet e gjysmë më parë, vendet e zhvilluara miratuan në parim marrëveshjen për reduktimin e borxhit të vendeve në zhvillim, si fazë e parë e kësaj iniciative globale. Takimi i G7 në Këln, në qershor të këtij viti (1999) i dha një shtysë të re këtij procesi, duke nxitur njëkohësisht edhe debatin publik rreth tij[7]. Për çfarë bëhet fjalë?

Borxhet e Botës së Tretë janë një problem që kanë ekzistuar për një kohë të gjatë, të paktën që nga viti 1982, kur Meksika paralajmëroi se bankat e saj nuk do të ishin në gjendje të

paguanin borxhet e marra, duke i dërguar sinjale tronditëse industrisë bankare botërore. Vende si Meksika e Brazili, zotërojnë borxhe të niveleve të tilla ndaj bankave perëndimore, veçanërisht bankave amerikane, saqë mospagimi i tyre mund të çonte në kolaps mjaft nga bankat e këtyre vendeve.

Të joshura nga normat e ulëta të interesave në fillim të viteve '70 dhe me besimin që çmimet e mallrave të tyre në tregjet botërore do të rriteshin, këto vende akumuluan në mënyrë konstante borxhe nga donatorët dypalësh, institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat private perëndimore. Por, në fund të viteve '70, çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare ranë ndjeshëm, ndërsa normat e interesave u rritën. Kostot e shërbimit të borxhit u rritën, duke krijuar një spirale në zhvillimin e tyre ekonomik, që vazhdon edhe sot. Midis viteve 1983-1990, vendet në zhvillim arritën të paguanin 1.5 trilionë dollarë për shërbimin e borxhit të jashtëm, ndërkohë që barra e borxhit të jashtëm të tyre sot llogaritet në 3 trilionë dollarë.

Takimi i G7 në Këln, shqyrtoi problemin e lehtësimit të barrës së borxheve të vendeve me shumë borxhe (HIPC), që përfshinë 42 vende kryesisht të Afrikës sub-Sahariane. Bëhet fjalë për një borxh total prej 310 miliardë dollarësh[8] që këto vende i detyrohen vendeve të zhvilluara, ndërkohë që paketa e fshirjes së borxhit përmbledh 42 miliardë ose 13.5 për qind të borxhit total të tyre.

Por Samiti i Këlnit ka lënë hapur çështjen se si do të financohet ky program. Financimi i kësaj pakete prej 42 miliardë dollarësh ishte në krye të axhendës së takimeve të Parisit dhe Washingtonit, gjatë muajve shtator dhe tetor.

Njëri nga sugjerimet ishte shitja nga FMN e 10 për qind të rezervave të saj të arit (300 ton), nga e cila pritet të realizohen 4.2 miliardë dollarë. Ky propozim është kundërshtuar nga vendet prodhuese të arit, duke përfshirë edhe vetë vendet afrikane, shumica e të cilave janë prodhuese të arit. Pas shitjeve të një pjese të rezervave të arit nga ana e Bankës së Anglisë, çmimi i këtij malli (qershor '99) arriti në kuotën më të

ulët që prej 20 vjetësh. Ky propozim ka shumë gjasa të mos pranohet nga Kongresi Amerikan, pasi kjo do të godiste edhe vetë industrinë amerikane të minierave të arit, që është një ndër më të mëdhatë në botë. Nga ana tjetër, nëse ky program do të financohej nga programet e ndihmave financiare që vendet e zhvilluara ofrojnë për këtë grup vendesh, kjo përsëri do të thotë që të kufizohet në maksimum asistenca për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni.

Borxhet i detyrohen:

50 për qind qeverive perëndimore (Evropa, Amerika e Veriut dhe Japonia).
35 për qind institucioneve financiare ndërkombëtare; dhe
15 për qind huadhënësve privatë (bankave).

7. DEMOKRACIA DHE KRIZAT

Kriza e këtij fundshekulli ka çuar në fakt edhe në stimulimin e një debati më të gjerë në vendet në zhvillim: atë të qëndrueshmërisë së vlerave të demokracisë. A është e ashtuquajtura "rruga aziatike" drejt prosperitetit ekonomik përpara lirisë politike, shkaku i krizës? A janë demokracia dhe tregu i lirë zgjidhja e duhur? Përqasja e pikëpamjeve rreth këtij problemi, tashmë i vendosur në kuadrin e një diskutimi global (kryesisht nga vendet në zhvillim) përbën edhe një ndër fushat më tërheqëse të ekonomistëve, politologëve dhe sociologëve.

Sipas Amartya Sen (fitues i çmimit Nobel në ekonomiks, 1989), gjëja më e rëndësishme që ka ndodhur gjatë shekullit të 20-të është 'lindja e demokracisë'. "Në shekullin e 20-të, demokracia u themelua si një formë 'normale' e qeverisjes ndaj të cilës, i jepet e drejta çdo kombi. Ne nuk duhet ta fillojmë çdo herë nga e para, sa herë që ky apo ai vend është 'gati' për demokraci; ne tashmë e marrim këtë "si të dhënë" - argumenton Sen.

Në fakt, shumë analistë, ashtu si dhe Sen, theksojnë se "problemet e kohëve të fundit të Azisë Lindore dhe Juglindore janë ndëshkim i qeverisjes jodemokratike. "Të drejtat politike dhe civile të shoqërisë, i japin asaj mundësinë të tërheqë me forcë vëmendjen ndaj nevojave të përgjithshme dhe të kërkojë veprim publik".

Edhe shkencëtari amerikan i çështjeve politike Francis Fukuyama, në librin e tij të famshëm 'Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit' e deklaron liberalizmin perëndimor me parimet e tij përfaqësuese mbi demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe sipërmarrjen e lirë, si triumfuese pas Luftës së Ftohtë. Autoritarizmi aziatik ka vuajtur nga kthimet mbrapa, nga rënia e Suhartos tek shqetësimet e Mahatir. Edhe në Kinën autokratike, njerëzit e pasuruar apo të varfëruar nga reformat ekonomike, gjithnjë e më shumë po kërkojnë rritjen e të drejtave të tyre. Megjithatë, për shumë analistë mbetet e dyshueshme nëse Kina do të kishte të njëjtin prosperitet ekonomik në qoftë se ngjarjet e Tienanmen, do të kishin sjellë pluralizmin politik. Me zhvillimet e dhjetë viteve të fundit, (fatkeqësisht) pranohet se regjimi autoritar i Kinës ka dhënë rezultate shumë më pozitive se sa regjimi demokratik në Rusi.

Kim Dae Yung (Presidenti i Koresë së Jugut), thekson se: "Duke i kanalizuar burimet e rralla ekonomike në disa rajone të kufizuara dhe duke ndrydhur konfliktet sociale, regjimet autoritare mund të duken shumë efektive në afat të shkurtër… Por, pas fasadës së rritjes së shpejtë ekonomike, qëndrojnë dëmtimi moral, ngurtësia burokratike dhe kronizmi politik. Problemi i pabarazisë - ndërmjet rajoneve, klasave shoqërore dhe industrive, - bëhet edhe më serioz".

Nakasone (ish-Kryeministri i Japonisë) tërheq vëmendjen ndaj lëvizjes drastike drejt lirisë. "Mbitheksimi i demokracisë mbart rrezikun e çuarjes drejt humbjes së kontrollit dhe krijimit të kaosit; ndërsa mbitheksimi i ekonomisë së tregut tek eficienca, mund të shkatërrojë kulturën e një kombi. Pasi të jetë arritur zhvillimi ekonomik, atëherë demokracia duhet të zëvendësojë autoritarizmin".

Ndërsa Pei Minxin, profesor i shkencave politike të Princeton, duke përdorur analizat e regresionit në shqyrtimin e relacioneve midis demokratizimit, rritjes së të ardhurave dhe liberalizimit ekonomik, nga njëra anë dhe qeverisjes nga ana tjetër, me të dhënat për disa vende konkludon se: "...Nuk ekziston një dëshmi e qartë se qeveritë demokratike promovojnë zhvillimin ekonomik më mirë se qeveritë autoritare. Po kështu, as rritja e lirisë politike nuk e përmirëson mënyrën e qeverisjes. Përkundrazi, korrupsioni në vendet e demokracive të reja tenton të rritet".

Pei konkludon se avokatët e demokracisë duhet t'i japin prioritet reformave ekonomike - përkundër stilit të Perëndimit, që fillimisht bën thirrje dhe inkurajon të drejtat politike, shpesh të shoqëruara me sanksione ekonomike, e cila pengon dhe dëmton sipërmarrjen private. "Fatkeqësisht , - konkludon Pei, - është më e vështirë të edukosh Kongresin Amerikan në këtë çështje, se sa të gjesh reformatorë në vendet jodemokratike".

Duke përmbledhur mendimin e tij, Ramos (ish-President i Filipineve), thekson se "ndërsa rritja ekonomike mund të fillojë edhe pa demokraci, demokracia është e mundur vetëm në ekonominë e tregut, e cila ndihmon të krijohet e drejta private - e quajtur shoqëria civile,- që mundëson lulëzimin e lirisë sociale dhe politike".

Mbyllje:

Nëse krizat ndihmojnë në krijimin e një shpirti të ri shoqëror botëror edhe agonia që përjeton shoqëria jonë, me këtë axhendë të hapur problemesh të shtruara për zgjidhje, do të ishte e vlefshme.

SHËNIME

* Selami Xhepa, Specialist, Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve. Mars 2000.

[1] Pas Japonisë dhe vendeve aziatike krizat përfshinë edhe Rusinë, vendet e Amerikës Latine, veçanërisht Brazilin, por me shenja të dukshme edhe Venezuelën.

[2] Modeli i parë i krizave monetare i quajtur 'modeli i sulmit spekulativ' ishte ndërtuar nga Krugman (1979) dhe Flood & Garber (1984). Ky model e shpjegon krizën monetare bazuar në humbjen e kontrollit të bankës qendrore mbi rezervat valutore, si pasojë e politikave ekspansioniste monetare dhe fiskale. Efikasiteti i këtij modeli u vu në pikëpyetje me krizën monetare të Sistemit Monetar Evropian në vitin 1992-93, ku nuk dalloheshin shenja të politikave monetare dhe fiskale ekspansioniste si nga Britania e Madhe dhe nga Franca. Kjo i dha shtysë studiuesve të ndërtonin një tjetër model 'të klauzolës përjashtuese' (që shpesh emërtohet si modeli i gjeneratës së dytë). Sipas këtij modeli, autoritetet i bazojnë vendimet në ruajtjen e një kursi këmbimi 'pegged' të monedhës në mënyrë kondicionale (domethënë, sa kohë që përfitimet prej saj, si ulja e inflacionit, sigurimi kredibilitetit etj., nuk sjellin kosto të konsiderueshme për vendin). Roli i bazave ekonomike, sipas këtij modeli është shumë më i rëndësishëm në marrjen e vendimeve nga agjentët privatë se në rastin e modelit të sulmit spekulativ. Kriza aziatike ka inkurajuar mjaft ekonomistë të përpunojnë një model të tretë, të quajtur 'modeli i gjeneratës së tretë' (nga Krugman-Dooley-Sacs, 1999) në shpjegimin e krizave monetare. Ky model zhvillon një lidhje midis krizës bankare dhe monetare, dhe efekteve përhapëse të krizës midis vendeve.

[3] Përpjekjet amerikane për të penguar përhapjen dhe depërtimin e komunizmit në rajonet e tjera të botës, Amerikën Latine, Azi e Afrikë dhe një sërë konfliktesh të armatosura të krijuara në këto rajone.

[4] Lista e plotë e vendeve anëtare të G-20 është: Argjentina, Australia, Brazili, Kanadaja, Kina, Franca, Gjermania, India, Indonezia, Italia, Japonia, Koreja, Meksika, Rusia, Arabia Saudite, Afrika e Jugut, Turqia, Anglia, SHBA dhe presidenca e BE. Ky grup vendesh zë 86.7 për qind të PBB-së dhe 65.4 për qind të popullsisë botërore.

[5] J. Williamson, M. Makar "A survey of financial liberalization", cit. The Economist, May 1999.

[6] Kriza e borxhit e viteve 1980 e Amerikës Latine i afroi investitorët e huaj vetëm në fillim të viteve 1990 (të cilët u larguan përsëri për shkak të krizës valutore të Meksikës në vitin 1994).

[7] Një lëvizje e gjerë globale e njohur si 'Jubile 2000' ka gjetur përkrahës të shumtë, përfshirë edhe figura të rëndësishme të shkencës ekonomike si Barro, Sachs apo grupet e rock stars si U2 etj..

[8] Çdo person në vendet në zhvillim i detyrohet një borxh prej 250 dollarësh amerikanë, vendeve të zhvilluara.

ZHVILLIMI I KORRIDOREVE TË TRANSPORTIT NË EVROPËN QENDRORE E LINDORE DHE NË BALLKAN

*Selami Xhepa**

Fjalë kyçe
- Korridor rrugor - Transport ballkanik - Korridor panevropian - Interesat gjeostrategjikë - Energjitikë -

Shembja e murit të Berlinit, simbolizoi ribashkimin e një kontinenti që, për motive ideologjike, për dekada ishte ndarë në dy pjesë. Por, në realitet, kontinenti vazhdon të mbetet i ndarë. Diferencat në zhvillimin ekonomik dhe veçanërisht në strukturat e saj, diferencat teknologjike, por mbi të gjitha, disnivelet e theksuara në zhvillimet infrastrukturore, vazhdojnë të shërbejnë si barriera të pakapërcyeshme për një zhvillim të harmonizuar midis popujve të kontinentit tonë.

I. INICIATIVAT

Pikërisht, me synim afrimin e vendeve të kontinentit, dhe mbi bazën e konvergimit të interesave të vendeve të rajonit, lindi *Konferenca Panevropiane* e Transportit, nën mbështetjen dhe koordinimin e Komisionit Evropian. E mbledhur për herë të parë në Pragë (1991), ajo përcaktoi linjat e përgjithshme të projektit të zhvillimit të rrjetit panevropian të transportit. Ndërsa takimi i dytë, i mbajtur tre vjet më vonë në Kretë (1994), përcaktoi linjat e përgjithshme strategjike të projekteve, të ashtuquajturat *'Korridore panevropiane''*, të cilat janë 10. Përdorimi i termit *'korridor'* lidhet me faktin se ndërtimi i infrastrukturës së transportit, nuk përfshin vetëm thjesht rrjetin rrugor, por dhe

atë hekurudhor, ajror, portual dhe sistemet e kontrollit e të navigimit. Duke parë që rrjeti i përcaktuar i korridoreve ishte shumë skematik, takimi i tretë i mbajtur në Helsinki (1997) e zgjeroi skemën e korridoreve të transportit, duke shtuar dhe lidhjen e korridoreve rrugore (të quajtura *'linjë kryesore'*) me disa linja lidhëse (të quajtura *'degë'*) me ato rajone, që ishin ekonomikisht më të prapambetura.

Për financimin e kryerjes së studimeve projektuese të korridoreve rrugore, komisioni vuri në dispozicion një pjesë të financimeve nëpërmjet programeve PHARE dhe TACIS. Me qëllim që të aktivizohen fonde të tilla, vendet e interesuara duhet të nënshkruajnë protokollin e interesit (*Memorandumin e Mirëkuptimit*) për korridorin në të cilin ato janë të përfshira.

Vlerësimi i nevojave të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore për financimin e rrjetit të transportit iu besua dhe është kompletuar nga TINA *(Transport Infrastructure Needs Assessment)*. Raporti TINA vlerëson se kompletimi i rrjetit të transportit do të kushtonte afërsisht 90 miliardë euro dhe mund të përfundojë deri në vitin 2015. Aneksi 1 jep një paraqitje të 10 korridoreve panevropiane, të shoqëruar dhe me një hartë.

Box. 1: Vlerësime të raportit TINA.

Rrjeti i transportit panevropian është identifikuar si pjesë e procesit "Vlerësimi i nevojave të infrastrukturës së transportit" (TINA), me sekretariat në Vjenë. Në këtë proces marrin pjesë 26 vende nga BE dhe Evropa Qendrore dhe Lindore, të cilat së bashku, kanë identifikuar rrjetin e transportit që përfshin rreth:

18,000 kilometra rrugë,
20,000 kilometra hekurudhë,
38 aeroporte,
13 porte detare,
49 porte lumore.

Kostoja e përfundimit të gjithë këtij rrjeti deri në vitin 2015 është vlerësuar në 90 miliardë ecu.

Studimi i transportit ballkanik ofron një shembull të mirë, që përfshin një vlerësim strategjik të mbi 100 projekteve, ku hyjnë rrugët, hekurudhat, transporti i kombinuar dhe zhvillimi i porteve të Shqipërisë, Bullgarisë, FYROM-it, Hungarisë, Rumanisë dhe Sllovenisë. Studimi ka rezultuar në hartimin e një programi zhvillimi, që arrin në vlerësimin e nevojave për financim në shumën prej 10.5 miliardë ecu.

Studimi i transportit ballkanik është kompletuar në vitin 1997, duke identifikuar një numër projektesh prioritare për çdo vend.

Për Shqipërinë, studimi vlerëson prioritetin e nevojave për investime në infrastrukturën rrugore, së bashku me zhvillimin e Portit të Durrësit. Theks i veçantë, i përmendur në studim, ishte Korridori VIII Lindje – Perëndim. Ky korridor lidh Portin e Durrësit me Tiranën dhe me FYROM.

Burimi: Web site of EU/Phare Programme.

Në këtë analizë jemi ndalur posaçërisht në Korridorin VIII që, kohët e fundit, është bërë objekt i një debati të gjerë publik (shpesh dhe në mënyrë spekulative) kryesisht i drejtuar nga politikanët.

II. KORRIDORI VIII *(DETI ADRIATIK – DETI I ZI)*

Korridori VIII bën pjesë në 10 korridoret e transportit, të përcaktuara nga Konferenca Panevropiane e Transportit. Italia është ngarkuar me rolin e koordinatorit të këtij projekti.

Linja kryesore e këtij projekti zhvillohet: Portet italiane të Bari/Brindisit drejt Durrësit/Vlorës – Tiranë – Pogradec – Shkup – Sofie – Plovdiv – Burgas/Varna. Fillimi i këtij korridori nga portet italiane, duke devijuar nga ajo që ishte përcaktuar në Konferencën Panevropiane të Transportit *(ku ishte përcaktuar*

Durrësi), është konkorduar me GD VII të Komisionit Evropian, në pritje të një miratimi formal në takimin e ardhshëm të Konferencës Panevropiane.

Korridori ka lidhje dhe me Greqinë dhe Turqinë. Interesat e Greqisë lidhen me faktin se ajo *po* ndërton *rrugën Egnatia*, një aks rrugor që shkon në paralel me Korridorin VIII, i gjithi në territorin grek, me terminal portual atë të Igumenicës. Rruga Egnatia bën pjesë në projektet prioritare (një ndër 14 projektet e miratuara) të vendosura në samitin e Këshillit Evropian në Essen (1994), dhe mbështetet financiarisht me fondet komunitare të destinuara për rrjetet e transportit evropian (vendimi 2236/95).

Interesat e Turqisë qëndrojnë në faktin se Korridori VIII intercepton me Korridorin IV në Plovdiv (Bullgari) për në Stamboll. Për këtë arsye, të dyja këto vende (Greqi dhe Turqi) kanë kërkuar të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit.

Gjatësia e Korridorit (Durrës – Varna) është gati 1100 km rrjet rrugor. Gjendja e rrugës është relativisht e mirë në Bullgari dhe Maqedoni dhe e rënduar në Shqipëri. Ndërsa rrjeti hekurudhor paraqet dy ndërprerje: në kufirin Shqipëri-Maqedoni (65 km) dhe Maqedoni-Bullgari (55 km). Me eliminimin e këtyre ndërprerjeve, gjatësia e rrjetit hekurudhor është gati 1200 km.

Kostoja totale që Korridori VIII të vihet 'në gjendje të mirë' vlerësohet rreth 2.5 miliardë dollarë (5.000 miliardë lira italiane) në 5/6 vitet e ardhshme. Nëse nevojat strategjike të të gjithë aktorëve kryesorë perëndimorë (kryesisht Itali dhe Greqi) përputhen me njëra-tjetrën, kostoja e financimit nuk konsiderohet si barrierë e vështirë.

III. GJENDJA AKTUALE E PROJEKTIT

Teksti i Memorandumit të Mirëkuptimit është përgatitur por akoma nuk është firmosur: divergjencat e interesave midis vendeve të përfshira duket se janë bërë të pakapërcyeshme.

Nga ana e tij, Komisioni Evropian, ka rekomanduar fuqimisht përfshirjen e Greqisë në hartimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (1), me synim harmonizimin sa është e mundur, të propozimit *"të linjës kryesore"* të Korridorit VIII me projektin e rrugës Egnatia. Në rast të kundërt, firmosja e Memorandumit nga ana e Komisarit Evropian për Transportet do të vonohej, gjë që nuk do të krijonte mundësimin e financimit të tij nga fondet komunitare. (Ashtu siç u zvarrit dhe firmosja e Memorandumit për Korridorin V, për shkak të kundërshtimeve nga Austria.)

Në këtë situatë, Memorandumi i Mirëkuptimit i përgatitur prej muajsh qëndron i bllokuar, megjithë disa apele të bëra nga ana e qeverive pjesëmarrëse pranë autoriteteve të Komisionit të BE.

Aktualisht, i konsideruar si një projekt me rëndësi rajonale, ai është përfshirë në projektet që do të zhvillohen me përparësi në kuadrin e nismës së komunitetit ndërkombëtar për Paktin e Stabilitetit në Evropën Juglindore.

IV. KORRIDORI VIII NË SHQIPËRI

Që me konceptimin e korridorit në Konferencën e Kretës në vitin 1994, presidentët e Shqipërisë, FYROM-it, Bullgarisë dhe Turqisë nënshkruan në SHBA Memorandumin e Mirëkuptimit, gjë që i hapi rrugën financimit të kryerjes së studimeve të fizibilitetit dhe fillimit të financimit të fazës së parë të këtij projekti.

I quajtur si Korridori Lindje-Perëndim, gjatësia totale e tij është 247 km, ndërsa segmenti që lidhet me Korridorin VIII ka një gjatësi prej 154 km dhe punimet e tij për fazën e parë kanë nisur në pjesë të caktuara rrugore (në 67.5 për qind të totalit të korridorit që, mbi bazën e vonesave në realizimin e tyre, mund të përfundojnë deri në vitin 2003). Faza e parë përfshin punime rehabilituese të rrjetit rrugor ekzistues.

Box. 2: Korridori Lindje-Perëndim:

Segmentet ku kanë filluar punimet:

- *Durrës-Rrogozhinë (39 km): financuar nga Phare; kontraktorë "S&F" (ndërmarrje e përbashkët italo-greke e Sarandopullos – Falcione). Filluar punimet në 19.01.1998 me kohëzgjatje 27 muaj; Vonesa në punime: 9 muaj.*
- *Rrogozhinë-Elbasan (44 km): financuar nga ?; kontraktorë Behase (Turqi). Filluar punimet 01.09.1998 me kohëzgjatje 24 muaj; Vonesa 20 muaj?*
- *Librazhd-Qukës (21 km): financuar nga BB; kontraktorë Mavrovo (FYROM). Filluar punimet në 04.1.1999 me kohëzgjatje 24 muaj; Vonesa 6 muaj.*
- *Korçë-Kapshticë (32 km): financuar nga Phare. Kontraktorë Granit (FYROM). Fillimi punimeve në 01.06.1999 me kohëzgjatje 24 muaj. Nuk është pjesë e Korridorit VIII.*

Segmentet ku nuk kanë filluar punimet:

- *Elbasan-Librazhd (30.5 km); financuar nga BERZH.*
- *Qukës-Qafë Thanë (19.6 km); financuar nga Kuvajt.*
- *Qafë Thanë – Pogradec (21 km). Nuk është pjesë e Korridorit VIII.*
- *Pogradec-Korçë (40 km); financuar nga Phare. Nuk është pjesë e Korridorit VIII.*

Korridori Veri-Jug. Ka një gjatësi prej 374 km (me shtrirje nga Hani i Hotit në Gjirokastër).

Segmentet ku kanë filluar punimet:

- *Milot-Lezhë (12 km); financuar nga BB. Kontraktorë Falcione (Itali). Fillimi punimeve 11.08.1998, kohëzgjatja e punimeve 20 muaj; vonesa 24 muaj.*
- *Mamurras-Milot (12.8 km); financuar nga Qeveria Italiane. Kontraktorë Sarandopullos (Greqi). Marrë në dorëzim, por nuk është vënë në funksionim.*
- *Fushë Krujë-Mamurras (12 km); financuar nga BB. Kontraktorë*

Mak-Albania (arabe). Fillimi punimeve 16.11.1998, kohëzgjatja punimeve 7 muaj; vonesa 4 muaj.

- *Vorë-Sukth (14.2 km); financuar nga Phare. Kontraktorë Ital-Strade (Itali). Fillimi i punimeve 11.01.1999, kohëzgjatja 22 muaj.*
- *Sukth-Durrës (8.7 km); financuar? Kontraktorë Ruscala (Itali). Fillimi i punimeve 04.01.1999, kohëzgjatja 18 muaj.*
- *Rrogozhinë-Lushnje (18 km); financuar nga Phare. Kontraktorë Graniti (FYROM). Fillimi i punimeve 04.01.999, kohëzgjatja 22 muaj.*
- *Kakavijë-Gjirokastër (23 km); financuar nga Phare. Kontraktorë Step-Metin (Greqi). Fillimi punimeve 01.06.1999, kohëzgjatja 18 muaj. Nuk është pjesë e Korridorit VIII.*

Segmentet ku nuk kanë filluar punimet:

- *Shkodër-Han i Hotit (35 km); financuar Qeveria Italiane.*
- *Lezhë-Shkodër (40 km); financuar nga Qeveria Italiane.*
- *Ura e Matit-Ura e Drinit-Tapizë-Fushë Krujë (7 km); financuar nga BB.*
- *Lushnjë-Fier (32 km); financuar nga Qeveria Italiane.*
- *Fier-Vlorë (35 km); pa financim.*
- *Fier-Tepelenë (85 km); pa financim.*
- *Tepelenë-Gjirokastër (30 km); financuar nga Phare.*

Burimi: Koha Jonë, 2000-03-14.

V. INTERESAT GJEOSTRATEGJIKË

Skenarit të vështirësive të brendshme ekonomike të vendeve të Ballkanit, i shtohen dhe interesat ekonomikë dhe politikë mjaft kompleksë të fuqive të mëdha. Nga njëra anë, SHBA duken pasive në shfaqjen e interesave të tyre në Ballkan. Megjithatë, ato nuk harrojnë se në planet e tyre strategjike në afat të gjatë, drejtimi i zhvillimeve në pellgun e Mesdheut, shkon përtej mbrojtjes së aleatëve të tyre në rajon, Turqisë dhe Izraelit.

Kjo duket se do të diktojë një prezencë afatgjatë ushtarake të saj në Ballkan.

Nga ana tjetër, Evropa duket se është e preokupuar më tepër me problemet e saj të brendshme. Mjetet financiare, që ajo ka vënë në dispozicion të rajonit, janë krejtësisht të pamundura që të plotësojnë ekzigjencat e rimëkëmbjes së tij.

Ana tjetër e lojës, që reflektohet në ekuilibrat e brendshëm të brishtë të vendeve të rajonit, kufijtë e të cilave kanë qenë objekt i ndryshimeve të përhershme përgjatë historisë, është kontrolli i kanaleve të lidhjes së vendeve me burimet energjitike (gazit dhe naftës) nga Kaspiku dhe Deti i Zi.

Rrjetet e reja të naftë dhe gazsjellësve që janë në studim, për shkak të investimeve të konsiderueshme që nevojiten, imponojnë që ato të kalojnë në territore "të sigurta", ndërkohë që siguria në këtë rajon është e vogël.

Nga ana tjetër, Rusia kërkon të ruajë kontrollin e saj: me zhvillimet në Çeçeni, Moska duket se heziton në riparimin e naftësjellësit që del në Detin e Zi (në Novosimbrisk) që nga Azerbajxhani dhe po projekton një gazsjellës të ri, që do të dalë në Portin gjeorgjian Supsa.

Hipotezat e tjera ballafaqohen, gjithashtu, me të tjera probleme: Irani duket se nuk është i favorizuar (duke parë raportet e lidhjeve të tij me SHBA dhe Perëndimin), ndërsa konsorciumi i krijuar, i quajtur *"Central Asia Gas Pipeline"* (ku bëjnë pjesë të gjitha vendet kryesore të interesuara), është shprehur i gatshëm të investojë 2 miliardë dollarë në ndërtimin e një gazsjellësi prej 1400 km, nga Turkmenistani, përmes Afganistanit, deri në Karaçi (Pakistan).

Cili nga këto projekte do të realizohet është akoma e vështirë të thuhet: por tashmë është evidente që për rëndësinë e tyre, ato janë të destinuara të ndikojnë shumë mbi projektet (dhe mundësinë e financimit të tyre) e korridoreve evropiane të transportit.

Box. 3: Projektet e energjitikës.

Pas shpalljes së pavarësisë nga ish-Bashkimi Sovjetik, republikat e Azisë Qendrore kanë hyrë në fokusin e "Lojës së Madhe" të superfuqive botërore. Arsyeja është e mirënjohur: burimet energjitike tepër të mëdha nëntokësore, veçanërisht në naftë dhe gaz.

Azia Qendrore dhe Azerbajxhani zënë një sipërfaqe prej 3,937,600 km2 (Kazakistani 2,717,000 km2; Uzbekistani 447,400 km2; Turkmenistani 488,100 km2; Kirgiztani 198,500 km2 dhe Azerbajxhani 86,600 km2). Kjo sipërfaqe është gati sa 2/3 e sipërfaqes së gjithë kontinentit evropian.

Azerbajxhani, Kazakistani dhe Turkmenistani së bashku, renditen në vend të tretë në botë në zotërimin e rezervave të naftës, pas Lindjes së Mesme dhe Siberisë. Gjithashtu, Turkmenistani, Kazakistani dhe Uzbekistani zotërojnë gati gjysmën e rezervave të njohura botërore të gazit. Veç naftës dhe gazit, ky rajon është i pasur dhe me rezerva burimesh strategjike, si uranium, ar dhe minerale joferrore. Është për këto arsye që rajoni është bërë qendra e vëmendjes së diplomacisë botërore.

Për shkak të lidhjeve historike etnike dhe kulturore, Turqia është tërësisht e përfshirë në këtë lojë, në projektet e linjave të transportit të energjisë dhe daljen e tyre në tregun botëror.

Nëse do të realizohen, naftë dhe gazsjellësit e planifikuar Baku-Ceyhan; Tengiz (Kazakistan) - deti Kaspik - Ceyhan; dhe Turkmenistan – Iran – Ceyhan, do t'i japin Turqisë një pozicion tepër strategjik në kontrollin e linjave energjitike që dalin nga Azia Qendrore drejt Evropës dhe Mesdheut.

Lidhur me shfrytëzimin e burimeve të naftës dhe gazit në detin Kaspik, "Statusi ligjor i detit Kaspik" po tërheq vëmendjen e fuqive të mëdha. Marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kazakistanit dhe Federatës Ruse, që e pranon "Kaspikun" si një "det", ka kontribuar në rritjen e paqartësive të marrëveshjes midis pesë shteteve që preken prej tij, ku Irani deklaroi se nuk e njeh marrëveshjen e konkluduar midis Federatës Ruse dhe Kazakistanit.

Ndërkohë që administrata amerikane e ka bërë të njohur që mbështet një korridor energjitik (për naftën dhe gazin) nga rajoni i detit Kaspik në Turqi.

Dilemat dhe mosmarrëveshjet e diplomacisë botërore dhe asj rajonale edhe për këtë çështje, vazhdojnë të mbajnë "peng" dhe projektet e naftë dhe gazsjellësve të vendit. Projekti i studiuar nga kompania AMBO (që në fakt është një konsorcium midis shteteve të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë) akoma nuk mund të thuhet se është përcaktuar përfundimisht.

VI. POZICIONI I GREQISË NË RAPORT ME KORRIDORIN VIII

Në Samitin e shefave të shteteve evropiane në Essen (dhjetor 1994), ndër projektet prioritare të transportit evropian, Greqia përfitoi dy projekte: projektin e rrugës *Egnatia* dhe projektin *PATHE*.

Projekti PATHE (shkurtim për Patra-Athinë-Selanik), siç del dhe nga emri i tij, bën lidhjen e Patrës me Athinën dhe, në vazhdim, me Selanikun. Projekti përfshin një gjatësi rrugore (rehabilitim të rrjetit rrugor ekzistues) prej 860 km, me kosto totale prej 3880 milionë eurosh dhe kompletimi i punimeve është planifikuar për vitin 2002.

Rruga Egnatia, me një gjatësi prej 780 km, kosto totale prej 2480 milionë eurosh, planifikuar të kompletohet brenda vitit 2002, realizon lidhjen e Portit të Igumenicës dhe përshkon gjithë Greqinë e Veriut deri në Aleksandropulos (kufiri me Turqinë), si dhe ka degëzimet me Bullgarinë dhe Shkupin (pjesë e korridoreve panevropiane). Ajo qëndron në paralel jugor të Korridorit VIII që pritet të përshkojë vendin tonë me drejtim Shkupin deri në Varna/Burgas.

Siç shihet, këto dy projekte përfundojnë brenda një kohe shumë më të shkurtër nga sa pritet të realizohen segmentet rrugore të

korridorit shqiptar Lindje-Perëndim, i cili në shumë segmente akoma nuk ka filluar dhe nuk ka financimet që kërkohen.

Akset kryesore të rrjetit rrugor të Greqisë janë:

- Aksi Perëndimor: me drejtimin Patra/Igumenicë–Itali-Austri-Gjermani.
- Aksi Qendror: me drejtimin Greqi Qendrore/Veriore – FYROM- ish-Jugosllavi –Kroaci-Slloveni-Austri-Gjermani (nëpërmjet Korridorit X); dhe
- Aksi Lindor: me drejtimin Greqi-Bullgari-Rumani-Moldavi/ Ukrainë-Rusi (nëpërmjet Korridoreve IV dhe V).

Kjo do të thotë se zhvillimi i Portit të Igumenicës, do të zhvendoste gjithë aktivitetin tregtar të pritshëm që të përshkojë "urën e Adriatikut" nga porti i Durrësit, duke siguruar dalje të menjëhershme për në Turqi. Nga ana tjetër, këmbëngulja (ose koncensioni) e Shkupit për daljen e Korridorit X në Follorinë e Selanik dhe bashkimin e tij me rrugën Egnatia, i siguron "valvolën e sigurimit" "në rast se... diçka" ndodh në marrëdhëniet me Tiranën.

Duke shtuar dhe vendimin për zgjatjen e Korridorit IV nga Sofja në Selanik, pa dyshim që vendos Portin e Selanikut në pozita privilegjuese në kryqëzimin e trafikut të mallrave. Në këtë kuptim, lidhja apo moslidhja e Shqipërisë (rruga lidhëse nga Pogradeci me Follorinën duke u bashkuar me Korridorin X me dalje në Selanik) me Selanikun, besoj se nuk e ndryshon aspak pozicionin e këtij porti në raport me korridoret e transportit. Në planin politik, një lidhje e tillë mund të shërbente si kundërpeshë e vendimit të Shkupit, ndërsa në planin ekonomik, kjo lidhje do të shërbente si një zgjedhje tjetër alternative për transportuesit e mallrave. (Ndërsa vendimet e ndërtimit të korridoreve udhëhiqen më tepër nga konsiderata politike, shfrytëzimi dhe zgjedhja e tyre është subjekt i konsideratave të avantazheve që i ofrojnë operatorëve privatë).

Mbi këto konsiderata, gjykojmë se, në dallim nga propaganda e deritanishme, nuk është Porti i Selanikut konkurrenti i porteve

shqiptare të Durrësit/Vlorës. Mendojmë se konkurrenca do të vijë kryesisht nga portet e Igumenicës dhe të Patrës.

Në thelb, lidhjet që korridoret X dhe IV i sigurojnë Greqisë me rrugën Egnatia, praktikisht e nxjerrin Shqipërinë "një xhep" në gjithë vendet e rajonit. Ndoshta, dhe interesat strategjikë të Italisë nuk mund të jenë aq persistentë, sa kohë që ura e saj mbi Adriatik mund të kanalizohet në veri, nëpërmjet Portit të Rijekës dhe atij të Koperit, ndërsa në jug, nga Igumenica.

Argumenti në këtë rast mund të mbështetet nga fakti se largësia më e madhe e transportit do të kapërcehej nga ulja e kohës së vonesave në transportin e mallrave. Kështu, ngarkesat e ardhura nga Perëndimi të destinuara për në Lindje (Turqi dhe më tej), në këtë rast do të kalonin vetëm në dy pika doganore (hyrje-dalje në Greqi dhe hyrje (dalje) në Turqi), ndërkohë që tranzitimi i mallrave nga Vlora dhe Durrësi, do të kërkonte më shumë procese administrative doganore, gjë që në çdo rast do të ishte e dëshirueshme të shmangej nga subjektet.

Po për të njëjtat arsye, edhe për tranzitimin e mallrave që do të kalonin nëpërmjet porteve shqiptare, përsëri interesat e subjekteve private (gjithmonë për tranzitin drejt Lindjes) do të ishte e mundur të zhvendoseshin më tepër drejt Selanikut se nga Shkupi, Bullgaria dhe pastaj në Turqi e më tej.

Nga ana tjetër, janë rritur presionet nga grupet e brendshme të interesave në Greqi për dhënien e statusit "të zonës së lirë" për portet e Igumenicës dhe të Patrës (veç porteve të Pireut dhe tre porteve të tjera në ishuj që e gëzojnë këtë status). Kjo do të përbënte dhe një tjetër faktor shtesë në rritjen e pozicionit konkurrues të këtyre dy porteve, në raport me portet e Vlorës dhe të Durrësit si "urat lidhëse" të Adriatikut.

VII. POZICIONI I ITALISË

Interesat italianë për Korridorin VIII mendoj se qëndrojnë në dy plane:

Së pari, në përfshirjen si pikënisje të këtij korridori jo të Durrësit/Vlorës por të Barit/Brindisit. Kjo nënkupton sigurimin e financimeve në kuadrin e këtij projekti për dy portet e tyre si ura lidhëse mbi Adriatik. Në këtë mënyrë, Italia siguron fuqizimin e të gjitha kanaleve të daljes drejt Lindjes (Koper, Rijeka, Durrës dhe Patra/Igumenicë).

Së dyti, financimi nga ana e Qeverisë Italiane i disa segmenteve rrugore të Korridorit Veri-Jug, duket se shpreh synimet gjeostrategjike për një prezencë në Ballkan, dhe veçanërisht në territoret me popullsi shqiptare. Portet shqiptare do t'i siguronin asaj daljen më të lehtë dhe të shpejtë në Shqipëri dhe në Kosovë. Veç kësaj, Porti i Vlorës mund të jetë dhe terminali kryesor për kalimin e tubacionit të naftësjellësit nga Burgas drejt Italisë dhe më tej në perëndim.

Duke u mbështetur në analizën e mësipërme mbi pozicionin e dy vendeve fqinje në raport me këtë korridor, mendojmë se duhen mbajtur parasysh dhe këto fakte:

Kundërshtimi nga pala bullgare për përfshirjen e segmenteve lidhëse të Korridorit VIII për në Greqi, ka për qëllim ruajtjen e pozitave të saj të privilegjuara në trafikun e mallrave nga portet shqiptare drejt tregut rus, por zgjidhja e propozuar nuk duket të jetë ekonomikisht e arsyeshme. Së pari, vendosja e Korridorit VIII mendoj se do t'i shërbente tranzitimit të mallrave kryesisht për në Turqi dhe më tej, në Azinë Qendrore dhe jo për në Rusi.

Duke parë hartën e korridoreve, shihet qartë se lidhja nga veriu dhe qendra e Evropës me tregun rus, sigurohet plotësisht me korridoret e tjera panevropiane. Është e vështirë, që mendimi racional ekonomik i operatorëve privatë të shfrytëzonte një tranzitim nga Evropa Veriore për daljen në tregun rus, nëpërmjet Korridorit VIII. Pra, është kryesisht aktiviteti i pritshëm tregtar për në Azi, që suporton idenë e këtij korridori. Ndërkohë, vetë Bullgaria ka siguruar një zgjatim të korridorit në kufirin e saj me Turqinë për në Aleksandropulos (pikë ku do të vendoset dhe terminali i gazsjellësit që vjen nga Burgas).

Por, nëse kundërshtimi bullgar është logjik nga këndvështrimi i interesave të tyre ekonomikë dhe konkurrencialë, a është logjik qëndrimi i palës shqiptare? Veç konsideratave politike, që shprehen në këtë shkrim, mendoj se duhen mbajtur parasysh dhe disa probleme ekonomike. Zgjatimi i Korridorit VIII për lidhje me Selanikun, do të thotë shtim i gjatësisë rrugore edhe me segmente të reja, me një gjatësi prej gati 80 km rrjet rrugor, që do të përkthehet në gati po kaq milionë dollarë investime. Kjo nga ana e saj, flet për më shumë mundësi ekonomike për këtë zonë.

VIII. AKTIVITETI I ORGANIZMAVE FINANCIARË EVROPIANË NË KORRIDORET PANEVROPIANE

Financimi i korridoreve panevropiane (IV, V, VIII dhe X) nga BERZH:

Vihet re se nga të gjitha korridoret, ai VIII ka tërhequr afër 5 për qind të totalit të financimit (103.1 milionë euro), ndërsa prioriteti kryesor i BERZH-it ka qenë financimi i Korridorit IV (me 725.7 milionë euro ose 36 për qind të totalit të financimeve të korridoreve); Korridorit V (me 620.7 milionë ose 31 për qind) dhe X (me 585.2 milionë ose 29 për qind).

Nga 1021 milionë euro (1993-1999) të dhëna për vendet e përfshira në korridoret përkatëse, financimet sipas shteteve kanë qenë:

Shtetet	Financimi total (1993-1999), milionë euro	Në %
Shqipëria	10	1
Bosnje-Hercegovina	32.7	3.2
Bullgaria	84.1	8.2
Kroacia	88.7	8.7
Republika Çeke	17.8	1.7
Hungaria	329.4	32.2
Maqedonia	9	0.9
Rumania	279.4	27.4
Republika Sllovake	15	1.5
Sllovenia	74	7.2
Ukraina	80.9	7.9
Totali	1021	100

Burimi: llogaritur mbi të dhënat e botuara nga EST-OVEST, NR.6, 1999.

Shihet se financimet e BERZH-it janë përqendruar më tepër:

- Në Korridorin IV, që kalon kryesisht në Evropën Qendrore (nga Republika Çeke, Hungari, Rumani dhe del në Bullgari duke devijuar për në Turqi dhe Greqi);
- në Korridorin V, që kalon në vendet që ndodhen në veri të vendit tonë (nga Kroacia, Sllovenia, Bosnja, me drejtim Budapest e më tej në Ukrainë); dhe
- në Korridorin X, që zbret nga Austria/Hungaria, në ish-Jugosllavi dhe dalje në Greqi, duke u bashkuar me rrugën Egnatia.

Financimi i BEI për Korridoret panevropiane, 1990-1999.

	Në milionë euro	Në përqindje
Korridori I	50	1
Korridori II	590	12
Korridori III	525	10
Korridori IV	1746	34
Korridori V	914	18
Korridori VI	400	8
Korridori VII	0	0
Korridori VIII	181	4
Korridori IX	54	1
Korridori X	641	13
TOTALI:	5101	100

Financimet e BEI në sektorin e transportit sipas vendeve: në milionë euro dhe në përqindje, për vitet 1990-1999.

	Në milionë euro	Në përqindje
Estonia	76	1.4
Letonia	62	1.2
Lituania	124	2.3
Polonia	1265	23.7
Republika Çeke	1160	21.7
Sllovakia	322	6
Hungaria	297	5.6
Sllovenia	615	11.5
Rumania	845	15.9
Bullgaria	381	7.2
Shqipëria	51	0.96
FYROM	130	2.44
TOTALI:	5328	100

Burimi: llogaritur mbi të dhënat e botuara nga EST-OVEST, NR.6, 1999.

Edhe në financimet e BEI, vërehet se prioritar ka qenë financimi i korridoreve IV, V dhe X.

Por, në përgjithësi vërehet dhe një aktivitet shumë i ngadaltë i vendit tonë me organizmat financiarë evropianë. Nga të dyja këto institucione, vendi ynë nuk ka tërhequr më shumë se 1 për qind të totalit të financimeve të tyre në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të përfshira në këto korridore.

IX. DISA KONKLUZIONE TENTATIVE

- Zhvillimet e ekonomisë së sotme botërore kanë bërë që konkurrenca të mos shtrihet vetëm midis vendeve apo shteteve të ndryshme, por dhe midis rajoneve. Në këtë kuptim, zhvillimi nuk mund të arrihet thjesht në kuadrin e luftës dhe të sloganeve politike apo dhe vetëm pragmatizmit politik kombëtar, por me studimin e kujdesshëm të shkallës së kompetitivitetit të vendit apo të rajonit. Vetëm mbi këtë bazë, pragmatizmi politik mund të orientohet dhe më mirë në shërbim të interesave të vendit.

Nga kjo pikëpamje, "fryrja" e opinionit të brendshëm mbi bazën e interesave kombëtarë, duket se bie në kundërshti me iniciativat rajonale, të inkurajuara dhe të përkrahura nga komuniteti ndërkombëtar, në kuadrin e nismës më të rëndësishme të tyre deri më sot, në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Do të ishte më e mençur që interesat kombëtarë të mos pështjelloheshin në zhurmën e shtypit, i cili i jep atyre dukjen e nxitjes së 'nacionalizmit shqiptar' (që më tepër është fals dhe i fryrë).

- Pragmatizmi politik nuk mund të nënkuptojë orientimin e drejtimeve të zhvillimit brenda "një korridori" të vetëm lëvizjeje, por një diversitet të tyre. Në këtë kuptim, lidhja "e linjës kryesore" të Korridorit VIII me anë të "një dege" me Selanikun, nuk do të nënkuptonte zhvendosje të vendit tonë nga korridori në fjalë dhe anashkalim të tij, por do të shërbente si "një valvol sigurimi" në aspektin politik dhe

një diversitet mundësish për lidhje dhe komunikim, që i ofrohet agjentëve ekonomikë.

Si mund të shpjegohet ndryshe, për shembull, fakti që Bullgaria me portet e saj të Varna dhe Burgas mund të ishte e pakonkurrueshme për daljen në Detin e Zi, pranon lidhjen e saj me portin e Selanikut, nëpërmjet zgjatimit të Korridorit IV; apo fakti që Shkupi vendos për dy degëzime të zgjatimit të Korridorit X në territorin e tij, duke u lidhur me rrugën Egnatia në Follorinë dhe me Portin e Selanikut. Vetë kompleksiteti i marrëdhënieve ndërmjet vendeve ballkanike, bëhet një faktor shtesë në favor të diversitetit të kanaleve të lidhjeve të rrjeteve rrugore që do të përshkojnë rajonin.

- Diplomacia politike shqiptare, veç njohjes së problemit dhe orientimit të diplomacisë ekonomike, duhet ta ndjejë veten *fort* si pjesë të kësaj të fundit. Do të ishte me shumë rëndësi që Ministria e Punëve të Jashtme të shfaqte në publik linjat e përgjithshme të gjeopolitikës ekonomike të vendit (për aq sa kjo është e domosdoshme dhe e rëndësishme për publikun), gjë që do të kontribuonte në qartësimin e një pjese "të mjegullnajës" që mbështjell çështjen e korridoreve në veçanti, dhe orientimin e lidhjeve ekonomike të vendit, në përgjithësi. Pa gjetjen e ekuilibrave dhe të kompromiseve mes vendeve të përfshira në këtë projekt, financimi i tij do të vazhdojë të zvarritet dhe më tej, gjë që nuk do të ishte aspak në dobi të vendit. Do të ishte prioriteti kryesor i diplomacisë tonë gjetja e rrugëzgjidhjeve më të përshtatshme në ndërtimin e aleancave me vendet e rajonit, me qëllim kapërcimin e mosmarrëveshjeve që janë krijuar.
- Forcimi i diplomacisë ekonomike ndoshta mund të nënkuptonte ose një ridimensionim të objektivave të politikës së jashtme dhe organizimin dhe angazhimin e Ministrisë së Jashtme në përmbushje të tyre, ose një rikonsiderim të varësisë së të ngarkuarve me problemet ekonomike të personelit të ambasadave tona jashtë vendit.
- Konfuzioni i krijuar rreth "çështjes së korridorit" është kontribut i mungesës së transparencës së qeverisë para

publikut. Këtu kanë kontribuar ndjeshëm edhe deklarimet kontradiktore të vetë anëtarëve të qeverisë, duke e emërtuar herë si "superstradë" (rrugë 2+2) dhe herë si "autostradë" (3+3). Nënshkrimi i marrëveshjeve të bëra nga disa ministra me qeveritë e vendeve fqinje (Greqi dhe Italí), nuk janë pasqyruar dhe analizuar nga autoritetet zyrtare në median e përditshme, për t'i dhënë publikut informacionin e nevojshëm për një çështje kaq kritike dhe të ndjeshme. Dhe më tej, duket se mungon impenjimi i strukturave përkatëse të qeverisë për t'u azhornuar me "diplomacinë" e këtij problemi. Kështu, nëse në burimet zyrtare italiane deklarohet se porta e korridorit fillon në Bari/Brindisi, autoritetet zyrtare shqiptare vazhdojnë të deklarojnë se porta e fillimit të korridorit është Durrësi/ Vlora. Mungesa e burimeve zyrtare të informacionit është faktori kryesor "i tymnajës" së krijuar në opinionin publik, por dhe i vështirësisë që ndeshin analistët për qartësimin e problemit.

- Megjithëse i deklaruar si prioriteti kryesor i qeverisë, duket se kjo e fundit ka qenë e paaftë në marrëdhëniet e saj me organizmat financiarë, gjë që vihet re nga nivelet minimale të financimeve të përfituara në raport me të gjitha vendet e tjera, të përfshira në rrjetet rrugore panevropiane.
- Edhe në financimet e siguruara, firmat e përzgjedhura në realizimin e segmenteve rrugore, kanë manifestuar vonesa të konsiderueshme në afatet kohore të punimeve. Kjo është në përgjegjësinë direkte të autoriteteve shtetërore kompetente, duke shprehur një indiferencë të pakuptimtë të tyre. Po kaq indiferencë duket se manifestohet dhe në thithjen e fondeve të angazhuara nga organizmat financiarë për këtë projekt. Bie në sy fakti që BEI ka deklaruar disa herë (biles, deri dhe në kërcënim) se Ministria e Transporteve nuk po tërheq fondet e akorduara për Portin e Durrësit. Heshtja e ministrisë përkatëse përballë deklaratave të tilla të bëra publike në shtyp, duket shumë e çuditshme.
- Ndërsa Qeveria Shqiptare nuk është në gjendje të diktojë diplomacinë evropiane e botërore në realitetet e sotme gjeopolitike, ajo që mund të bëhet është adoptimi i vendit ndaj këtyre realiteteve, me qëllim ruajtjen e pozitave

konkurrenciale të vendit në raport me rajonin. Në këtë kuptim, mendojmë se ndonëse konkurrentët më eminentë të porteve të Durrësit dhe të Vlorës janë portet e Igumenicës dhe të Patrës, zhvendosja e vëmendjes së opinionit publik tek "rreziku" që përbën Porti i Selanikut, mendojmë se nuk do të sjellë asnjë dobi për çështjen në fjalë. Por, ajo që mund të bëhet është dhënia e "një statusi ekonomik" më të privilegjuar për portet tona, siç mund të ishte dhënia e statusit të porteve të lira. Kujtojmë këtu se zonat përreth janë zhvilluar nga aplikimi i politikave të tilla (portet e Triestes, Pireut, Maltës etj.), gjë që vazhdon t'iu japë atyre një pozicion të favorshëm në raport me portet tona. Këtë lloj statusi po e kërkojnë dhe grupet e caktuara të interesave për portet e Igumenicës dhe të Patrës.

* Selami Xhepa, Specialist, Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve.

BIBLIOGRAFI

Achille Vinci Giacchi (ministër fuqiplotë; këshilltar diplomatik i Ministrit të Transportit dhe Lundrimit, Romë) "Il disegnio di una rete transeuropea di transporto", Est-Ovest, nr 6/1999.

Vincenzo Calogero, Stefano Martini, "La BERS e i corridori di transporto Pan-europei: il contributo dell'InCE", Est-Ovest, nr. 6/1999.

Walter Cernoia, Massimo Cingolani, "Prestiti Bei per lo sviluppo dei transporti in Europa centrale e orientale: il Corridoio V", Est-Ovest, nr. 6/1999.

ANEKSI 1

Linjat e korridoreve panevropiane:

Korridori I	Helsinki-Talin-Riga–Kaunas-Varshavë & Riga- Kaliningrad – Gdansk
Korridori II	Berlin – Varshavë – Minsk – Moskë – Nizhni Novgorod
Korridori III	Berlin/Drezden-Vriclav-Lvov-Kiev
Korridori IV	Berlin/Nuremberg/Drezden – Pragë- Bratislavë- Gyor- Budapest – Arad- Bukuresht- Kostanca/Kraiova – Sofie – Selanik/Plovdiv – Stamboll
Korridori V	Venecie-Trieste/Koper – Lubiana – Budapest – Uzgorod – Lvov+ Bratislavë – Zilina – Kosice – Uzgorod+ Ploce – Sarajevë- Osijek – Budapest
Korridori VI	Gdansk – Katovice- Zilina+Torun – Poznan
Korridori VII	Danub: gjithë portet e Danubit në EQL
Korridori VIII	Durrës- Tiranë – Shkup – Sofie + Plovdiv – Burgas- Varna
Korridori IX	Helsinki –Shën Petersburg – Moskë/Pskov – Kiev – Ljubasevka – Kishinau- Dimitrovgrad – Aleksandropuli+ Odesa – Ljubevska – Kiev – Minsk – Vilnius – Klaipeda/Kaliningrad
Korridori X	Salzburg – Lubjana – Zagreb – Beograd – Nish – Sofje – Velesh – Selanik + Budapest – Novi Sad – Beograd - Nish – Sofje – në korridorin IV për Stamboll + Velesh – Bitola – Follorinë – Via Egnatia

BUJQËSIA SHQIPTARE NË PERIUDHËN E TRANZICIONIT

*Luljeta File**

Fjalë kyçe
- Kuadër makroekonomik - Sektor bujqësor - Tranzicion - Reforma e tokës - Tregu i brendshëm - Krediti bujqësor -

1. KUADRI MAKROEKONOMIK DHE POLITIK I TRANZICIONIT NË SHQIPËRI

Krijimi i sistemit pluralist në Shqipëri në fillim të viteve 1990, shënoi fillimin e një periudhe tranzicioni, nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi tregu. Në këtë moment, mund të identifikohen të paktën tre faktorë për keqësimin e kushteve të jetesës së popullsisë në Shqipëri:

- Rritja e shpejtë e çmimeve të produkteve ushqimore, të cilat u liberalizuan në 1 gusht 1992. Kështu, deri në fund të 1992 kishte një rritje të çmimeve prej rreth 7 herë krahasuar me fundin e vitit 1990.
- Kolapsi total i prodhimit në sektorin agro-ushqimor në vitet 1990-1992, i cili preku prodhimin e të gjitha produkteve.
- Rreth 380000 familje fshatare, të cilat sapo morën tokën (përfaqësonin 46 për qind të familjeve shqiptare dhe 75 për qind të popullsisë rurale) kishin tani tendencën e prodhimit për konsum vetjak dhe jo për tregun. Kjo, për arsye të mungesës së transportit dhe për vështirësi në zhvillimin e aktivitetit bujqësor.

Në këtë periudhë, pati një tronditje të madhe në mentalitetin e ngulitur tek fshatari shqiptar për të qenë gjithmonë i lidhur me fshatin dhe me tokën. Paradoksi i kësaj situate qëndron në faktin se fshati shqiptar u gjend i braktisur, sidomos nga të rinjtë, pra nga krahu i punës, tamam atëherë kur fshatarët u bënë përsëri pronarë të tokës që punonin.

Si çdo zhvendosje masive e pamenduar dhe e jomirorganizuar e popullsisë së fshatit drejt qytetit apo vendeve fqinje, edhe kjo pati pasojat e veta negative në prodhimin bujqësor, në pakësimin e dëshirës për të punuar, në shpërfytyrimin dhe lënien pas dore të sipërfaqeve të tëra të sistemuara. Në këtë moment, një apel i fuqishëm për ndihmë ushqimore iu bë komunitetit botëror nga ana e Qeverisë Shqiptare[1].

Qeveria aplikoi masa jo shumë "popullore" siç ishte heqja e subvencionimit nga shteti për çmimet e produkteve ushqimore dhe e përfitimit të asistencës në masën 80 për qind të pagës për të papunët.

Ndër arsyet e domosdoshmërisë së aplikimit të këtyre masave mund të përmendim: uljen e shpenzimeve buxhetore, si edhe nxitjen e iniciativës private në sektorin bujqësor.

2. SEKTORI BUJQËSOR

2.1. VENDI I BUJQËSISË NË EKONOMINË KOMBËTARE

Shqipëria është dhe do të mbetet për një kohë të gjatë akoma, një vend ku bujqësia zë vendin kryesor në totalin e PBB. Në 10-vjeçarin e fundit, prodhimi bujqësor kundrejt totalit të PBB është luhatur nga 39,5 për qind në vitin 1990[2], në 52.9 për qind në vitin 1999.

Tabelë 1.

	1993	1995	1996	1997	1998	1999
Bujqësia në totalin e PBB	57.1	55.8	53.5	58	54.4	52.9

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave; Për 1993 World Bank, 1994, "Albania Building a new economy".



Kalimi në ekonominë e tregut, shpërbërja e kooperativave dhe e ndërmarrjeve bujqësore kërkoi një kuadër të ri rregullues. Sektori bujqësor, si pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare, kërkonte një transformim të shpejtë të legjislacionit në këtë fushë. Struktura e prodhimit në sektorin bujqësor sipas formës së pronësisë pësoi këto ndryshime:

Tabelë 2.

Sektorët	1990	1991	1992	1993 e në vazhdim
Sektori shtetëror	29	22	9	0
Sektori kooperativist	50	0	0	0
Sektori privat	21	78	91	100

Burimi: Buletini statistikor MBU.

Sipas statistikave më të fundit të INSTAT-it (prill 2000) vetëm 1,73 për qind e ndërmarrjeve aktive i takojnë sektorit bujqësor në Shqipëri.

3. KUADRI LIGJOR

3.1. REFORMA E TOKËS NË SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS 1990-2000

Reforma e tokës e vitit 1991, ishte më progresivja dhe më vendimtarja, për sektorin bujqësor dhe për ekonominë në tërësi, sepse sanksionoi pronësinë mbi tokën dhe pati

një ndikim shumë të rëndësishëm mbi bujqësinë. Reforma e vitit 1991 është rezultat i "Ligjit mbi tokën", miratuar nga Parlamenti Shqiptar, në korrik 1991. Parimet bazë të këtij ligji ishin:

a) Shkrirja e kooperativave dhe e ndërmarrjeve bujqësore dhe shpërndarja e tokës së tyre në mënyrë të barabartë midis banorëve të çdo fshati.
b) Nga ky ligj përfitonin të gjitha familjet fshatare të regjistruara si anëtare të kooperativave apo ndërmarrjeve bujqësore, deri në 31.07.90.
c) Toka që do të ndahej sipas dy parimeve të mësipërme nuk duhej ta kalonte sipërfaqen që dispononte çdo fshat dhe do të ndahej në mënyrë të barabartë, në përputhje me numrin e anëtarëve për çdo familje.
d) Toka i jepej fshatarëve falas, por ata nuk gëzonin pronësi të plotë pasi nuk kishin të drejtë ta shisnin, ta blinin, ta jepnin me qira apo ta linin peng.
e) Ndarja e tokës u bë nga komisione të përbëra nga fshatarë në fshatin ku do të zbatohej ligji. Në linjë vertikale këto komisione ishin të lidhura me komisionet rajonale dhe komisionin qendror kombëtar.
f) Ish-pronarët e tokës (të regjistruar si të tillë deri në vitin 1946 vit kur u krye reforma agrare) do të kompensoheshin në vlerë. Problemi i mënyrës së kompensimit u la për t'u vendosur në një fazë të mëvonshme.

Një varg amendamentesh e pasuan këtë ligj për të përsosur shpërndarjen dhe për të shmangur, sa më shumë që të ishte e mundur, problemet që dilnin gjatë aplikimit të tij.

Për sa i përket ndërmarrjeve bujqësore, privatizimi i tyre u bë me implementimin e ligjit për privatizimin e ndërmarrjeve bujqësore, të 1 gushtit 1992. Edhe ky proces u shoqërua me një varg problemesh lidhur me kompensimin e ish-pronarëve apo me mundësitë e kufizuara për punimin e tokës, si rezultat i mekanikës bujqësore tepër të pakët në numër. Kjo, solli si përfundim, rënien e prodhimit bujqësor për bimët e arave, të cilat kërkojnë më tepër edhe përdorimin e mjeteve të mekanizuara.

Siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme, rënia e prodhimit është më e dukshme pikërisht për këto kultura.

Vlera e prodhimeve kryesore bujqësore me çmimet e vitit 1994 jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 3.

Emërtimi	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Totali 1000 lekë	71602	84927	91985	104157	107224	95634	99027	102384
Blegtoria %	42	45	49	49	48	47	48	49
Bimët e arave %	52	49	45	45	46	46	45	44
Pemëtaria %	6	6	6	6	6	7	7	7

Burimi: Statistikat e MBU.

Grafik 2. Prodhimi bujqësor me çmimet e vitit 1994.



Në zbatim të ligjit të tokës u shpërndanë 375000 ha tokë nga të cilat u krijuan 400000 ferma të vogla private me sipërfaqe që varionte nga 0,6 - 3 ha për familje.

Kalimi nga një numër i kufizuar ekonomish bujqësore, të administruara në mënyrë të centralizuar, në një mori ekonomish tepër të vogla të administruara nga vetë fermerët, u shoqërua edhe me një varg problemesh të tjera strukturore e organizative.

Për shembull, le të marrim këtu në konsideratë administrimin e ujitjes pas kalimit nga 500 përdorues të mëdhenj në një numër 100-1000 herë më të madh përdoruesish. I njëjti problem shtrohej edhe për shërbimin veterinar apo për mekanikën bujqësore.

Gati një vit pas implementimit të ligjit të tokës, gati 80 për qind e tokës së kooperativave bujqësore ishte shpërndarë. Pas korrikut 1992 shpërndarja vazhdoi me ritme më të ngadalta, kryesisht si rezultat i numrit të madh të problemeve të krijuara.

Problem kryesor gjatë shpërndarjes së tokës ishte se një pjesë e popullsisë rurale nuk pranonte të merrte tokat e "ish-pronarëve", problem ky që ekziston edhe sot. Mund të thuhet se në gusht 1993, sipas vlerësimeve të dhëna nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, ishte shpërndarë rreth 91,5 për qind e tokës. Pjesa e pashpërndarë ishte kryesisht tokë e papunueshme dhe që komisionet e fshatrave dhe të zonave e vlerësuan si tokë, që nuk mund të shfrytëzohej nga familjet. Të dhënat zyrtare japin gjendje të ndryshme për zona të ndryshme të vendit.

Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin nr. 7699 , në 21 prill 1993 për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve.

Në 27 qershor 1995, u miratua ligji për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve e kullotave. Ky ligj, pati për qëllim rregullimin juridik të transferimit (blerjen dhe shitjen) të pronësisë mbi tokën bujqësore, livadhet e kullotat.

Sot, askush nuk beson se miratimi i një ligji të tillë sjell një eksod rural masiv dhe një mospërdorim të tokës bujqësore.

Përveç tokës, problem të vështirë për t'u zgjidhur përbënte edhe ndarja e aseteve të tjera të kooperativave, SMT-ve apo NB-ve. Në aplikimin e kësaj shpërndarjeje nuk pati problem për asetet me vlerë të vogël, të cilat sipas ligjit iu dhanë atyre që i kishin përdorur më parë. Ndërsa për sa i takon aseteve me vlerë të madhe ndodhi e kundërta; ato edhe u shkatërruan fizikisht për të mos u marrë nga një person i vetëm.

Në 21 dhjetor 1995, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin për rregullimin ligjor të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve shtetërore, familjeve që e kishin në përdorim.

Në 23 prill 1998 u miratua ligji i transferimit të pronësisë të tokës bujqësore, livadheve, kullotave dhe pyjeve, ndërsa në 30 prill 1998 u miratua ligji i dhënies me qira të huajve për 30 –99 vjet (sipas aktiviteteve të ndryshme investuese) i tokës bujqësore në pronësi të shtetit.

Në Shqipëri akoma nuk ekziston një treg real për qëllime bujqësore. Nuk ekzistojnë të dhëna lidhur me sipërfaqen dhe çmimin e shitjes të tokës bujqësore. Aktet e shitblerjes të tokës bujqësore deri tani janë vënë re në: zonat pranë Tiranës, pranë rrugëve të hyrjes për në Tiranë, pranë zonave turistike. Sipërfaqet e shitura nuk janë përdorur më si tokë bujqësore, por për ndërtime dhe për vendosjen e industrive. Çmimi i shitjes së tokës bujqësore ka variuar nga 8 në 12 usd/m^2.

Ka edhe raste të qiradhënies për qëllime bujqësore (për prodhimin e farërave apo kulturave intensive) për periudha nga 1-3 vjet me një pagesë 150-250 usd/ha, sipas cilësisë së tokës, nivelit të ujitjes etj[3]..

Regjistrimi i zonave kadastrale pritet të përfundojë nga fundi i vitit 2001.

4. RIORGANIZIMI I SHËRBIMEVE NË BUJQËSI

Struktura e re e tokës ndryshoi edhe mënyrën e përdorimit të elementeve të tjera lidhur me të. Shërbimet e ndryshme si ujitja, shërbimi veterinar, higjiena, kontrolli sanitar dhe krediti bujqësor, që më parë administroheshin në mënyrë të centralizuar nga shteti, tani duhet të administroheshin nga individët dhe të viheshin në shërbim të një ekonomie bujqësore tepër të copëzuar.

4.1. UJITJA

Në vitin 1991, para modifikimit të strukturës së tokës, sipërfaqja totale e ujitshme arrinte 423000 ha, që përbënin

60 për qind të tokës së punueshme, duke kontribuar në 80 për qind të prodhimit bujqësor të vendit. Gjatë periudhës së turbullt në vitin 1991 shumë stacione pompimi dhe kanalizime u shkatërruan. Mungesa e mirëmbajtjes dhe dëmtimi i sistemit të ujitjes çuan në një humbje në vitin 1992, të 89000 ha toke të ujitshme.

Në fakt, krijimi i fermave të vogla solli dy probleme kryesore:

- fermerët nuk kishin ndonjë ide mbi mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemit ujitës;
- struktura e re e tokës kërkonte një strukturë alternative edhe për shpërndarjen e ujit.

Pasojë e kësaj gjendjeje në sistemin e ujitjes ishte edhe rënia e prodhimit bujqësor, që vihet re në vitet 1992, 1993.

4.2. MEKANIZIMI

Shumë nga inputet e prodhimit bujqësor si farërat, plehrat dhe pesticidet shpërndaheshin kryesisht nga agjenci shtetërore. Ristrukturimi i sektorit bujqësor ndikoi edhe mbi përdorimin e mekanikës bujqësore, veçanërisht nisur nga fakti që mekanika ekzistuese ishte në përshtatje me sipërfaqet e mëdha të kooperativave apo fermave shtetërore dhe nuk i korrespondonte nevojave të fermave të vogla.

Mekanika e rëndë bujqësore ishte e përqendruar kryesisht në SMT-të. Kur këto të fundit u privatizuan, sipas ligjit, mjetet i morën në pronësi ata që i kishin përdorur deri në atë moment. Deri në mars të vitit 1993, rreth 5350 traktorë nga SMT-të ose rreth 50 për qind e totalit për Shqipërinë, u bënë pronë private.

Puna për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre tani kryhet nga firmat private.

Meqenëse SMT-të ndodheshin kryesisht në zona të ulta edhe pas privatizimit nuk u zgjidh problemi i shpërndarjes gjeografike të tyre.

Evolucioni i numrit të mjeteve të mekanikës bujqësore në 5 vitet e fundit paraqitet si vijon:

Tabelë 4.

Pajisjet	1995	1996	1997	1998	1999
Traktorë me zinxhir	1440	1209	1018	1025	1008
Traktorë me rrota	7498	7104	6892	7125	7252
Mbjellëse	1462	1515	1519	1548	1652
Motokorrëse	132	129	149	198	294
Autokombajna	817	801	783	802	760

Burimi: Buletini statistikor i MBU 1999.

4.3. ASISTENCA TEKNIKE DHE KONTROLLI VETERINAR

Shërbimet e tjera bujqësore si ai këshillimor dhe veterinar pas privatizimit kryhen me pagesë. Shërbimet veterinare, ndër të tjera, duhet të përgjigjen edhe për parandalimin e sëmundjeve të rënda në blegtori si edhe për kontrollin sanitar në thertore, fabrikat e prodhimit të sallamrave apo në treg. Shpërndarja e blegtorisë fermerëve, krijoi probleme për veterinerët, të cilët për të kryer punën e tyre tani duhet të lëvizin nga njëra fermë në tjetrën. Kjo vështirëson, gjithashtu edhe dhënien e informacionit dhe trajnimin e fermerëve. Ligji mbi organizimin e shërbimit veterinar (ligji nr. 7630) u miratua në 23 tetor 1992.

4.4. KREDITI BUJQËSOR

Në periudhën 1990-1992, politika e kreditit bujqësor mbështeti aktivitetin e një numri të madh fermerësh të rinj, të cilët sapo kishin marrë në pronësi tokat e tyre. U akorduan kredi në shuma të vogla për blerjen e krerëve të blegtorisë, të farërave etj.. U desh të veprohej me një numër tepër të madh kreditorësh, një pjesë e të cilëve janë edhe sot klientë të vështirë, pasi nuk kanë kthyer kreditë e marra.

Në periudhën 1992-1995, sektori bujqësor u financua nga dy burime kryesore:

- fondet e Bankës Tregtare Agrare; dhe
- fondet e donatorëve të ndryshëm, që me anën e programeve të tyre kanë financuar dhe vazhdojnë të financojnë bujqësinë shqiptare. Ndër projektet më të rëndësishme, për këtë periudhë, vlejnë të përmenden ato të Bankës Botërore për rregullimin e sistemit të kreditit bujqësor, të Bankës Evropiane (projekti Phare) si edhe të Bankës Gjermane për Zhvillim. Në periudhën 1992-1993, politika e kreditit bujqësor mbështeti kryesisht mekanizimin në bujqësi, që përbënte një nevojë jetike për bujqësinë e asaj kohe nisur nga fakti, që theksuam edhe më sipër që mekanika ekzistuese përveç që ishte e papërshtatshme për fermat e vogla të krijuara ishte edhe tepër e kufizuar, dhe nuk mund t'i përgjigjej në kohë nevojave të fermerëve të rinj.

Në periudhën 1993-1995, ndër të tjera, theksi u vu në mbështetjen me kredi të aktiviteteve të industrisë agroushqimore. Kreditimi për këtë sektor u bë nga Banka Tregtare Agrare, Banka Kombëtare Tregtare si edhe nga donatorë të ndryshëm. Normat e interesit për kreditë e dhëna lëvizën nga 40 për qind, në vitin 1992 (1-vjeçare) në 17 për qind, në vitin 1995. Procedurat e kreditimit kanë evoluar së bashku me zhvillimin e mentalitetit të fermerëve. Në vitin 1992 procedurat e dhënies së kredisë ishin tepër të thjeshta, ndërsa pas vitit 1995 ato filluan të reflektojnë një përmirësim të kuadrit legjislativ. Kreditë e akorduara nga Banka Tregtare Agrare për periudhën 1992-1995 paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 5 (në mijë lekë).

Emërtimi	1992	1993	1994	1995
Sektori privat	638 159	2 780 299	2 479 662	1 545 169
Nga të cilat në %:				
Agro-biznes	25.3	12.1	9.8	12.2
Industria përpunuese	3.8	1.9	1.5	6.1
Mjete të mekanikës bujqësore dhe transporti	17.7	16.5	21.9	11.4
Tregtimi i inputeve bujqësore	0	4.2	7.8	10.2
Tregtim produktesh	41.8	45.9	46.2	54.8

Ndërtim	4.4	0.008	1.9	1.0
Të tjera	7	19.4	10.9	4.3

Burimi: Raporti statistikor 1995, Banka Tregtare Agrare.

Eksperienca shqiptare provoi domosdoshmërinë e shoqërimit të tranzicionit ekonomik me reforma institucionale. Reforma e sistemit financiar në përgjithësi dhe e sistemit bankar në veçanti, ka patur një progres mjaft të ngadaltë. Rezultat i parë i prekshëm në drejtim të privatizimit të bankave në Shqipëri është likuidimi i Bankës Tregtare Agrare, e cila u parashikua të mbyllet në dhjetor 1997. Në tremujorin e parë të vitit 1998, u miratua edhe likuidimi i saj. Në korrik 1998, kësaj banke iu hoq licenca. Një pjesë e aktivitetit të BTA u kalua në Bankën e Kursimeve dhe pjesa tjetër, Agjencisë së Trajtimit të Kredive.

5. TREGU I BRENDSHËM DHE I JASHTËM I PRODUKTEVE BUJQËSORE NË PERIUDHËN 1990-2000

5.1. TREGU I BRENDSHËM

Kalimi drejt ekonomisë së tregut dhe shpërndarja e tokës fermerëve, krijuan kushtet për nxitjen e fermerëve për të prodhuar, jo vetëm për nevojat e familjeve të tyre, por edhe për treg. Aktualisht, tregu është i furnizuar nga një numër i madh prodhuesish të vegjël, me një numër të kufizuar prodhimesh në sasi të vogla.

Sipas një anketimi të Bankës Botërore rreth 1/3 e fermerëve prodhojnë akoma për vetkonsum.

Fermerët privatë nuk janë akoma në gjendje të lidhin kontrata tregtimi. Për shumicën e prodhimeve nuk ekzistojnë akoma struktura të shitjes me shumicë dhe me pakicë. Informacioni mbi tregun është akoma i pamjaftueshëm. Në tërësi, mund të thuhet se marketingu i produkteve bujqësore mbetet akoma i pazhvilluar.

Konkurrenca e prodhimeve të importuara është shumë e fortë për fermerin shqiptar.

Çmimet mesatare të shitjes me pakicë të disa prej produkteve bujqësore dhe agroushqimore, për periudhën 1994-1999 paraqiten si më poshtë:

Tabelë 6.

Emërtimi	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Mish viçi	228.5	251.7	297.7	384.3	583.0	584.3
Djathë i bardhë	194.1	197.9	222.8	261.0	333.0	331.8
Gjalpë	203.8	235.5	336.2	420.9	547.0	549.1
Miell gruri	31.4	31.9	46.4	61.8	66.0	60.3
Bukë e bardhë	25.9	27.8	37.8	56.7	64.0	62.8
Patate	35.1	36.5	36.8	50.2	55.0	55.3
Mollë	53.6	61.4	71.8	83.0	100.0	112.5
Fasule	68.5	113.7	93.8	101.4	193.0	167.9
Domate	75.8	75.7	96.8	117.6	142.0	146.2
Vaj vegjetal	105.6	110.3	121.8	171.3	193.0	169.4

Burimi: INSTAT dhe statistikat e MBU.

Grafik 3. Evolucioni i çmimeve.



5.2. TREGU I JASHTËM

Eksporti

Produktet bujqësore kanë zënë gjithnjë një vend të rëndësishëm në strukturën e eksporteve shqiptare, si para Luftës së Dytë Botërore ashtu edhe deri në fund të viteve 1980. Kështu, në vitin 1992 pjesa e eksporteve bujqësore në totalin e eksporteve të vendit ishte rreth 38,4 për qind. Rritja e peshës specifike të

eksporteve bujqësore ndaj totalit të eksporteve i detyrohet edhe uljes së eksporteve nga sektorë të tjerë, si rezultat i ndryshimeve të viteve 1990. Brenda vetë produkteve bujqësore të eksportuara, peshën specifike më të madhe e kanë zënë vazhdimisht duhani dhe produktet e tij (deri në 60 për qind), ndërsa produktet e agroindustrisë zënë vetëm deri në 40 për qind të eksporteve bujqësore e ushqimore (në vendet e Komunitetit Evropian kjo strukturë është e përmbysur: 30 për qind janë lëndë të para dhe 70 për qind produkte bujqësore të përpunuara).

Destinacioni i produkteve të eksportuara kanë qenë kryesisht vendet e Evropës Lindore. Vendet e Komunitetit kanë blerë kryesisht bimët mjekësore dhe esencat etero-vajore.

Tabelë 7 (në mijë lekë).

Emërtimi	1995	1996	1997	1998	1999
Eksporte gjithsej	1742312	3685489	4252699	4947023	3877257
Bujqësia	961047	1559048	2312778	2411208	1639694
Blegtoria	164135	5974	284715	179218	8783
Agroindustria	145238	1467383	1365783	1938630	1825035
Peshkimi	471892	653084	289423	591507	403745

Burimi: INSTAT, Buletini statistikor i MBU;

Shpërndarja gjeografike e eksporteve bujqësore si edhe e gjithë eksporteve të tjera në Shqipëri deri në vitin 1990 ka qenë kryesisht me vendet e Evropës Lindore, ndërsa sot ajo kryhet në masën më të madhe me vendet e Evropës Perëndimore, kryesisht me vendet fqinje. Rreth 36 për qind e eksporteve bujqësore në vitin 1998 u zhvilluan me Greqinë dhe rreth 19 për qind me Italinë.

Tabelë 8 (në mijë lekë).

Shtetet	1950	1960	1970	1980	1990	91-93	1994	1995	1997	1998
Evropa Lindore	100	93.4	56.0	40.8	46.6	...	...	6.2	10.9	...10.5
Vendet e industrializuara		1.0	13.1	37.7	37.9	...	89.0	75.2	84.8	83

Burimi:Statistikat e MBU.

Importet

Importet bujqësore të periudhës 1990-1999 përbëhen kryesisht nga gruri, misri, orizi, sheqeri, mielli, vaji si edhe

shumë produkte të tjera të freskëta jashtë stinës. Nga të dhënat e deritanishme nuk ka të ngjarë që kjo strukturë të ndryshojë në të ardhmen e afërt.

Tabelë 9 (në mijë lekë).

Emërtimi	1995	1996	1997	1998	1999
Importe gjithsej	17244834	33004970	28309735	37101799	33215102
Bujqësia	2800559	8466702	6150740	9437549	7804926
Blegtoria	3277180	2404074	2652239	3769182	4014509
Peshkimi	104109	345230	309938	603152	533826
Agroindustria	11062986	21788964	19008998	23269069	21006444

Burimi: INSTAT, Buletini statistikor i MBU; Përpunimi L. File.

Siç shihet importet bujqësore janë rreth 10 herë më të mëdha se eksportet bujqësore në shifra absolute.

Duke filluar nga janari i vitit 1990 deri në vitin 1993 ndihmat e komunitetit ndërkombëtar, kreditë e huaja për blerje ushqimesh, kryesisht nga vendet e BE *(në tërësi importet e tregtueshme)* kanë përbërë deri në 80 - 90 për qind të konsumit ditor në ushqime të shqiptarëve.

Në gusht të vitit 1991, një vendim i qeverisë liberalizoi tregtinë e jashtme. Para fillimit të reformave ekonomike të vitit 1992 ekzistonin ndërmarrjet e tregtisë së jashtme (EKSIMAGRO, AGROEKSPORT, ALIMPEKS) strukturat e vetme, që kishin raporte me tregun e jashtëm të produkteve bujqësore. Ato praktikonin çmime fikse, pa asnjë lidhje me kursin ndërkombëtar dhe çmimet në tregun e jashtëm. Buxheti i shtetit përfitonte të ardhurat dhe mbulonte humbjet, që vinin nga tregtia e jashtme e produkteve bujqësore. Me fillimin e reformave në vitet 1992 – 1993, këto ndërmarrje fillimisht kaluan në ndërmarrje me vetëfinancim dhe sot ato janë në rrugën e privatizimit të plotë.

Tregtia e jashtme e produkteve bujqësore do të përfitojë mjaft nga përmirësimi i linjave të transportit sipas projekteve të fundit në rajon.

Tregjet e Evropës Perëndimore, të furnizuara mirë me produkte cilësore, do të jetë e vështirë të hapen për produktet e bujqësisë dhe të agroindustrisë shqiptare.

Potencialet e Shqipërisë në eksporte bujqësore janë të kufizuara si rezultat i:

a) një mungese totale të kushteve të tregtimit (magazinimi, përpunimi, ruajtja, paketimi etj.);
b) standardeve të ulta në lidhje me kontrollin e ushqimeve apo dhe kontrollin veterinar;
c) ekzistencës së fermave me sipërfaqe tepër të vogël (prodhojnë kryesisht vetëm për vetkonsum).

Në kuadrin e procesit të integrimit të Shqipërisë në OBT (negociatat dypalëshe u mbyllën gjatë vitit 1999) politikat tregtare në Shqipëri janë nga më liberalet, krahasuar me të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Për sa i takon nivelit të tarifave:

1. Asnjë produkt bujqësor nuk ka mbështetje financiare dhe nuk ekzistojnë çmime minimale të garantuara.
2. Nuk ka subvencionime për çmimet e inputeve apo të shërbimeve bujqësore.
3. Importi i të gjitha produkteve ushqimore është i liberalizuar dhe nuk ka kufizime për importet (niveli maksimal i tarifave doganore është prej 18 për qind), dhe nuk ka subvencione për produktet e eksportuara.

Në përfundim mund të theksohet se bujqësia do të vazhdojë të mbetet edhe për një kohë të gjatë, dega kryesore e ekonomisë shqiptare. Duke dalë nga ekonomia e centralizuar, ku çdo aktivitet ekonomik kontrollohej nga shteti dhe ku dominonte vetëm ekonomia e mbijetesës, si dhe nga situata e mungesave të mëdha të mëpastajme, objektivat e politikës bujqësore janë të qartë: *Prodhimi bujqësor duhet të rritet në sasi e cilësi, për të plotësuar nevojat e tregut të brendshëm e, gjithashtu, edhe për të eksportuar*. Slogani politik me të cilin nisën reformat ekonomike në vitin 1992 ishte "Të shkojmë drejt Evropës!", e rëndësishme mbetet të përcaktohen rrugët për të arritur këtë qëllim edhe në sektorin bujqësor.

BIBLIOGRAFIA

Buletini statistikor MBU 1996, 1997, 1998, 1999.

Option méditerranéennes: "L'Albanie une agriculture en transition"Ciheam Paris 1997.

"The Albanian Agro-Food system in economic transition", OCDE Paris 1995.

Bujqësia dhe industria ushqimore, MBU 1993.

The World Bank Atlas 1991.

M. Sivignon, O. Deslondes "Lágriculture Albanaise: de la coopérative à léxploitation de survie"Paris 1994.

Albanian human development report 1996, UNDP.

I. Beka, "Agricultural, trade and cooperation in South Eastern Europe", East – Ovest N.2, Studi e ricerche, Trieste 2000.

ANEKS

Projektet e huaja në bujqësinë shqiptare.

Institucioni financues/Shteti	Sektorët & Projektet	Shuma (milionë usd)	Kohëzgjatja (vite)	Data e fillimit
Banka Botërore	Projekti mbi importet kritike	53	3,5	Qershor 1992
	Ristrukturimi i sektorit bujqësor	55	3	Nëntor 1993
	Lehtësimi i varfërisë bujqësore	6,7		Prill 1993
	Projekti i zhvillimit bujqësor	12		1993
	Rehabilitimi i sistemit të ujitjes	44,1	6	Nëntor 1994
	Projekti i zhvillimit të agroindustrisë	7	3	Shkurt 1996
	Projekti i rrugëve rurale	34	3	Tetor 1995
	Projekti i pyjeve	21,6	6	Qershor 1996
BE	Phare 1992	18,34		
	Phare 1993	12,1		
	Phare 1994	6,05		
IFAD	Zhvillimi i zonës verilindore	254		
	Rehabilitimi i sistemit të ujitjes	9,64		
FAO	Forcimi i kapacitetit institucional të MBU	3,019	4	1992
	Asistencë për prodhimin bujqësor në Shqipëri	7,5	3	1995
USAID	Marketingu i plehrave	33,32		
	Projekti SARA		4	1994
Austri	Mbështetje fermerëve Skrapar	0,77	3	1993
Holandë	Zhvillimi bujqësor në rajonin e Fierit	3,4	1	1996
	Përmirësimi gjenetik i gjedhëve	0,545	3	1992
Itali	Mekanika bujqësore, përpunimi i qumështit, bashkëfinancim në projektin e ujitjes	22,74		
Gjermani	Mekanika bujqësore fabrika e qumështit "AJKA" Zhvillimi rural. Mbështetje për shkollat bujqësore	31,47		
Greqi	Furnizimi me traktorë dhe furra buke industriale	11,54		

Burimi: "Lálbanie une agriculture en transition", CIHEAM, Paris 1997.

SHËNIME

* Luljeta File, Specialiste, Departamenti i Kërkimeve dhe Publikimeve.

[1] Nga qershori i vitit 1991 deri në fillim të vitit 1993 shuma totale e ndihmës së dhënë nga ky komunitet arriti 900.000 usd.

[2] "The World Bank Atlas 1991" dhe "Albanian human development report 1996".

[3] Deri në vitin 1999 nuk ka të dhëna lidhur me numrin dhe sipërfaqen e dhënë me qira.

SHKURTIMISHT SISTEMI BANKAR SHQIPTAR PËR VITIN 1999

Miranda Ramaj
*Vjollca Berberi**

Fjalë kyçe
- Sistem bankar - Privatizim - Banka e Kursimeve - Kapital privat -

1. TIPARE TË PËRGJITHSHME TË SISTEMIT BANKAR NË VITIN 1999

Struktura e sistemit bankar shqiptar, gjatë vitit 1999, është përmirësuar ndjeshëm në favor të aktivitetit bankar privat. Tre banka të reja me kapital privat: Banka FEFAD, Banka Ndërtregtare dhe Dega Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve filluan aktivitetin e tyre.

Kështu, numri i bankave të përbashkëta dhe private arriti në 11 ndër 13 banka gjithsej në sistemin bankar shqiptar.

Shtimi i numrit të tyre ka rritur konkurrencën në tregun bankar. Për herë të parë, bankat me kapital privat dhe degët e bankave të huaja, e shtrinë gjeografikisht rrjetin e tyre edhe në rrethe të tjera të vendit. Deri në vitin 1998 vetëm bankat shtetërore kishin shtrirje në disa rrethe të vendit, si dhe Banka Tirana me dy degë, në Durrës e Fier. Bankat e tjera private që u hapën e përqendruan aktivitetin e tyre vetëm në Tiranë.

Në momentin kur po flasim Banka FEFAD ka dy degë në Fier e Durrës; Banka Italo-Shqiptare 1 agjenci bankare në Durrës;

Banka Kombëtare Greke 2 agjenci bankare, në Durrës dhe në Korçë.

Bankat private dhe degët e bankave të huaja kanë filluar t'i konkurrojnë bankat shtetërore në cilësinë e shërbimeve dhe llojshmërinë e produkteve që ofrojnë.

Kapitali i paguar i këtyre bankave zë 47,6për qind të kapitalit të sistemit bankar, nga 26,1për qind që zinte në vitin 1998.

Gjatë vitit 1999 ka vazhduar procesi i privatizimit të bankave shtetërore, që për pasojë, ka kufizuar aktivitetin e tyre. Kjo ka çuar në rritjen e peshës së bankave private, duke u bërë një tjetër faktor mbështetës i rritjes së konkurrencës në tregun bankar.

Për Bankën Kombëtare Tregtare janë përcaktuar aksionerët e rinj: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporata Ndërkombëtare Financiare (e cila bën pjesë në grupin e Bankës Botërore) dhe Kent Bank (bankë private turke); është nënshkruar marrëveshja e shitjes së aksioneve midis Ministrisë së Financave dhe aksionerëve të rinj. Pritet që brenda vitit 2000, Banka Kombëtare Tregtare, të ketë kaluar totalisht në duart e aksionerëve të rinj, të jetë bërë pagesa e kapitalit dhe banka të veprojë në treg si një bankë private, duke ruajtur edhe vendosjet e saj në rrethet e tjera të vendit.

Banka e Kursimeve po ristrukturohet duke u përgatitur për procesin e privatizimit.

Hyrja në treg e bankave të reja me kapital privat, ka ndryshuar ndjeshëm sjelljen e tregut bankar në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve bankare; privatizimi i bankave shtetërore do të ndryshojë përfundimisht mentalitetin e publikut shqiptar, për të besuar tek institucioni i ri - bankë pa pronar shtetin -.

Pra, në fund të dhjetëvjeçarit të transformimeve të tij të mëdha, sistemi bankar shqiptar, që numëron në përbërje të tij 13 banka nga të cilat 11 janë banka të përbashkëta dhe private; ka marrë përsipër të ndryshojë shijen e hidhur që ngjarjet e '97 bënë të

shoqërojnë shumë shpesh emrat e bankave shqiptare; hodhi hapa të sigurt në ndryshimin e psikologjisë dhe qëndrimit të opinionit shqiptar dhe të huaj ndaj bankave shtetërore, duke përfunduar privatizimin e njërës prej bankave më të mëdha të deritanishme shtetërore (Bankës Kombëtare Tregtare). Mbetet që projektet e guximshme të vitit në vazhdim, t'i shërbejnë rritjes së besimit të publikut tek bankat dhe përmirësimit të marrëdhënies së vendosur midis tyre.

2. PRIVATIZIMI I BANKËS SË KURSIMEVE

Procesi i privatizimit të bankave shtetërore ka filluar që në vitin 1995, me miratimin e ligjit nr. 8033, datë 16.11.1995 "Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre". Mbi bazën e këtij ligji, u hartua dhe miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 23.9.1996 "Strategjia e privatizimit të bankave tregtare shtetërore". Strategjia përcakton si qëllim të këtij procesi përsosjen e sistemit bankar dhe krijimin e një sistemi bankar efektiv, të qëndrueshëm dhe të shëndoshë financiarisht, që të jetë një mbështetje për rritjen e shpejtë ekonomike të vendit. Objektiv i qeverisë, siç është shprehur në strategji, përcaktohet "shitja e bankave shtetërore investitorëve strategjikë duke synuar një shpërndarje të gjerë të kapitalit, zhvillimin e tregjeve kombëtare të kapitalit, tërheqjen e investitorëve të huaj, mbrojtjen e interesave të klientëve të bankave dhe kalimin tërësor të tyre në duar të sektorit privat".

Strategjia përcaktoi përfundimin e privatizimit deri në fund të vitit 2000, si dhe metodat e shitjes dhe fazat e këtij procesi.

Mbështetur në bazën e mësipërme ligjore, Ministria e Financave ka marrë një numër vendimesh në lidhje me transformimin e bankave shtetërore në shoqëri tregtare dhe ristrukturimin e pjesës shtetërore të sistemit bankar.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", e në mbështetje të tij,

Banka e Shqipërisë bëri rilicencimin e bankave shtetërore, duke i vënë ato në kushte të barabarta me bankat e tjera që veprojnë në Shqipëri.

Përvoja e privatizimit të bankave shtetërore në vendet e Evropës Lindore, ka treguar se shteti megjithëse heq dorë nga pronësia mbi bankat tërësisht ose pjesërisht, përsëri vazhdon të jetë garant për investitorët e huaj, të paktën edhe për vitet e para pas privatizimit. Në këtë mënyrë, nxiten investitorët e huaj për t'u afruar. Një gjë e tillë iu sigurua edhe investitorëve të Bankës Kombëtare Tregtare me nënshkrimin e marrëveshjes "put option". Më tej, kjo do të ndikojë edhe në tërheqjen e investitorëve strategjikë në procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve.

Gjatë vitit 1998, u revokua licenca e Bankës Tregtare Agrare dhe pjesë të aktivit të saj u transferuan në bankat e tjera shtetërore, ndërsa asetet e këqija u transferuan tek Agjencia e Ristrukturimit të Kredive, e krijuar për këtë qëllim. Ky pakësim i numrit të bankave shtetërore, ndikoi në shkurtimin dhe përshpejtimin e procedurave për dy bankat e tjera.

Më kujdes duhet treguar me privatizimin e Bankës së Kursimeve, e cila është aktualisht banka më e madhe në sistemin bankar dhe me një shtrirje më të gjerë. Ajo është banka e vetme, që mbulon të gjitha veprimet e lidhura me buxhetin e shtetit dhe sistemin e pensioneve në Shqipëri, për shkak të shpërndarjes në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; mban 67.9 për qind të aktiveve totale të sistemit bankar në Shqipëri dhe 75 për qind të totalit të depozitave; zotëron 88,9 për qind të tregut të bonove të thesarit.

Në maj 1998, me asistencën e Bankës Botërore është firmosur kontrata e qeverisjes (dyvjeçare), me qëllim përgatitjen e bankës për ristrukturim/privatizim.

Gjatë kësaj periudhe, administrimi i Bankës së Kursimeve është asistuar në mënyrë të vazhdueshme nga këshilltarë të huaj (Bank of Ireland International Services Ltd.), në drejtim të:

(i) hartimit të një plani strategjik pesë-vjeçar;
(ii) hartimit të buxhetit vjetor të bankës;
(iii) krijimit të një sistemi informimi të administrimit;
(iv) përcaktimit të efektshmërisë së aktivitetit të degëve të veçanta;
(v) riorganizimit dhe saktësimit të funksioneve të departamenteve të drejtorisë së përgjithshme të bankës, sipas standardeve ndërkombëtare.

Por megjithatë, Banka e Kursimeve edhe gjatë kësaj periudhe vazhdon të mos plotësojë kërkesat e Bankës së Shqipërisë, si autoriteti mbikëqyrës në drejtim të kapitalit dhe të normave të tjera mbikëqyrëse. Kjo dhe qenia mbi 80 për qind të portofolit të kredive të këqija, e ka detyruar Bankën e Shqipërisë që të mos e lejojë Bankën e Kursimeve të zhvillojë aktivitetin kredidhënës.

Banka e Shqipërisë është e interesuar për përfundimin në kohë të procesit të privatizimit, pasi shtyrja e vazhdueshme e afatit të përfundimit të privatizimit të bankave shtetërore, ka efekte negative për vetë gjendjen e bankave, agonia e të cilave zgjatet duke rritur mundësinë për humbje të mëtejshme të vlerës së tyre, si dhe pengon zbatimin me efektivitet të politikës monetare. Gjithashtu procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve, si banka më e madhe e sistemit, që ka 75 për qind të depozitave të popullatës duhet të jetë sa më transparent për publikun në çdo fazë të tij. Të botohen ligji i formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve e vendimet e Këshillit të Ministrave, të debatohet në publik strategjia për ristrukturimin dhe privatizimin e saj etj.. Gjithashtu, miratimi i ligjit të garantimit të depozitave, do të krijonte siguri për publikun për depozitat e tyre, në mënyrë që gjatë procesit të privatizimit të mënjanohen ngjarje të tilla si tërheqja masive e depozitave për mungesë besimi, pasiguri etj., me pasoja për sistemin.

Banka e Shqipërisë ka luajtur rolin e këshilltarit në procesin e privatizimit të bankave shtetërore, ka dhënë mendimet dhe vërejtjet e veta për aktet ligjore dhe nënligjore, që janë nxjerrë për këtë qëllim; si ligji mbi formulën e privatizimit, vendime të ndryshme të Këshillit të Ministrave, duke bashkëpunuar

ngushtësisht me Ministrinë e Financave dhe me Bankën Botërore.

Rritja e numrit të bankave private dhe vazhdimi i procesit të privatizimit, kanë ndikuar disi në pozitat e monopolit të Bankës së Kursimeve në sistemin bankar, pasi:

- privatizimi i BKT do të sjellë riaktivizimin e saj për të rimarrë pozitat e humbura në treg;
- shtimi i numrit të bankave të reja, ekspansioni i tyre në depozita, në kredi, në tregun e bonove të thesarit, tërheqja e klientëve nëpërmjet cilësisë së shërbimeve dhe futjes së shërbimeve të reja, zgjerimi i numrit të degëve të bankave të huaja, 10 degë për vitin 2000 dhe 8 për vitin 2001 etj.;
- procedura e privatizimit step vetvetiu aktivitetin e bankës, ajo nuk mund të jetë më agresive, ulja e *yeild*-it të bonove të thesarit do t'i bëjë më agresive bankat e tjera;
- si pasojë e procesit të privatizimin do të ketë një kufizim të Bankës së Kursimeve në kreditim, investime, teknologji etj.;
- buxheti duhet të fillojë të kalojë pjesë-pjesë kryerjen e veprimeve të tij në banka të tjera, që mund të realizohet me tender ose me kushte më të mira.

Autoritetet shqiptare janë deklaruar për privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe kanë shprehur qartë interesin e tyre për zhvillimin e procesit të privatizimit të bankave me kapital shtetëror. Çdo vonesë në të krijon probleme për bankat, për tregun bankar dhe për politikën monetare, duke u bërë njëkohësisht edhe qendër e debateve politike.

Pas miratimit të ligjit "Për formulën e privatizimit të Bankës së Kursimeve", por në zbatim të tij Këshilli i Ministrave do të nxjerrë akte të tjera nënligjore, që do t'i shërbejnë procesit të privatizimit.

Në këtë fazë, nisur nga eksperienca e BKT janë hartuar edhe hapat e mëtejshëm të këtij procesi.

Programi i hartuar nga qeveria në bashkëpunim me Bankën Botërore përmban këto afate:

1. Shitja e BKT	Qershor 2000
2. Zgjedhja e këshilltarit për privatizimin	Fundi i prillit 2000
3. Përcaktimi i llogarive transparente në lidhje me rolin e njësive të BK si agjenci fiskale dhe të pagesave në favor të qeverisë	Dhjetor 1999
4. Analiza e aktivitetit fitimprurës të degëve të veçanta	Mars 2000
5. Forcimi i praktikave kontabile në gjithë BK duke përfshirë edhe kompjuterizimin	Qershor 2000
6. Mbyllja e degëve me humbje	
7. Qeveria do të bëjë tenderin për BK	Fund i shtatorit 2000
8. Zgjedhja e blerësit	Fund viti 2000

3. STRUKTURA E SISTEMIT BANKAR

Nisur nga origjina dhe pronësia e kapitalit të bankave dhe degëve të bankave të huaja, sistemi bankar do të paraqitej:

- 2 banka me kapital shtetëror (G1);
- 2 banka me kapital të përbashkët (shqiptar dhe të huaj) (G2);
- 6 banka me kapital privat të huaj (G3);
- 3 degë të bankave të huaja[1] (G3).

Këto grupe bankash kanë veçoritë e tyre që ndryshojnë me kohë.

Grupi i parë, i përbërë nga bankat tregtare me kapital shtetëror. Bankat përbërëse të këtij grupi vazhdojnë të jenë në procesin e privatizimit. Megjithë që aktiviteti i tyre gjatë procesit të privatizimit është kufizuar, përsëri ky grup nuk ka humbur pozicionin e tij monopol në treg.

Bankat e grupit të parë duke pasur këtë pozicion monopol në sistemin bankar konkurrojnë bankat e reja dhe, gjithashtu, pengojnë Bankën e Shqipërisë në zbatimin e standardeve të mbikëqyrjes bankare dhe krijojnë probleme për zbatimin e politikës monetare, sidomos në drejtim të prezantimit të instrumenteve indirekte. Privatizimi i bankave shtetërore pritet të

ndikojë në ndryshimin e kësaj strukture konkurrimi në treg dhe do të sjellë zhvillimin më tej të sistemit bankar.

Hyrja në treg e bankave të reja dhe e degëve të bankave të huaja si dhe kohëzgjatja e aktivitetit të tyre, disa prej të cilave kanë 3-4 vjet, ka bërë që pozicioni monopol i bankave shtetërore të ulet por kjo ulje është relativisht e vogël. Siç shihet edhe nga tabela:

Pesha e grupeve të bankave në sistemin bankar (në përqindje):

	G1		G2		G3	
Treguesit:	Dhjetor 1999	Dhjetor 1998	Dhjetor 1999	Dhjetor 1998	Dhjetor 1999	Dhjetor 1998
Totali i aktiveve	81.4	85.6	5.8	5.1	12.8	9.3
Totali i depozitave	84.8	91.3	4.6	3.5	10.6	5.2
Totali i kredive të dhëna	78.1	85.9	11.4	10.1	10.5	4.0
Totali i letrave me vlerë	95.9	98.3	0.8	0.6	3.3	1.1

Siç shihet kemi ulje të treguesve por kjo me ritme mjaft të ulta.

Grupi i dytë i bankave, bankat me kapital të përbashkët. Zënë rreth 6 për qind të sistemit bankar. Bankat e këtij grupi janë më të hershme nga bankat e tjera private, por gjatë viteve të para të aktivitetit këto banka u treguan shumë të tërhequra dhe numri i klientëve të tyre mbeti për disa vite i kufizuar.

Viti 1999 shënon një ndryshim në aktivitetin e tyre, një aktivizim në rritjen e numrit të klientëve, në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe kryesisht në rritje të shumës së kredisë së dhënë. Karakteristikë e këtyre bankave është se janë të kapitalizuara mirë dhe kapitali i tyre përbën rreth 38,1 për qind të kapitalit aksioner të sistemit bankar.

Ky grup bankash ka mbetur i pandryshuar si numër, si madhësi e kapitalit të paguar dhe pothuajse nuk ka ndryshim të rrjetit.

Grupi i tretë i bankave, bankat private dhe degët e bankave të huaja. Këto banka janë relativisht të reja.

Brenda këtij grupi, ku përfshihen 9 banka, ka banka që kanë 2-3 vjet që kanë marrë licencën dhe tani kanë filluar të zgjerojnë aktivitetin. Por, ka edhe banka që janë në vitin e parë të aktivitetit dhe janë në fazën e përshtatjes së tyre me tregun dhe të gjetjes së vendit të tyre në të.

Megjithatë, duket qartë se tendenca e tyre është zgjerimi i aktivitetit dhe rritja graduale e vendit që ato zënë në sistemin bankar. Pesha e tyre në sistem ka ardhur duke u rritur me një ritëm të shpejtë. Në vitin 1997 ato zinin 3,7 për qind të sistemit, në vitin 1998 pesha e tyre u rrit në 9.3 për qind dhe në fund të vitit 1999, arriti në 12,8 për qind të sistemit bankar.

Në rritjen e treguesve në këtë grup bankash, ka ndikuar jo vetëm rritja e numrit të bankave nëpërmjet hyrjes së bankave të reja, por edhe zgjerimi i veprimtarisë së atyre ekzistuese.

Kështu, totali i bilancit në këtë grup bankash krahasuar me një vit më parë është rritur 68 .8 për qind. Në këtë rritje, 45.7 për qind ka ardhur si rezultat i rritjes së aktivitetit të bankave ekzistuese dhe 23.1 për qind ka ardhur si pasojë e fillimit të aktivitetit të bankave të reja.

Karakteristikë e bankave të G2 dhe G3 është se ato kryesisht aktivitetin e tyre e zhvillojnë në monedhë të huaj. Kështu, totali i bilancit në monedhë të huaj kundrejt totalit të bilancit gjithsej për G2 përfaqëson 93,3 për qind ndërsa ky tregues për G3 rezulton 81,7 për qind.

4. MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si një tregues cilësor i qëndrueshmërisë së sistemit bankar, ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 1999.

Për herë të parë, mbas disa viteve, ai është në vlera pozitive prej 8,2 për qind nga – 1,8 për qind të rezultuar në fundvitin ’98. Faktori, që ka ndikuar në rritjen e këtij treguesi është rritja

e kapitalit rregullator të sistemit bankar, si rezultat i shtimit të kapitalit minimal të bankave dhe fitimit të realizuar në këtë fundviti.

Rritja e kapitalit të paguar të bankave lidhet me vendimin nr. 43, datë 31.03.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas të cilit të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja, duhet të plotësojnë kapitalin minimal të paguar prej 500 milionë lekësh. Mbështetur në këtë vendim, të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja (grupi III) të cilat janë licencuar dhe kanë filluar aktivitetin bankar me 200 ose 350 milionë lekë, rritën kapitalin e paguar në 500 milionë lekë. Këto banka, brenda marsit 2001, duhet të plotësojnë kapitalin minimal të kërkuar për hapjen e një banke prej 700 milionë lekësh.

Në rritjen e këtij treguesi ka ndikuar edhe struktura e aktiveve të bankave, vlerësuar sipas rrezikut. Siç shihet nga tabela, bankat G1 kanë investuar 71.5 për qind të aktiveve të tyre në aktive pa rrezik në bono thesari; bankat e G2 dhe të G3 kryesisht në aktive me rrezik të ulët (depozita në bankat e tjera). Ndërsa bankat e G3 kanë pakësuar investimet me rrezik të ulët dhe kanë rritur me 7.6 për qind investimet në kredi, gjithashtu, edhe në bono thesari.

Tabela e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut (në përqindje kundrejt totalit të bilancit të çdo grupi).

Aktive të klasifikuara sipas rrezikut	SB		G1		G2		G3	
	1999	1998	1999	1998	1999	1998	1999	1998
Aktive pa rrezik (0 %)	61.4	60	71.5	67.6	11.2	13.1	20.4	15.4
Aktive me rrezik të ulët (20 %)	19.5	23.8	11.7	17.7	48.2	39.4	56.0	70.9
Aktive me rrezik të mesëm (50 %)	1.4	1.2	0.7	0.2	10.2	18.4	1.8	0.1
Aktive me rrezik të lartë (100 %)	14.4	13.1	12.7	12.1	27.4	31.5	19.3	11.7

Për grupin e parë të bankave, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është negativ dhe ndikon në uljen e treguesit të sistemit në tërësi. E kundërta ndodh me grupin e dytë dhe atë të tretë të

bankave, që edhe për vitin 1999 paraqiten mjaft të kapitalizuara. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit respektivisht për këto dy grupe bankash, paraqitet 44,8 për qind dhe 43,5 për qind, nga 12 për qind që është norma e përcaktuar. Një strukturë e tillë e aktiveve në këtë grup bankash, ka çuar në raporte shumë të larta të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe në një tepricë të madhe të kapitalit rregullator.

Në aktivet me rrezik të mesëm përfshihet kredia hipotekore (për blerje, lëshime me qira ose përmirësime të banesave) ndërsa në aktivet me rrezik të lartë, të gjitha kreditë e tjera të dhëna.

Këto aktivitete, duke patur një normë të lartë fitimi, ndikojnë ndjeshëm në rritjen e të ardhurave financiare të bankave, duke mos lënë pas dore edhe ndikimin që ka kredidhënia në zhvillimin ekonomik apo të bizneseve të ndryshme private. Nivelet e ulta të pjesëmarrjes së bankave në këto aktivitete, ndikojnë drejtpërsëdrejti në të ardhurat financiare të bankave.

5. BILANCI I BANKAVE DHE CILËSIA E AKTIVEVE

Krahasuar me fundvitin'98, totali i bilancit për sistemin bankar ka pësuar një rritje për 23,6 për qind. Në rritjen e këtij treguesi kanë ndikuar kryesisht bankat e G2 dhe G3, që gjatë vitit 1999 rezultojnë me një rritje të ndjeshme në totalin e bilancit nga thithja e llogarive rrjedhëse dhe e depozitave të klientëve.

Për nga totali i bilancit pesha e çdo grupi ndaj sistemit bankar paraqitet:

	Dhjetor 1997	Dhjetor 1998	Dhjetor 1999
Grupi I	89,8	85,3	81,4
Grupi II	6,5	5,7	5,8
Grupi III	3,7	9,0	12,6
Totali bilancit (milionë lekë)	167,3	212,3	252,5

Nga treguesit e mësipërm del që, bankat dominuese në sistemin bankar, pavarësisht nga rritja e vazhdueshme e peshës specifike të bankave private dhe degëve të bankave të huaja, vazhdojnë të jenë bankat me kapital shtetëror.

Edhe gjatë vitit 1999 nuk shihet ndonjë veçori, krahasuar me vitet e mëparshme, në strukturën e aktivit të sistemit bankar. Bankat kanë investuar fondet e tyre kryesisht në bono thesari, vendosje pranë bankave dhe në kredidhënie, që krahasuar me vitin 1998 paraqiten me rritje.

Tabela me zërat kryesorë të aktivit (në përqindje ndaj totalit të bilancit të grupit përkatës).

Zërat e aktivit	G1		G2		G3	
	1998	1999	1998	1999	1998	1999
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	87.4	89.9	52.5	61.7	86.3	81.0
Nga këto :						
- bono thesari	55.2	60.0	4.4	6.0	5.4	12.2
- marrëdhënie me bankën qendrore	11.6	12.2	7.2	7.1	5.3	7.3
- marrëdhënie me bankat e tjera	19.3	16.7	39.5	44.4	71.8	55.7
2. veprime me klientët	2.2	1.1	33.5	30.1	7.5	12.5

Struktura e aktiveve nuk paraqitet e njëjtë për të tre grupet e bankave, duke shfaqur karakteristikat e veta. G1 investon në bono thesari për të mbuluar koston e depozitave, ndërsa G2 dhe G3 pjesën më të madhe të investimeve të tyre e kanë në depozitimet e fondeve të tyre të lira në bankat e tjera. Kreditimi bankar zhvillohet vetëm nga bankat e G1 dhe G2.

Nga pikëpamja e rrezikut vihet re që, në përgjithësi, sistemi bankar tregohet mjaft konservator, duke i përqendruar investimet e tij kryesisht në aktive pa rrezik apo me rrezik të ulët.

Tabela me zërat kryesorë të pasivit (në përqindje ndaj totalit të bilancit).

Zërat e pasivit	G1		G2		G3	
	1998	1999	1998	1999	1998	1999
1. veprime me thesarin dhe ndërbankare	1.0	0.4	3.0	6.6	4.7	5.0
2. veprime me klientët	88.5	86.5	57.3	64.5	46.1	68.9
nga këto :						
- depozita me afat	73.5	72.0	11.4	16.8	21.9	33.5
3. kapitali i aksionerëve	0.1	0.3	32.4	23.6	12.1	15.6

Rritja në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e klientëve për vitin'99 krahasuar me vitin'98 ka ndryshuar: ndërsa si sistem bankar vihet re një rritje vetëm 23 për qind, në bankat e G1

rritja rezulton 14,3 për qind, në ato të G2 është 59,3 për qind ndërsa në bankat e G3 rezulton një rritje 152,3 për qind.

Në këtë rritje të tejskajshme të llogarive dhe depozitave në bankat e G3, ka ndikuar jo vetëm shtimi i numrit të bankave (rreth 21,1 për qind e rritjes ka ardhur si rezultat i fillimit të veprimtarisë të 3 bankave të reja) por edhe rritja e këtij treguesi në bankat ekzistuese (në bankat ekzistuese ky tregues është rritur 131,2 për qind).

Bankat e G2 dhe G3 koston e depozitave e kanë mbuluar, në pjesën dërrmuese nëpërmjet vendosjeve në formë depozitash pranë bankave jorezidente, duke ndjerë një siguri më të madhe pranë tyre, si dhe një pjesë nëpërmjet kredidhënies, ndonëse tregohen mjaft të matura.

Aktiviteti kredidhënës si sistem bankar është tepër i papërfillshëm në krahasim me totalin e bilancit, duke zënë vetëm 4,2 për qind të tij dhe duke ndikuar ndjeshëm problemet e mëdha të trashëguara në vite, në drejtim të kthyeshmërisë së tyre.

Dhe, ndërsa bankat e G1 janë banka me mjaft probleme të akumuluara në aktivitetin kreditues, bankat e G2 dhe G3 janë në një pozicion më të mirë, duke u treguar edhe mjaft të matura.

Tabela e cilësisë së portofolit të kredive (në përqindje kundrejt tepricës së kredive gjithsej).

Cilësia e portofolit të kredive	SB		G1		G2		G3	
	1998	1999	1998	1999	1998	1999	1998	1999
Kreditë e klasifikuara								
- standarde	41.6	48.0	19.8	13.4	90.9	85.0	80.9	89.2
- në ndjekje	2.5	2.9	2.7	1.9	0.5	6.6	5.5	1.2
- nënstandarde	7.6	6.6	10.8	9.3	0.8	2.0	.6	5.0
- të dyshimta	6.3	2.4	6.2	2.7	5.7	3.8	8.0	0.1
- të humbura	41.2	36.6	59.5	67.0	1.9	1.7	2.8	3.2

Për bankat e grupit të parë, bankat me kapital shtetëror, dihet ecuria dhe problemet e akumuluara prej vitesh, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive gjithsej është tepër i lartë.

Bankat e grupit të dytë janë në pozicion të mirë, kreditë standarde përfaqësojnë 85 për qind të totalit të kredive. Kreditë me probleme ndaj totalit të kredive zënë vetëm 7.5 për qind, ndërsa raporti i kredive ndaj totalit të depozitave është 49.1 për qind.

Për bankat e grupit të tretë kreditë standarde përfaqësojnë 90 për qind të tepricës së kredive, ndërsa raporti kredi gjithsej ndaj totalit të depozitave është 19.2 për qind. Në këtë grup bankash jo të gjitha bankat japin kredi, tre prej tyre janë të reja që kanë filluar aktivitetin në vitin 1999, ndërsa njërës prej tyre i është ndërprerë aktiviteti kredidhënës për arsye të përkeqësimit të portofolit të kredive.

6. REZULTATI FINANCIAR DHE TREGUESIT E RENTABILITETIT

Në këtë fundviti sistemi bankar, për herë të parë pas një periudhe pesëvjeçare, paraqitet me rezultat financiar neto pozitiv, duke vlerësuar vitin 1999 si vitin më të mbarë të tij në drejtim të rezultatit financiar. Megjithatë, niveli i të ardhurave është akoma i pamjaftueshëm për të mbuluar humbjet për rreth 12,8 miliardë lekë, të trashëguara nga vitet e kaluara.

Fitimi i rezultuar në këtë fundviti është 1267,8 milionë lekë nga i cili 76.8 për qind është realizuar nga bankat e G1, 16.9 për qind nga bankat e G2 dhe 6.3 për qind nga bankat e G3.

Rezultati financiar ndikon në treguesit e kthyeshmërisë së aktiveve dhe të kthyeshmërisë së kapitalit, që në këtë fundviti rezultojnë të përmirësuar.

Për sistemin bankar treguesi i ROA[2]-së rezulton 0,6 për qind ku në G1 ky tregues rezulton 0,5 për qind; në G2 rezulton 1,6 për qind ndërsa; në G3, 0,3 për qind. Pra, vetëm G3 është nën nivelin e duhur të këtij treguesi.

Ndërsa ROE[3]- ja, si sistem bankar, rezulton 16 për qind, për G1 ky tregues nuk llogaritet si rezultat i kapitalit negativ, ndërsa

për bankat e G2 ky tregues është 6,1 për qind dhe për G3, 2 për qind.

Një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e rezultatit financiar dhe kjo pothuajse tërësisht në bankat e G1 (si dominuese të depozitave në lekë) ka dhënë ulja e normës së interesit për depozitat. E themi këtë sepse rezultati neto nga interesat, janë të ardhurat bazë të sistemit bankar si pasojë e të cilave, për vitin'99 sistemi rezulton me fitim për 5,1 miliardë lekë, nga 39,3 milionë lekë me humbje, të rezultuar në funvitin'98. Rezultati neto nga interesat është pozitiv në të gjitha bankat.

Niveli mjaft i lartë i të ardhurave nga interesat, që së bashku me të ardhurat nga komisionet bankare kanë bërë të mundur që sistemi bankar jo vetëm të përballojë shpenzimet për krijimin e fondeve rezervë, për mbulimin e humbjeve nga kreditë (konform rregulloreve të nxjerra për këtë qëllim) si dhe shpenzimet e veprimtarisë së vetë bankave, por dhe të dalë me fitim. Edhe në drejtim të burimit të të ardhurave financiare dhe të kryerjes së shpenzimeve, shihen veçori për grupet e bankave.

1. Në drejtim të sigurimit të të ardhurave nga interesat dhe të pagimit të tyre :

- bankat e G1, ndërsa 84 për qind të të ardhurave nga interesat i kanë siguruar nga investimi në bono thesari, 99,3 për qind të shpenzimeve për interesa shkojnë për pagimin e interesave për llogaritë dhe depozitat e klientëve;
- bankat e G2, kanë një shpërndarje në sigurimin e të ardhurave 36,1 për qind e tyre kanë ardhur nga interesat e siguruar nga vendosjet pranë bankave, 49,9 për qind nga interesat e arkëtuar nga kredidhënia, ndërsa rreth 14 për qind nga investimet në bono thesari. Përsa i përket shpenzimeve për interesa, rreth 80,4 për qind e tyre i takojnë interesave të paguar për llogaritë dhe depozitat e klientëve;
- bankat e G3, rreth 45 për qind të të ardhurave nga interesat i sigurojnë nga vendosjet pranë bankave, 24,4 për qind nga kredidhënia dhe 28,8 për qind nga investimet në bono thesari, ndërsa 87,2 për qind të shpenzimeve për interesa

i takojnë llogarive dhe depozitave të klientëve.

2. Në drejtim të shpenzimeve të veprimtarisë:
- për bankat e G1, rreth 4,7 për qind e të ardhurave financiare shkojnë për shpenzimet e veprimtarisë së vetë bankave ose 2,4 për qind e të ardhurave financiare shpenzohen vetëm për personelin e bankave;
- për bankat e G2, këta tregues rezultojnë respektivisht 37,1 për qind dhe 14,6 për qind;
- ndërsa për bankat e G3, treguesit rezultojnë 32,4 për qind dhe 9,1 për qind.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një kosto më të lartë të bankave të G2 dhe të G3 si për zhvillime teknologjike, por edhe për paga më të larta në drejtim të personelit të tyre.

3. Shpenzimet për provigjone:
- në bankat e G1, 180,9 për qind e të ardhurave nga kreditë shkojnë për krijimin e provigjoneve për mbulimin e humbjeve nga kreditë;
- në bankat e G2, 20,7 për qind e të ardhurave nga kredidhënia shkojnë për krijimin e provigjoneve;
- në bankat e G3 ky tregues rezulton 10,1 për qind (janë 3 banka që nuk kanë dhënë kredi dhe si rrjedhojë, nuk kanë krijuar provigjone).

KONKLUZIONE

- Zhvillimet e sistemit bankar janë ngushtësisht të lidhura me zhvillimin tërësor të ekonomisë së vendit, me zhvillimet dhe fuqizimin e shoqërive me kapital privat.
- Sistemi bankar gjatë vitit 1999 ka ndryshime strukturore, në favor të aktivitetit bankar privat, të cilit gjatë vitit 2000 do t'i shtohet edhe Banka Kombëtare Tregtare e privatizuar.
- Sistemi bankar, në përgjithësi, po investon në përmirësimin e teknologjisë që do të ndikojë në rritjen e cilësisë dhe të shpejtësisë së shërbimeve dhe për rrjedhim, në rritjen e klientelës së bankave.

- Një ndikim pozitiv në përmirësimin e strukturës së investimeve ka edhe politika e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, në drejtim të uljes së normës së interesit për depozitat në lekë për bankat me kapital shtetëror, por kjo lidhet me interesimin e bankave me kapital privat për thithjen e depozitave në lekë.

Në këtë kuadër të përgjithshëm, mbikëqyrja bankare luan rolin e saj nëpërmjet anës rregullative, inspektimeve në vend dhe analizave të veçanta apo të përgjithshme të bankave, si dhe nëpërmjet masave korrektuese të propozuara në kohë.

SHËNIME

* Miranda Ramaj, Drejtore, Departamenti i Mbikëqyrjes.
Vjollca Berberi, Përgjegjëse e Sektorit të Analizës, Departamenti i Mbikëqyrjes.
[1] Degët e bankave të huaja në mbështetje të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" trajtohen njëlloj si bankat e tjera . Si banka ashtu edhe dega e bankës së huaj kanë personalitet juridik dhe të dyja janë të regjistruara në gjykatë. Degët e bankave të huaja janë të krijuara si banka dhe të gjitha kërkesat ndaj tyre janë të njëjta si dhe për bankat. Dallimi për degët e bankave të huaja qëndron tek fakti që degët e bankave të huaja janë totalisht në pronësi të një banke tjetër të huaj, e cila përgjigjet për degën, në rastin e plotësimit të kapitalit ose në rast të vështirësive të ndryshme financiare. Dallimi qëndron edhe në anën organizative, banka ka këshill drejtues, komitet kontrolli etj., të zgjedhur të saj ndërsa dega e bankës së huaj këta organizma i ka të njëjtë me bankën-mëmë.
[2] ROA – Kthyeshmëria nga aktivet.
[3] ROE – Kthyeshmëria nga kapitali aksioner.

OFERTA PUBLIKE FILLESTARE (IPO)

Elvin Meka
*Brizejda Kreshpa**

Fjalë kyçe
- Oferta publike fillestare - Letra me vlerë - Bursë - Aksione - Prospekt -

I. HYRJE

Me ofertë publike fillestare (IPO) nënkuptohet shitja, për herë të parë, e aksioneve të një shoqërie aksionere (anonime), sh.a., publikut. IPO nuk duhet të ngatërrohet me "Ofertat fillestare" që nënkupton shitjen në vijim të aksioneve publikut. Një sh.a. mund të bëjë vetëm një IPO dhe shumë "oferta fillestare" gjatë aktivitetit të saj ekonomik.

II. HAPAT PROCEDURIALË PËR REALIZIMIN E NJË IPO-JE

Hapi i parë: *Kontaktimi me një bankë investimesh ose me një ndërmjetës të specializuar, që vepron si këshillues e nënshkrues.*

Sh.a.-ja, e cila dëshiron të rrisë kapitalin nëpërmjet IPO-s, mund dhe të mos kërkojë shërbimin e bankës së investimeve apo të ndërmjetësve të tjerë të specializuar për këtë qëllim, por ta realizojë atë vetë. Faktikisht, nuk ka asnjë ligj apo rregull që të detyrojë sh.a.-të të lidhen me një bankë investimesh për të kryer IPO-n.

Në rastin e kryerjes së IPO-s nëpërmjet bankës së investimeve, të dyja palët duhet të bien dakord për shumën e kapitalit të sh.a.-së, që do të ofrohet, për llojin e letrave me vlerë që do të emetohen, çmimin e letrës me vlerë (për copë), ndonjë tipar specifik ose të veçantë të saj si dhe koston e firmës për emetimin e letrës me vlerë. Vetëm në këtë rast, banka e investimeve mund të veprojë si ndërmjetës midis sh.a.-së dhe publikut.

Ekzistojnë dy lloj marrëveshjesh midis bankës së investimeve dhe sh.a.-së:

1. Marrëveshja Garantuese (Firm Commitment). Me anë të kësaj marrëveshjeje, banka(t) e investimeve bie(n) dakord të blejë të gjitha letrat me vlerë të emetuara nga sh.a.-ja dhe pastaj t'ia rishesë ato publikut. Nëpërmjet saj, banka e investimeve detyrohet t'i sigurojë sh.a.-së shumën e kërkuar të parave. Në këtë rast, rreziku i emetimit (domethënë i mosshitjes totale të letrave me vlerë të emetuara) bie totalisht mbi bankën e investimeve.

2. Marrëveshja e "Përpjekjeve më të mira" (Best Efforts Agreement). Me anë të kësaj marrëveshjeje banka(t) e investimeve bie(n) dakord të shesë letrat me vlerë të sh.a.-së, por nuk merr mbi vete asnjë rrezik (apo nuk jep asnjë garanci) për shumën e parave që do të fitohet nga emetimi i tyre (në këtë rast rreziku i mosshitjes së letrave me vlerë të emetuara, mbahet nga vetë sh.a.-ja).

MARRËVESHJA GARANTUESE

Përgjithësisht IPO-t kryhen (realizohen) nga më shumë se një bankë investimesh dhe kjo kryesisht për efekt të shpërndarjes së rrezikut të emetimit. Në këtë rast, formohet një sindikatë. Sindikata është një grup investitorësh (banka ose jobanka), i cili dëshiron të marrë pjesë në shitjen e letrave me vlerë. Zakonisht zgjidhet një drejtues sindikate, i cili harton një *letër mirëkuptimi*. Kjo letër shërben për të formalizuar marrëdhëniet brenda sindikatës (anëtarëve të saj) si dhe midis sindikatës dhe sh.a.-së (megjithëse faktikisht nuk ka karakter detyrues). Menjëherë pasi Komisioni i Letrave me Vlerë (KLV) miraton prospektin e sh.a-

së, të gjitha palët që kanë nënshkruar këtë letër, hyjnë në një marrëveshje, e cila i detyron ato ta zbatojnë atë. Ekzistojnë tre lloj marrëveshjesh për këtë qëllim: marrëveshja midis nënshkruesve, marrëveshja e nënshkrimit dhe marrëveshja e tregtarëve.

1. Marrëveshja midis nënshkruesve, përcakton marrëdhëniet midis nënshkruesve, drejtuesit të sindikatës si dhe të gjitha rastet kur drejtuesi i sindikatës vepron për llogari të anëtarëve të tjerë të saj.

2. Marrëveshja e nënshkrimit, përcakton marrëdhëniet midis sh.a.-së (sh.a.-ve) dhe nënshkruesve (ose nënshkruesit nëse nuk kemi sindikatë). Kjo marrëveshje ekzekutohet nga drejtuesi i sindikatës, duke u mbështetur në autoritetin që ai e gëzon nga marrëveshja midis nënshkruesve.

3. Marrëveshja e tregtarëve, përcakton se tregtarët e letrave me vlerë kanë të drejtën e blerjes së një pjese të letrave me vlerë, që po emetohen, si dhe të drejtën e blerjes së tyre me një zbritje nga çmimi fillestar i përcaktuar, i ofertës publike. Sasia e letrave me vlerë dhe zbritja, përcaktohen në mënyrë të qartë në këtë marrëveshje.

MARRËVESHJA E "PËRPJEKJEVE MË TË MIRA"

Në këtë rast, formohet "*Grupi Shitës*", që kujdeset vetëm për procesin e shitjes së letrave me vlerë që emeton sh.a-ja. Çdo anëtar i këtij grupi, sipas marrëveshjes së grupit me sh.a.-në, merr pjesën përkatëse të letrave me vlerë që do të shesë dhe bën përpjekjet maksimale për t'i shitur ato plotësisht. Në këtë rast, sh.a.-ja do të përfitojë dhe është e kënaqur me atë shumë parash që realizohet nga shitja, qoftë dhe pjesore, e letrave me vlerë. Megjithatë, ekziston dhe një lloj marrëveshjeje e veçantë midis sh.a.-së dhe grupit shitës (nënshkruesve), që quhet marrëveshja "Të gjitha ose asnjë", sipas të cilës nënshkruesit bien dakord të bëjnë përpjekjet më të mira të mundshme për të shitur të gjitha letrat me vlerë, që emetohen brenda një date të caktuar. Të gjitha të ardhurat shkojnë në një llogari të veçantë (jo direkt në favor të sh.a.-së). Nëse letrat me vlerë nuk shiten të gjitha brenda kësaj date, paratë u kthehen blerësve dhe oferta anulohet.

Hapi i dytë: *Përmbushja e të gjitha detyrimeve ligjore për një ekspozim të plotë të aktivitetit ekonomik të sh.a.-së.*

Sh.a.-ja është e detyruar me ligj të hartojë një prospekt. Banka e investimeve apo sh.a-ja duhet ta plotësojë atë në përputhje me rregullat e vendosur nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe në bashkëpunim me të. Dita që sh.a.-ja dorëzon prospektin te Komisioni i Letrave me Vlerë, njihet si "*data e dokumentimit*".

Prospekti përmban në mënyrë të plotë informacionin që investitorët dhe këshilltarët profesionalë të tyre do të kërkonin dhe do të shpresonin të gjenin në të, në mënyrë që të bënin një vlerësim korrekt mbi: mjetet, detyrimet, gjendjen financiare, fitimet/humbjet si dhe planet e ardhshme të sh.a.-së; të drejtat që kanë të bëjnë me këto letra me vlerë, informacion apo të dhëna shtesë, si dhe disa kërkesa dhe norma të tjera, ashtu siç mund të përcaktohen nga Komisioni i Letrave me Vlerë. Një vend të rëndësishëm në të, zë dhe deklarata e ekspertit kontabël të pavarur mbi cilësinë e raportimeve (pasqyrave) kontabël të sh.a.-së.

Pasi prospekti dorëzohet pranë Komisionit të Letrave me Vlerë, këtij të fundit i lejohet një periudhë kohe, që quhet "*periudha e ftohjes* (cooling off)"gjatë së cilës Komisioni i Letrave me Vlerë shqyrton nëse ekspozimi i informacionit të dhënë nga sh.a-ja është në përputhje me kërkesat e vendosura prej tij, ndërsa sh.a.-ja përpiqet të zgjojë interes mbi emetimin me shpërndarjen e një prospekti paraprak. Prospekti paraprak ka për qëllim të njohë publikun me sh.a.-në si dhe të masë shkallën e interesit të publikut mbi emetimin e letrave me vlerë në fjalë.

Prospekti paraprak përmban pothuajse gjithë informacionin e prospektit. Çmimi i ofertës publike dhe data efektive e emetimit nuk evidentohen në prospektin paraprak. Këta dy tregues nuk duhet të njihen gjatë "*periudhës së ftohjes*". Zakonisht çmimi i ofertës publike bëhet i njohur në datën efektive. Data efektive është data kur oferta publike i drejtohet zyrtarisht publikut.

Gjatë "*periudhës së ftohjes*" nuk duhet t'u jepet apo sigurohet klientëve asnjë informacion tjetër, përveç informacionit të

përfshirë në "prospektin paraprak". Nuk lejohet asnjë sugjerim, evidencë, raport, rekomandim apo literaturë rreth sh.a.-së.

Përpara datës efektive sh.a.-ja realizon, me palët e angazhuara në proces, një takim, që quhet "takimi i dorës së fundit" (Due Diligence meeting), në të cilin fiksohen dhe sheshohen të gjitha problemet e minutës së fundit, që dalin gjatë periudhës midis datës së dokumentimit dhe datës efektive. Ky takim, zakonisht përkon me ditën e miratimit të prospektit nga Komisioni i Letrave me Vlerë. Prospekti tashmë bëhet i vlefshëm për publikun (i shpërndahet zyrtarisht publikut) dhe përmban gjithë informacionin e prospektit paraprak, së bashku me çmimin e ofertës publike dhe datën efektive të shitjes së saj.

III. PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË OFERTËS PUBLIKE

Për të përcaktuar çmimin e IPO-s, nga ndërmjetësi i specializuar është e nevojshme një analizë e kujdesshme dhe profesionale e treguesve të mëposhtëm të sh.a.-së:

1. Treguesit financiarë.

Në këtë seksion, analiza fokusohet në shqyrtimin e pasqyrave dhe të dokumenteve kontabël të sh.a.-së, që janë audituar paraprakisht nga eksperti kontabël i pavarur. Më konkretisht, fokusi vendoset mbi çështjet e mëposhtme:

- metoda kontabël e përdorur dhe efekti i tyre në raportim;
- mjetet;
- kostoja e kapitalit;
- shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, në përqindje ndaj shitjeve;
- borxhet afatgjata;
- marzhi i fitimit;
- kapitali i vet (kapitali i ofruar nga aksionerët e zakonshëm).

2. Treguesit e përgjithshëm.

Në këtë seksion, analiza fokusohet në çështjet e mëposhtme:

- fusha dhe vitet e aktivitetit ekonomik;
- kostoja e produktit;
- eksperienca dhe kualifikimi i drejtuesve;
- perspektivat e rritjes në aspektin gjeografik e teknologjik;
- pjesa e tregut e sh.a.-së;
- furnizuesit e lëndës së parë.

3. Treguesit juridikë.

Në këtë seksion analiza fokusohet në çështjet e mëposhtme:

- konsideratat ambientale;
- detyrimet ligjore dhe paditë gjyqësore;
- legjislacioni kombëtar, shtetëror apo lokal (anët favorizuese dhe diskriminuese për sh.a.-në);
- markat tregtare, patentat ose pasuri të tjera të këtij lloji.

Pasi analizohen treguesit e mësipërm, përcaktohet shuma e nevojshme e parave si dhe çmimi për copë (për letrat me vlerë) dhe llogaritet automatikisht sasia e aksioneve, që do t'i ofrohet publikut. Këtu duhet të mbahet parasysh optimumi midis çmimit dhe sasisë së letrave me vlerë, që do të emetohen, për të siguruar likuiditetin dhe emetim të kënaqshëm të letrave me vlerë të sh.a.-së.

Normalisht, një muaj para datës efektive, nga sh.a.-ja dhe grupi i punës zhvillohet promovimi i sh.a.-së. Kjo fazë njihet si "*roadshow*". Kjo është një nga fazat më të vështira dhe më të rëndësishme nga e cila varet ecuria e sh.a.-së në treg. Kjo fazë konsiston në kryerjen e disa takimeve me:

- drejtuesit e lartë të nënshkruesve. Këto janë takime personale dhe për zyrat, që nuk vizitohen personalisht përgatitet zakonisht një kasetë video për këtë qëllim;
- drejtuesit e sindikatës;

- investitorët institucionalë (në grup dhe një nga një); dhe
- analistët.

Kjo fazë ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e çmimit të ofertës publike dhe të sasisë së aksioneve, që do të emetohen. Kyçi i suksesit të kësaj faze njihet si çelësi i 4 J-ve.

Ji i besueshëm!
Ji konservativ në vlerësime!
Ji i përgatitur mirë!
Ji mbresëlënës në momentin e parë!.

Hapi i tretë: *Shitja dhe mbyllja e IPO-s.*

Procesi i shitjes së IPO-s mund të bëhet nëpërmjet:

1. Shitje nëpërmjet Bursës[1]!
2. Metoda e kërkesave.

Kjo metodë mund të realizohet në dy mënyra:

- me çmim konstant;
- me çmim të ndryshueshëm.

Pas miratimit të prospektit sh.a.-ja është e detyruar me ligj t'i drejtohet bursës, me një kërkesë me shkrim për të listuar aksionet e saj në të (forma e kërkesës është e gatshme). Kësaj kërkese normalisht i bashkëngjitet prospekti dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme, që kërkohen nga bursa. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim, bursa liston aksionet e kësaj sh.a.-je nëse ajo është e përshtatshme (pra përmbush gjithë kriteret) për listim. Tregtimi i aksioneve më pas i nënshtrohet të gjitha rregullave e procedurave të vendosura nga rregulloret e bursës.

IPO me metodën e dytë realizohet në sportelet e bankave, ku çdo individ mund të paraqitet për të blerë aksionet e sh.a.-së. Një IPO quhet e mbyllur kur të gjitha transaksionet të kenë përfunduar, si dhe të kenë përfunduar të gjitha procedurat,

që kanë të bëjnë me transferimin e aksioneve, të parave dhe të komisioneve të paguara për kryerjen e saj. *Mbyllja* është e ndryshme, në varësi të metodës së zgjedhur për kryerjen e IPO-s.

Mbyllja[2]

Mbyllja sipas marrëveshjes garantuese (rasti i parë i IPO-s).

Mbyllja, në këtë rast, bëhet zakonisht një ose dy javë pas datës efektive. Kjo periudhë është e nevojshme për llogaritjen e saktë të parave dhe për përgatitjen e plotë të dokumentacionit. Dokumentacioni, që duhet të paraqitet në mbyllje përbëhet nga:

- Dokumenti i siguruar nga sh.a.-ja ose agjenti i tij, që përmban emrat e aksionerëve dhe prerjet e aksioneve.
- Vërtetimi i noteruar i aktit të themelimit të sh.a.-së.
- Vërtetimi, nga titullarët e sh.a.-së, që ajo ka zbatuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet ligjore, dhe është dakord me të gjitha hapat dhe procedurat e ndjekura deri në fazën e mbylljes së IPO-s dhe se nuk ka publikuar asnjë informacion, apo ka dhënë nëpërmjet kanaleve të tjera, materiale që mund të ndikonin në çmimin e ofertës publike.
- Dokumenti nga përfaqësuesi ligjor i nënshkruesit, që jep opinionin përfundimtar të nënshkruesit lidhur me IPO.
- Dokumenti nga përfaqësuesi ligjor i sh.a.-së, që jep opinionin përfundimtar të saj në lidhje me IPO-n.

Mbyllja sipas marrëveshjes së "Përpjekjeve më të mira" (rasti i dytë i IPO-s).

Kjo metodë ndiqet zakonisht për emetime të vogla. Në përgjithësi, kjo lloj oferte ka një periudhë shitjeje 60-120 ditë mbas datës efektive. Periudha e mbylljes në rastin e marrëveshjes së "Përpjekjeve më të mira" evidentohet në kapakun e prospektit si dhe në paragrafe të veçanta të tij.

Në fazën e mbylljes së ofertës, nënshkruesit dhe çdo anëtar i sindikatës që realizon shitjen, kanë të drejtë të marrin të gjitha

paratë, që ishin të depozituara në llogarinë e veçantë (jo direkt në favor të sh.a.-së). Në mbyllje, përfaqësuesi ligjor i sindikatës dorëzon një memorandum mbylljeje. Ky memorandum deklaron mbylljen e procesit dhe nënvizon palët, që do të pajisen me dokumentet origjinale dhe ato që do të pajisen me kopje të tyre. Të gjitha palët duhet të firmosin memorandumin. Gjithashtu, memorandumit i bashkëngjitet dhe vërtetimi, që të gjithë përfaqësuesit që e nënshkruajnë kanë marrë nga subjektet e tyre, se aktualisht janë të punësuar pranë tyre dhe ushtrojnë funksionet përkatëse. Eksperti kontabël i pavarur i sh.a.-së lëshon një dokument ku theksohet që çdo gjë është konform rregullave. Dokumentet, që do të paraqiten në fund janë:

- Dokumenti i siguruar nga sh.a.-ja ose agjenti i saj, që përmban emrat e aksionerëve dhe prerjet e aksioneve që ata zotërojnë.
- Vërtetimi i noteruar i aktit të themelimit të sh.a.-së.
- Vërtetimi nga titullarët e sh.a.-së ku të vërtetohet se ajo ka zbatuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet ligjore, se është dakord me të gjitha hapat dhe procedurat e ndjekura deri në fazën e mbylljes së IPO-s dhe se nuk ka publikuar asnjë informacion apo ka dhënë nëpërmjet kanaleve të tjera materiale, që mund të ndikonin në çmimin e ofertës publike.
- Dokumenti nga përfaqësuesi ligjor i nënshkruesit, që jep opinionin përfundimtar të nënshkruesit lidhur me IPO-n.
- Dokumenti nga përfaqësuesi ligjor i sh.a.-së, që jep opinionin përfundimtar të saj në lidhje me IPO-n.

Procesi i mbylljes ndiqet nga këta persona përgjegjës:

- Nga sh.a.-ja: drejtori ekzekutiv, shefi i financës, shefi i kontabilitetit dhe shefi i departamentit juridik.
- Nga nënshkruesi: drejtori ekzekutiv.
- Një përfaqësues i sindikatës së bankave të investimeve (nënshkruesve) dhe përfaqësuesi ligjor i saj.
- Nga banka ku mbahet llogaria e veçantë: drejtori ekzekutiv, shefi i financës, shefi i kontabilitetit dhe shefi

i departamentit juridik. Kjo bankë mbikëqyr blerjen, transferimin e aksioneve, si dhe dokumentimin e të gjitha lëvizjeve, çertifikatat e aksioneve sipas pronarëve dhe shumat përkatëse të depozituara prej tyre në llogarinë e veçantë.

IV. PËRPARËSITË E IPO-s

Emetimi i letrave me vlerë (aksioneve) nëpërmjet IPO-s paraqet disa përparësi, ku ndër më kryesoret janë:

- Përdorim "i pakufizuar" i fondeve.

Të ardhurat e përfituara nga IPO mund të përdoren për qëllime "të gjera" dhe të ndryshme si: për kërkim e zhvillim, blerje pronash, uzinash, pajisjesh, lëndësh të para, zvogëlimin e borxhit ekzistues, rritjen e kapitalit qarkullues etj.. Mjafton që ato të jenë konform paragrafit "përdorimi i të ardhurave" të përcaktuar në prospekt.

- Mjet kompensimi.

Vetë fakti i kryerjes së një oferte publike për sh.a.-në përbën një strategji të shkëlqyer kompensimi, për të tërhequr dhe mbajtur drejtues e punonjës të aftë.

- Përmirësim të gjendjes financiare.

Shitja e ofertës publike rrit vlerën neto të sh.a.-së dhe përmirëson aftësinë e sh.a.-së për të marrë borxh. Në qoftë se sh.a.-ja ecën mirë në treg, ajo mund të siguroje fonde të tjera shtesë me kushte më të favorshme, duke siguruar kështu mundësinë e rritjes së alternativave të investimit me kosto të reduktuar.

- Blerje të paketave kontrolluese.

Fondet e siguruara nëpërmjet IPO-ve (por dhe ofertave të tjera) mund të përdoren nga sh.a.-ja për të blerë aksione të sh.a.-ve të tjera, që tregtohen publikisht në bursa duke bërë të mundur që sh.a.-ja të blejë paketat e sipërpërmendura, pa patur nevojë të marrë borxh apo të shesë mjetet e saj.

- Prestigj.

Duke u bërë publike, më shumë informacion bëhet i vlefshëm për sh.a.-në dhe nëpërmjet publicitetit si dhe ekspozimit në shtyp të sh.a.-së dhe produkteve të saj, marketingu dhe mundësitë e saj të biznesit janë të shumëfishuara. Një sh.a.- publike bëhet më e dukshme dhe imazhi i saj mbetet në mendje të komunitetit të biznesit. Shumë klientë preferojnë të bëjnë biznes me një sh.a., treguesit financiarë të së cilës janë bërë të njohur publikisht.

- Llogaritje dhe nxjerrje të vlerës reale të tregut të sh.a.-së dhe sigurim likuiditeti.

Kur sh.a.-ja bëhet publike, automatikisht krijohet tregu i aksioneve të saj duke i dhënë kështu mundësinë aksionerëve të saj, në çdo moment, të llogarisin vetë vlerën e tregut për aksionet, që ata zotërojnë si dhe të sigurojnë në çdo moment (sipas nevojave) likuiditetin e investimit të tyre (shitje të aksioneve).

V. KONKLUZIONE MBI IPO-t

Nga këndvështrimi i bursës, nuk ka ndonjë dallim thelbësor në kryerjen e një oferte publike (qoftë kjo dhe IPO) të një sh.a.-je private apo privatizimi nëpërmjet bursës i ndërmarrjeve shtetërore, qofshin këto edhe strategjike. Kjo, pasi procedura deri në listimin dhe tregtimin e aksioneve të tyre në bursë është e njëjtë.

Më poshtë po paraqesim një skedulë përgjegjësish, në të cilën paraqiten subjektet e angazhuara në kryerjen e një IPO-je dhe detyrat (përgjegjësitë) e subjekteve përkatëse në këtë drejtim.

SKEDULI I PËRGJEGJËSIVE

Fazat	DETYRA	Subjekti përgjegjës
Fillestare	Kontaktimi me firmën konsulente që merr përsipër përgatitjen e sh.a.-së për IPO. Kontaktimi me ekspertin kontabël (EK). Kontaktimi me ekspertin ligjor (EL). Marrëveshja midis palëve apo subjekteve të mësipërme për detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse.	MEP dhe P
Përgatitore	Përgatitja e sh.a.-së për privatizim me ofertë publike: - themelimi i sh.a.-së si sh.a. me ofertë publike; - vlerësimi i treguesve të përgjithshëm të sh.a.-së; - vlerësimi i treguesve ligjorë të sh.a.-së; - vlerësimi i treguesve financiarë të sh.a.-së; - përpilimi i prospektit (dhe i atij paraprak); - bashkëpunimi me KLV-në. Dokumentimi i Prospektit te KLV-ja.	MEP dhe P EK, EL
Vlerësimi	Vlerësimi i ofertës publike. Përcaktimi i çmimit të ofertës publike. 1. Përcaktimi i madhësisë së kapitalit: - analiza e të gjithë treguesve; - takimi i dorës së fundit; - *roadshow;* - matja e shkallës së interesit. 2. Përcaktimi i sasisë së aksioneve, që do të emetohen. 3. Përcaktimi i metodës së shitjes.	MEP dhe P/EK/EL (KONSULENTI)
	Miratimi i PROSPEKTIT (Periudha e ftohjes).	KLV
Shitja dhe mbyllja	Pranimi dhe administrimi i kërkesave. Rikthimi i parave pjesërisht ose tërësisht kërkuesve të pasuksesshëm. Përcaktimi i çmimit. Shpërndarja e letrave me vlerë. Dokumentacioni i nevojshëm.[3]	Banka e Shqipërisë (Bursa e Tiranës) Bankat/ Brokerat QRA MEP dhe P/EK/EL

ME dhe P – Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
EK – Eksperti kontabël i pavarur.
EL – Eksperti ligjor.
KLV – Komisioni i Letrave me Vlerë.
QRA – Qendra e Regjistrimit të Aksioneve.

Detyrat dhe përgjegjësitë për Bursën e Tiranës (në rast të shitjes nëpërmjet bursës).

Në gjithë këtë proces, Bursa e Tiranës ka detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- miratimi për listim;
- përcaktimi i çmimit dhe shpërndarja e letrave me vlerë (faza e fundit).

KONSIDERATA TË FUNDIT

Privatizimi nëpërmjet bursës, përveç përparësive teorike të përmendura më sipër, do të shërbente për:

1. përcaktimin e një çmimi transparent për aksionet e këtyre sh.a.-ve;
2. eliminimin e elementeve të mundshme korruptive në procesin e privatizimit;
3. tërheqjen dhe konkretizimin e menjëhershëm të investimeve të huaja në Shqipëri;
4. kursimin e kohës dhe zvogëlimin e procedurave burokratike për listimin e tyre në Bursën e Tiranës;
5. rritjen dhe përmbushjen me lehtësi të kërkesave të tyre për kapital (në përmasa disi të mëdha e të papërballueshme nga një bankë e vetme në Shqipëri) nëpërmjet bursës;
6. zhvillimin e mëtejshëm institucional të Bursës së Tiranës dhe më kryesorja, formalizimin dhe fillimin e funksionimit real të tregut të kapitaleve në vendin tonë.

SHËNIME

* Elvin Meka, Brizejda Kreshpa, Departamenti i Bursës së Tiranës.

[1] Për sqarime të mëtejshme shihni seksionin V. Konkluzione mbi IPO.

[2] "Mbyllja" është një takim në të cilin marrin pjesë të gjitha palët e angazhuara në kryerjen e ofertës dhe zakonisht mbahet 3 ose 4 ditë pune, pasi janë shitur letrat me vlerë. Kjo periudhë i jep mundësi nënshkruesve të mbledhin fondet nga klientët e tyre. Qëllim i takimit është të shkëmbehen dokumentet, çertifikatat, çeqet dhe faturat e ndryshme. Gjatë këtij shkëmbimi, nënshkruesi i jep sh.a.-së një çek për të gjitha fondet e realizuara nga shitja e ofertës, pasi zbriten shpenzimet (komisionet) për shërbimin e nënshkrimit.

[3] Me përfundimin e kësaj faze fillon dhe tregtimi zyrtarisht në tregun sekondar të aksioneve të sh.a.-së.

KOSTO E NDËRMJETËSIMIT PËR VITIN 1999

*Suzana Kodra**

Fjalë kyçe
- Kosto e ndërmjetësimit - Depozitë - Kredi - Bono thesari -

Bankat tregtare janë institucione financiare, që pranojnë depozita nga publiku dhe i japin kredi sektorëve të ekonomisë. Mobilizimi i kursimeve nga njësitë, që kanë mjete financiare përkohësisht të lira dhe lëvizja drejt njësive, që kanë nevojë për kredi me ndihmën e bankave tregtare është një formë indirekte e financimit, e njohur si ndërmjetësim. Realizimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit ka koston e tij.

Llogaritja dhe analiza e diferencës midis interesit për depozitat dhe interesit për kreditë është vlerësues i kostos së ndërmjetësimit. Diferenca midis interesit për depozitat dhe kreditë duhet të qëndrojë në nivelin që pasqyron rrezikun, koston operative normale dhe fitimin.

Vlerësimi i kostos së ndërmjetësimit është, veçanërisht, i rëndësishëm për sistemin bankar i cili ka hyrë në procesin e privatizimit të bankave me kapital shtetëror. Përveç kësaj, informacioni për koston e ndërmjetësimit mund të përdoret, krahas faktorëve të tjerë makroekonomikë, në përcaktimin e interesave për depozitat në lekë.

Kostot e larta të ndërmjetësimit, zakonisht, lidhen me mungesën e efektivitetit, mungesën e konkurrencës dhe faktorë

të tjerë, që e rrisin atë. Për vlerësimin e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar ne përdorim dy metoda[1].

E para, llogaritet si diferencë midis interesit mesatar të ponderuar për investimet në lekë (kreditë e reja dhe bonot e thesarit, të blera në tregun primar) dhe pranimeve të reja të depozitave në lekë në sistemin bankar (metoda 1.). Metoda e dytë e llogaritjes mbështetet në të dhënat e rezultatit financiar (metoda 2.).

Përdorimi i të dyja metodave na lejon të krijojmë një panoramë të nivelit të kostos së ndërmjetësimit dhe shpërndarjes së burimeve, që hyjnë rishtazi në sistem. Koordinimi i të dyja metodave bëhet për të mos lejuar mbulimin e punës së dobët të bankave në drejtim të kredive të pakthyera në afat ose të humbura, të cilat do të përfshiheshin në këtë interval si të mirëqena dhe, nga ana tjetër, nuk do të merrte parasysh kushtet konkrete të situatës financiare të bankave.

METODA 1

Metoda e parë, mbështetet në diferencën midis interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave në lekë[2] dhe investimeve në bono thesari e kredi të reja, për çdo bankë, gjatë një muaji. E njëjta metodë gjen zbatim edhe për sistemin bankar në tërësi.

Intervali midis interesit mesatar të ponderuar për investimet në lekë (kreditë e reja dhe bonot e thesarit të blera në tregun primar) dhe pranimeve të reja të depozitave në lekë në sistemin bankar gjatë vitit 1999, luhatet në vlerat 9.24- 11.87 për qind.

Gjykimin më të saktë për intervalin na e jep niveli i tij që nga viti 1996 deri në vitin 1999, për çdo tremujor, si mesatare dhe si mesatare vjetore.

Tabelë 1. Niveli mesatar i intervalit (në përqindje).

	Trem I	Trem II	Trem III	Trem IV	Interes mesatar vjetor
1999	9.94	11.20	11.54	9.95	10.65
1998	13.18	15.02	14.09	13.02	13.83
1997	17.67	18.64	12.66	15.83	16.20
1996	15.26	17.24	20.46	21.83	19.70

Nga krahasimi i të dhënave sipas viteve, viti 1999 është viti, që ka patur nivelin mesatar më të ulët të intervalit, si për çdo tremujor ashtu edhe vjetor.

Vazhdimi i procesit të reformimit të sistemit bankar, reformimet në fushën financiare në drejtim të zhvillimit të tregut të parasë dhe kapitaleve dhe veprime të tjera, që rrisin konkurrencën midis pjesëmarrësve të tregut, do ta çojnë vlerën e këtij intervali në kufijtë e vendeve në zhvillim, duke iu afruar edhe nivelit të vendeve të zhvilluara.

Grafik 1. Intervali midis interesit mesatar dhe të ponderuar për depozitat dhe kreditë për sistemin bankar.



Në vazhdim do të bëjmë një analizë të të gjithë faktorëve, që kanë ndikuar në këtë interval, e cila do të tregojë nëse kjo tendencë, që është vënë re për vitin 1999, për sistemin bankar ka ardhur nga puna e mirë e bankave apo nga ndikimi i faktorëve, që nuk lidhen me punën e tyre.

A. Interesi mesatar i ponderuar për pranimet e depozitave[3] në lekë, në sistemin bankar për vitet 1999 dhe 1998, paraqitet në mënyrë të përmbledhur si në tabelë:

Tabelë 2. Interesi mesatar i ponderuar për pranimet e depozitave (në përqindje).

	Trem I	Trem II	Trem III	Trem IV	Int.mes vjetor
1999	11.22	9.23	6.98	5.86	8.32
1998	20.37	16.35	12.31	10.56	14.89

Interesi mesatar i ponderuar për depozitat e reja të vendosura në sistem, ka rënë ndjeshëm nga njëri vit në tjetrin dhe nga një tremujor në tjetrin, duke arritur mesatarisht nga 14.89 për qind në vitin 1998, në 8.32 për qind në vitin 1999.

Ndryshimi i interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave për këtë periudhë është ndikuar nga:

A.I. ndryshimi i nivelit të interesave për depozitat në lekë.

Ulja e vazhdueshme e nivelit të inflacionit me bazë vjetore nga 8.7 për qind në fund të vitit 1998, në - 1.0 për qind në fund të vitit 1999, bëri që niveli i interesave në terma realë pozitivë për depozitat në lekë të mbetej në kufij të lartë.

Ky fakt, si dhe ndikimi pozitiv i faktorëve të tjerë, krijuan kushtet për uljen e nivelit minimal të detyruar të interesave, për të tre tipet e depozitave me afat, gjashtë herë gjatë vitit (me 7.5 për qind depozitat dymbëdhjetëmujore dhe 7.25 për qind depozitat gjashtë dhe tremujore).

Reagimi drejt uljes nga bankat me kapital shtetëror, të ndjekura edhe nga ato me kapital joshtetëror, ndikoi në rënien e interesit mesatar të ponderuar për depozitat në lekë, duke dhënë efekt pozitiv në uljen e kostos së bankave. Në ndryshimin e intervalit, përveç nivelit të interesave për depozitat në lekë, ka ndikuar edhe:

A.II. ndryshimi i strukturës së depozitave.

Tabelë 3. Pranimet mesatare mujore të depozitave në lekë (në milionë lekë).

Depozita	3ml 99	3mll 99	3m lll 99	3m lV 99	1999	1998
12- mujore	4.007	4.039	3.144	2.486	3.419	4.298
6- mujore	1.578	1.260	1.236	1.078	1.288	895
3- mujore	11.884	13.308	12.874	12.238	12.576	9.756
Gjithsej	17.469	18.607	17.254	15.481	17.283	14.949
Llog. rrjedhëse	9.738	15.072	16.760	18.044	14.903	11.178

Gjatë vitit 1999, pranimet në depozitat me afat dhe në llogari rrjedhëse janë më të larta se gjatë vitit 1998. Vetëm se gjatë vitit 1999 depozitat me afat janë rritur me ritme të larta çdo tremujor dhe në tremujorin e katërt, vihet re një rënie në nivelin e pranimeve. E kundërta ka ndodhur me pranimet e reja të llogarive rrjedhëse. Këto llogari kanë ardhur vazhdimisht duke u rritur në çdo tremujor, duke u dyfishuar në tremujorin e katërt në krahasim me tremujorin e parë. Në rritjen e lartë të pranimeve të depozitave pa afat, në tremujorin e katërt, ka ndikuar edhe kalimi i shpenzimeve buxhetore, më të larta se në çdo periudhë tjetër të vitit, që u bënë në llogaritë e firmave të ndryshme private dhe publike. Rritja e peshës së tyre në totalin e pranimeve të reja ka ndikuar në uljen e interesit mesatar të ponderuar të depozitave, duke dhënë efekt në uljen e kostos së bankave.

Struktura e pranimeve të reja të depozitave me afat, gjatë vitit 1999, e parë sipas tremujorëve, ka patur tendencë pothuajse të qëndrueshme në depozitat tremujore dhe rënie të peshës së pranimeve të reja në depozitat gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore. Por, rënia më e lartë e pranimeve të reja spikat në depozitat dymbëdhjetëmujore.

Duke llogaritur pjesën që zënë bankat me kapital joshtetëror në totalin e pranimeve të reja, konstatojmë se këto banka e kanë rritur pjesën e tyre të pranimeve të reja ndaj totalit në çdo tremujor (duke lëvizur nga 1.2; 3.5; 3.7 dhe 4.5 miliardë lekë ose 4.4 %, 10.4 %, 10.9% dhe 13.4 % përkatësisht në tremujorin I, II , III dhe IV).

B. Investimet e reja, që janë bërë nga bankat në sistem, kanë reflektuar një rënie të interesit mesatar të ponderuar për sistemin nga tremujori në tremujor, si dhe për çdo tremujor të vitit 1999 krahasuar me ato të vitit 1998. Niveli i interesit mesatar për investimet e kryera ka patur një rënie të vazhdueshme. Si mesatare vjetore ai ka rënë me 9.75 për qind në krahasim me vitin 1998.

Tabelë 4.

në përqindje (%)

	Trem I	Trem II	Trem III	Trem IV	Int.mes vjetor
1999	21.16	20.42	18.52	15.81	18.97
1998	33.55	31.37	26.4	23.59	28.72

Të shohim faktorët, që kanë ndikuar në këtë rënie, sipas efektit që kanë dhënë.

B.I. Struktura e investimeve nga ana e bankave sipas rrezikut do të vlerësohej si më poshtë:

Tabelë 5.

në milionë lekë

Treguesit	Trem I	Trem II	Trem III	Trem IV	1999	1998
Kredi në lekë	152.49	388.20	553.13	547.38	410.3	18.93
Bono thesari	9689.58	10001.74	9905.73	13848.64	10861.31	10512.07
Investime të reja	9842.07	10389.94	10458.40	14396.02	11271.61	10531.0
% e kredive/ Inv	1.55%	3.74%	5.28%	3.80%	3.64%	0.17%

Të dhënat janë mesatare tremujore dhe vjetore.

Në këtë ndryshim, efekti i strukturës së kredive të reja të dhëna në lekë është i vogël.

Kjo për faktin se, për vitin 1999, kredia e re e dhënë mesatarisht çdo muaj në lekë, zë peshë të vogël në krahasim me investimet e kryera në tregun primar të bonove të thesarit.

Kredia në lekë, për këtë vit, është dhënë kryesisht nga Banka Tirana, Banka Ndërkombëtare Malajziane, Banka FEFAD dhe Banka Alpha Credit. Peshën kryesore e zë Banka FEFAD dhe Banka Tirana. Tendenca kryesore në dhënien e kredive është nga 6 muaj deri në 1 vit dhe mbi 3 vjet.

Krahasuar me vitin 1998, në strukturën e investimeve sipas rrezikut, ka ndryshim në drejtim të peshës që zë kredia e re, e dhënë në lekë ndaj totalit të investimeve. Kjo tendencë, edhe pse jo shumë e theksuar, tregon se bankat kanë filluar ta rrisin shumën e kredive, që japin në lekë.

Liberalizimi i kufirit të kreditit, në fund të vitit 1999, do t'i lirojë bankat nga "barrierat psikologjike", që ekzistonin për plotësimin

e kërkesave të ekonomisë me kredi. Kjo dhe liberalizimi i normave të interesit për depozitat me afat në lekë do të rrisin edhe më shumë rolin e forcave të tregut në shpërndarjen efektive të kredive në ekonomi.

Heqja e kufirit të kreditit dhe rritja e fleksibilitetit të normave të interesit për depozitat në lekë, do të çojnë në përmirësimin e shpërndarjes së burimeve financiare.

Edhe pse kreditimi për ekonominë është më i lartë se në vitin e kaluar dhe ka ardhur duke u rritur, përfitueshmëria që ka investimi në bono thesari[4] ka bërë që ky i fundit të vazhdojë të zërë peshën kryesore. Në totalin e pranimeve të reja, investimet në tregun primar të bonove të thesarit zënë, për çdo tremujor, përkatësisht 35 për qind, 30 për qind, 30 për qind dhe 42 për qind.

Bankat me kapital privat dhe të përbashkët e kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në tregun primar të bonove të thesarit krahasuar me vitin 1998. Gjatë vitit 1999, këto banka kanë investuar në bono thesari çdo tremujor rreth 1.7; 1.2; 1.2 dhe 1.7 miliardë lekë ose 17.7 për qind, 12 për qind, 12.1 për qind dhe 12.3 për qind (me vlerën e skontuar).

Megjithë shtimin e numrit të pjesëmarrësve në tregun primar dhe të vëllimit me të cilin kryesisht bankat me kapital privat dhe të përbashkët marrin pjesë, përsëri nuk mund të pretendohet që në treg, konkurrenca midis kërkesës dhe ofertës është përcaktuese në *yield*-in e bonove të thesarit. Në deformimin e këtij përcaktimi ndikon pozicioni monopol i Bankës së Kursimeve, e cila është edhe investuesja kryesore në treg. Ndryshimi i pozicionit të kësaj banke do t'i vendosë bankat e sistemit në pozita të barabarta konkurruese dhe në përcaktimin e një norme tregu të vërtetë, midis kërkesës dhe ofertës.

B.II. Ndikimi i *yield*-it të bonove të thesarit.

Ndryshimi i normave të interesit për depozitat me afat në lekë në bankat shtetërore, normalisht duhet të shoqërohet me

ndryshimin në të njëjtin kah të *yielde*-ve të bonove të thesarit për të njëjtat maturitete. Realisht kështu ka ndodhur. Ulja, gjashtë herë gjatë vitit 1999 e interesave për depozitat ndikoi në uljen e *yield*-it, niveli i të cilit, në fund të vitit, arriti kuotën më të ulët të paktën që nga viti '96.

Por, uljet në *yield*-et e bonove të thesarit nuk kanë qenë të menjëhershme dhe me nivele të njëjta. Kjo çoi në rritje të përkohshme të diferencës së tyre me interesat e depozitave. Sjellja e diferencave për maturitete të ndryshme nuk ka qenë e njëjtë. Kështu, megjithë ndryshimet e pësuara gjatë vitit, diferenca midis *yield*-it të bonove të thesarit dhe normës së interesit për depozitat me afat një vit, ka ruajtur të njëjtat nivele si në fillim dhe në fund të vitit.

Ndërsa për maturitetet tre dhe gjashtëmujore, në krahasim me fillimin e vitit, diferenca është rritur. Për më tepër, në të tre maturitetet tendenca është rritja e diferencës midis *yield*-eve dhe normave të interesit të depozitave, por më e theksuar kjo diferencë është për afatin tremujor. Ndërsa, në shifër absolute diferencat më të larta i gjejmë tek maturiteti dymbëdhjetëmujor. Grafiku 2 ilustron çfarë u tha më lart.

Grafik 2. Diferenca midis interesit të depozitave dhe *yield*-it të bonove të thesarit.



Në përfundim, intervali për vitin 1999 është ngushtuar ndjeshëm krahasuar me dy vitet e marra për krahasim.

Ritmet e rënies së interesit mesatar të ponderuar për investimet janë më të larta se sa ritmet e rënies së interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave në lekë.

Ngushtimi i intervalit gjatë vitit 1999 tregon se bankat, në sistemin bankar, me punën e tyre, kanë synuar në drejtim të uljes së kostos së ndërmjetësimit, duke u përpjekur që të ruajnë diferenca në nivelet më të ulta që ato kanë patur që nga viti 1996.

Tabelë 6.

në përqindje (%)

Vitet	Interes mesatar vjetor inves.	Interes mesatar vjetor depo.	Diferenca (në përqindje)
1997	32.05	15.85	17.38
1998	28.72	14.89	13.83
ndryshimi vjetor	-3.33	-0.96	
1999	18.97	8.32	10.65
ndryshimi vjetor	-9.75	-6.57	

Ky nivel i krahasuar me nivelet ku ky interval lëviz për vendet në zhvillim është 3-4 herë më i lartë ndërsa, i krahasuar me vendet më të zhvilluara 3-5 herë më i lartë. Ekzistenca e një intervali, disa herë më të lartë se sa vendet në zhvillim, vjen si pasojë e kostos së lartë operacionale të bankave, e konkurrencës së pamjaftueshme në sektorin financiar etj..

METODA 2

Metoda e dytë, konsiston në vlerësimin e rezultatit financiar të bankave dhe të sistemit bankar nëpërmjet nivelit të treguesve të interesit marxhinal, marxhinalit bruto dhe atij neto. Sipas metodës së dytë[5], duke u nisur nga rezultati financiar i bankave, për vitin'99 sistemi bankar paraqet tregues më të mirë se viti 1998 për marxhinalin bruto dhe neto. Nga grafiku 3 duket që, kryesisht nga gushti, ndryshimi si për marxhinalin bruto edhe për atë neto ka qëndruar pozitiv. Ndryshimet mesatare mujore, për çdo tremujor dhe si vit, për interesin marxhinal dhe marxhinalin bruto e atë neto, jepen në tabelën më poshtë:

Tabelë 7.

në milionë lekë

	3MI	3MII	3MIII	3MIV	1999
Interes marxhinal	47.6	287.8	504.9	891.1	432.8
Marxhinal bruto	200.6	269.4	625.4	948.8	511.0
Marxhinal neto	45.6	-17.1	373.3	651.2	263.2

Fakti që ndryshimi mujor i interesit marxhinal për çdo tremujor është rritur, tregon se në sistemin bankar ka patur një tendencë në drejtim të rritjes së arkëtimeve për interesat, në krahasim me shpenzimet për to. Nga një ndryshim mesatar mujor 47.6 milionë lekë të interesit marxhinal në *tremujorin e parë*, niveli i tij ka arritur mesatarisht si ndryshim mujor në 891.1 milionë lekë, në tremujorin e katërt.

Nga ana tjetër, edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, me ndonjë përjashtim, janë rritur duke sjellë rritje të ndryshimit mesatar mujor të marxhinalit bruto nga një tremujor në tjetrin. Pas zbritjes së shpenzimeve të veprimtarisë, niveli i lëvizjeve të marxhinalit neto në sistem, me përjashtim të tremujorit të dytë, qëndron në nivele mesatare mujore pozitive. Rritja në ndryshimin mujor të tyre në tremujorin e tretë dhe atë të katërt, ka ardhur nga rritja e interesave të arkëtuar dhe nga të ardhura të tjera, ndërkohë që shpenzimet e veprimtarisë së bankave tregtare nuk kanë ndryshuar shumë gjatë vitit.

Grafik 3. *Flow* i marxhinalit bruto dhe neto i sistemit bankar.



Llogaritja e treguesve të mësipërm për banka të veçanta në sistem, pasqyron përmirësim të këtyre treguesve për vitin 1999.

Nga analiza e mësipërme mund të themi, se gjatë vitit 1999 sistemi bankar:

- shënon vitin në të cilin është arritur niveli më i ulët i intervalit, midis interesit mesatar të ponderuar për depozitat në lekë dhe investimeve të reja. Megjithatë, ky interval është 3-4 herë më i lartë krahasuar me vendet në zhvillim dhe 3-5 herë më i lartë krahasuar me vendet e zhvilluara;
- ngushtimi i intervalit, tregon se bankat në sistemin bankar, me punën e tyre, kanë synuar në drejtim të uljes së kostos së ndërmjetësimit, duke u përpjekur që të ruajnë diferenca në nivelet më të ulta, që ato kanë patur;
- treguesit sipas rezultatit financiar të veprimtarisë së bankave tregtare, tregojnë për përmirësim të punës së çdo banke në veçanti dhe të të gjithë sistemit në tërësi, duke arritur për herë të parë treguesit më të lartë;
- investimet për ekonominë, megjithë tendencën në rritje krahasuar me vitin 1998, zënë një peshë të papërfillshme ndaj investimit në bono thesari.

Në situatat kur niveli i zhvillimit të sistemit financiar nuk e bën të mundur mobilizimin e burimeve nëpërmjet formave të tjera të tregut, dhe niveli i *yield*-it të bonove të thesarit është i lartë, një formë e tillë e investimit të likuiditeteve në lekë e ka lehtësuar punën e bankave në drejtim të përballimit të kostos së depozitave në lekë.

Por, nga ana tjetër, nuk shërben si nxitje për një punë më krijuese nga ana e tyre në fushën e administrimit të pasiveve në lekë, duke marrë përsipër rrezikun.

-Kalimi drejt instrumenteve indirekte të politikës monetare, - zhvillimi i tregut financiar, - rritja e kooperimit midis bankave, - rritja e disiplinës financiare, -përmirësimi i sistemit të pagesave, -pastrimi i bilancit të bankave me kapital shtetëror nga aktivet pa interes tregu, -adoptimi i praktikave më të mira të mbikëqyrjes bankare, - privatizimi i Bankës së Kursimeve, reformime të tjetra në sistem, që do të rrisin konkurrencën dhe do të ruajnë stabilitetin financiar, do të ndihmojnë në vendosjen e diferencave

optimale midis interesave të investimeve dhe depozitave brenda kufijve, në të cilët duhet të lëvizin ndërmjetësit financiarë, për të plotësuar shpenzimet e tyre dhe për të arritur fitimin optimal.

Heqja e kufirit të kredititi dhe rritja e fleksibilitetit të normave të interesit, për depozitat në lekë, do të ndihmojnë ndjeshëm në përmirësimin e shpërndarjes së burimeve financiare, duke ndikuar në rritjen ekonomike të vendit. Mungesa e tregut të parasë, portofoli i huave të këqija dhe niveli aktual i kostos së veprimtarisë të bankave tregtare krijojnë një nivel më të ulët të interesit mesatar për pranimet e reja të depozitave dhe një nivel të lartë të interesit mesatar për investimet e reja.

SHËNIME

* Suzana Kodra, Specialiste, Departameni i Politikës Monetare.
Ky material është përgatitur me të dhënat, që bankat e nivelit të dytë raportojnë në Bankën e Shqipërisë, sipas metodave standarde ndërkombëtare për vlerësimin e intervalit mesatar. Saktësia e të dhënave varet nga cilësia e informacionit dhe Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi për mangësi në të dhënat e raportuara.
[1] Këto dy metoda shfrytëzojnë informacionet, që raportohen në bankën qendrore, ndërsa bankat tregtare kanë edhe metoda të tjera, që mund të orientohen nga administrimi i fondeve, rreziqet e ndryshme etj..
[2] Pranimet e reja të depozitave përfshijnë depozitat, që pranohen në çdo bankë tregtare brenda një periudhe kohe të caktuar (një muaj) - këtu hyn edhe riinvestimi i depozitave që maturohen gjatë periudhës.
[3] Interesi mesatar i ponderuar për pranimet e depozitave në lekë është produkt i shumave të pranuara të depozitave, sipas çdo afati me interesin e zbatuar për çdo afat, kundrejt totalit të pranimeve.
[4] Rreziku i kthimit zero.
[5] Të dhënat janë marrë nga pasqyra mujore e të ardhurave dhe shpenzimeve, përgatitur nga Departamenti i Mbikëqyrjes. Rezultati financiar përfshin veprimtarinë në lekë dhe në valutë.

RRITJA E TRANSPARENCËS NË VEPRIMTARINË E BANKËS SË SHQIPËRISË

Teuta Baleta
Neritan Kallfa
*Adriana Meko**

Fjalë kyçe
- Transparencë - Ndërgjegjësim i publikut - Komunikim - Informim - Zyra e Shtypit -

I. HYRJE

Në nëntor të vitit 1999, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi dokumentin e strategjisë afatmesme të zhvillimit institucional të Bankës. Ndër objektivat më kryesorë strategjikë, të renditur në këtë dokument, përmendej dhe "ndërgjegjësimi i publikut".

"Ndërgjegjësimi i publikut", si objektiv në vetvete, është menduar të arrihet nëpërmjet rritjes sasiore dhe cilësore të transparencës për publikun. Rritja e transparencës, si botëkuptim dhe mënyrë sjelljeje, përmban dy elemente kryesore. Së pari, është respektimi i të drejtës së publikut për informim. Së dyti, është rritja e shkallës së përgjegjshmërisë së Bankës së Shqipërisë në realizimin e objektit të veprimtarisë së saj.

Gjithashtu, ky objektiv, nënkupton jo vetëm një rikonceptim të marrëdhënieve institucionale ndërmjet Bankës së Shqipërisë

dhe publikut, por edhe një angazhim të të gjitha strukturave të Bankës së Shqipërisë për të arritur transparencën në nivelet bashkëkohore.

Në funksion të këtij qëndrimi disa hapa kryesorë, që do të inicionin këtë proces u konsideruan:

- përgatitja dhe miratimi i platformës rregullatore brenda Bankës së Shqipërisë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi;
- krijimi dhe adoptimi i strukturave individuale dhe kolegjiale në funksion të zbatimit të ligjit e të akteve nënligjore me objekt rritjen e transparencës;
- ndërgjegjësimi i vetë punonjësve të Bankës së Shqipërisë mbi rëndësinë e rritjes së transparencës. Kjo me qëllim që angazhimi i tyre në këtë "detyrë të re" të vinte sa më natyrshëm;
- ndërgjegjësimi indirekt i publikut.

Ky artikull është në funksion të rritjes së transparencës. Gjithashtu, ky artikull ka për qëllim të ndihmojë publikun dhe punonjësit e Bankës së Shqipërisë që të kuptojnë sa më mirë të drejtën për informim të publikut dhe transparencën në Bankën e Shqipërisë.

II. PSE DUHET TRANSPARENCA?

Sot, gjithmonë e më tepër, po flitet për transparencë. Organizma ndërkombëtarë, kryesisht FMN, kanë hartuar dhe standarde të të qenit transparent. Akoma më shumë u vu theksi në transparencë pas krizës, që përfshiu Azinë Juglindore dhe sinjaleve të gabuara që u dhanë për këtë rajon nga mënyra e raportimit të informacionit. Pra, po jetojmë një epokë, që ka bërë të vetën filozofinë e transparencës. Kjo është një arsye që edhe Banka e Shqipërisë të ecë sipas një modeli të përgjithshëm.

Në tërësi, me termin "transparent" nënkuptohet të qenurit i qartë, lehtësisht i kuptueshëm apo i identifikueshëm, i hapur, pa

u fshehur dhe i sinqertë, që lejon depërtim të rrezeve të dritës. Nga kjo pikëpamje me "rritje të transparencës" në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë nënkuptohet publikimi, informimi, shpjegimi i politikave, procedurave, objektivat dhe opinionet e Bankës së Shqipërisë së pari, të bëhen të ditura, të lejohet njohja e tyre (të kalojnë rrezet e dritës); së dyti, të jenë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme; së treti, të jenë të hapura dhe të mos fshihen; së katërti, veprimet e Bankës të jenë të sinqerta dhe të paanshme. Transparenca tregon se sa e hapur synon të jetë Banka e Shqipërisë, në aktivitetin e saj, në radhë të parë të politikës monetare.

Së dyti, rritja e transparencës rrit përgjegjshmërinë në veprimtarinë e bankës qendrore. Aktiviteti i saj i nënshtrohet një debati publik dhe i krijohen mundësi ballafaqimi për të kuptuar sa të drejta janë vendimet e marra apo politikat e ndjekura, a duhen korrektuar ato, ku, kur dhe si.

Së treti, rritja e transparencës me institucionet e tjera shtetërore ndihmon në koordinimin e politikave dhe të aktiviteteve, ndihmon ne rritjen e shkallës së konsultimit.

Së katërti, rritja e transparencës, sidomos me median dhe publikun, rrit shkallën e njohjes së Bankës së Shqipërisë si institucion dhe i jep mundësi asaj të rrisë autoritetin dhe ndikimin e vet edhe mbi institucionet e tjera shtetërore. Ajo që është më e rëndësishme, rrit masën e përkrahësve të Bankës së Shqipërisë.

Së pesti, rritja e transparencës do t'i shërbejë edhe një qëllimi tjetër atij "të edukimit". Për shumë arsye, media dhe publiku janë pak të ambientuar me çështjet e natyrës ekonomike. Nëse rritet shkalla e informimit të publikut dhe thjeshtësia e dhënies së informacionit, gjykimi mbi politikat dhe vendimet ekonomike do të bëhet pjesë e pandashme e veprimtarisë së këtyre grupeve si dhe e bizneseve dhe ekonomistëve, do të disiplinojë sjelljen e tyre ekonomike dhe do t'i orientojë ata. Në fund të fundit, kjo i shërben Bankës së Shqipërisë për të ndërtuar dhe vënë në funksionim efikas mekanizmat e transmisionit në ekonomi të vendimeve të saj. Nëse askush nuk kupton pse merret një vendim

i politikës monetare, asnjë vendim nuk e ka të sigurt suksesin e tij dhe sinjalet, që merr banka qendrore nga mjedisi ekonomik shtrembërohen duke vështirësuar marrjen e vendimeve të tjera.

Së fundi, rritja e transparencës nga Banka e Shqipërisë do të shërbejë edhe për ndërrimin e mentalitetit dhe të traditës së "ruajtjes së sekreteve" dhe "monopolit mbi informacionin" ose "pushtetit mbi informacionin".

III. TRANSPARENCA DHE E DREJTA PËR INFORMIM

Për të kuptuar synimin e transparencës është e rëndësishme të bëhet e qartë se transparenca është detyrim dhe jo e drejtë. Transparenca imponohet drejtpërsëdrejti nga e drejta e publikut për informim mbi dokumentet zyrtare.

E drejta e informimit mbi dokumentet zyrtare është një nga të drejtat themelore të njeriut në një shoqëri demokratike dhe shtet ligjor. Kjo e drejtë është thelbësore për demokracinë, sepse nëpërmjet këtij instrumenti, publiku ushtron pushtetin e tij për të vlerësuar nivelin e qeverisjes së institucionit publik. Vetëm një publik i mirinformuar është në gjendje të kryejë si duhet detyrimin e tij për të dhënë kontribut në demokracinë e një vendi dhe për t'i dhënë formë administratës publike.

Në demokracinë moderne e drejta për informim e publikut instrumentalizohet në dy drejtime. Së pari, publiku nëpërmjet ligjvënësit, detyron pushtetet ekzekutive dhe gjyqësore që të mos censurojnë informacionin. Së dyti, është legjitimimi i instrumenteve të kërkimit, grumbullimit dhe analizimit të informacionit nga individët duke i njohur edhe të drejtën për t'u informuar edhe për dokumentet shtetërore të llojeve të ndryshme.

E drejta e informimit mbi dokumentet zyrtare gëzon mbrojtje kushtetuese dhe ligjore në shumë vende me demokraci të zhvilluar. Mënyrat e garantimit dhe të rregullimit të saj kanë si

nivel më të lartë Kushtetutën ndërsa në nivel ligjesh varion në tre lloj drejtimesh kryesore:

a) vende që e sanksionojnë me ligje të veçanta;
b) vende që e sigurojnë nëpërmjet ligjeve të ndryshme si për shtypin, për organet e zgjedhura, për procedurat administrative etj.;
c) vende që formulojnë në një ligj të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës detyrimi ligjor i informimit, i sanksionuar me ligj, luajti një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e administratës publike amerikane dhe konvertimin e saj në një administratë me të vërtetë transparente. Jurisprudenca amerikane e të drejtës së informimit si pasojë është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të institucioneve publike.

Fryma e filozofisë së transparencës dhe të drejtës për informim është ankoruar edhe në Evropë, pavarësisht se nuk është aq dominuese sa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Disa vende anëtare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet iniciativave individuale, kanë miratuar akte ligjore për rregullimin e drejtpërdrejtë të kësaj të drejte.

Të tjera vende e kanë realizuar jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke plotësuar akte të veçanta, dhe më tej nëpërmjet akteve nënligjore. Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës, mbështetur në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kanë miratuar disa akte në mbështetje të kësaj të drejte si rekomandime për adoptimin e tyre në legjislacionin e vendeve anëtare.

Megjithatë, në asnjë rast liria e individit nuk është absolute. Liria është relative, sepse kufizohet vetëm për interes publik dhe për mbrojtjen e interesave të të tretëve. Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" në nenin 17 përcakton këto dy raste si rastet e vetme të kufizimit të së drejtës për informim. Gjithashtu, është e rëndësishme të

përmendim se edhe këto dy raste të kufizimit mund të bëhen vetëm me ligj. Aktualisht, nga ligji nr.8457, datë 11.2.1999 "Për sekretin shtetëror" dhe ligji nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare".

Kushtetuta e Shqipërisë është mbështetur në parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Mbi këtë bazë, në nenin 23 të saj mbron të drejtën e informimit mbi veprimtarinë e organeve shtetërore duke e klasifikuar atë si të drejtë themelore. Në Kushtetutë përcaktohet se kjo e drejtë rregullohet me ligj. Në fakt legjislacionin në zbatim të së drejtës kushtetuese për informim e gjejmë në dy ligje të veçanta. Në Kodin e Procedurave Administrative (nenet 51 dhe 55) dhe në ligjin për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

Dispozita e Kodit të Procedurave Administrative mbi të drejtën për t'u informuar, rregullon marrëdhënien në rastet kur zhvillohet ndonjë procedim administrativ, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një individ. E drejta për t'u informuar, kur një individ është pjesë e një procedimi administrativ dhe sidomos kur ka procesim apo trajtim të të dhënave personale të tij, sigurohet, gjithashtu, edhe nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili në këtë rast nuk vepron si kufizues, por si garantues i kësaj të drejte. Dispozitat e këtyre dy ligjeve përcaktojnë edhe afatet kohore brenda të cilave duhet bërë njoftimi i personave të interesuar.

Në të dyja këto raste informimi i personave të interesuar bëhet duke prezumuar që ata nuk kanë dhe nuk mund të kenë dijeni që ata apo të dhëna, që kanë lidhje me ta, janë bërë pjesë e ndonjë procedimi administrativ. Është e qartë që në këtë rast ligjvënësi është i interesuar që e drejta për informim të gëzohet në mënyrë automatike edhe në rastet kur nuk ka kërkesë specifike për të marrë informacion.

Ligji për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare është, jo vetëm një plotësim i kodit të procedurave administrative, por edhe një zhvillim i mëtejshëm i kësaj të drejte të sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Shqipërisë. Me këtë ligj, krijohet baza ligjore, praktike dhe proceduriale për vënien në jetë të kësaj të

drejte. Nga njëra anë, ky ligj i bën të qartë publikut rrugët dhe mënyrat për gëzimin e së drejtës kushtetuese për informim. Nga ana tjetër, ligji i tregon administratës publike mënyrën e punës për të qenë sa më transparente në aktivitetin e saj.

IV. SI MENDON TA REALIZOJË BANKA E SHQIPËRISË RRITJEN E TRANSPARENCËS

Ndoshta, si fillim, ka nevojë të bëjmë një ndërhyrje të vogël për të sqaruar, për herë të parë në mënyrë "zyrtare", se komunikimi i mirëfilltë është në fund të fundit një marrëdhënie dhe si e tillë kërkon të paktën dy palë, të mirëkuptuara në parim dhe të barabarta në dëshirën për të përfituar dhe respektuar reciprokisht njëra - tjetrën. Njëra palë duhet të vlerësojë angazhimin e bankës qendrore për të rritur transparencën e saj; të respektojë veprimet që ndërmerr banka qendrore dhe të mos përpiqet të spekulojë me to (në veçanti media). Kjo kërkon dhe kohën e nevojshme për t'u krijuar. Por, nëse përballet me qëndrimin korrekt të bankës qendrore, sigurisht që edhe reagimi do të jetë gjithnjë e më serioz. Ky mendojmë se është kushti i parë i domosdoshëm për të patur një bazë mbi të cilën të ndërtohet marrëdhënia, që në rastin tonë quhet komunikim.

Për të vazhduar më tej me këtë abstragim të thjeshtë, që jemi përpjekur ta sjellim në ndihmë të argumentit tonë, nuk duhet të harrojmë që çfarëdo lloj marrëdhënieje lind, zhvillohet dhe është e vendosur në një realitet të caktuar; detyrohet të përballojë një mentalitet të caktuar; bëhet pjesë e një opinioni të caktuar dhe në rastin më të mirë i paraprin një dimensioni të ri në botëkuptimin ekzistues.

Në rastin konkret, marrëdhënia e Bankës së Shqipërisë me publikun është një fenomen krejtësisht i ri. Kjo për shumë arsye. E para dhe më e rëndësishmja është mungesa e traditës. Të gjithë e dimë që shqiptarët kanë ardhur tek banka vetëm në këta dhjetë vjetët e fundit. Pra, nuk kanë patur nevojë të dinë çfarë është një bankë dhe si shkohet atje. Aq më pak u ka interesuar të njohin "gjuhën" e saj, shërbimet që mund t'u ofrojë, sigurinë

që mund t'u japë, apo komoditetin fizik në lëvizjen e parave. Dhe e gjitha kjo, asnjëherë për fajin e tyre.

E dyta, ka të bëjë me shkallën e "miqësisë" që bankat u kanë treguar atyre deri tani. Të konceptuara fillimisht si institucione të mirëfillta shtetërore, bankat e vetme të trashëguara nga ekonomia socialiste, vazhduan të ishin të largëta për klientin - individ, që tashmë kishte nevojë të ngutshme për shërbim, informacion, mbështetje dhe siguri. "Ngathtësia" e tyre u shoqërua me indiferencën e dukshme të bankave me kapital të huaj apo të përbashkët, që u licencuan këta vjet, ndaj biznesit dhe klientit shqiptar. Si shumë shpesh në teorinë dhe praktikën e këtyre rasteve, hapësirat boshe plotësohen gjithmonë me çfarë më të thjeshtë realiteti ofron. Më e thjeshta gjë që ofroi realiteti shqiptar, i rënduar tej mase nga dëshira për fitim të lehtë e të shpejtë dhe prirja drejt aventurës financiare e shtresës së re të biznesmenëve, që u krijua, ishte fenomeni: Piramidë.

Si çdo përmbysje e madhe e një besimi, të bazuar në një llotari fatsjellëse, edhe përfundimi i epokës së "lumtur piramidale të shqiptarëve" ishte më tepër se i dhimbshëm. Ky moment mundet që shumë mirë të ishte shfrytëzuar nga banka për të zënë vendin e merituar në ekonominë, biznesin dhe mendimin financiar shqiptar. Erdhëm kështu në problemin tjetër, atë të mentalitetit, ku për lehtësi do të përfshijmë njëkohësisht nivelin e publikut (që normalisht është bashkëbiseduesi ynë) dhe predispozicionin e bankës për të qenë sinqerisht e hapur.

Duket sikur vështirësia më e madhe qëndron në formimin dhe kulturën ekonomike të publikut shqiptar, për arsyet që thamë pak më lart. Por, që të mos vazhdojmë të fshihemi pambarimisht pas të kaluarës dhe për të patur kurajën e më të mençurit, në pranimin e pjesës së fajit që na takon, duhet të pranojmë që vështirësitë më të mëdha qëndrojnë në "përmbysjen" botëkuptimore që më parë duhet të arrijmë të realizojmë brenda institucionit.

Që Banka e Shqipërisë të mund të arrijë të jetë e hapur në aktivitetin e saj, do të duhet që në nivelet drejtuese dhe tek punonjësit të kuptohet si një domosdoshmëri, që nuk mund të

tolerohet më, transparenca ndaj publikut. Kjo, sepse përvoja ka treguar që, kur në një proces kaq delikat dhe njëkohësisht të rëndësishëm, angazhohen njerëz, që akoma kanë dyshime brenda vetes për suksesin e tij, rezultati është gjithmonë i lëkundur. Ai që nuk është i sigurt për dobishmërinë e asaj që bën, nuk mund të bindë askënd me ato që thotë.

Hapat konkretë, që ka vendosur Banka e Shqipërisë të hedhë në këtë drejtim, për momentin, marrin parasysh kënaqjen e të gjitha shtresave të interesuara. Themi për momentin, pasi për arsye të shumta, të cilat nuk janë objekt i këtij shkrimi, boshllëku informativ dhe i edukimit duhet plotësuar me investimin e përbashkët të të gjitha bankave, që aktualisht operojnë në sistemin bankar shqiptar. Sepse, çfarë ndodh realisht është në tërësi një indiferencë e bankave të nivelit të dytë ndaj mungesave të theksuara në edukim.

Për të mos u zgjatur në këtë pikë, mendojmë që për të gjitha arsyet, Bankës së Shqipërisë i takon dhe më shumë se kaq, është në nderin e saj të luajë rolin e paraprijësit në këtë detyrim "të harruar", deri tani të institucionit bankar ndaj opinionit shqiptar.

Kjo është vetëm një nga pengesat që duhen kapërcyer për të ndryshuar krejtësisht atë, që mjaft mirë mund ta quajmë opinion të bankierit të sotëm. Sepse, me të drejtë mund të flasim për shtresë të re bankierësh dhe për opinion të qytetarizuar të tyre. Nuk themi të zyrtarizuar, sepse një i tillë, fatkeqësisht, neve deri tani na ka munguar.

Që të kesh opinion zyrtar të bankierëve do të thotë të kesh prononcime publike, me shkrim dhe me gojë të titullarëve më në zë të bankave; të kesh shpjegime publike të drejtuesve më të suksesshëm për politikat që ata ndjekin; të kesh teknikë që me kompetencë profesionale t'i japin siguri publikut për të gjitha fenomenet financiare, që ai i kupton ose jo; me fjalë të tjera, të kesh transparencë të vendimmarrjes dhe të komunikimit në të gjitha hallkat e sistemit bankar. Të paktën e tillë ka qenë praktika deri më sot. Në forma fillestare këto gjëra kanë nisur.

Viti i fundit kalendarik, ka shënuar disa dalje të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë para Kuvendit, në konferenca të ndryshme shtypi apo takime të karakterit bashkëbisedues. Ajo që synohet ka të bëjë me vijueshmërinë e fenomenit.

Për të qenë e suksesshme edhe në këtë impenjim të saj, Banka e Shqipërisë ka përpunuar një strategji të thjeshtë dhe mjaft komode për t'u zbatuar, e cila me siguri do të ketë rezultate të dukshme pozitive.

Çfarë synon të realizojë ajo tashmë dihet. Si do ta realizojë atë, mbetet për t'u renditur më poshtë. Mënyrat, të cilat do të përdoren nga Banka e Shqipërisë për komunikim do të jenë format klasik: komunikimi i shkruar dhe ai verbal. Në të parin bëjnë pjesë: botimet, deklaratat për shtyp, intervistat e shkruara dhe artikujt. Në komunikimin verbal bëjnë pjesë: daljet në Kuvend apo në Komisionin Ekonomik, konferencat e shtypit, daljet në mediat elektronike, pjesëmarrjet në konferenca dhe aktivitete të ndryshme. Këto lloj aktivitetesh nuk i kanë munguar Bankës së Shqipërisë deri më sot. Por, hartimi i një rregulloreje për transparencën siguron mirorganizimin e tyre. Krijimi i një Zyre Shtypi në Bankën e Shqipërisë është një domosdoshmëri dhe po kështu edhe krijimi i ambienteve për zhvillimin e konferencave. Nisur nga rëndësia, që paraqet një njësi e tillë për një bankë qendrore, struktura organizative e miratuar në Këshillin Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 4 tetor përmban një zyrë të tillë.

Ana tjetër e këtij procesi është rritja e transparencës në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë. Sipas vlerësimit që i është bërë raportimit të derisotëm me standardet e përpunuara për praktikat e transparencës në fushën monetare, të përpiluar nga FMN, konkludohet që Banka e Shqipërisë është në një nivel të pakënaqshëm raportimi dhe shpjegimi.

Kjo dobësi është menduar të kapërcehet nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

IV.I RRITJA E TRANSPARENCËS NË VEPRIMTARINË E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Në këtë pikë vlen të ndalemi më gjatë për ta shpjeguar si një fenomen të ri të vendimmarrjes kolektive në vendin tonë. I zgjedhur nga Kuvendi, ky këshill është përgjegjës për vendimet që merr qoftë kolegjialisht, qoftë në mënyrë individuale. Bërja publike e këtyre vendimeve dhe e mënyrës së marrjes së tyre, e kalendarit të mbledhjeve të rregullta të tij apo e një përmbledhjeje të protokollit të këtyre mbledhjeve nuk është një kërkesë e tepruar dhe as tepër e guximshme. Është, përkundrazi, plotësim i një detyrimi profesional e qytetar dhe tregues i të kuptuarit drejt të përgjegjësisë individuale në vendimmarrjen kolektive.

IV.II RRITJA E TRANSPARENCËS NË FUSHËN E POLITIKËS MONETARE, E OPERACIONEVE MONETARE, E MBIKËQYRJES BANKARE, E KUADRIT LIGJOR E RREGULLATIV SI DHE E KONTABILITETIT

Praktikisht, kërkohet një rritje transparence në të gjitha aktivitetet e Bankës së Shqipërisë duke theksuar më tepër aktivitetet kryesore të saj, politikën dhe operacionet monetare.

Çështjet për të cilat do të ofrohet informacion do të jenë nga më të ndryshmet:

- deklarim objektivash, politikash, vendimesh, procedurash dhe ndryshimesh që pësojnë ato;
- shpjegim i objektivave, politikave, vendimeve, procedurave dhe ndryshimeve që pësojnë ato në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë. Gjithmonë do të përpiqemi t'u përgjigjemi pyetjeve: "pse u bë?"; "pse tani?"; "çfarë pritet të ndryshojë ose çfarë efekti do të ketë?".

Po kështu, kërkohet rritja e audiencës së Bankës së Shqipërisë duke diferencuar kategoritë e ndryshme të saj. Kështu, nivelet e dhënies së informacionit do të përfshijnë:

- Kuvendin, si organi më i lartë legjislativ i shtetit ku me ligj Banka e Shqipërisë është e detyruar të raportojë.
- Institucione të tjera të larta që merren me çështje të ekonomisë dhe të politikave ekonomike si Presidenti, Kryeministri, ministritë, kryesisht e financave, ekonomisë publike dhe privatizimit dhe bashkëpunimit ekonomik dhe tregtisë, organizma ndërkombëtarë.
- Përdorues të rëndësishëm profesionistë, që janë pjesë e mekanizmit të transmisionit si bankat, institucionet financiare, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Drejtësisë, bizneset, ambasadat.
- Përdorues të tjerë si media, institute të studimeve ekonomike e publiku.

Për të qenë e sigurt në suksesin e kësaj ndërmarrjeje të guximshme të Bankës së Shqipërisë në emër të transparencës në komunikimin me publikun duhet që, secili nga hapat e mësipërm të shoqërohet me rritje të ndërgjegjshmërisë kolektive të specialistëve dhe drejtuesve të Bankës së Shqipërisë.

Tre elemente të tjera që do të rrisin transparencën e Bankës së Shqipërisë janë:

1. Hapja e bibliotekës. Kjo nënkupton mundësinë e shfrytëzimit nga publiku të fondit të bibliotekës së Bankës së Shqipërisë.
2. Hapja e arkivës. Është një proces që e njeh publikun me historikun e marrëdhënieve të Bankës së Shqipërisë me institucionet e tjera, bën transparente të kaluarën e këtij institucioni, vendimet e marra etj..
3. Publikimi i librit të telefonave. Sintetizon një mënyrë komunikimi të Bankës së Shqipërisë me të interesuarit për informacion. Banka e Shqipërisë duhet të hartojë një numërator telefonik, që të përmbajë emrin e punonjësit, njësinë ku punon, fushën për të cilën ky person mund të japë përgjigje dhe numrin e telefonit.

E pamë të arsyeshme të shoqërojmë me disa fjali sqaruese elementet e fundit, sepse këto janë krejtësisht të reja në aktivitetin

e bankës qendrore dhe plotësojnë më së miri përpjekjet për të qenë më të qartë e më transparentë me publikun duke i ofruar dhe komoditetin përkatës.

V. KONSIDERATA PËR ZYRËN E SHTYPIT

Me miratimin e strukturës së re në Bankën e Shqipërisë, si në të gjitha institucionet e tjera, do të funksionojë një Zyrë Shtypi. Nisur nga rëndësia që ka kjo zyrë për një bankë qendrore, sidomos në procesin e rritjes së transparencës, dhe krijimit të saj për herë të parë e gjykojmë të vlefshme të japim disa konsiderata për të. Zyra e Shtypit është e nevojshme të jetë e aftë të mirëkuptojë publikun dhe të jetë e mirëkuptuar prej tij. Deri në këtë moment Banka e Shqipërisë ka komunikuar me publikun, në një shkallë jo të vogël dhe me mjaft dinjitet falë publikimeve të saj të shumta në lloje. Në këtë mënyrë, ajo ka mundur të vendosë një marrëdhënie të ndryshme, të rregullt dhe serioze me shtypin dhe publikun e interesuar brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Gjithashtu, Zyra e Shtypit do t'i japë mundësi Bankës së Shqipërisë dhe titullarëve të saj, të plotësojnë portretin e tyre institucional, profesional dhe qytetar. Më shumë se kaq, një Zyrë Shtypi e mirëfilltë shton sigurinë e autoriteteve të Bankës dhe i bën të ndjehen të qetë kur shfletojnë shtypin e mëngjesit. Kjo, sepse Zyra e Shtypit, kryen me mjaft kompetencë rolin e një ndërmjetësi midis institucionit dhe mediave të ndryshme.

Për të përmbushur funksionin e mësipërm, ajo ka nevojë të harmonizojë maksimalisht tiparet e mëposhtme:

1. Të arrijë të vendosë një marrëdhënie të gjallë me median e shkruar dhe elektronike, si të gjitha homologet e saj. Në këtë funksion ajo është e detyruar të përgjigjet para publikut me konferenca shtypi, intervista të folura dhe të shkruara, njoftime të shkurtra deri edhe biseda telefonike.
2. Të jetë agresive në përmbushjen e detyrimit të saj ndaj institucionit, për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm

të imazhit të Bankës së Shqipërisë në publik. Kjo do të thotë që të ketë gjithë kompetencën, guximin, aftësinë për të reaguar në çdo moment në emër dhe për interes të Bankës së Shqipërisë.

3. Të jetë qartë e pozicionuar në aspektin teknik të detyrimeve të saj. Kjo do të thotë që një Zyrë Shtypi i shërben institucionit të saj, krejtësisht e pandikuar nga ndryshimet e politikës dhe të programeve qeverisëse. Kjo do të thotë që ajo punon duke respektuar ligjet, që rregullojnë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe marrëdhëniet e saj me strukturat e tjera financiare, të vendit dhe të huaja.
4. Të jetë e moralshme, e qytetëruar dhe elegante në ballafaqimin e saj me publikun. Kjo do të thotë që në morinë e takimeve, prezantimeve apo bisedave të panumërta me të cilat publiku shqiptar "ushqehet" çdo ditë, ajo që Banka e Shqipërisë i bën të shohin në fytyrën e njerëzve të saj të shtypit dhe të dëgjojnë me zërin e tyre, të jetë më shumë se e pëlqyeshme dhe e përpunuar estetikisht.
5. Të jetë ambicioze në vendin që duhet të zërë në një renditje të pashkruar të homologeve të saj, renditje e cila në mënyrë spontane shfaqet në preferencën e medias për një zyrë të caktuar shtypi. Që të jesh më i miri duhet të kesh shkathtësi në kapjen e problemeve më të mprehta të momentit, largpamësi në parashikimin e fenomeneve të ndryshme financiare dhe gjithë autoritetin e duhur për të ndërhyrë në dhe atëherë kur duhet për sqarimin apo parandalimin e situatave të ndryshme.

Bankës së Shqipërisë i takon që të ketë një strukturë të tillë. Akoma më tepër, Banka e Shqipërisë është një institucion, që meriton të jetë i pavarur dhe disponon aftësitë për të qenë i tillë.

---

* Teuta Baleta, Drejtore, Departamenti i Kërkimeve.
Neritan Kallfa, Këshilltar, Kabineti i Guvernatorit.
Adriana Meko, Specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

REGJIMET E POLITIKËS MONETARE DHE PRIRJA E BANKËS SË SHQIPËRISË

*Gramoz Kolasi**

Fjalë kyçe
- Politikë monetare - Inflation targeting - Regjim i targetimit të parasë - Programimi dinamik -

Një politikë monetare është e aftë të bëjë gjithçka, dhe kjo mund të ndodhë njësoj, si në një ekonomi të shëndoshë ashtu dhe në një ekonomi të brishtë, që ndryshe mund të quhet "ekonomi në tranzicion". Pavarësisht nga shkalla e zhvillimit të ekonomisë, stabiliteti makroekonomik do të vihet në dyshim njësoj, nëse politika monetare, në mënyrë të vazhdueshme, do të jetë ekspansioniste apo në qoftë se treguesit e përftuar do të jenë larg niveleve objektiv të vendosura. Pasojat do të jenë të dukshme në rritjen e çmimeve, rritje e cila nga ana e saj, tenton ta bëjë akoma më ekspansioniste vetë politikën monetare, duke krijuar një rreth vicioz midis inflacionit dhe politikës monetare.

Paefektshmëria e politikës monetare mund të jetë rrjedhojë e dy faktorëve:

i) Marrjes gabim të vendimeve; në qoftë se vendimmarrësit interpretojnë gabim shifrat e arritura, në qoftë se ata nuk karakterizohen nga aftësia për të parashikuar drejt zhvillimet e së ardhmes është e kuptueshme që vendimet e marra do të çojnë në rezultate të gabuara, duke gjeneruar prishje të ekuilibrit makroekonomik.
ii) Mungesës së një instrumenti monetar efektiv; nga ana tjetër, nuk mjafton të kesh të zhvilluar aftësinë e analistit.

Mund të gjykosh drejt mbi fenomenet e caktuara dhe të kesh aftësinë e programimit të saktë të së ardhmes, por në qoftë se nuk zotëron të paktën një instrument monetar efektiv, atëherë padobishmëria e politikës monetare është e sigurtë.

Përmendëm vetëm këta dy faktorë pasi të tjerë, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, institucional, shkallën e zhvillimit ekonomik dhe me veçoritë individuale të çdo vendi, i kemi marrë të mirëqenë.

Cili është objektivi bazë i politikës monetare? Në ditët tona stabiliteti i çmimeve të konsumit, gjithnjë e më shumë, po shihet si i vetmi objektiv, që politika monetare duhet ta realizojë në mënyrën më strikte të mundshme, pavarësisht faktit që shumë studiues janë të mendimit se pjesë e objektivave të politikës monetare duhet të jenë rritja ekonomike, pozicioni i jashtëm i vendit, punësimi etj.. Debati dhe sot e kësaj dite është i ndezur, por gjithnjë e më shumë po mbizotëron ideja se politika monetare duhet të jetë e prirur vetëm në një drejtim, në atë të kontrollit mbi inflacionin. Pjesa e parë e këtij artikulli synon të japë një përgjigje të pyetjes së mësipërme bazuar në idetë bashkëkohore mbi funksionin e politikës monetare[1].

I. ÇFARË MUND DHE ÇFARË NUK MUND TË BËJË POLITIKA MONETARE

Përpara se të hartosh një kuadër logjik për mbajtjen e politikës monetare, është thelbësore të dish se çfarë ajo mund dhe nuk mund të bëjë. Politika monetare në vetvete është tërësia e veprimeve të bankës qendrore, të ndërmarra për të arritur objektivat e politikës monetare.

Në shumicën e vendeve të zhvilluara, instrumenti më i rëndësishëm i politikës monetare është përqindja afatshkurtër e interesit, e vendosur nga banka qendrore, për të ndikuar faktorët financiarë, të cilët, nga ana e tyre, ndikojnë kërkesën agregate. Në vende të tjera, veçanërisht aty ku tregjet financiare nuk

janë të zhvilluara, ndikimi i bankës qendrore arrihet nëpërmjet rezervave të detyruara dhe kontrollit administrativ mbi përqindjet e interesit, të ofruara nga bankat tregtare dhe mbi akordimin e kredisë.

Nga një vrojtim[2] i kryer me pjesëmarrjen e 77 vendeve është vënë re se, në pjesën më të madhe, politika monetare merr jetë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve indirekte. Më konkretisht, 60 për qind e vendeve të marra në vrojtim përdorin rezervën e detyruar, 48 për qind përdorin marrëveshjen e riblerjes dhe 45 për qind operojnë nëpërmjet shitjes dhe blerjes së letrave me vlerë. Vetëm 3 për qind, ku përfshihet dhe vendi ynë, përdorin instrumente të drejtpërdrejta kontrolli[3].

Modeli monetar standard ka si parim bazë ndikimin që përqindja e interesit e bankës qendrore jep mbi kërkesën agregate në ekonomi: një përqindje interesi më e ulët rrit sasinë e parasë së kërkuar ndërkohë që, për bankat është më fitimprurës përdorimi i rezervave të tepërta gjë që rrit kërkesën agregate; në të kundërt rritja e përqindjes së interesit pakëson sasinë e parasë së kërkuar sepse, për bankat, kostoja e fondeve kapërcen përqindjen potenciale në kthim.

Alan Blinder (1998, faqe 14) thekson që një politikë monetare logjike duhet të fillojë me një funksion objektiv dhe të paktën me një model makroekonomik, kërkesë minimale e të cilit të jetë një instrument i vetëm monetar, që ndikon ekonominë. Më tej, Blinder shton se modeli makroekonomik duhet të bazohet mbi konceptin e programimit dinamik, që konsiston në idenë "mendo që më parë për vendimet që do të marrësh sot". Kjo duhet kuptuar që vendimmarrësi duhet të jetë i aftë të gjejë atë shteg, që do ta çojë në mënyrë të suksesshme nga e tashmja drejt së ardhmes së dëshiruar. Është pikërisht përqasja e programimit dinamik, e cila bazuar në ndikimin e vonuar të një variabli mbi një tjetër, që eliminon ndonjë mosrealizim të mundshëm të objektivave në të ardhmen. Përqasja alternative, ajo e programimit statik, e forcimit dhe e zbutjes së politikës monetare në varësi të përqindjes aktuale të inflacionit do të detyronte politikën monetare, që për një kohë të gjatë, të

qëndronte e pandryshuar në sensin e forcimit ose të zbutjes të saj.

Duke bërë një përmbledhje të të dyja përqasjeve Blinder konkludon që "të menduarit mbi mënyrën e programimit dinamik nuk është ingranuar në mënyrë të mjaftueshme në zakonet e politikëbërësve, të cilët, shpeshherë, vetëm sa "shikojnë jashtë dritares" dhe marrin vendimet e rastit mbi një bazë gjykimesh të rrethanave të momentit. Ky është një gabim themelor dhe një arsye pse bankat qendrore, shpesh, ruajnë gjatë të pandryshuar një lloj politike."

Një shembull tipik sipas Blinder, i suksesit të programimit dinamik është rasti i masës parandaluese të Rezervës Federale në vitin 1994, rast në të cilin politika monetare u shtrëngua përpara se të rritej inflacioni. Megjithatë, në rastin e programimit dinamik, në dukje ekziston një paqartësi, e cila ka të bëjë me faktin se në disa raste masat shtrënguese të marra nga politika monetare duken sikur janë të panevojshme.

Në rastin kur masa parandaluese rezulton e suksesshme, inflacioni do të mbetet në nivele të ulëta, gjë që do t'i pajiste kritikët me argumentin se politika monetare e shtrënguar ishte jo e nevojshme. Natyrisht, një politikë perfekte parandaluese bën që të mos vihen re lidhje midis vendimeve monetare me variablat makroekonomikë. Më konkretisht, në qoftë se inflacioni për një kohë të gjatë ruhet në nivelin 2,5 për qind, do të jetë e pamundur të zbulosh efektin e politikës monetare mbi inflacionin (variabli i varur do të jetë konstant).

Është e njohur se kontrolli monetar nuk është një proces mekanik i kontrollit të parasë nëpërmjet përqindjes së interesit.

Kërkesa për para mund të pësojë shumë goditje, të cilat imponojnë nevojën për ndryshimin e përqindjeve të interesit brenda një intervali të arsyeshëm. Kjo do të thotë që, banka qendrore është gjithmonë e detyruar të rregullojë ofertën e parasë me anë të një përqindjeje të pranueshme interesi. Edhe pse fillimisht mund të kërkojë kohë, në ekonomitë me sisteme

bankare të orientuara drejt tregut, në qoftë se kontrolli mbi sasinë e parasë nëpërmjet përqindjes së interesit nuk arrihet menjëherë me siguri do të arrihet me kalimin e kohës.

Debati mbi atë se çfarë mund dhe nuk mund të bëjë politika monetare vazhdon akoma. Në njërin krah qëndron mendimi se politika monetare, përveç stabilitetit të çmimeve duhet të vërë në shënjestrën e saj dhe punësimin dhe rritjen ekonomike. Në të kundërt, mendimi alternativ fokusohet vetëm mbi stabilitetin e çmimeve. Për paradoks, të dyja teoritë bashkohen në idenë se politika monetare i shërben punësimit dhe rritjes ekonomike, vetëm në qoftë se sigurohet stabiliteti i çmimeve.

Pra, stabiliteti i çmimeve është një kusht i nevojshëm për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe rrjedhimisht, i vetmi objektiv i përshtatshëm i politikës monetare. Debati ndërmjet alternativave ka një histori të gjatë.

Aktualisht, peshorja po anon në favor të pikëpamjes së dytë: një numër në rritje bankash qendrore po këmbëngulin në stabilitetin e çmimeve. Pikëpamjet mbi çka duhet të bëjë politika monetare kanë qenë në ndryshim të vazhdueshëm gjatë shekullit XX. Ndërsa Irving Fischer (1922 - teoria sasiore) konkludoi se efekti primar i politikës monetare ishte se ndryshimet në sasinë e parasë shkaktonin ndryshime në nivelin e çmimeve, Kejnsi (1959 - Radccliffe Report) gjeti se roli i parasë në makroekonomi ishte pak më i zbehtë. Milton Frideman dhe monetaristët e tjerë, sfiduan konkluzionet e Kejnsit kur ata konkluduan se ekziston një lidhje shkakësore midis parasë, rritjes dhe inflacionit.

Dy momente shumë të rëndësishme në këtë literaturë, kanë të bëjnë me punën empirike të Bill Phillips (1958) mbi lidhjen midis përqindjes së ndryshimit në paga dhe përqindjes së papunësisë në Britaninë e Madhe dhe artikullit vijues të Pol Samuelson dhe Robert Solow (1960) mbi koston e reduktimit të inflacionit në terma të ngadalësimit të rritjes ekonomike.

Në vitin 1958 Bill Phillips demonstroi ekzistencën, në Mbretërinë e Bashkuar, të një lidhjeje të qëndrueshme midis

punësimit dhe përqindjes së ndryshimit në paga, për gati gjatë gjithë shekullit të mëparshëm.

Figurë 1. Kurba origjinale e Philips-it.



Ai e përdori këtë lidhje për të vlerësuar nivelin maksimal të kërkesës agregate dhe për rrjedhim, nivelin minimal të papunësisë në konsistencë me stabilitetin e çmimeve. Ai zbuloi se disa kombinime të përqindjeve të ulëta të papunësisë me një inflacion shoqërues pozitiv përbëjnë një zonë *non-grata* për konceptet e politikës makroekonomike, e për rrjedhim, ato duhen shmangur.

Brenda katër viteve të zbulimit të tij, Samuelson dhe Solow (1960) përmbysën analizat e Phillips kur konkluduan se një normë inflacioni prej 3 - 4 për qind ishte e nevojshme për të ulur papunësinë në nivelin 3 për qind në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Samuelson dhe Solow e paraqitën kurbën e Phillips si një lidhje midis inflacionit dhe papunësisë se sa si lidhje midis ndryshimit në paga dhe papunësisë. Ky transformim ishte në të njëjtën linjë me pretendimin e Phillips, se rritja e ulët e produktivitetit në Britani, në mënyrë që të mbahej stabiliteti në çmime, lejoi që paga nominale të rritet vetëm 2 për qind. Me fjalë të tjera u pa e arsyeshme të supozohej një rritje e produktivitetit në masën 2 për qind. Kështu boshti *y* i diagramës së Phillips u rikalibrua në një përqindje inflacioni 2 pikë më të ulët se ndryshimet korresponduese në paga.

Figurë 2. Kurba e transformuar e Phillips-it 1961-1969.



Kombinimi i supozimeve për një rritje konstante të produktivitetit dhe të forcës së punës, i mundësoi Arthur Okun (1962) të derivonte një lidhje monotone ndërmjet rritjes dhe punësimit. Në këtë mënyrë kurba e Phillips, nga një kurbë rënëse shndërrohet në një kurbë rritëse ndërmjet inflacionit dhe rritjes ekonomike: rritje më e lartë mund të sigurohet me një kosto më të lartë inflacioni. Figura 2 paraqet kurbën e transformuar të Phillips për Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë viteve të para të pasluftës, duke filluar me 1 për qind inflacion dhe me më pak se 2 për qind rritje në vitin 1961. Praktikisht, për të gjitha vendet në zhvillim, kurba e Phillips, për shkak të mungesës së të dhënave të punësimit, mund të paraqitet në formën e transformuar të saj.

Në vitet '60 teoria ekonomike pranoi se ekzistonte një lloj lidhjeje në përpjesëtim të drejtë ndërmjet inflacionit dhe rritjes: një rritje më e lartë mund të arrihej me një kosto më të lartë inflacioni. Në fakt, vetë Phillips (1958) kishte evidentuar, se si pasojë e mosveprimit të politikëbërësve për të shfrytëzuar lidhjen e kurbës së Phillips, lidhja e kurbës origjinale kishte filluar të zhdukej. Kështu, 10 vjet pas zbulimit të saj, kurba e Phillips u gjend nën sulme të shumta. Në të vërtetë, brenda dy dekadave pasuese kurba e Phillips nuk ekzistonte më. Nga një kurbë rritëse, që shprehte lidhjen midis inflacionit dhe rritjes, ajo u shndërrua në një kurbë vertikale, gjë që do të thotë se lidhja afatgjatë midis rritjes ekonomike dhe inflacionit nuk mund të

vërtetohet më, sidomos me të dhënat e mbledhura mbas vitit 1970.

Në dy dekadat e fundit, kurba e Phillips është rrotulluar përsëri duke zbuluar një lidhje negative midis inflacionit dhe rritjes për një grup të madh vendesh, pa bërë dallim nga pikëpamja kohore. Ideja e pranuar aktualisht është se në periudha afatgjata, lidhja midis prodhimit dhe inflacionit është negative: inflacioni në rritje shoqërohet me një prodhim në rënie (Barro 1995, Fischer 1994). Ndërsa, efektet negative të hiperinflacionit mbi rritjen janë lehtësisht të dukshme, me çrregullimet që shkaktojnë te kursimet, te mekanizmat monetarë dhe tek ata të formimit të çmimeve.

Ekziston një variete kanalesh potenciale me anë të të cilave inflacioni ushtron ndikimin e vet negativ dhe pozitiv mbi rritjen ekonomike dhe anasjelltas. Në vendet në zhvillim, përqindjet nominale fikse të interesit dhe kurset e këmbimit, mund të kenë qenë faktorë destabilizimi (Fry 1995). Ndërsa inflacioni rritet, përqindja reale e interesit në ulje (pasojë e një përqindjeje nominale fikse të interesit) pakëson dëshirën për të dhënë kredi dhe shformon akordimin e saj, ndërkohë që çmimet e eksporteve, si pasojë e kursit fiks të këmbimit, mbeten jashtë tregjeve botërore. Të dyja efektet, së bashku, ndikojnë në uljen e rritjes ekonomike.

Lidhja negative ndërmjet rritjes ekonomike dhe inflacionit e diktuar në këto vitet e fundit mund të jetë pasojë e goditjeve, që pësoi oferta në mbarë botën gjatë viteve '70 dhe '80: një zhvendosje majtas në kurbën e ofertës ul sasinë dhe rrit çmimin. Vitet në vazhdim (periudha 1988 - 1995) nuk u karakterizuan nga goditje të ofertës dhe për rrjedhim, lëkundjet në kërkesë ndikuan çmimet dhe sasinë në të njëjtin drejtim. Për më tepër, këto vitet e fundit, kjo lidhje negative duket se është bërë më e fuqishme.

Pavarësisht nga sa më sipër, me sa evidentohet nga ekonomitë e vendeve të zhvilluara, në tranzicion dhe ato në zhvillim, në asnjë rast nuk gjen mbështetje ideja, që politika monetare mund të përshpejtojë rritjen ekonomike dhe të pakësojë numrin e të papunëve duke gjeneruar inflacion.

II. RREGULLAT PËRBALLË GJYKIMIT

Një çështje e rëndësishme ka të bëjë me faktin nëse banka qendrore, gjatë zbatimit të politikës monetare është e detyruar të ndjekë rregulla fiksë apo ajo është e lirë të përdorë gjykimin. Milton Friedman (1960, faqe 87) thekson se vendimet e politikës monetare i japin efektet e pritura në një periudhë më të vonshme nga ajo e vendimmarrjes "... ka shumë raste që ndryshimet monetare e japin efektin e tyre vetëm pas një vonese të konsiderueshme dhe një periudhe të gjatë kohe dhe, për më tepër, kjo vonesë është vetë variabël".

Meqenëse këto vonesa janë të paparashikueshme nga pikëpamja kohore, është e pamundur të arrish rezultatet e dëshiruara nëpërmjet zbatimit të politikës monetare në një mënyrë arbitrare, thjesht nëpërmjet gjykimit.

Në këtë rast, kur njohuritë rreth mënyrës se si funksionon ekonomia janë jo të plota si dhe kur ekziston rreziku për masa jo të përshtatshme të vendimmarrësve (për shkak të paaftësisë apo të shkaqeve politike), është më mirë që secili specialist të aplikojë një rregull të politikës monetare (për shembull rritja e parasë me një përqindje të caktuar) sesa të mbështetet thjesht në intuitë dhe në gjykim. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet e mundur shmangia e një politike monetare prociklike, ekspansioniste.

Kështu edhe pse jo perfekt, një rregull mund të sjellë më shumë stabilitet se sa një veprim i bazuar mbi gjykimin.

Debati modern mbi këtë çështje përqendrohet mbi problemin e mospërputhjes në kohë. Ky argument mund të ilustrohet me rastin e patentave. Një patentë nxit zhvillimin, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies shoqërore. Edhe pse novacioni mund të ketë ndodhur, mirëqenia shoqërore do të rritet vetëm nëse shkelet e drejta e patentës, shkelje e cila mundëson prodhimin e mallit të patentuar në kushte konkurruese. Për analogji, në rastin e politikës monetare ekziston një motiv nxitës (rritja e prodhimit) për të shkelur, edhe pse përkohësisht, mbi rregullin e stabilitetit të çmimeve dhe për të gjeneruar inflacion të paparashikuar.

Rritjet e papritura të nivelit të çmimeve, për shkak të pranisë së kurbës së Phillips, rrisin aktivitetin ekonomik në terma realë, ekspansion i cili, edhe pse krijon dobishmëri, përsëri vlen të vihet në dyshim pasi kostoja e shkaktuar prej tij është e madhe.

Nga ana tjetër, individët e një ekonomie me racionalitetin e tyre kuptojnë motivet nga shtyhen vendimmarrësit dhe mënyrën se si funksionon ekonomia. Pra, ata kuptojnë se rritja e inflacionit është në shërbim të rritjes së prodhimit dhe në kushtet e ekuilibrit të plotë, inflacioni aktual përshpejtohet në mënyrë korrekte vetëm në terma mesatarë. Kështu, për të maksimizuar pasurinë kombëtare, vendimmarrësit krijojnë inflacion të paparashikuar deri në atë pikë kur kostoja marxhinale e inflacionit barazohet me përfitimin marxhinal të inflacionit të paparashikuar (Barro 1986, faqe 16 - 19).

Në këto rrethana, përqindja ekuilibër e inflacionit është relativisht e lartë, pasi është vetë kostoja e inflacionit. Megjithatë, vendimmarrësit mund të përmirësojnë mirëqenien shoqërore duke u angazhuar se do ta mbajnë inflacionin të ulët. Në qoftë se ky angazhim është i besueshëm, individët do të përshpejtojnë uljen e inflacionit dhe ekuilibri do të përkojë me një përqindje të ulët dhe stabël të inflacionit, por me të njëjtën shumë të inflacionit të papritur në terma mesatarë (zero) si më parë.

Aftësia për të imponuar angazhimin është gjithçka e rëndësishme për të siguruar kredibilitet. Në kushtet e një reputacioni të ulët të vendimmarrësve, individët do të kuptonin se përpjekjet e autoriteteve për të mbajtur inflacionin e ulët do të rezultonin të kota dhe politikat e maksimizimit të pasurisë do të kthenin ekonominë në ekuilibrin e inflacionit të lartë.

Për shkak të vështirësive në marrjen e një angazhimi serioz dhe të besueshëm, janë propozuar alternativa të ndryshme për të vepruar kundër shmangieve inflacioniste në kornizën monetare standarde.

i) Veprimtari bankare e lirë dhe konkurruese. Vetëm konkurrenca do të siguronte që publiku të pranojë vetëm

bankat tregtare që ofrojnë një kthim real konkurrues mbi depozitat.

ii) Kushtetutë monetare, "një regjim i vendosur nga ligji konstitucional i cili mund të ndryshohet vetëm në linjat kryesore me amendamente kushtetuese" Yeager, (1992, faqe 731).

iii) Sigurimi që përfitimet e bankierëve qendrorë, ndoshta financiarisht, të jenë të lidhura me vendosjen dhe me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

iv) Rekrutimi i bankierëve qendrorë konservatorë.

v) Motivimi i bankierëve qendrorë nisur jo nga stimuj të vegjël financiarë, por nga përdorimi i inflacionit si qëllim për t'u arritur.

vi) Lidhja e punës së bankës qendrore me ecurinë e inflacionit. Shumë studiues kanë konkluduar se regjimi i *inflation targeting*[4] është ilaçi më i mirë për të ecur me sukses në dualitetin e sipërpërmendur rregull apo gjykim.

"Duke imponuar një strukturë konceptuale dhe disiplinë të brendshme mbi bankën qendrore, por që sigurisht nuk eliminon gjithë fleksibilitetin, *inflation targeting* kombinon disa nga përparësitë e përcaktuara nga rregullat me disa nga ato që i atribuohen gjykimit" - Bernake, Laubach, Mishkin and Posen (1999, faqe 6).

III. REGJIMET E MBAJTJES SË POLITIKËS MONETARE

Aktualisht, vendimet e politikës monetare marrin jetë nëpërmjet zbatimit të një regjimi të caktuar të ndikimit të tregut. Normalisht, bankat qendrore në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë vetëm një tregues makroekonomik, pikërisht paranë. Por, të mos harrojmë se në shumë raste bankat qendrore kanë dhe ekskluzivitetin e përzgjedhjes së politikës valutore, duke patur kështu një mundësi tjetër për të kontrolluar ekonominë. Sot, gjithnjë e më shumë po bëhet si modë, që bankat qendrore të jenë më të drejtpërdrejta në drejtim të inflacionit të pritshëm dhe kjo mundësohet duke bërë publike shifrën e objektivit të inflacionit në të ardhmen si dhe strategjinë, që banka do të

ndjekë për ta detyruar inflacionin e pritshëm të përputhet me atë, që është vënë objektiv.

Pavarësisht nëse objektiv përfundimtar i politikës monetare do të jetë vetëm stabiliteti i çmimeve apo do të ketë dhe objektiva të tjerë si rritja ekonomike, punësimi, ekuilibri i jashtëm etj., e rëndësishme është të theksohet se suksesi final i politikës monetare arrihet falë regjimit të zgjedhur për mbajtjen e politikës monetare. Ky regjim, në fund të fundit, nënkupton përzgjedhjen e një objektivi të ndërmjetëm, i cili vlerësohet të jetë kontribuesi kryesor në përmbushjen e objektivave finalë. Në ndryshim nga objektivat finalë, objektivat e ndërmjetëm janë variabla makroekonomikë, të cilët, në një mënyrë ose në një tjetër, janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të bankave qendrore si për shembull baza monetare, kursi i këmbimit etj..

Mënyra klasike e kontrollit mbi këta variabla është e thjeshtë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në treg (të parasë, këmbimeve valutore) ku çmimi i vendosur nga banka qendrore bëhet faktor përcaktues në formimin e të gjitha çmimeve të tjera si të huadhënies ashtu dhe atë të shitblerjes së valutave të huaja.

Figurë 3. Roli i përqindjes së interesit në ekonomi.



Skema e mësipërme ilustron në një mënyrë të thjeshtë mënyrën sesi, nëpërmjet manipulimit të përqindjes së interesit, banka qendrore arrin të kontrollojë presionet inflacioniste në ekonomi.

Aktualisht, kontrolli mbi inflacionin sa vjen e bëhet një proces gjithnjë e më i vështirë. Sot inflacioni nuk është thjesht një fenomen, që ka të bëjë me faktin nëse oferta e parasë është rritur apo jo.

Ekzistojnë shumë goditje rastësore, të cilat nga pamundësia për t'u parashikuar kthehen në fenomene, që tentojnë prishjen e ekuilibrave të vendosur në ekonomi. Po kështu, suksesi në vendosjen e kontrollit mbi inflacionin, në masë të madhe, varet dhe nga konsolidimi fiskal, i cili në ekonomitë në tranzicion dhe në ato në zhvillim akoma përbën një sfidë të madhe për autoritetet. Nuk duhet harruar se ekonomi e hapur do të thotë shkëmbim i lirë mallrash, shërbimesh dhe kapitali, që, në një mënyrë ose në një tjetër, do të thotë importim i një sasie të caktuar inflacioni.

Për më tepër në ditët e sotme, globalizimi i tregjeve financiare përveç eliminimit të ndarjeve gjeografike po thith gjithnjë e më shumë kapitale dhe, nga ana tjetër, po e bën gjithnjë e më të vështirë punën e bankave qendrore. Ndërvarësia e madhe midis tregjeve ka bërë që dhe efekti kontaminues të jetë i madh në formën e "efektit domino", gjë që i ka detyruar fuqitë më të mëdha ekonomike t'i kushtojnë shumë kohë përforcimit të rregullave dhe mbikëqyrjes së tyre. Evidencë e qartë e kësaj të fundit janë krizat e ndodhura në rajonin e Azisë dhe në Rusi.

Nën këtë fokus të ri politika monetare duhet të jetë shumë më e kujdesshme, veçanërisht kur ajo duhet të gjykojë për inflacionin në të ardhmen.

Është kjo një nga arsyet, që së bashku, me nevojën për më shumë transparencë kanë bërë shumë të modës regjimin e targetimit të inflacionit ose që më thjesht mund të quhet inflacioni, qëllim për t'u arritur.

Si konkluzion mund të thuhet se ekzistojnë tre regjime të mbajtjes së politikës monetare: regjimi *monetary targeting*, regjimi *exchange-rate targeting* dhe regjimi *inflation targeting*. Zgjedhja e llojit të regjimit të politikës monetare, para së gjithash,

kushtëzohet nga ambienti ekonomik dhe nga natyra e mekanizmit të transmetimit që karakterizon çdo vend të veçantë.

Për shkak se vende të ndryshme përballen me ambiente dhe struktura të ndryshme ekonomike dhe financiare, është e kuptueshme se dhe ankorat e politikës monetare do të jenë të ndryshme në vende të ndryshme.

Siç shkruan dhe Andrew Crockett "një masë, jo në mënyrë të domosdoshme, duhet t'i korrespondojë të gjitha përmasave" (1999, faqe 222).

IV. REGJIMI I TARGETIMIT TË PARASË

Regjimi i targetimit të parasë konsiderohet si më i vlefshëm për të ashtuquajturat ekonomi në emergjencë dhe në tranzicion. Në këto vende, ku kanalet e financës nuk janë të zhvilluara (rast tipik ai i vendit tonë) me anë të vendosjes së objektivave monetarë i shërbehet shumë më mirë kontrollit mbi ekspansionin e kredisë në përgjithësi.

Është fakt se në këto lloje vendesh kanalet e transmetimit të kredisë, nga këndvështrimi i politikës monetare janë nga më të rëndësishmet.

Nga ana tjetër, objektivat e ndërmjetëm monetarë ndihmojnë dhe në vendosjen dhe në ruajtjen e disiplinës së buxhetit. Kjo është një arsye shtesë pse Fondi Monetar, në programet e tij të mbështetjes, imponon kushte për përqindjen e rritjes së parasë dhe të kredisë.

Faktorët e tjerë, që argumentojnë zbatimin e këtij regjimi, kanë të bëjnë me vështirësitë e mëdha, që hasen në adoptimin e dy regjimeve të tjera në ekonomitë në tranzicion.

Regjimi i targetimit të kursit të këmbimit mbart rrezikun e prishjes së ekuilibrit të jashtëm, në rrethanat kur inflacioni i shkaktuar nga brenda vazhdon të jetë jashtë kontrollit.

Ndërkohë, *inflation targeting* mund ta pësojë nga besueshmëria e pakët në një ambient me inflacion të paqëndrueshëm. Kjo do të pengonte arritjen e një objektivi themelor për *inflation targeting*, atë të orientimit të pritjeve të çmimeve të brendshme.

V. REGJIMI I KURSIT TË KËMBIMIT

Edhe pse në shumë raste regjimi i kursit të këmbimit ka çuar në krizë valutore, nuk mund të mohohet fakti se regjimi valutor ku kursi i këmbimit është fiksuar me një monedhë tjetër, ka arritur të frenojë shpërthimet e inflacionit në ekonomi. Mund të thuhet se një kurs këmbimi i varur, i administruar me kujdes mund të përbëjë një kuadër politik shumë të dobishëm për një treg në zhvillim, në një shkallë të caktuar të zhvillimit të tij. Disa vrojtues sugjerojnë që ky regjim mund të jetë instrument i dobishëm i politikës në hapat e parë të paketës së masave antiinflacion, por që me kalimin e kohës duhet të zëvendësohet me një regjim të politikës monetare, që bazohet në instrumente politike të brendshme.

Shpesh, kursi i këmbimit mund të ketë efekte mbi ekonominë. Kjo mund të ndodhë kur një pjesë e madhe e prodhimit të brendshëm është e influencuar nga çmimet ndërkombëtare ose, kur pritjet inflacioniste janë të kushtëzuara nga kursi i këmbimit (këtu mund të futet dhe Shqipëria). Në kushtet kur ndjeshmëria e çmimeve ndaj ndryshimeve politike dhe ekonomike, sidomos në shoqëri me nivel të ulët dhe të mesëm të ardhurash, është e lartë, përpjekjet e vendimmarrësve për të zbutur luhatjet e importuara të çmimeve do të bëhen më të vështira. Fatkeqësisht ata nuk do të jenë të aftë të administrojnë kursin e këmbimit vetëm nëpërmjet uljes ose rritjes së përqindjes së brendshme të interesit. Kjo është një pikë ndryshimi midis këtyre vendeve dhe vendeve të zhvilluara, ku përqindja e brendshme e interesit pasqyron një ndikim të parashikueshëm mbi lëvizjet e kapitalit dhe kursin e këmbimit.

Një pikë tjetër e fundit ka të bëjë dhe me besueshmërinë. Në qoftë se kredibiliteti është i ulët dhe autoritetet janë të pafuqishme

ta vendosin atë, atëherë zgjedhja e këtij regjimi mund të jetë me pasoja negative, që mund të çojnë dhe në prishje të ekuilibrit të jashtëm si dhe mund të jetë pre e spekulimeve.

Në përfundim, është e vështirë të gjykosh saktë mbi përdorimin e kësaj ankore të politikës monetare. "Vështirësia qëndron në një çështje shumë praktike: shumë pak vende kanë arritur të hartojnë një 'strategji të daljes' me sukses nga aplikimi i kursit fiks të këmbimit. Për aq kohë sa sistemi është duke funksionuar në rregull, autoritetet politike nuk gjejnë arsye për ta zëvendësuar atë. Ndërkohë kur monedha gjendet nën presion, autoritetet duke e abandonuar regjimin e kursit të varur të monedhës, nuk duan të thonë se janë të gatshme të pranojnë edhe dështimin e politikës" - Andrew Crockett (1999, faqe 224).

VI. REGJIMI *INFLATION TARGETING*

Inflation targeting është një mënyrë e të mbajturit të politikës monetare nën të cilën vendimet politike ideohen nga raporti midis inflacionit të pritshëm në të ardhmen me një objektiv inflacioni të shpallur që më parë. Në një regjim të *inflation targeting*, autoritetet shpallin objektiv një shifër të vetme ose një interval objektiv (kjo e dyta është më tipike) për inflacionin në të ardhmen (John H. Green, 1996). Në qoftë se në periudhën që pason (1 ose 2 vjet) inflacioni i pritshëm bie jashtë intervalit të shpallur objektiv atëherë diçka nuk shkon me politikën monetare, e për rrjedhim, diçka duhet ndryshuar për të rritur efektivitetin e saj. Nga ky këndvështrim inflacioni i pritshëm nuk është gjë tjetër veçse "një objektiv i ndërmjetëm" i politikës monetare.

Në një regjim të *inflation targeting*, autoriteti monetar (zakonisht banka qendrore) shpall zonën objektiv për inflacionin në përputhje me objektivin final të politikës monetare, atë të stabilitetit të çmimeve. Në praktikë synohet mbajtja e inflacionit të ardhshëm brenda ekstremeve të zonës së shpallur. Mund të qëllojë që për një grup të caktuar fenomenesh rastësore, efekti i të cilave mbi bandë është studiuar dhe shpallur paraprakisht, inflacioni i pritshëm të jetë diçka jashtë intervalit, por gjithsesi

brenda disa hapësirave shtesë, të cilat janë pranuar që më parë. Në këtë mënyrë, shmangiet e parashpallura nxjerrin në evidencë domosdoshmërinë e matjes së inflacionit bazë, një tregues ky, që lë jashtë vëmendjes presionet inflacioniste që janë jashtë kontrollit të politikës monetare.

Një element tjetër i rëndësishëm i regjimit *inflation targeting*, vlerësohet të jetë transparenca në matje, për arsyen e thjeshtë se suksesi i këtij regjimi varet nga fakti nëse agjentët privatë, individët, publiku, në përgjithësi, do të pranojë apo jo objektivin e shpallur zyrtarisht. Ky parim i rëndësishëm i këtij regjimi është i lidhur ngushtë dhe me kredibilitetin e institucionit dhe të politikës së aplikuar. Vetë *inflation targeting* lë hapësira të lira për politikën, të cilat mund ta tundojnë politikën monetare të adoptojë politika ekspansioniste për të mbështetur rritjen e prodhimit në terma afatshkurtër.

E thënë ndryshe, mospërputhjet e dukshme midis *inflation targeting* dhe preferencës për të rritur prodhimin përtej kapaciteteve potenciale, mund të çojnë si në rënien e kredibilitetit ashtu dhe në zbehjen e rolit të tij në ekonomi. Në këtë kontekst, shumica e vendeve, që kanë adoptuar këtë regjim, kanë paraqitur fillimisht masa të forta në shërbim të rritjes së kredibilitetit, përfshirë diskutime të hapura politikash dhe interpretimesh të të dhënave ekonomike.

Një tipar përcaktues i *inflation targeting* është se objektivi i ndërmjetëm, inflacioni i së ardhmes, nuk është një variabël i vrojtuar.

Pra, nga një këndvështrim operacional, *inflation targeting* mund të shikohet si një proces me dy hapa, në të cilin autoriteti monetar pikësëpari bën një parashikim të inflacionit për të vlerësuar nëse nën politikat aktuale, inflacioni do të qëndrojë brenda zonës objektiv apo jo. Hapi i dytë del në skenë në qoftë se pritet që inflacioni i së ardhmes të rezultojë jashtë intervalit kufi.

Në këtë rast, një rregull i mirëpërcaktuar, që lidh procesin vendimmarrës me inflacionin e projektuar duhet të përcaktojë

drejtimin për instrumentet e politikës monetare, që të mundësojnë kanalizimin e inflacionit të projektuar brenda zonës objektiv.

Me përkufizim *inflation targeting* është një politikë monetare afatmesme, që nënkupton pesë elemente kryesore:

1) bërjen publike për një periudhë afatmesme të shifrës së inflacionit si një qëllim për t'u arritur;
2) angazhimin institucional për stabilitetin e çmimeve, si qëllim parësor të politikës monetare, nga i cili varen të gjitha qëllimet e tjera;
3) ndërtimin e një strategjie në të cilën përfshihen shumë variabla, jo vetëm agregatët monetarë apo kurset e këmbimit, të cilët janë përdorur për të përcaktuar kuadrin e politikës së instrumenteve;
4) rritjen e transparencës së strategjisë së politikës monetare, nëpërmjet komunikimit me publikun dhe tregun, për planet, objektivat dhe vendimet e autoriteteve monetare;
5) rritjen e përgjegjësisë së bankës qendrore për të arritur objektivat e saj për inflacionin.

Të pesë elementet e mësipërme janë të rëndësishme, por, pa dyshim, më i spikaturi është domosdoshmëria e shpalljes publike të shifrës së vendosur si objektiv për t'u arritur, për vitin e ardhshëm.

Megjithatë, që të pretendosh se regjimi i adoptuar përkon me një *inflation targeting* është e rëndësishme t'i përmbahesh edhe katër parimeve të tjera. Ky fakt është shumë tregues për vendet në tranzicion ekonomik, sepse mjaft prej tyre e raportojnë objektivin për inflacionin si një rutinë të pjesës së planit ekonomik të qeverisë për vitin e ardhshëm, ndërkohë që strategjia e politikave të tyre monetare akoma nuk karakterizohet si një regjim për arritjen e objektivit të vendosur për inflacionin, i cili kërkon edhe aplikimin e katër elementeve të tjera, si mbështetje përtej periudhave afatmesme.

VII. PËRPARËSITË E *INFLATION TARGETING*

Inflation targeting ka përparësi të shumta, si një strategji afatmesme për politikën monetare.

Në kundërshtim me një regjim të këmbimit valutor të fiksuar, *inflation targeting* i lejon politikës monetare të përqendrohet në situata konkrete dhe t'i përgjigjet efekteve *shock* të ekonomisë së vendit. Në kundërshtim me një politikë monetare, e cila ka si objektiv të ndërmjetëm rritjen e parasë (targetimi monetar), *inflation targeting* ka përparësinë se ekzistenca e një lidhjeje të qëndrueshme ndërmjet parasë dhe inflacionit nuk është faktor kyç në arritjen e suksesit. Kjo strategji nuk varet nga një lidhje e tillë, por në vend të saj, ajo përdor të gjithë informacionin e mundshëm të disponueshëm, për të përcaktuar grupin më të mirë të instrumenteve të politikës monetare. Gjithashtu, *inflation targeting* ka dhe një të mirë tjetër shumë të madhe: ai është i thjeshtë për t'u kuptuar nga publiku dhe njëkohësisht shumë transparent.

Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me një shifër konkrete për inflacionin, rritet llogaridhënia e bankës qendrore ndërkohë që ulet dhe mundësia për të rënë në kurthin e paqëndrueshmërisë kohore.

Paqëndrueshmëria në kohë shfaqet në formën e presioneve politike mbi bankën qendrore, që synojnë ndërmarrjen e politikave monetare ekspansioniste. Në këtë kontekst, *inflation targeting* ka përparësinë e kanalizimit të debatit politik më së shumti në atë se çfarë banka qendrore mund të bëjë për periudha afatgjata për shembull, kontrollin e inflacionit, se sa në atë që ajo nuk mund të bëjë, si, rritja e prodhimit, ulja e papunësisë, rritja e konkurrencave të jashtme.

Për arritjen e suksesit në *inflation targeting*, është shumë e rëndësishme ekzistenca e një angazhimi të fortë institucional ku të cilësohet: ruajtja e stabilitetit të çmimeve si qëllim parësor i bankës qendrore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në vendet me ekonomi tregu në tranzicion që në të shumtën e rasteve,

në të kaluarën e tyre, kanë patur mangësi në administrimin monetar. Angazhimi institucional nënkupton mbështetjen ligjore për një pavarësi të bankës qendrore, e cila duhet të ketë dy karakteristika themelore:

1) veçim i plotë i politikëbërësve të këshillit të bankës qendrore nga politikanët (anëtarë qeverie dhe politikanë të tjerë) për t'u mbrojtur nga arbitrariteti;
2) dhënie e një kontrolli të plotë ekskluziv bankës qendrore, për zgjedhjen dhe përdorimin e grupit të instrumenteve të politikës monetare.

Angazhimi institucional për mbajtjen e stabilitetit të çmimeve kërkon, gjithashtu, që t'i jepet një mandat bankës qendrore ku të specifikohet stabiliteti i çmimeve si qëllimi i saj kryesor. Ky mandat duhet të sqarojë se në raste kundërshtish me objektivat e tjerë për shembull, stabiliteti i kursit të këmbimit ose rritja e punësimit, stabiliteti i çmimeve duhet të ketë përparësi.

Regjimi i *inflation targeting*, thekson nevojën e bërjes sa më transparente të politikës monetare dhe ruajtjen e komunikimit me publikun; në fakt, këto karakteristika kanë qenë në qendër të suksesit të strategjive të ndjekura në vendet e industrializuara. Bankat qendrore nga IT kanë bërë një hap më përpara: ato publikojnë raportin e inflacionit (publikuar për herë të parë nga Banka e Anglisë), i cili është një dokument i shtypur, për të qartësuar pikëpamjet prezente, të kaluara dhe të ardhshme për ecurinë e inflacionit dhe të politikës monetare.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e *inflation targeting* është që me rritjen e transparencës rritet dhe përgjegjësia e bankës qendrore përballë publikut. Suksesi i qëndrueshëm i politikës monetare i matur si arritje e objektivit të shpallur për inflacionin, qoftë dhe në mungesë të standardeve ligjore, të përcaktuara mirë, për ta vlerësuar apo hedhur poshtë atë, do të çonte në krijimin e mbështetjes publike për një bankë qendrore të pavarur.

VIII. MANGËSITE E *INFLATION TARGETING*

Kritikat për *inflation targeting* janë përqendruar në disa drejtime të kësaj strategjie të politikës monetare. Fillimisht do të theksonim se *inflation targeting*, në kushtet kur shpall një shifër të vetme si objektiv për t'u arritur, përbën një regjim shumë strikt dhe për më tepër, në rrethana të caktuara mund të shkaktojë paqëndrueshmëri në prodhim, duke çuar dhe në uljen e rritjes ekonomike.

Këto të meta janë diskutuar nga Mishkin (1999) dhe Bernanke (1999) dhe realisht, nuk përbëjnë probleme serioze për një strategji të targetimit të inflacionit, të hartuar ashtu siç duhet.

Mangësitë më serioze lidhen me adoptimin e këtij regjimi në ekonomitë në tranzicion. Së pari, *inflation targeting* mund të çojë në një dobësim të llogaridhënies së bankës qendrore. Në ekonomitë në tranzicion, përveç vështirësisë në kontrollin e inflacionit ndikimi i instrumenteve monetare bëhet i pranishëm në një periudhë të dytë, relativisht të largët.

Vështirësia e kontrollit të inflacionit është më problematike sidomos në ekonomitë, ku inflacioni ka rënë në nivele shumë të ulëta nga nivele relativisht të larta. Në këto rrethana, parashikimi për inflacionin do të mishërojë gabime të mëdha. Për pasojë, objektivi për inflacionin nuk do të arrihet. Kështu, do të jetë e vështirë për bankën qendrore të fitojë kredibilitetin nga një strategji e tillë dhe aq më tepër për publikun është e pamundur të kuptojë arsyet e këtyre shmangieve.

Sipas disa autorëve, *inflation targeting* gjykohet të jetë një strategji më efektive vetëm në qoftë se aplikohet pas një periudhe relativisht të gjatë disinflacioniste.

Nga ana tjetër, shkalla e bashkërendimit institucional, konsolidimit fiskal dhe rreziku që mbart kursi fleksibël i këmbimit, gjykohet të jenë faktorë të cilët komprometojnë suksesin e një strategjie *inflation targeting*. Një faktor që prek kontrollin e inflacionit dhe që shfaqet më shumë në vendet me

ekonomi në zhvillim, është prania e çmimeve administrativisht të kontrolluara.

Si rezultat, *inflation targeting* mund të kërkojë një nivel të lartë koordinimi ndërmjet autoriteteve monetare dhe fiskale për afatin dhe magnitudën e ndryshimeve të ardhshme në çmimet e kontrolluara ose në mënyrë alternative, përjashtimin e çmimeve të kontrolluara nga indeksi i çmimeve, i cili do të shërbejë si objektiv për inflacionin (rasti i Republikës Çeke).

Inflation targeting nuk është i mjaftueshëm për të garantuar një disiplinë fiskale efikase, për më tepër nuk eliminon aplikimin e politikave fiskale të papërgjegjshme nga qeveritë. Për periudha afatgjata, deficitet e mëdha fiskale të akumuluara, do të çonin në rritjen e inflacionit e, për rrjedhim, do të shkaktonin një dështim të plotë të regjimit të *inflation targeting*.

Eliminimi i shthurjes fiskale është çelësi kryesor i një strategjie të *inflation targeting*. Krijimi i institucioneve, që do të ndihmojnë në vënien nën kontroll të politikës fiskale gjykohet të jetë i një rëndësie themelore në arritjen e suksesit. Po kështu, një sistem financiar solid është një tjetër element i rëndësishëm për suksesin e saj. Sidoqoftë, stabiliteti financiar dhe konsolidimi fiskal përbëjnë themelin e suksesit të çdo strategjie të politikës monetare.

Së fundi, një nivel i lartë i dollarizimit, mund të krijojë problem potencial serioz për *inflation targeting*. Në fakt, në shumë vende në emergjencë ekonomike, bilanci i firmave, individëve dhe i bankave, në të dyja anët e tij (përfshirë edhe borxhin afatgjatë) është i shprehur në dollarë. Për arsye se *inflation targeting* kërkon një kurs këmbimi të luhatshëm, luhatjet e këtij të fundit janë të pashmangshme.

Zhvlerësimet e mëdha dhe abuzive mund të rrisin peshën e borxhit të vlerësuar në dollarë gjë, që do të çonte në një përkeqësim të bilanceve duke rritur rrezikun e krizave financiare.

Pra, sugjerohet që vendet me ekonomi në zhvillim, nuk duhet të injorojnë kursin e këmbimit, kur kërkojnë të aplikojnë një

strategji të *inflation targeting*. Një sugjerim tjetër është se kjo strategji, në ekonomitë pjesërisht të dollarizuara, mund të mos të jetë e qëndrueshme, prandaj duhen ndërmarrë rregullime të kujdesshme për kontrollin e institucioneve financiare, në mënyrë që sistemi të jetë i aftë t'i rezistojë *shock*-eve të kursit të këmbimit.

IX. REGJIMI I *INFLATION TARGETING* NË SHQIPËRI

Prej një periudhe trevjeçare, inflacioni në Shqipëri ka rënë në nivele të ulëta, në kushtet e një rritjeje të lartë ekonomike. Të ardhurat nga privatizimi në vitin 2000 dhe ndihmat e marra në vitin 1999, lehtësuan mjaft detyrën e qeverisë në përballimin e shpenzimeve të buxhetit, duke mbajtur në nivelet e programuara deficitin buxhetor. Megjithë përpjekjet e bëra, niveli i papunësisë vazhdon të mbetet i pandryshuar ndërkohë që niveli i prodhimit të përgjithshëm akoma nuk ka arritur atë të vitit 1989 (viti bazë).

Megjithë arritjet në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik faktorë të tillë, që do të siguronin një stabilitet afatgjatë, vazhdojnë të konsiderohen si faktorë dytësorë e për shumë arsye (objektive dhe subjektive) ata vazhdojnë të anashkalohen.

Ky fenomen vihet re në realizimin e reformave strukturore, të cilat vazhdojnë të karakterizohen nga zvarritje të pajustifikueshme, edhe pse gjatë vitit të fundit u përfundua privatizimi i disa institucioneve dhe enteve të rëndësishme si BKT, AMC, Fabrika e Çimentos, Fabrika e Birrës etj.. Më tej, tregjet vazhdojnë të karakterizohen nga një gjendje amullie e përgjithshme dhe për më shumë, ekonomia që zhvillohet në hije vlerësohet të jetë akoma mbizotëruese.

Kjo hyrje, ndonëse e shkurtër, përbën dhe një pasqyrë të përmbledhur të ambientit të përgjithshëm ekonomik në të cilin autoritetet duhet të vendosin nëse politika monetare duhet të ndryshojë apo jo, natyrisht, në favor të adoptimit të regjimit *inflation targeting*. Për t'i dhënë përgjigje një pyetjeje të tillë,

ndoshta, është i arsyeshëm një kthim i vështrimit mbi politikën e ndjekur gjatë viteve të kaluara si dhe rezultatet e arritura.

X. POLITIKA MONETARE NË DEKADËN E KALUAR

Për herë të parë politika monetare në Shqipëri u ideua dhe u zbatua në mesin e vitit 1992, kur, si pjesë e marrëveshjes së mbështetjes të FMN-së për Shqipërinë, u prezantuan për herë të parë disa vendime, të cilat synonin vendosjen e kontrollit mbi ofertën e parasë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit. Që në ligjin e parë të Bankës së Shqipërisë u cilësua se objektiv kryesor i saj është ruajtja e vlerës së monedhës kombëtare dhe si rrjedhim i saj, do të ishte sigurimi i stabilitetit të çmimeve të konsumit. Në Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 1992, përmendet se objektiv final i politikës monetare është stabiliteti i çmimeve të konsumit, rritja e prodhimit dhe sigurimi i bilancit të plotë në pozicionin e jashtëm të vendit. Si objektiv i ndërmjetëm u zgjodh baza monetare, ndërkohë që si instrumente bazë për kontrollin monetar ishin dy: kufiri i kredisë dhe përqindja e interesit për depozitat me afat në lekë, të vendosura në bankat me kapital shtetëror. Që nga korriku i vitit 1992 (vazhdon akoma dhe në ditët e sotme) u adoptua një regjim "luhatje e lirë" e kursit të këmbimit ndërkohë që, transaksionet në llogarinë korente u liberalizuan plotësisht.

Këto masa, së bashku me adoptimin e një politike fiskale të shtrënguar, liberalizimin e një pjese të madhe të çmimeve të konsumit, çuan në një frenim të menjëhershëm të zhbalancimit të mëtejshëm të ekuilibrit makroekonomik. Inflacioni galopant i viteve 1990 - 1991 filloi të bjerë, shoqëruar me një stopim të rënies së mëtejshme të prodhimit etj.. Konsolidimi makroekonomik i vendit vazhdoi me hapa të shpejtë në vitet 1993 - 1995. Duhet theksuar se ndër faktorët, që ndikuan në arritjen e këtij konsolidimi një vend të veçantë zë dhe politika monetare me vendimet e saj. Rritja e menjëhershme e përqindjes së interesit dhe kontrolli i vendosur mbi kredinë për ekonominë, bënë që të ndalohej hemorragjia e madhe monetare dhe në

fund të vitit 1995, rritja e çmimeve të konsumit të ishte vetëm 6 për qind.

Periudha dyvjeçare në vijim përkon me "lulëzimin" dhe "perëndimin" e firmave piramidale. Përqindjet e larta të firmave "zëvendësuan" totalisht përqindjen e interesit të ofruar nga sistemi bankar e, për rrjedhim, efektiviteti i politikës monetare u reduktua ndjeshëm.

Përqindjet e larta çuan në prurje të mëdha depozitash në sportelet e këtyre firmave, ndërkohë që investimi i tyre në prodhim dhe letra me vlerë ishte minimal krahasuar me shumën e mbledhur.

Për më tepër u vu re fenomeni i riinvestimit jo vetëm të principalit, por edhe të interesave.

Pamundësia e administrimit të depozitave nga ana e firmave bëri që këto të fundit t'i depozitonin ato në llogari rrjedhëse në bankat tregtare, duke iu krijuar atyre rezerva të tepërta në sasi të mëdha, të cilat shkonin direkt në blerje bonosh thesari. Si përfundim, në fund të vitit 1996, inflacioni rezultoi 3 herë më i lartë nga ai i vitit paraardhës duke reflektuar një rritje të madhe të kredisë për qeverinë nga ana e sistemit bankar.

Pasojat e falimentimit të firmave rentiere ishin të gjithanshme dhe, për rrjedhim, ato sollën dhe një faturë të madhe ekonomike. Në fund të vitit 1997, rënia e prodhimit u shoqërua me një përshpejtim të inflacionit, përkeqësim të pozicionit të jashtëm të vendit, dhe me shtim të papunësisë.

Megjithatë, përpjekjet e bëra nga ana e Bankës së Shqipërisë duke rritur përqindjen e interesit në rreth 32 për qind, filluan të jepnin frutin e tyre.

Rezultatet e politikës monetare dhe të asaj fiskale u bënë më të prekshme në fund të vitit 1998, ku si pjesë e Programit të Emergjencës pas Konfliktit nënshkruar me FMN-në, u imponuan disa kufizime sasiore në rritjen e rezervave valutore për neto, në rritjen e kredisë së Bankës së Shqipërisë për qeverinë dhe

në rritjen e kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë. Viti 1999 dhe viti që sapo lamë, regjistruan përqindje të pazakonta inflacioni[5] për një ekonomi si ajo e Shqipërisë. Edhe pse gjatë vitit 1999 Shqipëria u detyrua të përballonte eksodin biblik të popullsisë së Kosovës, përsëri për shumë arsye të shpjeguara dhe më parë, inflacioni mbeti në kuota të ulëta. Nga ky moment e deri në fund të vitit 2000, përqindja e interesit është ulur në mënyrë të vazhdueshme, por, megjithatë, në terma realë ajo ka mbetur shumë e lartë.

Nga ana tjetër, reagimi i tregut nuk ka qenë i menjëhershëm dhe kjo, përveç të tjerash, reflektohet edhe në diferencën e lartë që ka ekzistuar midis përqindjes minimale të interesit për depozitat me përqindjen e *yield*-it të bonove të thesarit. Në këto kushte, duke parë të arsyeshëm eliminimin e kufijve të poshtëm për depozitat me afat në lekë për bankat me kapital shtetëror, Banka e Shqipërisë synoi të shkelë një rrugë të re, atë të kontrollit monetar nëpërmjet tregut.

Duke nxjerrë disa konkluzione të përgjithshme për gjithë periudhën 1992 - 2000, mund të nënvizohet se në përgjithësi, politika monetare është karakterizuar:

- Nga një objektiv final i qartë që është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në çdo vit si pjesë e programeve të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i ekonomisë së vendit, ka pasur objektiva sasiorë për inflacionin në fund të vitit ushtrimor, ndonëse gjykimi i përdorur asnjëherë nuk ka qenë transparent. Megjithatë, rrugët për të arritur këtë stabilitet, në përgjithësi kanë qenë të paqarta. Gjatë gjithë periudhës nuk është zbuluar ndonjë lidhje e fortë midis rritjes së parasë dhe inflacionit. Me përjashtime të rralla niveli i programuar i rritjes së agregatëve monetarë nuk është përputhur me nivelet e faktuara, e megjithatë inflacioni është mbajtur nën kontroll (në shumë raste ndjeshëm poshtë objektivit).
- Nga vendosja e një objektivi të ndërmjetëm për rritjen e parasë. Rritja e parasë është konsideruar nga Banka e Shqipërisë si një objektiv i ndërmjetëm, i cili do të çojë

në përmbushjen e objektivit final. Në fakt, paraja (baza monetare) është nga të vetmit tregues që Banka e Shqipërisë mund ta kontrollojë në mënyrë të plotë. Pavarësisht kësaj, siç u tha më sipër, nuk ka rezultuar që lidhja midis këtij treguesi dhe inflacionit të jetë e fortë, e për rrjedhim të tjerë faktorë, ku mund të veçohet kursi i këmbimit, vlerësohet të jenë përcaktues më të drejtpërdrejtë të sjelljes së presioneve inflacioniste në ekonomi.

- Nga aplikimi i kufizimeve sasiore në krahun e aktiveve. Që në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1992 u vendosën nivele kufi të sipërme dhe të poshtme për gjendjen e treguesve të tillë si: mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë (kufi i poshtëm), mjetet e brendshme neto të sistemit bankar (kufi i sipërm) i ndarë në kredi neto për qeverinë dhe kredi për ekonominë. Të ashtuquajturat kritere të arritjes së suksesit vazhdojnë të përdoren dhe sot, ndonëse diçka më ndryshe nga vitet e para të tranzicionit. Pa u ndalur konkretisht në llojin e atyre që përdoren aktualisht, do të theksonim se, të paktën për periudhën 1998 - 2000, të tre objektivat sasiorë janë realizuar shumë brenda kufijve të vendosur, ndërkohë që realizimi faktik i treguesve monetarë sidomos rezervës së parasë dhe agregatëve monetarë është larg nivelit të programuar të tyre.
- Nga një kontroll i parasë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Vetëm tremujorin e tretë të vitit 2000, u hoq dorë në mënyrë përfundimtare nga aplikimi i instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar, kur vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nxori "jashtë loje" nivelin minimal të përqindjes së interesit për depozitat me afat në lekë, të vendosura në bankat e nivelit të dytë me kapital shtetëror. Ndërkohë, kufizimet në akordimin e kredisë së re ishin hequr në një fazë më të hershme.
- Nga një paqartësi dhe eficiencë e ulët e mekanizmit të transmetimit monetar. Nga tremujori i tretë i vitit 2000, Banka e Shqipërisë filloi të kontrollojë ofertën e parasë, nëpërmjet aplikimit të instrumenteve të tërthorta, ku vendin kryesor e zënë ankandet e repove në tregun e parasë. Në të vërtetë, historia e aplikimit të instrumenteve jo të drejtpërdrejta është më e hershme, që nga mesi i vitit 1992.

Pavarësisht kësaj, duhet theksuar se efektiviteti i tyre ka qenë i ulët dhe në të gjitha rastet kryesisht vendimet janë transmetuar nëpërmjet përqindjes administrative të interesit. Kjo është e vërtetë për aq kohë sa është tentuar të frenohet rritja e mëtejshme e inflacionit, sepse në periudhat e tjera, kur është tentuar zbutja e politikës monetare edhe kjo masë ka rezultuar jo shumë e efektshme. Parë nga ky këndvështrim, me të drejtë mund të shtrohet pyetja: a do të jetë përqindja e repove e aftë të përçojë vendimet e Bankës së Shqipërisë në ekonomi? Përgjigjja e kësaj pyetjeje është relativisht e vështirë. Tregu monetar, megjithë, përpjekjet e Bankës së Shqipërisë, është akoma një treg i pazhvilluar, jofleksibël, i përqendruar etj.. Numri i transaksioneve në të është ende i vogël, ku njëra palë, në shumicën e rasteve, është Banka e Kursimeve dhe vëllimi i transaksioneve të realizuara nuk është ndonjë shumë e rëndësishme. Në fakt, prej shumë vitesh, "gllabërues" i rezervave të tepërta ka qenë vazhdimisht buxheti i shtetit.

Kufizimet e mbikëqyrjes bankare kanë penguar bankat me kapacitete të mëdha kreditimi (BKT dhe BK) të financojnë ekonominë e për rrjedhim, të gjitha rezervat e tyre të tepërta janë shndërruar në shpenzime buxhetore.

Kjo situatë ka bërë që dhe tregu i emetimit të bonove të thesarit të jetë një treg i sunduar nga Banka e Kursimeve, gjë që është reflektuar në ruajtjen e një diference relativisht të lartë midis *yield*-it të bonove dhe kostos së bankave. Edhe pse ka disa kohë që tregu rregullohet nëpërmjet shitblerjes së repove është e paqartë nëse ekziston ndonjë nivel optimal për gjendjen e rezervave të tepërta në sistem.

- Nga një gjendje e lartë e kredisë për qeverinë. Fillimisht në formë të drejtpërdrejtë e më pas me anë të emetimit të bonove të thesarit u arrit që pjesa dërrmuese e borxhit të qeverisë të blihet nga sistemi bankar. Në këtë mënyrë, buxheti u shndërrua në "konsumatorin" më të madh të parasë. Sipas të gjitha shenjave, skenari i emetimit të bonove dhe blerjes së tyre nga bankat (më së shumti nga Banka e Kursimeve) ka gjasa të ndodhë edhe gjatë vitit 2001, dhe duket se

përqindja bazë e interesit në lekë do të jetë përqindja e *yield*-it të bonove të thesarit me maturim dymbëdhjetëmujor.

Një ulje e kërkesës për para nga ana e buxhetit do të ulte *yield*-in e bonove dhe anasjelltas, një rritje e kërkesës për para nga ana e qeverisë do të rriste *yield*-in e bonove, pavarësisht faktit nëse Banka e Shqipërisë do të ulë apo do të rrisë përqindjen e repove në tregun e parasë. Ndryshimi i përqindjes së interesit nga banka qendrore, mishërimin e tij në treg e gjen në ndryshimin me kahje të njëjtë të përqindjes së kredive, të investimit në letra me vlerë, të çmimit të aktiveve fikse, të pritjeve në përgjithësi etj..

Në rastin e vendit tonë kur ekziston një treg ndërbankar i pazhvilluar, një treg primar bonosh thesari shumë i përqendruar dhe një treg formal kredish ku huazohet më shumë monedhë e huaj, kuptohet që sinjalet e bankës qendrore vështirë të depërtojnë në "terren" e, për rrjedhim dhe eficienca mbetet në nivele modeste.

XI. A ËSHTË KOHA PËR TË ADOPTUAR *INFLATION TARGETING* NË SHQIPËRI?

Në përgjigje të pyetjes së mësipërme mund të thuhet se *inflation targeting* është një strategji e suksesshme kur ajo, nga njëra anë gjen një terren të shëndoshë makroekonomik dhe institucional dhe, nga ana tjetër, vihet përballë një auditori (agjentët ekonomikë, individët, publiku në përgjithësi) i cili e kupton dhe e mirëpret atë.

Kohët e fundit një nga shprehjet më të përdorura është ajo, që citon konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik. Në fakt, kjo shprehje ndeshet më shumë në prezantimet zyrtare (përfshirë dhe FMN-në) ndërkohë që analistë të tjerë flasin për arritje dhe mosrealizime, si dhe për një amulli të madhe të shkaktuar nga të dhënat ekzistuese. Shumë dyshime, edhe nga vetë Banka e Shqipërisë, janë ngritur mbi të dhënat se si matet inflacioni.

Duke u ndalur në secilin nga aspektet e sipërpërmendura do të fillonim me:

XI.1 ASPEKTI MAKROEKONOMIK

XI.1.1 Inflacioni

Në përgjithësi, literatura rekomandon se një periudhë 2 - 3 - vjeçare me inflacion të ulët duhet t'i paraprijë adoptimit të regjimit të *inflation targeting*, ku normë e ulët konsiderohet një normë inflacioni që luhatet nga 1- 3 për qind. Aktualisht, inflacioni është në nivele shumë të ulëta, duke rezultuar për të tretin vit rradhazi poshtë objektivit të shpallur (grafiku 1). Në tërësi, gjatë viteve të fundit, tendenca ka qenë ulja e normës së inflacionit.

Megjithatë, në vite të ndryshme ka qenë i pranishëm faktori *shock* si për norma të larta inflacioni ashtu dhe për norma të ulëta. Mesatarisht, norma vjetore e inflacionit për periudhën janar 1993 - nëntor 2000 ka qenë 26,2 për qind, ndërkohë që vetëm për tre vitet e fundit janar 1998 - nëntor 2000 ka qenë 7,4 për qind. Po të hedhim një shikim më të hollësishëm në secilin nga vitet e periudhës së fundit, në mënyrë respektive për vitin 1998, 1999 dhe 2000 do të kishim 21,6 për qind, 0,4 për qind dhe - 0,2 për qind.

Grafik 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
(ndryshimi 12-mujor në përqindje).
(Për dhjetorin 2000, është supozuar një rritje e çmimeve në masën 2,5%)



Duke parë grafikun 1 bie në sy se inflacioni i faktuar, me përjashtim të vitit 1996, në të gjitha rastet e tjera ka qenë më i

ulët se inflacioni objektiv, ndërkohë që në disa vite, përfshirë dhe vitin 1999, ka qenë shumë larg inflacionit objektiv. Fenomen i njëjtë, por me kahje të kundërt ka ndodhur dhe me rritjen e ofertës së parasë (matur me anë të agregatit monetar M_3). Kjo gjë demonstrohet në grafikun numër 2, ku vihet re se në të gjitha rastet rritja e faktuar e agregatit M_3 është më e madhe se niveli i programuar.

Parë nga një këndvështrim teorik dy grafikët paraqesin një lloj paradoksi: rritja më e madhe e ofertës së parasë se niveli i programuar ka çuar në një ulje të inflacionit poshtë objektivit?!

Ky lloj paradoksi nxjerr edhe një herë në evidencë pyetjen nëse është real inflacioni i shpallur apo në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës hartuesit e programit kanë gabuar? Në fakt, studiuesit (Hadëri dhe Mytkolli; Kunst dhe Luniku 1998) kanë arritur në përfundimin se lidhja midis parasë dhe inflacionit është e dobët dhe të tjerë faktorë mendohet se e ndikojnë inflacionin më fuqishëm. Gjetja e përgjigjes së pyetjeve të mësipërme, në të vërtetë, është pjesë integrale e një strategjie të hartuar mbi parimet e *inflation targeting*. Për rrjedhim, mbështetur në ecurinë e deritanishme të inflacionit, megjithëse ai ka vetëm dy vjet që endet në nivele shumë të ulëta, gjykuar nga ky tregues mund të thuhet se ekzistojnë premisat që të aplikohet një regjim i *inflation targeting*.

Grafik 2. Rritja e ofertës së parasë
(ndryshimi 12-mujor në përqindje).
(Matja faktike për vitin 2000 i takon muajit nëntor)



XI.1.2 Kursi i këmbimit

Regjimi i kursit të këmbimit është një ndër pikat e tjera të forta në adoptimin e *inflation targeting*. Në rastin e vendit tonë është fat që Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimet, që zgjedhin dhe administrojnë llojin e politikës valutore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Për më tepër, që nga viti 1992, Banka e Shqipërisë ka zgjedhur një regjim këmbimesh valutore *free float*, ku si tipar kryesor është përcaktimi i çmimit të monedhës në bazë të kërkesë - ofertës. Aplikimi i këtij regjimi është një nga kriteret, që kërkon aplikimi i targetimit të inflacionit e për rrjedhim, mund të themi se edhe ky tregues përbën një pikë të fortë mbështetjeje, për fillimin e zbatimit të regjimit *inflation targeting*.

XI.1.3 Konsolidimi fiskal

Vitet e fundit kanë shënuar hapa të rëndësishëm edhe në drejtim të konsolidimit fiskal. Është fakt se si në vitin 1999 ashtu dhe në vitin 2000, buxheti i shtetit pati "fatin'' të përfitojë të ardhura të konsiderueshme në valutë (në formën e ndihmave dhe të të ardhurave për privatizimin) dhe sipas parashikimeve për vitin 2001, përsëri buxhetit do të vazhdojnë t'i grumbullohen të ardhura në valutë nga privatizimi.

Këto të ardhura kanë zbutur ndjeshëm presionin e politikës fiskale mbi atë monetare, e për rrjedhim, sistemi bankar nuk është vënë përpara vështirësish për likuiditete, ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka respektuar kufijtë që përcakton ligji në financimin e deficitit buxhetor.

Megjithatë, nuk mund të flitet ende për konsolidim dhe stabilitet fiskal. Për këtë gjykim nisemi nga struktura e të ardhurave të buxhetit (pjesë të konsiderueshme kanë ende të ardhurat nga doganat), niveli i lartë i evazionit fiskal dhe praktikat disi arbitrare, në grumbullimin e tatimeve dhe në aplikimin e çmimeve të referencës. Nga ana tjetër, autoriteti fiskal nuk ka adoptuar shkallën e duhur të transparencës. Kjo do të thotë që efektiviteti i përdorimit të të ardhurave buxhetore nuk është plotësisht i qartë.

Së fundi, niveli i ulët i mirëqenies në Shqipëri (renditet vendi i katërt më i varfër në Evropë), papunësia e lartë si dhe praktikat jo të mira në administrimin e të ardhurave buxhetore janë faktorë, që do të ushtrojnë presion të fortë mbi autoritetet për ekspansion buxhetor dhe për dobësim të pozicionit dhe të stabilitetit fiskal.

Parë nga ky këndvështrim, duke ditur dhe vështirësitë në veçimin e asaj pjese të inflacionit, që shkaktohet nga politika fiskale, mund të thuhet se për aq kohë sa tregu i bonove do të jetë i vetmi treg letrash me vlerë në Shqipëri, për aq kohë sa nuk do të ndalohet me ligj huamarrja e qeverisë nga Banka e Shqipërisë, për aq kohë sa nuk do të ketë një angazhim të plotë dhe të besueshëm nga të gjitha forcat politike për një administrim rigoroz dhe transparent të të ardhurave fiskale etj., është i vështirë aplikimi i suksesshëm i regjimit *inflation targeting*.

XI.1.4 Stabiliteti financiar

Nëse nisemi nga krizat e sistemit financiar, Shqipëria nuk ka kaluar të tilla. Kjo qëndron për atë pjesë të ekonomisë, e cila ndryshe quhet dhe ekonomi formale. Në Shqipëri, *de facto*, me gjithë krijimin e dy instituteve të reja të sigurimit, sistemi financiar mund të identifikohet me atë bankar. Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se kriza e vitit 1997, megjithëse nuk u shkaktua nga sistemi bankar, përsëri kishte në bazë një fenomen tipik financiar, pasojat e të cilit ishin të pallogaritshme mbi treguesit kryesorë makroekonomikë, prodhim, inflacion, papunësi, bilanc pagesash etj..

Nga sa më sipër mund të ngrihet pyetja: cili është sistemi imunitar i Shqipërisë ndaj krizave financiare?

Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, që janë bërë në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes bankare, ende sistemi bankar është i pazhvilluar dhe ofron shkallë të ulët ndërmjetësimi. Ai paraqitet shumë i përqendruar dhe operon në kushtet e ekzistencës së një niveli të lartë të rrezikut (i gjithë spektri që nga ai politik e deri

tek ai operacional), kuadri rregullativ nuk është i plotë dhe ka difekte në zbatimin e rregullave etj..

Nga ana tjetër, tregjet dhe institucionet e tjera financiare janë akoma në nivele foshnjore dhe shkalla e ekspozimit është e lartë. Ekonomia informale vazhdon të jetë e pranishme dhe, me gjithë eksperiencën e hidhur, përsëri ka të dhëna se vazhdon huamarrja ndonëse me përmasa më të vogla. Siç vihet re, sistemi mbrojtës i Shqipërisë ndaj krizave financiare ka probleme të shumta, të cilat edhe pse njihen prej kohësh nuk po arrijnë të eliminohen. Ky imunizim i dobët, bën që ekonomia shqiptare të ketë shkallë të lartë ekspozimi, e, për rrjedhim, një kusht shumë i rëndësishëm i *inflation targeting* mbetet pa u plotësuar.

XI.2 Aspekti institucional

Ndërkohë që në aspektin makroekonomik ekzistojnë faktorë, që të shtyjnë të zgjedhësh *inflation targeting* si regjim të politikës monetare, në aspektin institucional gjykohet se më tepër peshë kanë pikat e dobëta të tij.

XI.2.1 Pavarësia e bankës qendrore

Ligji ofron një pozicion të pavarur, por në realitet, pavarësia e bankës është larg asaj ligjore dhe nën kërcënim. Autoritetet e tjera nuk duket të kenë prirje për të respektuar pavarësinë e bankës qendrore. Nga ana tjetër, nuk ka garanci të mjaftueshme se pavarësia e shprehur në ligjin ekzistues (tërësisht apo elemente të veçanta të saj) nuk do të jetë subjekt i ndryshimeve të mëvonshme.

XI.2.2 Transparenca e bankës qendrore

Banka e Shqipërisë është e angazhuar për rritjen e transparencës, por vlerësohet se është ende larg standardeve. Banka e Shqipërisë nuk është ende transparente në thelbin e saj: shpjegimin e procesit vendimmarrës, sidomos për çështje të politikës monetare.

XI.2.3 Besueshmëria e bankës qendrore

Nuk mund të thuhet se Banka e Shqipërisë ka fituar besueshmëri në publik. Duhet kuptuar se publiku shqiptar në fillim ka patur nevojë të dijë se ekziston një bankë qendrore që quhet Banka e Shqipërisë. Nga ana tjetër, sigurimi i kredibilitetit do të jetë i vështirë në përgjithësi, dhe akoma më i vështirë në kushtet e adoptimit të *inflation targeting*. Në Shqipëri, ku inflacioni ndikohet mjaft nga faktorët *shock* dhe ata spekulativë, mundësia e devijimit nga objektivi është e lartë.

XI.2.4 Përgjegjshmëria e bankës qendrore

Banka e Shqipërisë me ligj, gjithashtu, ka një nivel të konsiderueshëm përgjegjshmërie të matur me detyrimet për raportim. Por, në realitet, vlerësohet se përgjegjshmëria duhet rritur. Banka e Shqipërisë është angazhuar në respektimin e të gjitha detyrimeve për raportim, por cilësia e këtij raportimi është subjekt përmirësimi gjë që pritet të rrisë përgjegjshmërinë reale të saj.

XI.2.5 Marrëdhëniet jo të mira me autoritetin fiskal

Niveli i koordinimit midis autoritetit monetar dhe atij fiskal nuk është në nivelin që kërkon regjimi i *inflation targeting*. Në praktikë kjo mungesë koordinimi pengon Bankën e Shqipërisë në zbatimin me efikasitet të instrumenteve për arritjen e politikës monetare.

Pra, në tërësi, aspekti institucional konsiderohet si një pikë e dobët për adoptimin e regjimit *inflation targeting*.

XI.2.6 Shkalla e kuptimit nga publiku

Leksionet e para praktike mbi atë se çfarë është inflacioni, shqiptarët i morën në fillim të viteve '90. Me kalimin e viteve, pak a shumë, kushdo e kuptoi se rritja e çmimeve gërryen të ardhurat dhe kursimet e tyre, por shumë pak e kuptojnë se misioni i vështirë i mbajtjes së tyre stabël i përket një institucioni, që quhet Banka e Shqipërisë.

Në fakt, shqiptarët kuptuan një gjë që "për të gëzuar nesër, sot duhet të shtrëngojnë rripin", një apel i bërë nga të dyja forcat kryesore politike në kohën e ardhjes së tyre në pushtet.

Pavarësisht kësaj, ata nuk arritën të kuptojnë mekanizmin, që të çon nga e sotmja e shkatërruar në një të ardhme më të pasur dhe më të sigurtë. Për këtë ka ndihmuar dhe zgjatja e pambarimtë e periudhës tranzitore dhe e dështimeve të shumta gjatë saj (kryesisht për arsye subjektive).

Një numër i kufizuar njerëzish, janë të aftë të shpjegojnë se pse nevojiten reforma të thella, ndërkohë që një pjesë tjetër gjendet në pozitat e të zhgënjyerit dhe shumica me indiferencën e saj, i pranon ato siç i jepen.

Në këtë prizëm është e vështirë të besohet se Banka e Shqipërisë do të gjejë "partnerë" të denjë në krahun tjetër, për të kuptuar dhe për të interpretuar drejt vendimet e saj. Në rastin kur publiku kupton dhe e mirëpret politikën e bankës qendrore, ai vetë me pritjet e tij për inflacionin (të orientuara nga objektivi i vënë për inflacionin) shndërrohet në një lloj faktori për përcaktimin e inflacionit të së ardhmes.

Në fakt, ndërgjegjësimi i publikut, familjarizimi i tij me politikat, bankingun etj., përmirësimi i kuadrit institucional në përgjithësi, është një detyrë e momentit, e cila nuk ka nevojë për të pritur për kompletimin e kushteve të tjera paraprake. Disa nga rrugët ku duhet punuar, do të identifikoheshin si më poshtë:

1. Angazhimi për rritjen e transparencës së Bankës së Shqipërisë. Për këtë qëllim ky institucion, ka shtuar numrin e publikimeve, sidomos publikimeve shpjeguese, paraqitjen në media, kontaktet me publikun, organizimin e takimeve e seminareve, ka miratuar strategjinë dhe një rregullore për transparencën.
2. Angazhimi për përmirësimin e marrëdhënieve me institucionet e tjera shtetërore. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë, ka adoptuar një qëndrim më intensiv në të gjithë organizmat ndërinstitucionalë (integrimi në BE,

Pakti i Stabilitetit, diskutimin e dokumenteve si strategjia e zhvillimit të SME-eve). Më e spikatur është veprimtaria në kuadrin e komitetit të borxhit.

3. Angazhimi për rritjen e përgjegjshmërisë. Banka ka shtuar kontaktet dhe raportimet në Kuvend duke u munduar të rrisë nivelin e shpjegimit për vendimet e marra.
4. Angazhimi për rritjen e kredibilitetit. Përveç realizimit të objektivave dhe shpalljes së këtij fakti, Banka e Shqipërisë po përpiqet të fitojë publikun dhe të vendosë komunikim të rregullt me të. Banka po organizon fushata (për kreditimin); po afrohet me biznesin për të kuptuar pritshmëritë e tij etj..
5. Angazhimi për të realizuar edukimin. Edukimi përfshin vetë Bankën e Shqipërisë, të autoriteteve të tjera dhe të publikut. Për këtë, Banka ka ofruar dhe mbështetjen financiare.
6. Angazhimi në rritjen e pavarësisë së bankës qendrore.
7. Angazhimi në çështje të tjera, që nuk janë drejtpërdrejt detyrë e Bankës së Shqipërisë, por që ndikojnë në krijimin e parakushteve për adoptimin e *inflation targeting*. Si të tillë përmendim angazhimin në projektet për përmirësimin e statistikave. Mbi këtë bazë, Banka e Shqipërisë ka mundësi të realizojë ndërtimin e modeleve për analizimin dhe parashikimin e inflacionit dhe të përsosjes së mekanizmit të transmetimit.

Plotësimi i secilit prej kushteve të mësipërme ose përmirësimi i tyre, kërkon një periudhë kohe 2 - 3-vjeçare, ndoshta dhe më shumë. Ky interval kohe, para së gjithash, përcaktohet bazuar në paqartësinë e Bankës së Shqipërisë mbi angazhimin e autoriteteve të tjera për këtë regjim, mbi reagimin e publikut; në nevojën për ndërtimin e një modeli makroekonomik (përfshirë dhe një periudhë testimi); në rritjen e eficiencës të tregut financiar, zgjerimin e tij nëpërmjet thithjes së aktiviteteve joformale, forcimin e mbikëqyrjes bankare etj.; në përsosjen e mëtejshme të tregut të parasë në mënyrë që të zotërohet një instrument efikas kontrolli mbi paranë etj..

SHËNIME

* Gramoz Kolasi, Nëndrejtor, Departamenti i Kërkimeve.

[1] Konkluzionet e arritura janë publikuar nga një grup studiuesish anglezë, në botimin e tyre "Monetary Policy Frameworks in a Global Context" - Maxwell Fry, DeAnne Julius. Lahavan Mahadeva, Sandra Roger and Gabriel Sterne-1999.

[2] Vrojtimi është kryer nga Banka e Anglisë nëpërmjet një pyetësori të shpërndarë në 77 vende të ndryshme të botës, ku hyjnë vendet më të industrializuara, shumë vende në tranzicion si dhe një numër i madh i ekonomive në zhvillim. Rezultatet e këtij anketimi janë bërë publike në botimin: 'Monetary Policy Frameworks in a Global Context' - Maxwell Fry, DeAnne Julius, Lahavan Mahadeva, Sandra Roger and Gabriel Sterne -1999.

[3] Duke filluar që nga tremujori i tretë i vitit 2000, Banka e Shqipërisë nuk përdor më asnjë lloj instrumenti të kontrollit të drejtpërdrejtë mbi ofertën e parasë.

[4] Një lloj politike monetare ku objektiv i ndërmjetëm është vetë inflacioni. Ky term është përdorur në anglisht për faktin se akoma nuk ka një shqipërim zyrtar nga ana e Bankës së Shqipërisë.

[5] Materiali është përgatitur përpara bërjes publike të shifrës së inflacionit për fundin e vitit 2000, e, për rrjedhim, ai i referohet të dhënave të muajit nëntor. Megjithatë shifra e dhjetorit 2000, është një argument më shumë në kujdesin që duhet treguar në adoptimin e inflation targeting.

BIBLIOGRAFI

Alan Blinder (1998), Central Banking in Theory and in Practice, Cambridge, Massachusetts: MIT Press.

Barro R. (1995), "Inflation and economic growth", Bank of England Quarterly Buletin, May.

Barro R. (1986), "Rules versus discretion", in Alternative Monetary Regimes, Campbell, C. D. and Dougan, w. R. (eds) Baltimore: John Hopkins University Press.

Bernake B., Laubach T., Mishkin F. and Posen A. (1999), Inflation Targeting: Lessons from the International Experience, Princeton, New Jersey: Princeton University Press.

Crockett A. (1999), "Monetary policy objectives in light of Asian crisis", Monetary Policy Frameworks in a Global Context, p 222.

Fischer I. (1922), The Purchasing Power of Money, MacMillan.

Fisher S. (1994), "The role of macroeconomics factors in growth", Journal of Monetary Economics, Vol. 32, pp 485 - 512.

Friedman M.(1 960), A Programme for Monetary Stability, New York: Fordham University Press.

Green J. (1976), "Inflation targeting: Theory and policy implications", IMF Staff Papers, Vol. 43, No. 4, December 1996.

H. Mytkolli, S. Hadëri "Inflacioni në Shqipëri - Burimet, prirjet aktuale dhe ato të perspektivës. Ekonomia dhe Biznesi, Buletini Nr.4, Fakulteti Ekonomik.

Kunst R., Luniku R. (1998), "Inflation, its dynamics and its possible causes in Albania", Institute for Advanced Studies, Vienna, WP, No. 57.

Okun A.M. (1962), "Potential GNP: its measurement and significance", Proceedings of the Bussines and Economics Statistics Section of the American Statistical Association, pp. 98 - 104.

Phillips A.M. (1958), "The relation between unemployment and the rate

of change of money wage rates in the UK, 1861 - 1957", Economica, Vol. 25.

Radcliffe Report (1959), Report of the Committee on the working of the Monetary System, London: Her Majesty'SPB Stationery Office.

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, 1992 - 1999.

Samuelson P.A. and Robert M.S. (1960), "Analytical aspects of anti-inflation policy", American Economic Review, Vol. 50, No. 2, May 1960, pp. 1 -17.

Botuar nga Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: 355-4-222230; 235568; 235569
Faks: 355-4-223558
public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 800 kopje